

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE
DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË

Turizmi kulturor si mundësi për një zhvillim të qëndrueshëm në rajonin e Korçës

Përgatiti
Alket Dino

Për marrjen e gradës:
Doktor i shkencave në Sociologji

Udhëheqës: Prof.Dr Fatos Tarifa

Tiranë, 2018

**TURIZMI KULTUROR SI MUNDËSI PËR NJË
ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM NË RAJONIN E
KORÇËS**

Alket Dino

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca Sociale, me
profil Sociologji-Antropologji , për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor : Prof.Dr Fatos Tarifa

Numri i fjalëvë:59512

Tiranë, Prill 2018

Studimi i mëposhtëm është punë kërkimore origjinale. Çdo material i përdorur është cituar në referencat.

Studenti:

Pedagogu:



Abstrakt

Sot në të gjithë botën flitet gjithnjë e më shumë për zhvillimin ekonomik të vendeve në zhvillim. Një ndër degët e sukseshme të ekonomisë së këtyre vendeve është turizmi. Bazuar në studimin sociogjeografik të Shqipërisë në përgjithësi dhe të rajonit të Korçës në veçanti, lind nevoja e një studimi shkencor të orientuar të këtij atraksioni ekonomik e kulturor në këtë rajon, të dobishëm e fitimprurës për ekonominë rajonale në veçanti dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë shqiptare në përgjithësi.

Ky studim evidenton instrumentet dhe mënyrën e studimit të zonave turistike për t'i kthyer ato në qendra të rëndësishme ekonomike për vetë rajonin dhe për ekonominë kombëtare.

Probemit mund të shtrohet në këtë menyrë: Sot në Shqipëri ndihet nevoja e studimeve serioze mbi zhvillimin e qëndrueshëm sidomos në fushat e sociologjisë së turizmit, studime të cilat kanë munguar deri me sot, por që janë shumë të rëndësishme për zhvillimet ekonomike e shoqërore të vendit. Ka burime natyrore, burime njerëzore, kapital dhe iniciativë sipërmarrjeje të cilat duhen njohur, vlerësuar, orientuar dhe nxitur me qëllim që të rriten investimet në turizmin rajonal e kombëtar. Por ka edhe mungesë të ndjeshme të njohurive mbi instrumentet që duhen përdorur nga këta sipërmarrës për të qënë pjesë e suksesit dhe jo e dështimit, siç ka ndodhur në disa raste për ata që kanë guxuar të investojnë në këtë sektor të rëndësishëm të ekonomisë e kulturës kombëtare.

Në kuadër të këtij studimi turizmi, konsiderohet i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm në rajonin e Korçës. Larmia e monumenteve të kulturës, traditat kulturore dhe mikpritja tradicionale, përbëjnë një tërheqje të fortë për turistët vendas dhe të huaj.

Objekti i këtij studimi është prezantimi i potenciali turistik për zhvillimin e qëndrueshëm të qarkut Korçë për ti shërbyer promovimit të tij, si dhe ngritjes së infrastrukturës turistike përkatëse që do të ndikojë fuqishëm në rritjen e interesimit të turistëve për të vizituar qarkun dhe për rrjedhojë në zhvillimin e qëndrueshëm të kësaj zone juglindore të vendit.

MIRËNJOHJE

Realizimi i kësaj detyre të rëndësishme është bërë i mundur nëpërmjet ndihmës, inkurajimit dhe mbështetjes së shumë individëve të cilët dua t'i falenderoj.

Falenderoj në radhë të parë pedagogun udhëheqës, Prof. Dr. Fatos Tarifa, për mbështetjen dhe sugjerimet që më ka bërë lidhur me studimin.

U jam mirënjohës individëve pjesëmarrës në këtë studim për përkushtimin dhe kohën e shpenzuar për plotësimin e pyetësorëve.

Falenderoj të gjithë ata individë që më kanë dhënë mbështetje teknike gjatë realizimit të kësaj detyre, në vecanti kolegët e Universitetit "Fan.S.Noli" të Korçës.

Një falenderim të veçantë për familjen dhe miqtë e mij, të cilët më kanë inkurajuar dhe mbështetur në shumë mënyra përgjatë punimeve të këtij studimi.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË.....	1
Tiranë, 2017	1
Abstrakt	4
MIRËNJOHJE.....	5
KAPITULLI I: HYRJE.....	1
1.1 Zhvillimi turizmit kulturor në qarkun e Korçës.....	3
1.2 Ndikimi i turizmit kulturor në zhvillimin social-ekonomik të qarkut Korçë	8
1.2.1 Turizmi si strukturë e kapitalizmit.....	10
1.2.2 Idetë e para rreth turizmit.....	11
1.2.3 Dobia e propozimit.....	17
1.2.4 Konstruksioni shoqëror i kohës së lirë.....	24
1.2.5 Nga udhëtari tek turisti.....	26
1.3 Qëllimi dhe objektivat e studimit	28
1.5 Organizimi i studimit	30
KAPITULLI II: SKELETI TEORIK	33
2.1 Koncepte dhe përkufizime mbi zhvillimin e qëndrueshëm dhe turizmin	33
2.2 Kultura dhe trashëgimia kulturore	34
2.3 Kultura dhe zhvillimi	37
2.4 Vlerësimi i trashëgimisë kulturore si pjesë e zhvillimit të qëndrueshëm.....	39
2.5 Vlerësimi gjeografik dhe social – ekonomik i qarkut Korçë.....	41
2.6 Potenciali natyror i qarkut Korçë.....	41
2.6.2. Kushtet natyrore	42
Relievi	42
Klima	43
Pasuritë ujore.....	43
Tokat.....	45
Biodiversiteti	46
2.6.3. Organizimi administrativ dhe hapësinor i qarkut Korçë	47
2.6.4 Potenciali human i qarkut Korçë.....	50
Tabelë – Ecuria e numrit të popullsisë gjatë periudhës 2001-2013.....	51
Grafiku – Ecuria e numrit të popullsisë (1989-2013).....	52

Grafiku – Raporti meshkuj-femra në qarkun e Korçës (2001-2013).....	53
Meshkuj Femra	53
2.7. Zhvillimi social-ekonomik i qarkut Korçë	55
2.7.2. Zhvillimi social-ekonomik pas vitit 1990	58
KAPITULLI III: TRASHËGIMIA KULTURORE MATERIALE E SHPIRTËRORE SI POTENCIAL ZHVILLIMOR.....	63
3.1 Trashëgimia kulturore materiale	63
3.1.1 Vlerat e trashëgimisë kulturore materiale	63
3.1.2 Monumente arkeologjike	64
3.1.3 Vendbanimet (kalatë, kështjellat, shpellat).....	64
3.1.4 Vendvarrimet (tumat).....	68
3.2 Monumentet arkitekturore	69
3.2.1 Varret monumentale.....	69
3.2.2 Banesat	70
3.2.3 Pazari, hanet e qytetit të Korçës.....	147
3.3 Monumente historike	75
3.3.1 Muzetë	75
3.3.2 Dorëshkrimet	77
3.4 Monumente të kultit.....	78
3.4.1 Objektet e kultit kristian (kishat)	78
3.4.2 Kishat e Voskopojës.....	80
3.4.3 Objektet e kultit mysliman.....	82
Harta – Monumentet e kulturës të qarkut Korçë	83
3.5 Monumentet artistike	84
3.5.1 Piktura murale	84
3.5.2 Fotografia	86
3.6 Trashëgimia etnografike	86
3.6.1 Veshjet popullore	87
3.6.2 Artizanati dhe punimet tekstile	89
3.6.3 Zejtari të ndryshme tradicionale.....	91
3.7 Trashëgimia kulturore shpirtërore	92
3.7.1 Folklori (këngët dhe vallet).....	93
3.7.2 Këngët folkloristike.....	95
3.7.3 Vallet	97
3.8 Festat dhe frekuentimi turistik.....	97
3.8.1 Traditat	101

3.8.4 Kulinaria tradicionale.....	102
KAPITULLI IV: TURIZMI KULTUROR DHE MUNDËSITË E TIJ PËR ZHVILLIM SOCIAL – EKONOMIK NË QARKUN E KORÇËS (QASJE EMPIRIKE).....	105
4.1 Roli i turizmit në promovimin e destinacionit turistik	105
Imazhi.....	106
4.2. Metodologjia e anketimit	108
4.2.1 Analiza e të dhënave nga anketimet e turistëve	110
Grafiku - Prejardhja e turistëve të huaj	110
Grafik – Moshë e turistëve	111
Grafik – Të ardhurat mujore të turistëve	111
Grafiku - Niveli i edukimit Grafiku - Punësimi	112
Grafiku – Përqindja e frekuentimit të zonës	112
Grafiku – Përqindja sipas kohës së qëndrimit	113
Grafiku – Llojet e akomodimit	113
Tabela - Qëllimi primar i vizitës në qarkun e Korçës.....	114
Tabela - Arsytet e zgjedhjes së destinacionit.....	115
Q6a.....	115
Grafiku - Arsytet e zgjedhjes së destinacionit	116
Tabela – Informacioni për zgjedhjen e destinacionit.....	116
Grafiku - Mjetet e udhëtimit Grafiku – Shoqërimi në udhëtim	117
Grafiku - Shpenzimet e bëra në destinacion	118
4.2.2. Atraksioni Korçar.....	118
Grafiku - Vlerësimi i pushimeve në tërësi.....	118
Grafiku - Vendndodhja/distanca e destinacionit (nga aeroporti).....	119
Grafiku - Vlerësimi mbi gjendjen e rrugëve	119
Grafiku - Rëndësia e informacioni turistik	120
Grafiku - Vlerësimi mbi informacionin turistik (hartat turistike).....	120
Grafiku - Rëndësia e pastërtisë së mjedisit.....	120
Grafiku – Vlerësimi i turistëve mbi pastërtinë e mjedisit.....	121
Grafiku - Rëndësia e mikpritjes/ vlerësimi i turistëve mbi mikpritjen.....	121
Grafiku - Vlerësimi mundësive për të bërë aktivitete zbavitëse.....	122
Grafiku - Evente kulturore/festime	122
Grafiku - Vlerësimi dhe performanca e atmosferës së brendshme.....	122
Grafiku -Vlerësimi dhe performanca e shërbimeve.....	123
Grafiku - Vlerësimi dhe performanca e atmosferës së brendshme të restoranteve apo vendeve të ngrënies	123

Grafiku – Rëndësia dhe vlerësimi i çmimit lidhur me shërbimin	124
4.2.4 Veçanëtitë e territorit	124
Grafiku - Vlerësimi i resurseve natyrore	125
Grafiku - Vlerësimi i rrugëve turistike	125
Grafiku - A mendoni ta vizitoni përsëri destinacionin?.....	126
Grafiku - Do t'ia rekomandonit miqëve dhe të afërmeve tuaj?.....	126
4.2.5 Vlerësimi i trashëgimisë kulturore të qarkut.....	127
Grafiku – Pritshmëria/ kënaqësia për ndërtesat historike/muzetë	127
Grafiku - Pritshmëria dhe kënaqësia për pamjen tradicionale të fshatrave	127
Grafiku - Pritshmëria për arkitekturën Grafiku - Kënaqësia për arkitekturën	128
Grafiku - Pritshmëria për festimet/eventet.....	128
Grafiku - Pritshmëria/kënaqësia për ushqimin	129
Grafiku - Pritshmëria/ kënaqësia për qendrat e informacionit	129
Grafiku - Pritshmëria/kënaqësia për mjedisin përreth/njerëzit.....	130
Grafiku - Pritshmëria/kënaqësia për paketat turistike	130
Grafiku - Kënaqësia mbi muzetë e qytetit të Korçës	131
Grafiku - Kënaqësia për kishat e Voskopojës.....	132
Grafiku - Kënaqësia për tumën e Kamenicës	132
Grafiku - Sa të kënaqur jeni ju me vizitën në qarkun e Korçës?	133
Grafiku - A bletë suvenire?	133
4.3. Analiza e të dhënave nga anketimi i komunitetit	133
Grafiku - Origjina e banorëve të përfshirë në anketime	134
Grafiku - Të ardhurat e banorëve të anketuar Grafiku - Niveli i arsimimit	135
Grafiku - Jeni të përfshirë në aktivitet e turizmit ? Grafiku - Kontaktet me turistët.....	135
Grafiku - Çfarë arsimi është i nevojshëm në fushën e turizmit?	136
4.3.1. Interesimi për trashëgiminë kulturore.....	136
Grafiku - A keni dijeni për trashëgiminë Grafiku - Dini nëse ka objekte kulturore	137
Grafiku - A vizitohen nga vizitorët vendas dhe të huaj që vijnë në zonën tuaj?	137
Grafiku - Kush është qëndrimi juaj për turizmin ? Grafiku -Ndikimi potencialeve	137
4.3.2. Të konceptuarit dhe ndërgjegjësimi për përfitimet nga turizmi	138
Grafiku - Numri i turistëve ka ardhur duke u rritur nga viti në vit.....	140
Grafiku - Zhvillimi i turizmit do të krijojë më shumë mundësi për punësim	141
Grafiku - Turizmi do të ndihmojë në zhvillimin ekonomik të zonës	141
Grafiku - Do të më pëlqente të kisha një biznes timin në funksion të turizmit.....	140
Grafiku - Do të më pëlqente të kishte investime të huaja për zhvillimin e turizmit në zonë	140

Grafiku - Investimet qeveritare duhet të luajnë rolin kryesor në zhvillimin e turizmit	141
Grafiku - Turizmi ndikon në përmirësimin e transportit lokal.....	141
Grafiku - Turizmi ka përmirësuar jetën e komunitetit të zonës.....	142
Grafiku - Zhvillimi turizmit do të ndihmojë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore.....	142
Grafiku - Objektet tona kulturore duhet të tërheqin më shumë turistë.....	143
Grafiku - Turizmi kulturor ruan origjinalitetin kulturor të popullsisë lokale	143
Grafiku - Turizmi kulturor sjell ndryshime në veshje, zakone dhe tradita lokale	143
Grafiku - Turizmi kulturor shkakton rritje të ndotjes	144
Grafiku - Turizmi kulturor sjell mbipopullim të zonës me vizitorë nga vende të tjera.....	144
Grafiku - Qeverisja lokale ka bërë një punë të mirë për promovimin e vlerave të zonës.....	145
4.4 Analiza e pyetësorit të njësive turistike	145
Tabela - Njësitë turistike të anketuara	146
Grafiku - Kategoria e njësive turistike.....	146
Grafiku - Kapaciteti mbajtës i njësive turistike	147
Grafik - Burimet e përdorura për ngrohje.....	148
Grafiku - Mjediset e ofruara në ndërtesë	148
Grafiku - Shërbime të tjera që ofroni për turistët	149
Grafiku – Çfarë mendoni për promovimin e potencialeve kulturore në qarkun e Korçës?	149
Grafiku - Rritja e të ardhurave në sezonet turistike	150
Tabela - Pengesat e evidentuar lidhje me mirëfunksionimin e aktivitetit në funksion të turizmit	151
5.1 Itineraret turistike-kulturore të qarkut të Korçës	152
Kufiri me Greqinë (km)	154
Kufiri me R. Maqedonisë (km).....	154
Tabela . Numri i vizitorëve vendas dhe të huaj në zonat turistike të qarkut	157
Tabela 5. Struktura akomoduese e turistëve në qarkun e Korçës.....	158
5.1.1 Zonat/fshatrat kulturorë, avantazhet dhe disavantazhet.....	160
Tabela - Avantazhet dhe disavantazhet e zonave/fshatrave turistike të qarkut.....	163
5.1.2 Tregjet turistike ekzistuese dhe potenciale që vizitojnë qarkun e Korçës.....	164
5.2 Institucionet dhe aktorët e menaxhimit të trashëgimisë kulturore	165
5.3 Monitorimi i gjendjes aktuale të menaxhimit të trashëgimisë kulturore në qarkun e Korçës.....	168
5.4 Probleme aktuale të trashëgimisë kulturore dhe turizmit kulturor.....	171
5.5 Përvoja e huaj. Dobia studimore e përvojave të huaja	173

5.6 Teknologjia e informacionit në menaxhimin e trashëgimisë kulturore të qarkut Korçë	176
VESHJET ETNOGRAFIKE TË QARKUT KORÇË	188
KAPITULLI VI: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	191
BIBLIOGRAFIA	195
Zeje dhe punime artizanale	206
Trashëgimia kulturore shpirtërore (festat)	208
Frekuentimi dhe infrastruktura turistike	212
.....	191

KAPITULLI I: HYRJE

Rritja e interesimit për të vizituar vende të reja me oferta të pasura natyrore dhe kulturore, e ka shndërruar sot turizmin në një ndër sektorët kryesor të zhvillimit ekonomik në botë. Turizmi është një ndër historitë më të dukshme të suksesit në kohën tonë. Të ardhurat që vijnë nga turizmi janë të jashtëzakonshme dhe, për këtë arsye, zhvillimit të tij i kushtohet një vëmendje e veçantë kudo në botë.

Shqipëria është një vend me histori të lashtë në, e cila reflektohet në trashëgiminë e pasur kulturore të saj me vlera kombëtare dhe ndërkombëtare. Deri më sot ruajtja e vlerave të saj, ka qenë e lidhur me ruajtjen e identitetit, të krenarisë dhe të pasurisë kombëtare, ndërkohë që integrimi në politika zhvillimi, rajonale lokale, shihet si një mundësi mjaft e mirë jo vetëm për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, por edhe për kontributin e saj real në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e social të vendit. Sipas të dhënave të Organizatës Botërore të Turizmit WTO-së¹, që nga viti 2001 numri i turistëve në Shqipëri, veçanërisht i turistëve të huaj, ka ardhur duke u rritur nga viti në vit.

Rajoni i Korçës, si një ndër hapësirat urbane me zhvillim të hershëm social-ekonomik dhe kulturor në Shqipëri, është dalluar për frekuentim të hershëm turistik. Në zhvillimin e turizmit, krahas elementëve të tjerë të rëndësishëm, ka ndikuar edhe pozicioni gjeografik i këtij rajoni, komunikimi i hershëm dhe i vazhdueshëm me dy shtetet kufitare: Greqinë dhe Maqedoninë. Interesi i vizitorëve dhe i turistëve të huaj për potencialet natyrore, tashmë është fokusuar në njohjen e trashëgimisë kulturore të trevave përbërëse të qarkut, dëshmi e një popullimi të hershëm dhe të vazhdueshëm të tyre. Rritja e interesit të turistëve të huaj në këtë drejtim ka ndikuar pikërisht në promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore në funksion të zhvillimit të turizmit dhe për rrjedhojë edhe të zhvillimit social – ekonomik të këtij qarku.

Trashëgimia kulturore e qarkut të Korçës përbëhet nga trashëgimia kulturore materiale dhe ajo shpirtërore. Trashëgimia kulturore materiale përfaqësohet nga disa kategori monumentesh, si monumente arkeologjike (vendbanime); monumente arkitekturore (varre monumetale, kala, banesa, pazare, hane, etj); monumente historike (muze, dorëshkrime); monumente kulti të besimit të krishterë dhe mysliman (bazilika, kisha, katedrale, xhami, teqe, tyrbe, etj);

¹UNWTO, Tourism Hightlight 2013 edition, f.7

monumente artistike (piktura murale, skulptura, mozaikë); monumente etnografikë (veshje popullore, artizanat, zeje), etj.

Për vlerat e tyre kombëtare dhe më gjerë, 158 objekte të trashëgimisë kulturore materiale kanë fituar statusin ligjor të monumenteve të kulturës dhe janë pjesë e trashëgimisë kulturore kombëtare. Në këtë qark ka edhe një numër objektesh të tjera, të cilat, ndonëse kanë vlera kulturore nuk mbrohen me status të veçantë. Ndër objektet kulturore më të rëndësishme të vizitueshme në qarkun e Korçës përmendim: Tumën e Kamenicës, Varret Monumentale të Selcës, Muzeun Arkeologjik, Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar, Muzeun Kombëtar të Arsimit, pazarin e qytetit të Korçës, shtëpinë muze të piktorit Vangjush Mio, Muzeun Historik në qytetin e Pogradecit, Muzeun Historik të qytetit të Ersekës, Bazilikën e Linit, kishat e Voskopojës, kishat e Vithkuqit, kishën e Shën Mërisë në ishullin e Maligradit, Xhaminë e Iliaz Bej Mirahorit, etj.

Trashëgimia kulturore jomateriale, ose shpirtërore, përfaqësohet nga folklori i pasur gojor, muzikor dhe koreografik (këngë dhe valle), festat lokale (festa e birrës, karnavalet e Korçës, festa e lakrorit, festa e liqenit, etj), artizanati, zejet e ndryshme (vegla pune, vegla muzikore, etj), traditat si edhe kuzhina e pasur tradicionale. Elementë të veçantë të kësaj trashëgimie janë pjesë e vlerave të trashëgimisë kombëtare, që meritojnë të vlerësohen dhe mbrohen me statusin e trashëgimisë shpirtërore. Teza qendrore e këtij studimi është ajo se zhvillimi i turizmit kulturor në qarkun e Korçës luan e mund të luajë një rol të rëndësishëm në zhvillimin social-ekonomik të tij, duke u konsideruar nga banorët si një burim i rëndësishëm të ardhurash për familjen e tyre. Kjo duket qartë edhe në vëmendjen që i kushtohet ngritjes së kapaciteteve turistike si hotele, bare, restorante, etj. Nga ana tjetër, pushteti qendror (Ministria e Kulturës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes etj), pushteti lokal (bashkitë dhe komunat e qarkut) i kushtojnë vëmendje zhvillimit të turizmit nëpërmjet përmirësimit të menaxhimit të potencialeve në funksion të tij. Një rol të rëndësishëm luajnë gjithashtu edhe organizmat ndërkombëtare dhe OJF-të e ndryshme, nëpërmjet hartimit dhe realizimit të projekteve për zhvillimin e turizmit kulturor në qarkun e Korçës.

Industria e turizmit, aktiviteti me global kërkon që edhe vlerat Rajonale të prezantohen në një formë mbresëlënëse. Investimet bashkëkohore, ndërhyrjet në infrastrukturë dhe sigurim fasilitetesh të përshtatshme për të mbërritur tek destinacionet turistike, janë çelësi për të tërhequr vizitorë vendas dhe të huaj.

Turizmi, udhëtimi për çlodhje, argëtim, biznes, kulturë, histori etj, është një industri e madhe, e cila ofron mundësi punësimi në bujqësi, pyje, peshkim, komunikim, përdorim burimesh ujore, industrinë e shërbimit, ku kuptojmë shërbime transporti, akomodime, shërbime të tjera të industrisë së mikpritjes. Janë investimet e viteve të fundit argumenti më bindës i politikave zhvillimore të qeverisë shqiptare dhe jovevtem, përderisa niveli aktual i financimit të turizmit përputhet me trajtimin që i bëhet kësaj industrie si sektor prioritar.

Bukuria dhe diversiteti i Shqipërisë juglindore ofron eksperiencë për vizitorë vendas dhe të huaj. Këta të fundit kanë mundësinë të shijojnë në rajonin e Korçës veçoritë e turizmit malor, ekoturizmit, bukurinë e valleve dhe veshjeve tradicionale, shijen e gatimeve tradicionale, që ofron arti i kulinarisë; kanë mundësinë të marrin përshtypjet që dhurojnë objektet e kultit, vlerat monumentale, zonat e mbrojtura me përparësi, parqet natyrore, zonat e liqeneve, shtëpitë muze të piktorëve të mëdhenj, me emër brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë.

“Turizmi familjar” dhe çdo formë tjetër e turizmi është vetëm një pjesë e industrisë së turizmit. Trashëgimia kulturore, peizazhet e mrekullueshme, lokalet e ngrohtë, muzetë, galeritë, teatrot, kinematë, turoperatorët me paketat e tyre turistike, argumentojnë përse turizmi është biznesi i çdo anëtarit të shoqërisë (njeriut) si prodhues dhe konsumator i produktit turistik gjithëvjetor. Kjo është edhe arsyeja përse të ardhurat nga turizmi shpërndahen në komunitet dhe ekonomi në mënyra shpesh surprizuese. Gjithsesi është shoqëria ajo që përfiton në fund të fundit si ekonomikisht edhe shpirtërisht.

1.1 Zhvillimi turizmit kulturor në qarkun e Korçës

Udhëtimet dhe lëvizja e njerëzve kanë filluar qysh me lindjen e shoqërisë njerëzore dhe krijimin e qytetërimeve. Të para me kalimin e shekujve, motivet e udhëtimit të tyre ndryshuan; tregti, luftëra, qëllime ekonomike, fetare dhe studimi. Me të ashtuquajturin “Grand Tour” në shekullin e XVII, lindi edhe koncepti “turisti”, i cili do të gjente përhapje të gjerë në shekullin e XIX, ku udhëtimet u bënë më të organizuara. Sipas Deklaratës së të Drejtave të Njeriut e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 10 Dhjetor 1948, Neni 24 “...çdo njeri ka të drejtë të pushojë, të argëtohet, duke përfshirë një limitim të arsyeshëm të kohës së punës dhe pushime të paguara”.

Lidhur me këtë përkufizim i dhënë nga Organizata Botërore e Turizmit (WTO) është gjerësisht më i pranuar sipas të cilit, “...turizmi është aktiviteti i personave që udhëtojnë dhe

qëndrojnë në vende jashtë mjedisit të tyre të zakonshëm, për jo më shumë se një vit, për kalimin e kohës së lirë, biznes apo qëllime të tjera . Turizmi është cilësuar si “si çelësi i zhvillimit, prosperitetit dhe mirëqenies.” , të shumë vendeve dhe rajoneve në Evropë e më gjerë, “...rrallë mund të gjendet ndonjë sektor i ekonomisë i tillë si turizmi, ku mund të krijohet mjaft shpejt vlera e shtuar e produkteve, ku mund të hapen mjaft vende të reja pune, ku mund të thithet shpejt valuta e huaj përballë një kostoje relativisht të ulët”.

I cilësuar si “çelësi i zhvillimit, prosperitetit dhe mirëqenies”, të shumë vendeve dhe rajoneve në Evropë e më gjerë, “...rrallë mund të gjendet ndonjë sektor i ekonomisë i tillë si turizmi, ku mund të krijohet mjaft shpejt vlera e shtuar e produkteve, ku mund të hapen mjaft vende të reja pune, ku mund të thithet shpejt valuta e huaj përballë një kostoje relativisht të ulët”².

Duke reflektuar rëndësinë ekonomike të turizmit në përgjithësi dhe turizmit kulturor në veçanti një sërë organizmash kombëtare dhe ndërkombëtare si WTO, USAID, UN, UNDP, FMN, UNESCO, WB, TTC, GIZ, SNV etj. ofrojnë ekspertizë dhe mbështetje financiare për këto aktivitete në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim.

Turistët e huaj, (vizitorë me mbi një natë qëndrimi) u rritën me 4 % në vitin 2012 duke arritur në 1 miliard, për herë të parë në histori, ndërkohë që të ardhurat u rritën në 4 % duke shënuar rekord me 1.075 miliard \$ ose 837 miliard € të gjithë botën.

“Në vitet e para të shekullit të 21-të, pavarësisht një mjedisi ndërkombëtar që përfshiu performancën e turizmit global, Evropa i konsolidoi pozitat e saj si destinacioni turistik numër 1 në botë”³. Në vitin 2000 numri i turistëve huaj në Evropë ishte 385 milion, ai u rrit në 439 milion në vit 2005 dhe 477 milion në vitin 2010, ndërkohë që të ardhurat nga turizmi u rritën respektivisht 230 miliard \$ në 2000, 378 miliard \$ në 2005 dhe 407 miliard \$ në 2010. Në vitin 2012 Evropa e vjetër tërhoqi 52% të turistëve të huaj nga e gjithë bota, pra 534 milion njerëz, pra 18 milion më shumë se në 2011. Kjo rezultoi në rritjen e të ardhurave nga turizmi me 2 % në terma realë, llogaritur në 458 miliard \$ (356 miliard €), duke përbërë 43 % të totalit të ardhurave botërore . Sipas të dhënave të WTO-së, që nga viti 2001 numri i turistëve në Shqipëri ka ardhur duke u rritur. Në vitin 2010, Shqipëria (rajoni jugor mesdhetar) u arrit nga 2.347 milion turistë ndërkombëtare dhe në 2011 nga 2.865 milion. Të ardhurat nga ky sektor

² WTO

³ WTO

llogariteshin nga 1 626 milion \$ në 2011, në 1 628 milion \$ në 2011 dhe 1 471 milion \$ në 2012 .

Vizioni i Organizatës Botërore të Turizmit për vitin 2020, parashikon se turistët ndërkombëtarë priten të rriten në 1.56 miliard, nga të cilët 1.18 miliard do të jenë ndër rajonale dhe 0.8 miliard do të jenë turistë të largësive të mëdha. Në arritjet totale të rajoneve në 2020, në top listë do të jenë Evropa (717 milion turistë), Azia Lindore dhe Paqësorit (397 milion) dhe Amerika me 282 milion turistë. Për periudhën e parashikuar Evropa Perëndimore do të mbetet nënrajoni me tërheqjen më të madhe, ndërkohë që tërheqja do të rritet në nënrajonin e Mesdheut Lindor. Po sipas këtij parashikimi dhjetë vendet e Ballkanit, do të kenë arritjen e 79 milion turistëve ndërkombëtare, ndërkohë që destinacionet kryesore turistike si Greqia, Turqia, Bullgaria, Rumania dhe Kroacia do të kenë mbi 92 % të totalit të turistëve. Duke vlerësuar tendencën dhe parashikimet e rritjes së lëvizjes dhe numrit të turistëve të huaj në Evropë, Mesdhe dhe Ballkan, si edhe duke patur në konsideratë ofertën e pasur të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, mendojmë se është një mundësi mjaft e mirë për Shqipërinë për t'u përfshirë ndër këto destinacione. Sigurisht, që këtu është i nevojshëm mirëorganizimi dhe angazhimi gjithëpërfshirës i aktorëve të sektorit turistik.

Nga vëzhgimet dhe analizat e shumta që po i bëhen turizmit si dukuri ekonomike, sociale dhe kulturore, turizmi me synim kulturën dhe trashëgiminë kulturore po konsiderohet, veçanërisht në shekullin e ri, si një nga aktivitetet me impaktin më të madh në industrinë botërore të turizmit.

Duke iu referuar ecuresë së zhvillimit, industria e turizmit kulturor tashmë ka avancuar në të gjitha vendet dhe rajonet Evropiane, duke zënë hapësirat e lëna bosh nga industria prodhuese . Sipas përcaktimit të bërë nga Komisionit Evropian, turizmi tipik kulturor në Evropë përfshin festivale dhe evente, vizita në muze, interes për arkitekturën tradicionale, rrënojat arkeologjike, vizita te objekteve të kultit, kisha, interes për fshatin dhe jetën rurale, eksperiencat e jetuara, muzikë, gatimet tradicionale, njerëz të shquar të rajoneve”.

Në drejtim të turizmit kulturor Shqipëria ka shumë pasuri të trashëgimisë kulturore me vlera kombëtare dhe ndërkombëtare, që kanë ngjallur tashmë interesin e vizitorëve, veçanërisht atyre ndërkombëtarë. Përmendim këtu Parkun Kombëtar të Butrintit (Trashëgimi Botërore e mbrojtur nga UNESCO), i cili gjatë vitit 2012 u vizitua nga 76 488 vizitorë, ndërkohë që numri u rrit në 84 633 vizitorë vendas dhe të huaj, në vitin 2013. Po kështu të ardhurat e siguruar nga

Parku i Butrintit u rritën përkatësisht nga 30.2 milion në vitin 2012, në 34.02 milion lekë në vitin 2013. Të ardhurat e siguruar shkojnë në buxhetin e shtetit dhe nëpërmjet ministrisë përkatëse alokohen fondet për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e parkut.

Zhvillimi i turizmit kulturor në rajonin e Korçës i ka fillesat e para mjaft të hershme. N.q.s. do t'i referoheshim përkufizimeve të ndryshme për turizmin dhe fillesave të tij në botë, me drejtë do të shtronim pyetjen: A përbënte Voskopoja, qendra e qytetërimit në shek. XVIII, një vend tërheqës dhe argëtues për ata që e vizitonin atë?

Tabela 3. Tipet e turizmit kulturor

Tipet e turizmit kulturor	Vendet tipike/ aktivitetet e interes
Turizmi i trashëgimisë	Vizita në kështjella, pallate dhe shtëpi vendase Site/vende arkeologjike Monumente Arkitekturë Muze Site fetare
Turizmi i artit	Vizita në teatro Koncerte Galeri Festivale, karnavale dhe evente Site letrare
Turizmi kreativ	Fotografi Pikturë Gatim Zejtari Mësim i gjuhës
Turizmi kulturor urban	Qytete historike Qytetet e rilindur industrial Atraksionet e artit dhe të trashëgimisë Dyqanet Jeta e natës
Turizmi kulturor rural	Fshati, ferma apo agroturizmi Ekomuzetë Peizazhet kulturore Parqet kombëtare Shtigje

Turizmi kulturor indigjen	Ekoturizmi Vizita në qendra kulturore Arte dhe artizanat Shfaqje kulturore Festivale
Turizmi kulturor popullor	Parqe dhe atraksione Dyqane komplekse Ngjarje sportive Media dhe evente filmi Site të trashëgimisë industriale Muzetë e modës dhe stilit

*Burimi: Përshtatur sipas tipologjisë së turistit kulturor
 Melanie K. Smith, (Issues in Cultural Tourism Studies)⁴*

Krahas zhvillimit të dukshëm social-ekonomik, pranisë së objekteve kulturore mjaft të rëndësishme për kohën, organizimi i panairove tregtare (panairi i Shën Prodhomit) si dhe kremtimi i festave të shumta fetare, sillte në qytet udhëtarë dhe vizitorë nga vendet përreth, si dhe nga ato më të largët lindor dhe jugor. Prania e numrit të madh të haneve në qytet dhe përgjatë rrugës së karvaneve, është një tregues i lëvizjeve të shpeshta të njerëzve, që hynin e dilnin për qëllime tregtare apo me interes për të vizituar qytetin. Studiuesit dëshmojnë se jeta sociale dhe kulturore këtu, dallohej për një nivel të lartë zhvillimi.

Pas rënies së Voskopojës, ishte qyteti i Korçës që mori një zhvillim të shpejtë social-ekonomik, funksioni tregtar i të cilit, e bënte atë të frekuentuar. Ndërkohë në fillimet e shek. XX, në qytetin e Pogradecit filloi të kultivohej tradita e kalimit të kohës së lirë dhe e pushimeve. Kjo gjeti shprehjen e vet në vitet 1920-1930, kur klasa e pasur nga qytetet më të afërta ndërtoi këtu shtëpitë e para të verimit (kultura e të priturit të miqve të verës).

Në vitet 1945-1990, Shqipëria nën sistemin socialist zbatoi politikat e izolimit të vendit, duke penguar ardhjen e turistëve të huaj dhe duke u mbështetur vetëm në pikëpamjet e turizmit social, një turizëm për të gjithë dhe me shpenzime të pakta. Ky lloj turizmi do të kontrollohej dhe administrohej nga shteti, si në strukturat akomoduese ashtu edhe në shërbimet e ndryshme. Përveç hoteleve, kampet e punëtorëve dhe kampet e pionierëve, ishin strukturat e akomodimit në zonat turistike të vendit. Në vitet 1960-1990 Korça, Pogradeci, Voskopoja dhe Dardha ishin destinacionet më të frekuentuara turistike kryesisht për pushime (leje vjetore).

⁴Melanie K. Smith, 2003, Issues in Cultural Tourism Studies, Routledge, London & New York, fq.37

1.2 Ndikimi i turizmit kulturor në zhvillimin social-ekonomik të qarkut Korçë

Zhvillimi social-ekonomik i qarkut Korçë, është i lidhur ngushtë me pasuritë natyrore dhe humane që ai disponon. Aktualisht tiparet e një zhvillimi ekonomik bujqësor-industrial, falë pasurive të shumta, jo vetëm natyrore, por dhe ato kulturore i kanë dhënë mundësi zhvillimit të industrisë së turizmit natyror dhe kulturor. Nga anketimet e realizuara me tre target-grupet (turistët e huaj, komunitetin dhe njësitë turistike) vihet re se, interesi për zhvillimin e turizmit në qarkun e Korçës është i lartë. Potencialet kulturore që përmban hapësira e studimit janë mjaft tërheqëse për të gjithë vizitorët, por në veçanti për turistët e huaj që vijnë në zonë. Në krahasim me një vit më parë numri i turistëve të huaj ka ardhur në rritje, madje disa prej tyre e kanë vizituar më shumë se një herë zonën.

Nga anketimet e realizuara me këtë target grup (siç është shprehur nga analiza e pyetësorit) motivacioni kryesor që turistët e huaj e vizitojnë qarkun e Korçës është motivacioni kulturor, konkretisht për t'u njohur me objektet e kulturës materiale, si edhe traditat dhe elementët e tjerë të kulturës shpirtërore. 81 për qind në një vlerësim të përgjithshëm ata janë të kënaqur me ofertën gjeografiko-kulturore të ofruar dhe për disa elementë të saj si: kishat, muzetë, arkitektura tradicionale, gatimet lokale, mikpritja etj., i kanë realizuar pritshmëritë e tyre. Për t'u konsideruar paraqiten problemet e konstatuara lidhur me mungesën e infrastrukturës, si rrugore ashtu dhe asaj turistike (shërbime hotelerie, mungesë e informacionit turistik, guidave, hartave, dyqaneve të suvenireve etj).

Nga anketimet e realizuara me komunitetin lokal (banorët e zonave më të frekuentuara turistike), rezulton se ata janë mjaft të interesuar për zhvillimin e turizmit. Banorët kanë njohuri mbi potenciale kulturore që ndodhen në zonën e tyre dhe rëndësinë që paraqesin për zhvillimin e turizmit. Të ardhurat mujore të deklaruara nuk janë shumë të larta dhe vetëm një përqindje e vogël e tyre, 17 përqind e kanë aktivitetin e turizmit si burim kryesor të ardhurash. Nisur nga fakti se të anketuarit kanë një nivel të lartë arsimimi (79% me arsim universitar dhe i mesëm), rreth 91 për qind e shikojnë me mjaft interes zhvillimin e turizmit duke e konsideruar si një burim të rëndësishëm ekonomik për familjet e tyre.

Ndërsa nga anketimet e realizuara me njësitë turistike del në pah ndikimi i drejtpërdrejtë i zhvillimit të turizmit në rritjen e të ardhurave të tyre ekonomike. Një pjesë e mirë janë shprehur se gjatë pikut të sezonit turistik, të ardhurat e tyre rriten 2 herë më shumë sesa gjatë periudhës

tjetër të vitit (74% e të anketuarve), ndërkohë që ka të anketuar që shprehen se gjatë kësaj periudhë të ardhurat e tyre 5-fishohen. Kjo tregon se prania e turistit sjell të ardhura të konsiderueshme në zonë, sidomos e turistëve të huaj. Duke u nisur nga fakti se turizmi është një burim i rëndësishëm ekonomik, njësitë turistike e vlerësojnë si të rëndësishëm promovimin e potencialeve kulturore të qarkut dhe se aktorët përkatës duhet të bëjnë më shumë në këtë drejtim.

Po kështu njësitë e anketuara janë shprehur se ofrojnë shërbime bazë dhe të kualifikuara për turistët si: ngrohje, shërbim dhome, mëngjesin e përfshirë në çmimin e hotelit, shkëmbimin valutor, etj, por pak aktivitetet argëtuese, ekskursionet, guida në zonë, ushtrim të sporteve të ndryshme etj. Gjithsesi nga këndvështrimi i turistëve niveli i shërbimeve të ofruara vlen të përmirësohet. Për këtë arsyeje njësitë turistike duhet të investojnë më së tepërmi në përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe realizimin e aktiviteteve, në përputhje me kërkesat e tyre.

Bazuar në këto anketime rezulton se zhvillimi i turizmit kulturor është burim i rëndësishëm punësimi për komunitetin e zonës. Lidhur me këtë, duhet forcuar bashkëpunimi sektorit publik me atë privat në fushën e investimeve në drejtim të infrastrukturës turistike (rritjen e kapaciteteve të akomodimit), dhënies së kredive të buta për atë kategori të popullsisë që dëshiron të investojë në fushën e turizmit, në drejtim të restaurimit të objekteve monumente kulturore, në nxitjen e arsimit profesional në profesione që lidhen me artizanatin dhe traditat kulturore të zonës etj. Këto do të nxisin zhvillimin e turizmit dhe gjithë zhvillimin social-ekonomik të qarkut, duke ofruar mundësi në rikthimin e banorëve drejt vendit të origjinës, për të investuar në ngritjen e kapaciteteve akomoduese apo shërbimeve të tjera turistike.

Trashëgimia e pasur kulturore e qarkut Korçë ka mundësuar zhvillimin e një prej llojeve të turizmit më të frekuentuara sot në botë, atij kulturor. Interesi për njohjen e historisë, kulturës, traditave dhe zakoneve i shtyn gjithmonë e më shumë turistët, si vendas ashtu edhe të huaj, për të vizituar këtë hapësirë gjeografike. Nisur nga analiza e potencialit të trashëgimisë kulturore dhe interesi që paraqet ky potencial për tërheqjen turistike, arrijmë në konkluzionin se turizmi kulturor mund të konsiderohet si prioriteti i zhvillimit të turizmit në qarkun e Korçës.

Nga njëra anë turistët shprehin dëshirën dhe kuriozitetin për të njohur zonën dhe nga ana tjetër popullsia lokale dhe njësitë turistike janë shumë të interesuara mbi zhvillimin e turizmit në zonën e tyre. Investimet në drejtim të restaurimit të monumenteve kulturore shihen si të

rëndësishme për ruajtjen dhe përmirësimin e gjendjes aktuale si edhe për një prezantim dinjitoz të vlerave të saj. Gjithashtu ato mund të konsiderohen si një mundësi për punësimin e komunitetit, rritjen e të ardhurave dhe mirëqenies së tij.

1.2.1 Turizmi si strukturë e kapitalizmit

Ky studim ofron gjithashtu një vështrim sociologjik rreth turizmit rajonal. Pra sociologjia e turizmit si nëndisiplinë dhe e parë nën këtë optikë turizmi sjell zhvillim të qëndrueshëm pjesë e studimit tek njësitë e qeverisjes vendore në lidhje me strategjinë e turizmit.

Akomodimi (i turistit) si pjesë integrale e strukturës:

- 1 – Ekonomike
- 2 – Politike
- 3 – Kulturore

Kjo strategji mund të ndërtohet në tre aspekte:

- 1- Aspekti Teorik: Turizmi në kohën tonë - rishikim në të kaluarën.
- 2- Aspekti Empirik: Identifikimi i disa qendrave turistike për zhvillimin ekonomik dhe social, p.sh eko turizëm, turizëm kulturor (disa destinacione kulturore) pra atë që ofron Korça interesante si për turistët vendas dhe të huaj.

3-Aspekti i perspektivës:Çfarë mund të bëhet dhe çfarë mund të bëhet më mirë ?

Pra këtu në duhet të përcaktojmë dhe nivelin e analizës i cili në rastin tonë është tipik lokal/rajonal shtrirë në një hark kohor 5 vjeçar pikërisht viti 2010 – 2015 e parë në aspektin e harxhimit të “kohës së lirë” si pjesë e turizmit në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm. Kjo është një përpunim i tezës së mikrokredisë dhe mikrofinancës së trajtuar nga Muahmad Yunus, tezë e cila do ta çonte varfërinë në muze. Biznesi social sjell ekonomi sociale që ka në thelb dy objektiva:

- 1- fitimin
- 2- punësimin,

pra biznesi social kryen një rol social, një aktivitet social që sjell fitimin dhe zgjidhjen e disa problemeve siç është papunësia nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm, një aktivitet social që në thelb mund të konsiderohet si një formë e re e veprimtarisë ekonomike me karakter social.

Vetë politikat për turizmin do të sjellin ndërtimin e një strategjie e cila do të ketë impakt kombëtar duke u nisur nga lokalitetet të cilat janë potenciale reale në këtë fushë. Gjithashtu iniciativat post diplomim, për të diplomuarit në këtë fushë do të sjellin dhe një frymëmarrje në tregun lokal të punësimit, por edhe në atë kombëtar.

- Mos përqendrimi i vëzhgimit sociologjik sjell shpërdorim të kotë resursesh.
- Efektiviteti i sociologjisë lidhet me studimin e tendencave të konsumit në shoqëritë post moderne. Pra ky është specializim në sensin ekonomik.
- Kontributi i sociologjisë sjell hapësira të reja për veprim
- Karakteristikat e turizmit në sensin postmodern në shoqëri. Shpërdorimi i resurseve nuk mund të tolerohet.

Turizmi është konsideruar vazhdimisht si një ndër prioritetet e Bashkisë së Korçës. Pavarësisht aktiviteteve të ndryshme me qëllim nxitjen e turizmit në këtë qytet deri më tani në Bashki kishte munguar një strukturë për promovimin e qytetit apo një plan veprimi për turizmin, duke ia lënë gjithçka spontanitetit. Me strukturën e re të krijuar në vitin 2015 filloi funksionimi i zyrës për marketingun e qytetit dhe Zhvillimin e Turizmit e cila në bashkëpunim me SNV po harton strategjinë lokale për zhvillimin e turizmit. Në këtë kuadër u organizua një takim me të gjithë aktorët lokalë në fushën e turizmit ku u bë një prezantim i iniciativave të ndërmarra si dhe i planeve në të ardhmen në fushën e turizmit nga Bashkia, Qarku, Universiteti i Korçës, Dhoma e Tregtisë, biznesi lokal, GTZ, EDEM, si dhe u krijua Komiteti për Zhvillimin e Turizmit, nga i cili u krijua një dokument i rëndësishëm për zhvillimin e qytetit në këtë drejtim.

Plan – veprimi për turizmin, pasi të prezantohet në Këshillin Bashkiak dhe të marrë miratimin e tij do të jetë i hapur për sugjerime dhe ide nga opinion publik.

Sondazhi i UNWTO (Organizata Botërore e Turizmit) nxjerr në pah se 10% e turistëve që vijnë në qytet, vijnë enkas për eventet dhe festat e organizuara nga Bashkia e qytetit.

1.2.2 Idetë e para rreth turizmit.

Nga ana sociologjike të gjithë e ndjenë në një mënyrë ose në një tjetër nevojën për të lëvizur, nevojën për të njohur dikë apo diçka e cila ekziston larg nesh por me të cilën ne dëshirojmë e që ndoshta të kemi një raport, një marrëdhënie. Bëhet fjalë për një ndjeshmëri të

përgjithshme e cila ka pasojat sociale të konsiderueshme të cilën nuk mund ta kufizojmë si një mini fenomen të veçantë i cili ska nevojë për trajtesë shkencore.

Prandaj logjikisht shtrohen disa pyetje: Përse kemi nevojë për të bërë turizëm? Përse zgjedhim në mënyrë deterministe një tip të caktuar pushimesh? Çfarë sjellim me vete pas çdo periudhe pushimi? Çfarë i kemi lënë në lokalitetin që vizituar si turistë?

Këto janë disa pyetje klasike që shtrohen në fushën e sociologjisë edhe pse mund të ketë kohë që të jenë shtruar si të tilla, gjithsesi përgjigjet nuk kanë qenë asnjëherë pjesë debati sociologjik shqiptar; në thelb pyetje shumë empirike dhe konkrete për të patur dinjitet shkencor. Gjithsesi jam i mendimit që pikërisht këtu ne mund të flasim edhe për atë nën degë të sociologjisë, pikërisht për “sociologjinë e turizmit”. Gjithashtu mund të ndërtohet edhe një nën disiplinë e re për mendimin shkencor shoqëror shqiptar pikërisht “Antropologjia e turizmit”.

Turizmi fenomen i vjetër që edhe i ri për të cilin kanë shkruar dhe mendimtarë të tjerë si G. Simmel, T. Veblen ose I. Goffman.

Në kongresin botëror të sociologjisë në Bielefeld në vitin 1994 debati shkencor mbi nocionin e “autenticitetit”, nocion të cilin studiuesi D. MacCannell ka pasur në qendër të reflektimit të tij, një funksion kyç në të gjithë sesionin. Antropologët vlerësonin në maksimum punimin e studiuesit E. Hobsbawm në lidhje me “Shpikjen e traditës”, e cila fertilizonte shumë kërkime të mëtejshme. Gjithashtu një hapësirë të konsiderueshme në këtë kongres kishte dhe publikimi i artikullit të Z. Bauman “Në brendësi të globalizmit”, i cili i kushtonte shumë vëmendje pasojave sociale të mobilitetit territorial, por edhe në këndvështrimin e një procesi migrator edhe si lëvizje turistike. Gjithsesi situata sot nuk është më e njëjta me atë të viteve 1990. Sot panorama është më e gjerë dhe më komplekse, dhe procesi i cili na ka sjellë në këtë situatë meriton studim të mirëfilltë, pasi na ndihmon të kuptojmë hartën e mendimit shkencor në lidhje me këtë çështje.

Për t’i hapur udhë procesit kompleks të reflektimit mbi rezultatet që dalin në pah nga studimi ynë, na duket me vend të marrim në konsideratë edhe të dhënat që ofron sistemi universitar si edhe operatorët turistikë të sektorit rajonal. Pra zhvillimi i qëndrueshëm në rastin tonë është një ofertë përfaqësuese e rajonit në një farë mënyre njohja e nivelit më të avancuar të këtij sektori nga pikëpamja kulturore dhe gjithashtu potencialin turistik që rajoni ofron. Pra të evidentojmë mundësinë për të pasur turizëm përgjatë gjithë vitit në të katër stinët – turizëm gjithëvjetor në rajon.

Situata që ne kemi evidentuar na sjell në një përfundim logjik sesi rajoni i Korçës mund të zërë një pozicion lideri në të gjithë vendin si dhe në të gjithë hapësirën ndër – rajonale. E gjitha kjo si një pasojë e një tregu turistik jo të kontraktuar por shumë të zhvilluar. Pra tërheqja turistike e disa prej njësive administrative më të frekuentuara deri më tani në qark që në origjinë i jep rajonit një pozicion lider në turizmin kombëtar.

Por shfrytëzimi i këtyre hapësirave nga ana e palëve të interesit le për të dëshiruar, pasi një arsye shumë kokëfortë në këtë drejtim është mungesa e “shkollave të hoteleri-turizmit” apo e “instituteve profesionale të shërbimeve hotelerike” për të formuar teorikisht e praktikisht: kuzhinierë, banakierë, kamerierë, ose “institute teknike për turizmin” për të formuar recepsionist hotelesh si dhe punonjës të specializuar për agjencitë e udhëtimit.

Pra e thënë me fjalë të tjera na duhet një “personel”i gatshëm me një nivel kualifikimi të ulët dhe të mesëm të ulët. Gjithashtu në këtë skenar një ndryshim cilësor bën Universiteti i Korçës, jo vetëm si një gjenerator social por dhe konkretisht me fakultetin e ekonomisë dega ekonomi – turizëm megjithëse në thelb ka një kontrast me atë që i duhet vërtet tregut rajonal të punësimit. Në thelb nga studimi identifikohet një nevojë profesionale e tipit të mesëm të ndërmjetëm pra kuadro teknike që aktualisht ekziston në këtë sektor por kërkon një diplomim apo një certifikim të domosdoshëm për të ushtruar profesionin e vet. Kjo vjen edhe si pasojë që nuk ka një rakordim të mirë të edukimit tekniko – profesional parauniversitar me atë universitar, sepse edukimi parauniversitar nuk është i mjaftueshëm e ndërsa edukimi i lartë kërkon kohë ndërkohë që imediate është një “certifikim i shpejtë” në ekonomi turizëm.

Do të mendonim që formati i modelit të ri parashikon formimin e kapacitetit për të analizuar strukturën e produktit turistik, në veçantinë aspektet e tij të manaxhimit dhe administrimit, mbrojtjen e paketave turistike, marrjen e kompetencave juridike dhe ekonomike që i lejojnë të mbulojnë pozicione profesionale të ndërmjetme, ndërmjet top management e punëtorëve të thjeshtë të sektorit, qoftë në administratë qoftë në sipërmarrje. E thënë ndryshe një “Administrator i Resurseve Turistike” në sipërmarrjen e një Biznesi social.

Natyrisht është e vetëkuptueshme që këtu theksi vihet gjithnjë e më tepër në aspektin ekonomik të produktit turistik, që gjithandej perceptohet si “shërbim turistik”. Në thelb si sistem referimi marrim për bazë sipërmarrjet në të cilat ky person punësohet që kanë nevojë për shërbimin e tij ashtu si edhe ky person ka nevojë për to, në radhë të parë në këto lloj sipërmarrjesh hynë hotelet, agjencitë e udhëtimeve, restorantet prestigjioze. Pra në fund duhet

të kemi një projekt të harmonizuar ndërmjet punëdhënësve punë marrësve dhe jo vetëm, si dhe palëve të interesit në këtë sektor në mënyrë që të rrisim ofertën turistike si nga ana cilësore edhe nga ana sasiore, pasi kjo do të sjellë dhe një ofertë universitare shumë më cilësore në baze edhe të kartës së Bolonjës, pasi oferta aktuale tashmë mëse e amortizuar nuk mund ti japë me implus këtij projekti rajonal. Me institucionalizimin e diplomës së nivelit të parë(3-vjeçar) në “Shkencat e turizmit” si dhe diplomat e nivelit të dytë të specializuara (me kohëzgjatje 2-vjeçare) në “Projektim dhe administrim i sistemeve turistike” do të ishte një hap i madh përpara, i cili përmbush një hendek në procesin e profesionalizimit të sektorit turistik. Specializimi – zgjidhja për ecjen përpara në tregun Global.

Në formatin e ofertës universitare, produkti turistik nuk është më vetëm thjesht një shërbim të cilin duhet ta studiojmë sesi organizohet apo administrohet, por sesi transformohet në një produkt me karakteristika të spikatura të sistematizimit, përshkrimi i të cilit i përket sektorëve të ndryshëm të jetës sociale e prodhuese. E gjitha kjo mbështet në thelb në një transformim të rëndësishëm konceptual, i cili ka pasoja relevante si në planin formativ dhe atë didaktik: pasi kalohet nga një vizion për turizmin si pjesë ekskluzive e ekonomisë, praktikisht asaj shtëpiake, tek një definicion ndërdisiplinor i lëndës.

Në qendër të këtij propozimi për një format të ri universitar në këtë sektor, vendoset turizmi, i konceptuar jo vetëm si pjesë e produktit, por si sektor me aktivitet kompleks dhe intesiv, në të cilin konkurrojnë/lëvrojnë sociologjia, psikologjia, gjeografia, drejtësia, historia, e natyrisht ekonomia. Pra “shkencat e turizmit” vjen si një disiplinë më vete e pajisur me një autonomi shkencore të mirëfilltë.

Megjithëse mund të lind një debat për këtë propozim si dhe për ta unifikuar gjeografinë me shkencat e turizmit, që i jep prioritet dimensionit territorial të produktit turistik në krahasim me atë strukturor determinist. Pse jo për të patur dhe politika të mirëfillta për këtë sektor na duhet të kemi edhe një komision parlamentar për turizmin. Ndoshta njohja akademike dhe institucionale e sektorit turistik është zgjidhja e nyjes gordiane që agjencitë turistike kërkojnë prej vitesh. Në kurs diplomantësh në “shkencat e turizmit” rikthen vendosmërinë e çështjes së autonomisë së turizmit dhe njeh kompleksitetin e përqasjes së kësaj discipline shkencore për të cilën nevojitet. Është me vend të theksojmë që në bazë të adoptimit të këtij përcaktimi shkencor gjithashtu sjell dhe një aset të ri ndërdisiplinor, për të cilën kjo disiplinë ka nevojë. Nëse analiza e ndryshimeve strukturore sjell një centralizim/ qendërzim të të ashtuquajturit proces të

globalizimit të tregut, atëherë si të mos i japim prioritet studimit të ekonomisë politike apo të politikave ekonomike? Nga njëra anë e ndërsa nga ana tjetër i japim rëndësi centralizimit të procesit të integritit shoqëror që promovohet nga intensifikimi i qarqeve komunikuese të cilin nuk mund ta studiojmë pa metodologjinë përkatëse sociologjike/ metodologjinë e sociologjisë.

Zakonisht bëhet fjalë për çështje të hapura që gjithsecili zgjidh sipas përjasjes së vetshkencore. Ajo ç'ka është e sigurt bëhet fjalë që rifitimi i autonomisë disiplinore ka sjellë intensifikimin e procesit të akreditimit të atyre pak studiuesve që ndodhen në vendin tonë. Pikërisht e kam fjalën këtu për atë të ashtuquajturit apo vetë – shpallurit “ekspert turizmi”, megjithëse kemi të bëjmë me një ofertë shumë të madhe nga bota universitare të njëjtës fushë por jo të ketij titulli. Kemi disa diploma të nivelit të parë si dhe pak diploma të nivelit të dytë si dhe pedagogë të “ekonomi turizmit” pa lidhje me oportunitetin e kohës, vetë ky fakt sjell si një domosdoshmëri një akreditim kurrikulash adekuat, për të shmangur anomalitetin universtar që vihet re në këtë sektor. Kjo do të sjellë një rritje të ofertës së këtij tipi, mirëpo në vendin tonë nuk kemi për fat të keq aq shumë aq sa duhet studiues të mirëfilltë për turizmin, megjithatë kemi me mijëra të diplomuar në fushën e ekonomisë së turizmit..!

Domosdoshmëria për të ripozicionuar studiuesit dhe studentët në fushën e turizmit dhe zhvillimit të qëndrueshëm do të sjellë promovimin e kurseve dhe degëve të reja të cilat nuk do të kishin arsye të mos ekzistonin.

Sociologjia e turizmit në këtë drejtim përbëhet nga 2 komponentë shumë thelbësore: Kërkimi dhe Studimi.

Në fushën specifike të sociologjisë së turizmit, do të asistojmë jo vetëm rritjen e kërkimeve në këtë fushë por edhe në studimin e mëtejshëm të kësaj disipline. Sjella e ideve klasike nga studime thelbësore do të kontribuojë jo vetëm nga ana akademike por edhe nga ana profesionale sepse do ti japë udhë iniciativës post – diplomim të profesionistëve dhe ekspertëve të turizmit. E gjitha kjo do të sjellë një pluralizim diplomash qoftë të nivelit të parë por dhe në ato të nivelit të dytë.

Është diskutuar shumë mbiofertën që jep sistemi universitar dhe raporti i saj me të diplomuarit si dhe me formatin e shpejtë të eksperteve që i nevojiten sektorit të turizmit.

Me gjithë diskutimet vihet re mungesa e punës e shërbimit të kualifikuar. Brishtësia e tregut shqiptar në krahasim me atë rajonal dhe botëror. Pra me fjalë të tjera duhet një rakordim imediat ndërmjet ofertë për punë si dhe ofertës cilësore si krah pune në këtë sektor. Le të jetë

Rajoni i Korçës si lidërsip Kombëtar dhe qyteti i Korçës si lidërsip Rajonal. Në momentin që del në pah një ofertë e mirëfillte turistike, e profesionalizuar dhe e mirë strukturuar atëherë mund të flasim për pasjen e një tregu turistik funksional i cili i jep vlerë të gjitha aspekteve që banorët e zonës nuk mund ta bënin dot vetë.

Praktika Evropiane në këtë drejtim na jep shumë shembuj suksesi për zhvillimin e qëndrueshëm në lidhje me ndërtimin e tregut të turizmit rajonal dhe pozicionimin e tij në arenën ndërkombëtare. Me gjithë përpjekjet e deritanishme në këtë drejtim për fat të keq shifrat në lidhje me frekuentimin turistik të vendeve fqinje nuk flasin në favorin tonë! Si ka mundësi që ndodhemi në këtë paradoks, pasi dhe ne ofrojmë potenciale natyrore dhe burime njerëzore të cilat e bëjnë shumë tërheqëse paketën tonë rajonale? Madje duke e hedhur atë edhe në anën e konkurrencës shumë të vështirë ndër – rajonale!

Jemi të bindur që jo vetëm për arsye të auto – tutelës së kësaj disipline, por edhe mos përqëndrimi i vëzhgimit sociologjik sjell shpërdorim resursesh. Kjo sjell humbjen e atraksionit për rajonin.

Projektimi i produktit turistik si paketë rajonale si dhe planifikimi i zgjidhjeve strategjike, për të cilat pak a shumë vendasit janë të ndërgjegjshëm sjell një imazh për “udhëtarin” sot turistin e së nesërme.

Ideja e turistit të së nesërme për hir të së vërtetës është pak anakroniste, pasi aftësia jonë e konkurimit është difektoze e nuk arrin të “lexojë”, “interprettojë” e për rrjedhojë t’i “përgjigjet” mutacioneve kontekstuale që ky sektor pëson vazhdimisht. Pikërisht në këtë aspekt efekti i sociologjisë lidhet me studimin apo “fotografimin” e tendencave të konsumit në shoqërinë post moderne. Shoqëri ku koha dhe mënyra e punës në krahasim me papunësinë ka pësuar transformime të thella, duke favorizuar hera herës zhvillimin e praktikave të kohës së lirë. Në këtë kontekst merr vlerë dhe një motivim turistik i një lloji krejt të ri, i cili origjinën e ka në sjelljen e individëve me bazë zgjedhjeje vlerash kulturore, tipike e shoqërisë industriale si produkt i masave.

Duke marrë iniciativë nga konsiderata të tilla, specializimi akademik në këtë sektor duhet me patjetër të ketë sens ekonomik, duke vënë theksin në transformimin nga një administrim në turizëm shtëpiak si produkt final, në një sistem intens duke amplifikuar në këtë mënyrë objektin e studimit.

Çka do të thotë që edhe refleksioni shkencor duhet të përballët me procese të tilla të ripërcaktimit të kufijve ndër – disiplinore, kurrikulare. Që do ketë efekt të menjëhershëm e profesionalizimin e brezave të studentëve të rinj në këtë fushë.

1.2.3 Dobia e propozimit

Dobia e propozimit tonë për një formatim është i pashmangshëm, nëse duam t'i imponohemi problemeve profesionale, dhe nëse gjithashtu duam të merremi seriozisht në konsideratë për atë se çfarë diplomash prodhohen çdo vit atëherë do të shohim me qartësi çfarë dimë e çfarë kemi mësuar, e në cilin spektër përkatës mund ta aplikojmë aftësinë tonë.

Nevoja e sociologjisë lind me reformën që është ndërmarrë për sistemin universitar në Shqipëri. Pra siç e kemi përmendur e më lart: institucionalizimi i diplomave të nivelit të dytë në “projektim dhe administrim të sistemeve turistike” , imponohet në thelb një produkt turistik i cili sistematikisht është konceptuar me të gjitha implikimet dhe ndërveprimet që kjo mund të sjell si proces. Ky proces i zgjerimit të kufijve të “shkencave turistike” na udhëheq/çon drejt individualizimit të atyre problematikave që janë më të lidhura me transformimet e shoqërisë bashkëkohore dhe që mund të studiohen vetëm me instrumentet përkatës të metodologjisë së shkencës sociologjike. Produkti turistik nuk lind brenda sipërmarrjes ekonomike, fryt i proceseve produktive brenda kufijve të sipërmarrjes interferojnë ndërmjet sipërmarrjes të territorit, kjo është mënyra specifike në të cilën sipërmarrja di të vlerësojë dhe të vendosë në drejtimin e duhur shfrytëzimin territorial.

Kontributi që sociologjia mund ti japë këtij procesi nuk kufizohet më si më parë. Në analizë të motivacioneve për zgjedhjen turistike me një mbështetje mbi studimet e sjelljes ekonomike të konsumatorit mund të fitojmë hapësira të reja veprimi. Pra, kontributi i sociologjisë sjell hapësira të reja veprimi të cilat lindin si karakteristikë e turizmit në sensin post-modern të shoqërisë.

Dy janë fushat e reflektimit që marrin spunto nga ky inovacion.

-Studimi i karakteristikave specifike të turizmit në lidhje me ndryshimet që ka pësuar shoqëria post-moderne.

-Instrumentet e duhur për të analizuar a) territorin dhe b) produktin turistik.

Pra, çdo moment kur nuk je duke punuar quhet kohë e lirë, e përkthyer kjo në sensin post-modern të shoqërisë, koha e mos-punës është koha e lirë. Koha e lirë është kohë aktive në shoqërinë post-moderne.

Në fazën historike të masivizimit të zhvillimit shoqëror është e mundur të përcaktojmë kohën e mos-punës si kohë bosh nga ana sociale. Megjithatë, sensi i qytetarisë sociale në epokën post-moderne, këtë kohë (koha e mos-punës), e vlerëson si kohë rikreative-aktive. Kështu, standardi i kohës së lirë është koha aktive. Bëhet fjalë për “kohë” që nuk zë një hapësirë të madhe nga pikëpamja sasiore, as është e dominuar nga pikëpamja sociale, por që shpesh shpreh një kuptim të lidhur me objektin i cili është shumë më i rëndësishëm se çdo aktivitet tjetër.

Riformimi i kufijve të qytetarisë sociale dhe të kohës së lirë në krahasim me aktivitetin e përditshëm të punës, ripërcakton të gjitha praktikat e kohës së lirë dhe të turizmit. Duke marrë si atribut një kuptim social, pra duke e bërë shumë atraktive praktikat shoqërore tradicionale si për shembull: shpenzimi i kohës së lirë duke vizituar një muze është qytetari. Ngjitja në mal gjatë kohës së lirë po ashtu është një manifestim qytetarie. Nuk mund të planifikohet koha e lirë pa profesionalitetin e sociologut, i cili së fundmi është i mirëpërcaktuar.

Raporti profesional ndërmjet sipërmarrjes dhe territorit, ndaj të cilit duhet të kemi një vëmendje më të madhe nga pikëpamja e sociologjisë, përgjithësisht çon të gjitha sipërmarrjet të jenë të hapura ndaj ndërhyrjeve territoriale me kusht që të jenë sipërmarrje turistike funksionale, të hapura për të gjithë, të afta për të kryer lidhje reciproke ndërmjet sipërmarrjes dhe territorit, në mënyrë që të përballojnë flukset turistike që kushtet e sotme shoqërore imponojnë si në aspektin rajonal ashtu dhe në atë ndërajonal, pra si në marrëdhëniet e brendshme ashtu dhe në ato të jashtme. Nuk mund ta kundërshtojmë procesin e ndërveprimit reciprok duke mos marrë në konsideratë procesin evolutiv në mënyrë të njëtrajtshme dhe të parashikueshme.

Me rritjen e ndërveprimeve turistike vendasit dhe turistët bëhen pjesë e një procesi transformimi reciprok që i bën më të ngjashëm ndërmjet tyre, madje nderi aty sa mund të humbasin çdo element që i dallon. Pra evidentimi i çdo elementi që e bën tërheqës rajonin, përbën pikat e forta mbi të cilat bazohet raporti ndërmjet territorit dhe sipërmarrjes. Nga ana teknike duhet ta projektojmë këtë dinamikë e cila kthehet në zhvillim të qëndrueshëm me ndihmën e specialistëve të fushës.

Administrata lokale për të iniciuar dhe zhvilluar projekte që i shërbejnë zhvillimit turistik, në bashkëpunim me sipërmarrjet që interesohen për zhvillimin e produkteve lokale, nuk mund të mos e bëjnë këtë panjë bashkëpunim teknik në mënyrë që t'i japin vlerë resurseve territoriale. Impakti social i këtyre fenomeneve parashikon në mënyrë të mundshme evoluimin e shoqërisë lokale dhe për rrjedhojë zhvillimin e sipërmarrjes dhe të territorit, pra ndërtimin e zhvillimit të qëndrueshëm rajonal.

Në sektorin turistik ka një nevojë shumë të madhe për kompetencën sociologjike, vështirësitë, vonesat, pengesat që sjell burokracia në shumë raste vijnë si rrjedhojë e mungesës së profesionalizmit, por më specifikisht e mungesës së një profesionalizmi sociologjik.

Deri më tani sektori i turizmit ka qenë në dorë të llogaritarëve, të ekonomistëve të thjeshtë dhe atyre të marketingut. Më këto profesione është arritur maksimumi i mundshëm që ishte i pritshëm nga shfrytëzimi i këtij sektori për ndërtimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Tashmë, duhet të ndryshojë koncepti i të bërit turizëm dhe duhen aftësuar në mënyrë profesionale kapacitetet rajonale njerëzore në mënyrë që mund t'i përshtatemi ndërtimit të zhvillimit të qëndrueshëm. Duke mbrojtur pikëpamjen sociologjike, nuk fshihemi përpara fakteve që edhe shumë profesione të tjera mund ti atashohen zhvillimit të qëndrueshëm rajonal. Shpërdorimi i resurseve dhe mundësive në këtë moment nuk mund të tolerohen.

Në gjykimin tonë do të mendonim që do ishte i nevojshëm një manual profesional në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm. Manual ky i cili do japë fillimisht të dhëna të përgjithshme në lidhje me mundësitë e punësimit në rajon si dhe të dhëna specifike në lidhje me profesionet e mundshme për tu realizuar në këtë rajon. Në këtë aspekt konformizmi tashmë është jashtë mode, pasi duhet parë me sy kritik çdo punë e bërë deri më tani dhe ato për të ardhmen. Pasi parimi intelektual është antikonformizimi, zbatimi i të cilit sjell vetëm progres.

Sipas rastit, kërkimi didaktik ose kërkimi studimor, duhet të marrë në konsideratë punimet e deritanishme si të dhëna sasiore dhe duhet t'i çojë ato me tej për të sjellë produkte cilësore, të cilat përbëjnë resurse potenciale për zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit. Në bazë të kësaj ideje është e rëndësishme të arrijmë rezultate shkencore kuptimplota, por ti shtojmë këtu dhe faktin e shfrytëzimit të tyre për të ndërtuar një dimension social ekonomik rajonal.

Përdorimi i të dhënave shkencore duhet shtrirë dhe në fushën universitare, përfshirë këtu temat e diplomave të studentëve, që nuk duhen bërë thjesht për të kaluar radhën por për të dhënë një impakt social rajonal, idetë e të cilit ja u jep ky manual si dhe kërkimet online. Duke

ndërtuar në këtë mënyrë një bibliotekë të vërtetë në lidhje me sociologjinë e turizmit. E përmbledhur në mënyrë sistematike për sa më tepër eksperiencia didaktike sjell kërkim empirik që na çon në zhvillim të qëndrueshëm rajonal dhe pasurimin e koncepteve tona nëpërmjet zbulimeve që mund të arrijmë në bazë të këtij studimi dhe jo vetëm, ndoshta të dimë të ndërtojmë një manual të saktë që mund të çojën në një guidë për të mësuar se cilat janë rrugët në qoftë se duam të arrijmë zhvillim të qëndrueshëm.

Të qenit i përditësuar është fitimprurëse si nga ana akademike ashtu dhe nga ana ekonomike. Kjo do të thotë të jesh pjesë e një komuniteti shkencor, të njohësh çfarë diskutojnë specialistët, të jesh në gjendje të integrosh dijet e tyre në mënyrë profesionale për ti shërbyer zhvillimit të qëndrueshëm. Pra, një përditësim profesional në këtë sektor kërkon një rrjet komunikimi funksional për turizmin.

Të shumta janë mediat të cilat propagandojnë turizmin kombëtar dhe atë rajonal. Në thelb ky turizëm mediatik është marketing i cili i shërben zhvillimit ekonomik dhe social. Për ta bërë të mundur shfrytëzimin e potencialeve rajonale në të gjithë kapacitetin e tyre duhet që e pamundura të bëhet e mundur, sepse tashmë e pabesueshmja është realitet. Ky është evolucioni i praktikës turistike. Për shëmbull, në aspektin e turizmit botëror tendenca e fundit është turizmi hapësinor me pagesë. Japonezët studiojnë sesi t'i japin vlerë këtij turizmi të ri, që është një formë e re dhe sjell perspektivë për të ardhmen. Evolucioni i praktikës turistike do të thotë “shija e të parit ndryshe” të gjërave për shëmbull: portokalle blu. Kjo do të thotë të marrim në konsideratë qoftë udhëtarin-turist një ditë deri në udhëtarët super të pasur të gatshëm për të shpenzuar pasuri të tëra për të provuar të parët eksperiencia të reja turistike për të qënë në avantgardë në krahasim me pjesën tjetër të shoqërisë.

Në këtë moment dalim në një tjetër aspekt të turizmit, pikërisht në atë që quhet turizmi elitar. Aftësia jonë për ta bërë turizmin elitar pjesë të zhvillimit të qëndrueshëm është mundësia për ta kthyer atë në turizëm masiv, pra të praktikuar nga shumica e atyre që frekuentojnë lokalitetin, pra në rastin konkret rajonin e Korçës.

Turizmi si fenomen poliedrik, polifunksional që nga Marko Polo deri tek Lord Bajroni na mëson se cilat janë ekspertizat dhe eksperiencat të cilat kërkojnë udhëtarët dhe turistët. Me fjalë të tjera, teza për zhvillimin e qëndrueshëm në këtë rast është : edhe pse fenomeni i turizmit ka ekzistuar gjithmonë dhe me shumë mundësi do vazhdojë të ekzistojë dhe në shoqëritë e epokës post-moderne, mënyra e shfrytëzimit të tij përbën potencial për zhvillimin e qëndrueshëm në

mënyrë deterministe. Kështu që gjykohet se ekziston një sens për të quajtur turizëm çfarëdo lloj forme të mobilitetit teritorial që është manifestuar historikisht brenda shoqërisë njerëzore. Mund të pohojmë me siguri që mobiliteti teritorial i njerezve ka ekzistuar gjithmonë dhe ashtu si tashmë është e njohur popullata të tëra kanë qenë në lëvizje, duke modifikuar thelbësisht rrënjët e tyre territoriale. Ky afirmim edhe pse i rëndësishëm, nuk është vendimtar në fund të fundit për të bërë një bazë interpretimi mbi fenomenin e turizmit.

Vlerë shumë të madhe ka në fakt konstatimi se mobiliteti teritorial me qëllim kulturor rikreativ dhe informues për periudha të shkurtra kohe pa sjellë humbjen e rezidencës së përditshme përfaqëson një sjellje që lind në një fazë historike gjatë procesit të industrializimit dhe modernitetit. Turizmi si fenomen dhe mobilitet social, lind në fazën industriale dhe evoluon për tu përshtatur në fazën moderne dhe post-moderne të shoqërisë. Vazhdimësia historike e turizmit është legjitime pasi përderisa ekziston kjo formë e shoqërisë (shoqëria post-industriale) do ekzistojë dhe nevoja për turizëm.

Në analizë të fakteve në studimin tonë janë të dukshme transformimet shoqërore të nevojshme të cilat kanë kaluar nga sjellje tradicionale të një mobiliteti teritorial tek sjellje specifike që lindin nga turizmi modern. Pikërisht në këtë moment lind pyetja se cilat janë ato sjellje që na çojnë në lindjen e fenomenit të turizmit modern dhe për ti dhënë përgjigje duhen metoda sociologjike, pasi teoria sociologjike e udhëtimit sjell një tërësi refleksionesh, të cilat mund të bëhen bazë e një modeli interpretativ që mund të çojë në një orientim më të saktë të studimeve që mund të realizohen në këtë sektor.

Duke patur në vëmendje një qasje të tillë, qoftë studiuesit, qoftë operatorët turistikë duhet të kuptojnë lidhjet që ekzistojnë ndërmjet shoqërisë dhe motiveve turistike që na çojnë në mobilitetin teritorial për të njohur nga ana historike dhe shkencore strukturën e udhëtimit turistik. Lidhja mes udhëtimit dhe turizmit bëhet në bazë të një kriteri metodologjik që është historik, ndërsa evidentimi i transformimit nga udhëtimi në turizëm është një qasje sociologjike. Ky udhëtim është si zbulim i elementëve të rinj të turizmit modern. Ndryshe mund ta quajmë dhe “Grand Tour” në sensin klasik të kësaj fjale.

Do të kërkojmë të kemi formulime të sakta që të jenë të mundshme në përdorimin e udhëtimeve dhe qëndrimeve, për të patur mundësi më vonë të tregojmë se cilat janë arsyet që sjellin lindjen e turizmit masiv duke u nisur nga modeli aktual i turizmit. Tematika mund të jetë historike, por objekti i studimit është sociologjik dhe ndoshta kjo është mënyra më e mirë për të

patur zhvillim të qëndrueshëm rajonal. Për këtë mund të na nevojitet një tip i ri i sociologjisë që të jetë në gjendje të studiojë jo vetëm të tashmen me fenomenet e saj të evoluara, por një sociologji e cila të jetë në gjendje të përdorë çelësin historik për të qenë në krye të procesit shoqëror të kompleksitetit dinamik, që çon në konstruksionin historik të shoqërisë.

Turizmi është i lidhur në mënyrë të pashmangshme dhe me letërsinë, ndoshta si një treg i ri për të përshkruar udhëtimin, vendet dhe ngjarjet, të cilat kanë si protagonist intelektualin romantik. Ky i fundit nuk është një fenomen statik, por në bërje e sipër dhe që ka pësuar transformime historike qoftë në aspektin fenomenologjik dhe në atë teorik. Ky udhëtim sjell personazhe të cilët japin provën për një eksperiencë jetësore të pavarur si dhe për të konsoliduar të drejtën e qytetarisë brenda klasave shoqërore. Turizmi është pavarësi në të jetuar dhe investim në aspektin akademik atë personal dhe shoqëror.

Brenda klasës elitare të shoqërisë mund të kemi një tjetër funksion të turizmit që nuk praktikohet nga masa, pikërisht atë të pelegrinazhit akademik, i vlefshme ky për tu ndërmarrë nga diplomantët e rinj ashtu dhe për akademikët e sprovuar.

Në një shoqëri e cila synon të qytetërohet me vlera perëndimore, në një shoqëri e cila respekton qytetarin vendas dhe po ashtu i jep një vend të veçantë qytetarit të huaj, qoftë për shkak të traditës apo kulturës, të bësh turimizëm cilësor në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm është një vlerë e shtuar në gjykimin tim për shoqërinë aktuale dhe në të ardhmen.

Për të përshkruar më tej këtë koncept të qytetarisë në të bërit turizëm do t'i referohemi George Simmel sipas të cilit Mobiliteti social edhe pse i ligjshëm, është negativitet për shoqërinë. P.sh të ardhurit ristazh – tok e zanun. Ndërsa intelektual i mirëfilltë sjell kulturën, pasi i prek dhe i sheh vetë klasikët dhe pasi largohet këto eksperiencia i ndan me të tjerët. Në këtë mënyrë firmohet ajo që mund ta quajmë kontakt me qytetërimin i cili është rrjedhojë selektive e fenomenit që ne po marrim në studim. Një nga elementët shumë domethënës të analizës së George Simmel, i cili e cilëson mobilitetin teritorial si një fenomen negativ, është nënvizimi i karakterit të qëndrueshëm në lidhje me denominacionin e termit të “huaj”. Në një shoqëri në të cilën mobiliteti teritorial nga ana shoqërore është i papranueshëm, kush ndryshon rezidencën edhe duke mos qenë devijant, por nuk e humbet kurrë njohjen e tij në përballje me komunitetin vendas. Të “huajt” edhe pse zhvillojnë funksione shoqërore të nevojshme si për shembull tregtia edhe në disa raste, ata e gjejnë veten duke jetuar në një realitet shoqëror ku nuk kanë paraardhës, nuk kanë rrënjë dhe për rrjedhojë etiketohen për të gjithë jetën si të huaj

ose të ardhur. Ndërsa për intelektualin, turizmi në përgjithësi dhe ai kulturor në veçanti, është ushqim shpirtëror. Intelektuali sjell dhe përçon gjithmonë kulturë, kur i prek dhe i sheh vetë vendet dhe fenomenet i ndan këto eksperiencia dhe me të tjerë, gjë e cila e çon atë në një kontakt me qytetërimin.

Vetëm duke ndaluar në vende religjioze, duke qenë në kontakt spiritual me to apo dhe duke marrë pjesë në teatër, muze, në monumente që vijnë nga historia, mund të fitohet një lloj ndjeshmërie dhe vëmendjeje për pjesën më të bukur dhe madhështore që të jep qytetërimi klasik. I gjithë ky proces historiko-kulturor nën kuadrin e një ndjeshmërie sociologjike është gjithashtu në informim të themeleve bazë për identitetin kombëtar. Turizmi si element i identitetit kombëtar, turizmi si nevojë për edukim dhe komunikim ndërmjet brezave. Vetë udhëtimi si transformim kulturor dhe shoqëror mund të konsiderohet si element thelbësor në shoqërinë moderne. Ky lloj komunikimi vjen si një element për të komunikuar apo si një nevojë për të vendosur një komunikim qytetar ndërmjet së shkuarës, së tashmes, për t'u projektuar në të ardhmen.

Është tashmë e afirmuar ideja se qytetari i botës së re ka nevojë të ndërtojë një rrugëtim për rritjen e tij kulturore, i aftë të vihet në kontakt me komunitetin intelektual që lind dhe lufton për autonominë e vet sociale dhe politike. Turisti si qytetar i botës së re është në ndërtim të një rrugëtimi të kulturës individuale që lind nga autonomia shoqërore dhe politike. Një kulturë udhëtimi e asaj që në sot e quajmë borgjezi intelektuale, është jo vetëm një model sjelljeje por dhe ndërtimi simbolik i karakteristikave të kësaj faze historike. Unifikimi dhe standardizimi i vetë udhëtimit promovon jo vetëm burimet natyrore, por dhe inspiron pjesëmarrësit për sjelljet komunikative ndërmjet bujtësve dhe mikut, në terma modernë këtë e quajmë turizëm. Në të gjitha epokat historike njerëzore ka pasur udhëtarë, por mundësia teknologjike dhe mundësia në çon sot tek udhëtari modern, që sot njihet si turisti. Pikërisht në këtë moment turisti heq etiketimin negativ të të "huajt" dhe nëpërmjet komunikimit fiton dhe transmeton kulturë të ndryshme nga shoqëria tradicionale. Komunikimi si parakusht shoqëror i nevojshëm për lindjen dhe zhvillimin e fenomenit të turizmit modern intensiv është një element kusht për zhvillimin e qëndrueshëm. Ky udhëtim në planin cilësor nuk është vetëm sipërfaqësor, por ndërtohet nga karakteristika dhe elementë të tillë si: itinerari, shpirti i aventurës, interesimi për të bërë biznes e të tjera. Nëse do t'i referohemi të shkuarës, Uliksi si mit për themelimin dhe ndërtimin e kulturës perëndimore ka një vlerë shoqërore ndryshe nga Marko Polo si tregtar dhe blerës. Nëse

do ta shqipëronim këtë lloj krahasimi do të kujtonim si një mit Shqipërinë e Lord Bajronit dhe Edit Durham. Pikërisht ky është ndryshimi në kuptueshmërinë shoqërore ndërmjet udhëtarit dhe turistit. Historiku i mobilitetit territorial hap një kapitull të ritë panjohur më parë, pikërisht atë të turizmit modern.

1.2.4 Konstruksioni shoqëror i kohës së lirë

Përcaktimet që kemi bërë deri më tani nuk japin të dhëna mbi të gjithë proceset e transformimit shoqëror, që janë baza për lindjen e turizmit modern. Me rënien e regjimit të vjetër, bien edhe elementët e një mentaliteti të vjetruar. Lindja e kësaj shkence të re është në kërkim të teknologjisë për të fituar mbi kohën e punës, duke lënë të lirë individët që punojnë të jenë më të angazhuar në kohën e tyre të lirë ndërmjet zgjedhjeve individuale. Forca prodhuese e njeriut gjatë kësaj kohë kthehet në tregti. Turizmi gjatë komunizmit nuk sillte asgjë tjetër përveç një largim nga koha e punës, pra një pseudo çlodhje. Në kapitalizëm sjell copëtimin e kohës së punës në sjellje të ndryshme. Kjo çon shpërndarjen në ditën e punës, sepse sot na intereson të kemi një forcë motore njerëzore, jo forcë motore kafshërore. Një ndarje progresive e kohës që mund të bëhet në këtë kontekst është ajo në kohë pune dhe jo-pune, ku kjo e fundit klasifikohet si kohë e lirë.

Kultura e shfrytëzimit të kohës së lirë është një kulturë shkencore iluministe. Ajri i pastër i fshatit si higjienë për kulturën dhe sjelljen shoqërore urbane, quajtur ndryshe dhe kultura e higjienës urbane, propozimi për një përmbysje të sjelljes shoqërore aktuale meriton të nënvizohet pasi roli i individit sot në familje dhe në shoqëri është i mirëpërcaktuar. Jeta në fshat behët sinonim i jetës së shëndetshme ku ti mund t'i përkushtohesh më lehtë kurimit të trupit dhe mendjes, ku mund të ndihesh njeri. Koha e lirë në fshat si ndërtim për të rifituar energji fizike, mendore dhe shpirtërore në thelb është një përkushtim ndaj kohës produktive, kohës së punës. Në një javë 40 orëshe të punës pushimi i javës vjen si domosdoshmëri legjitime për një sjellje shoqërore më të shëndetshme. Historia e kapitalizmit modern është dhe historia progresive e strukturimit të kohës së punës dhe kohës së lirë. Demokratizimi i kohës së lirë, i udhëtimit dhe turizmit, si zgjedhje e ndërgjegjshme gjatë aktivitetit të individëve, vjen si shpikje intelektuale në zhvillim të kulturës shoqërore për ti dhënë hapësirë më të madhe kohës së lirë. Qendrat turistike mund ti trajtojmë pikërisht si hapësira shoqërore për të kaluar kohën e

lirë. Organizimi brenda këtyre hapësirave shoqërore mund të çojë në një diferencim cilësor për llojin e turizmit që do të aplikohet nga kampingu deri tek hoteli me pesë yje.. Tendenca e elitës për të pushtuar lokalitet e ajrit të pastër tashmë në rajonin e Korçës është një realitet në zbatim e sipër. Lokalitet që lindin, rriten dhe zhvillohen si vendbanime të klasave shoqërore nuk i përkasin më vetëm një shtrese të caktuar të shoqërisë, por përbëjnë një gjenerator socio-ekonomik për banorët vendas dhe jo vetëm.

Pikërisht në kuadrin e zhvillimit të qëndrueshëm, elita demokratizon tregun e turizmit dhe vetë lokalitetin , kjo çon në kërkimin e elitave të reja, sjellje kjo e cila në thelb është inovative dhe ka kërkesa ambicioze si për shembull: ndërtimi i hoteleve me pesë yje në rajonin e Korçës si dhe kulinaria specifike ndërkombëtare është po ashtu kërkesë e kësaj sjelljeje. Të gjitha këto e udhëheqin ofertën për turizmin elitë në një kërkesë masive të cilën mund ta definojmë si këtë mënyrë: të paktën një herë në jetë të bëhesh pjesë e turizmit elitë.

Turizmi elitë i cili gjendet në një formë tranzicioni dhe që na udhëheq në praktikën turistike moderne tenton të jetë më i preferuari për tu bërë pjesë e turizmit masiv. Në bazë të këtij arsyetimi mund të kemi një analizë për sjelljen shoqërore sepse një pjesë ekonomike e elitës shqiptare shfrytëzojnë resurset turistike mëse të kushtueshme. Lidhjet turistike ndërmjet bujtësve dhe miqve në një pjesë të mirë të tyre bazohen në njohjen reciproke. Në këtë mënyrë krijohet bagazhi i informacionit, që të shtyn të vizitosh një zonë të caktuar më tepër se një tjetër. Kurioziteti, disponibiliteti i vendit që do vizitohen luajnë një rol shumë të rëndësishëm për ndërtimin e traditës kulturore turistike dhe shoqërore. Udhëtimi kulturor dhe rikreativ po zëvendësohet dalëngadalë nga vendqëndrimi dhe akomodimi me një kohëzgjatje të caktuar e cila solli lindjen e fshatrave turistike.

Eksplorimi i vendeve të reja dhe qëndrimi i përkohshëm në të çon në një realitet kulturor të ndryshëm nga ai i turizmit tradicional, pra nuk është më një udhëtim i gjatë stresues dhe i lodhshëm, me mjete dhe infrastrukturë transporti jo të përshtatshme, por tashmë kthehet në një udhëtim të njohur çlodhës dhe me vendqëndrim mëse komod. Në një hapësirë gjeografike dhe shoqërore e cila është elementi bazë për zhvillimin e qëndrueshëm. Jemi ende në brendësi të shfrytëzimit të turizmit masiv në rajonin tonë dhe ambiciozë për të ndërtuar një turizëm elitë nëse na e lejojnë kushtet e së ardhmes. Gjithsesi, masivizimi sjell evolucion të fenomenit pasi turizmi social në thelb është masiv, por një menaxhim më i mirë i kësaj karakteristike të këtij fenomeni do të sjellë një zhvillim të qëndrueshëm më cilësor. Në disa raste turizmi shoqëror

sjell dhe ndryshime në skenarin social dhe politik. Lindja e turizmit në natyrë, në qiell të hapur, nuk është vetëm pjesë e ekskursionizmit apo kampingut por e një cikli shoqëror post-metropolitan. Ndoshta ky është dhe sensi i të bërit turizëm në kohët e sotme dhe zhvillimi i qëndrueshëm është ekonomia që në përfitojmë prej tij. Më këto karakteristika kemi kaluar në atë që quhet turizmi gjithëvjeter. Masivizimi i këtij fenomeni është orientimi drejt lokalitetit dhe menaxhimi më i mirë i resurseve të tij. Pjesëmarrës në këtë lloj turizmi bëhen dhe kategoritë shoqërore të papërfshira më parë, turizmi masiv vjen si argument për ndryshime shoqërore ashtu sikundër turizmi përfaqëson një element për modernizimin e shoqërisë.

Duke marrë shkas nga potencialet kulturore të zonës si dhe përfitimet e zhvillimit të turizmit kulturor ky kapitull është konceptuar në disa çështje dhe nënçështje. Çështja e parë e kapitullit lidhet me trashëgiminë kulturore të qarkut Korçë, e cila është konceptuar në dy nënçështje kryesore: trashëgimia kulturore materiale dhe trashëgimia kulturore shpirtërore. Në çështjen e dytë të kapitullit trajtohet zhvillimi i turizmit kulturor në qarkun e Korçës. Në këtë çështje jepen aspekte të zhvillimit të turizmit kulturor në rang kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe gjendja aktuale e zhvillimit të turizmit kulturor në qarkun e Korçës. Dy çështjet e fundit të kapitullit të tretë lidhen me zonat apo fshatrat turistike të qarkut të Korçës, avantazhet dhe disavantazhet që ofron zona në funksion të zhvillimit të këtij lloji turizmi si dhe roli i imazhit në zhvillimin e turizmit. Kapitulli përmbyllet me konkluzionet përkatëse të tij.

Evidentimi dhe vlerësimi i trashëgimisë kulturore është bërë në bashkëpunim të ngushtë me literaturën e gjerë të studiuesve shqiptarë, brenda këndvështrimit gjeografik të realizimit të objektit të studimit.

1.2.5 Nga udhëtari tek turisti.

Analiza dhe reflektimi mbi këtë fenomen derivojnë nga eksperiencat e udhëtarëve të mëdhenj në krahasim me ato të turistëve të sotëm, që janë tipikë për shoqërinë moderne bashkëkohore e që janë shumë të rëndësishëm për studimin. Turizmi përfshin një sërë aktiviteteve ku dy nga më kryesorët janë udhëtimi dhe qëndrimi/akomodimi. Duke përdorur termin turizëm e parë në dy këndvështrime si nga ana e atyre që ofrojnë shërbime dhe nga ana e atyre që i përfitojnë ato, kalojmë në një kategori ekonomike nga prodhuesit në konsumatori, që janë figura sociale të ndara nga njëra – tjetra. Sjella bashkë e këtyre praktikave shoqërore çon

në një qarkullim ekonomik, shumëdimensional, të ndryshëm nga ai klasik pasi lindja e praktikës moderne turistike vjen si pasojë e një organizimi specifik social. Kur flasim për treg turistik kemi parasysh dy karakteristika ekonomike: tregun dhe shërbimin turistik.

Udhëtimi turistik është një sjellje shoqërore, qëndrimi apo akomodimi është gjithashtu sjellje shoqërore, të dyja këto kanë një utilitet ekonomik. Udhëtimi dhe qëndrimi janë paracaktuar si sjellje shoqërore edhe para lindjes së turizmit modern. Ashtu siç kemi thënë më lart, udhëtimi dhe qëndrimi janë pjesë e fenomenit të turizmit, ajo që do të gjykonim si specifike dhe si risi në lidhje me fenomenin turistik është ekskursioni, pra ky i fundit si fenomen (turistik) është shumëdimensional që çon në lindjen e lokalitetit turistik. Duke iu referuar OBT-së, ekskursioni konsiderohet si praktikë e jashtme e botës së turizmit. Rëndësia dhe qartësia në aplikimin e këtij fenomeni është frekuentimi dhe zhvillimi i zonave turistike. Organizimi i festave lokale, liqenet, pyjet apo dhe vendet e shenjta kthehen më pas në pika turistike nga frekuentimi i ekskursionistëve. Është e rëndësishme të nënvizohet fakti se duke përdorur logjikën e ekskursionizimit arrijmë në përfundimin se çdo gjë është praktikë turistike.

a) Udhëtimi si praktikë turistike realizohet jo vetëm për të arritur një destinacion të caktuar, por më tepër për të shijuar rrugëtimin ndërmjet pikës së fillimit dhe asaj të mbarimit.

b) Qëndrimi ose akomodimi si praktikë turistike sedentare, realizohet në një vendqëndrim për një kohë relativisht të gjatë, larg rezidencës së zakonshme.

c) Ekskursionizmi si praktikë turistike rastësore që ndodh dhe shpjegohet gjatë një vizite një ditore ose me anë të qëndrimit të përkohshëm, duke përdorur të njëjtat sjellje si turistët e zakonshëm.

Kjo lloj tipologjie nuk e përjashton ekzistencën e praktikave turistike të ndërmjetme, duke patur parasysh kategori të ndryshme që aplikohen në rrugëtime ose qëndrime për një periudhë të caktuar, nxjerrin në pah një tjetër karakteristikë, pikërisht atë të paketave turistike, që përmbledhin të tre elementët e sipërsëhënuar. Paketa turistike një ose dy javore, paketa për fundjava, ekskursione kampingu dhe qëndrimi në qiell të hapur për një natë, ekskursione që i propozohen turistëve të vendosen në një lokalitet të caktuar për më shumë se një natë dhe të vizitojnë një destinacion jashtë lokalitetit turistik.

Interesante është të nxjerrësh praktika turistike nga ato që quhen pushimet e zakonshme. Linja e organizatës botërore të turizmit mund të përdoret si udhërrëfyese për tu ndjekur. Të flasësh për turizmin më shumë se për udhëtimin është të analizosh fenomenin në një përjasje

globale që do të thotë të kërkojë të mbash distancë nga analiza e thjeshtë fenomenologjike për të fituar një pikëpamje më të gjerë, të aftë për të inicuar procese historike-shoqërore në baze të sjelljeve specifike, të cilat strukturojnë praktikën e kohës së lirë sipas praktikave shoqërore të caktuara.

Turizmi si fenomen kompleks dhe gjithë përfshirës në të cilin mund të gjejmë elementë dhe modele të tipit sociologjik, antropologjik, politik, juridik, historik dhe gjeografik e njëkohësisht mund të themi se turizmi është një qasje ndërdisiplinore e këtyre shkencave, fakt i cili na jep shkas të gjendemi përballë një fenomeni tejet kompleks ndërdisiplinor dhe multidisiplinor, që na lejon të arrijmë rezultate kuptimplota vetëm duke përdorur metodologji e qasje të orientuara ndryshe, duke përjashtuar interpretimet e thjeshta dhe teknike që synojnë ta reduktojnë praktikën turistike vetëm në një dimension analitik, pikërisht në atë të zhvillimit të qëndrueshëm.

1.3 Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i këtij studimi është të evidentojë potencialin turistik të rajonit të Korçës si dhe rolin që mund të luajë turizmi kulturor në zhvillimin e qëndrueshëm të këtij rajoni.

Studimi synon: (a) të evidentojë vlerat dhe potencialet turistike, ekonomike e kulturore, në qarkun Korçë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm social – ekonomik të tij.

(b) të bëjë vlerësim të atraksioneve kulturore nëpërmjet frekuentimit turistik dhe përfitimeve që rrjedhin prej tij.

(c) të analizojë ato elementë atraktivë për vizitorët e huaj në territorin që merret në shfrytëzim, si edhe pritshmëritë e përfitimeve social-ekonomike të komunitetit, nga prania e atraksioneve kulturore në territorin e tyre.

(ç) të identifikojë problemet aktuale të menaxhimit të turizmit dhe trashëgimisë kulturore, në lidhje me ruajtjen e vlerave të saj dhe përdorimin turistik.

(d) të analizojë rolin e teknologjisë GIS, nëpërmjet krijimit të gjeoinformacionit të monumenteve të trashëgimisë kulturore, pikave dhe destinacioneve turistike në funksion të informimit të turistëve dhe promovimit të vlerave dhe potencialeve të tyre.

Problemi qëndror që ne përpiqemi ti japim përgjigje në këtë studim është ky: ***Çfarë potencialesh zhvillimore ofron turizmi në qarkun e korçës dhe si mund e duhen integruar ato***

në potencialet zhvillimore ekonomike e social – kulturore të potencialet zhvillimore ekonomike e social – kulturore të këtij qarku ?

1.4 Metodologjia e studimit

Metodologjia e përdorur për realizimin e studimit bazohet në shfrytëzimin dhe kombinimin e të dhënave *primare* dhe *sekondare*. Sipas autorit Therese L.Baker (Doing Social Research) në punën kërkimore, *të dhënat sekondare janë të dhënat që nxirren nga ekzaminimet e studimeve, që të tjerë studiues kanë bërë rreth këtij objekti*. Sigurimi i këtyre të dhënave u mundësua nëpërmjet rishikimit të literaturës në fushën e turizmit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Për realizimin e këtij studimi janë përdorur një sërë metodash si: ajo e hulumtimit, metoda statistikore, metoda e anketimeve, metoda e vëzhgimeve të drejtpërdrejta në terren dhe metoda hartografike.

Metoda e hulumtimit është përdorur për shfrytëzimin e të gjithë literaturës ekzistuese mbi zhvillimin e qëndrueshëm dhe zhvillimit të turizmit në qarkun e Korçës. Janë shfrytëzuar studime dhe botime të ndryshme të sociologeve, arkeologeve dhe studiuesve vendas dhe të huaj në lidhje me turizmin dhe trashëgiminë kulturore të qarkut Korçë, projekte kombëtare dhe ndërkombëtare të ndërmarra në kuadër të zhvillimit të turizmit kulturor të zonës dhe menaxhimit të tyre, plane strategjike të zhvillimit social-ekonomik të qarkut Korçë, përmbledhje statistikore të realizuara nga organizma kombëtar dhe ndërkombëtar (UNWTO, ATLAS, UN, GTZ, SNV) mbi ecurinë e zhvillimit të turizmit, numrit të turistëve, të ardhurat e siguruar nga turizmi etj.

Metoda e anketimeve dhe intervistimeve është një ndër metodat bazë të këtij studimi, e përdorur për përfitimin e të dhënave primare sasiore dhe cilësore. Ajo është realizuar nëpërmjet hartimit dhe realizimit të anketimeve 200 (dyqind) pyetësorë për tre target grupe: turistët e huaj 80 (tetëdhjetë), komunitetin lokal 100 (njëqind) dhe njësitë turistike 20 (njëzetë) pyetësorë. Nëpërmjet përdorimit të kësaj metode është synuar që të dalë në pah rëndësia që ka zhvillimi i turizmit kulturor në zhvillimin social-ekonomik të komunitetit lokal. Gjithashtu pyetjet që përmbanin pyetësorët synonin të nxirrnin opinionin e turistëve mbi ofertën kulturore dhe shërbimet turistike në hapësirën e vizituar. Po kështu anketimi nxori në pah, problematikat me të cilat përballen objektet turistike në këndvështrimin socio – ekonomik.

Metoda statistikore është përdorur për të treguar të dhënat statistikore mbi numrin e turistëve, njësiive akomoduese, të ardhurat që i vijnë popullsisë nga aktivitetet e turizmit. Kjo metodë është përdorur dhe gjatë realizimit të pyetësorëve në rastet kur pyetjet kanë patur natyrë sasiore (vjeljen e informacionit sasior mbi të ardhurat, shpenzimet, etj).

Metoda e krahasimit është një metodë e cila është përdorur për krahasimin e të dhënave statistikore gjatë analizimit të anketimeve. Gjithashtu kjo metodë është përdorur dhe në krahasimin kronologjik mbi zhvillimin e turizmit gjatë dy periudhave të ndryshme kohore (para vitit 1990 dhe pas vitit 1990 deri në ditët e sotme).

Metoda hartografike ka qenë e nevojshme gjatë punimit për interpretimin e të dhënave sasiore dhe hapësinore. Për këtë ishte e nevojshme përvetësimi i dy programeve kompjuterike *Software SPSS* (Statistical Package for the Social Sciences) software *ArGIS 10*. Software *SPSS* është përdorur për interpretimin e të dhënave statistikore të anketimeve të realizuara në terren. Nëpërmjet këtij softi janë ndërtuar të gjithë grafikët në studim dhe janë bërë interpretime të tyre. Ndërsa nëpërmjet software *ArcGIS 10*, është bërë interpretimi hapësinor i trashëgimisë kulturore të qarkut Korçë, paraqitja hartografike e tij, krijimi i gjeo-informacionit të monumenteve të kulturës së qarkut, si dhe itineraret turistike.

Metoda e vëzhgimeve të drejtpërdrejta në terren është përdorur për t'u njohur më nga afër me objektet e trashëgimisë kulturore të qarkut Korçë, si edhe për të evidentuar konkretisht gjendjen e tyre aktuale dhe problemet që lidhen me menaxhimin e këtyre objekteve.

1.5 Organizimi i studimit

Disertacioni është konceptuar në pesë kapituj, ku secili kapitull trajton çështje të veçanta, me synim realizimin e qëllimit dhe përmbushjen e objektivave të studimit.

Në kapitullin e parë është bërë një prezantim i shkurtër mbi rëndësinë e studimit, qëllimin dhe objektivat e studimit, puna e bërë për realizimin e tij si edhe metodologjia e përdorur për arritjen e qëllimit dhe objektivave. Në fund të kapitullit të parë jepen në mënyrë të përmbledhur disa përkufizime dhe koncepte mbi zhvillimin e qëndrueshëm dhe turizmin kulturor, të përdorura në literaturën botërore.

Në kapitullin e dytë është bërë një vlerësim i përgjithshëm fiziko-gjeografik dhe social - ekonomik i qarkut të Korçës. Në funksion të tij, janë trajtuar potenciali natyror (pozita gjeografike dhe kushtet natyrore), organizimi administrativ dhe hapësinor i zonës gjatë

periudhave të ndryshme kohore. Në vijim është bërë vlerësimi i potencialeve humane si dhe zhvillimi social-ekonomik para vitit 1990 dhe pas vitit 1990.

Kapitulli i tretë është fokusuar në evidentimin e potencialit turistik, si dhe në zhvillimin aktual të turizmit kulturor në qarkun e Korçës. Në çështjen e parë të këtij kapitulli është trajtuar trashëgimia kulturore e qarkut, ku është evidentuar i gjithë potenciali kulturor i ndarë sipas trashëgimisë kulturore materiale dhe asaj shpirtërore. Në trashëgiminë kulturore, materiale, përfshihen monumentet arkeologjike, arkitekturore, historike, kultit, etnografike etj. Ndërsa në trashëgiminë kulturore jomateriale ose shpirtërore përfshihen folklori (këngët dhe vallet), festat, traditat, artizanati, gastronomia, etj. Në vijim të këtij kapitulli është trajtuar zhvillimi i turizmit kulturor, ku jepen në mënyrë të përmbledhur disa statistika mbi frekuentimin turistik dhe zhvillimin e tij në qarkun e Korçës. Në vijim trajtohen itineraret turistike dhe qytetet dhe fshatrat turistike, duke nxjerr në pah avantazhet dhe disavantazhet në zhvillimin e tyre. Në mbyllje të kapitullit, i rëndësishëm është perceptuar edhe trajtimi i rolit të imazhit për zhvillimin e turizmit në një hapësirë gjeografike të caktuar dhe konkretisht për qarkun e Korçës.

Kapitulli i katërt bën një analizë të hollësishme të anketimeve të realizuara në terren. Në çështjen e parë të kapitullit jepen disa të dhëna të përgjithshme mbi hartimin e pyetësorëve dhe realizimin e anketimeve, ku tregohet se në anketime janë përfshirë tre target grupe: turistët e huaj, komuniteti lokal dhe njësitë turistike. Në çështjen e dytë është bërë analiza e pyetësorëve të realizuar me turistët, motivacionet dhe vlerësimi i tyre për trashëgiminë kulturore të qarkut. Në vijim, në çështjen e tretë është bërë analiza e pyetësorëve të realizuar me komunitetin lokal të zonës, e fokusuar në njohuritë e tyre mbi trashëgiminë kulturore dhe përfitimet nga zhvillimi i turizmit kulturor. Në çështjen e tretë është bërë analiza e anketimeve të realizuara me njësitë turistike e fokusuar në shërbimet dhe përfitimet e tyre nga zhvillimi i turizmit. Kapitulli përmbyllet me një analizë të shkurtër mbi ndikimin e zhvillimit të turizmit kulturor në zhvillimin social dhe ekonomik të zonës.

Kapitulli i pestë trajton menaxhimin e trashëgimisë kulturore në qarkun e Korçës. Në këtë kapitull janë trajtuar konventat ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është aderuar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, legjislacioni kombëtar dhe aktorët përgjegjës për mbrojtjen dhe mirëmenaxhimin e objekteve të trashëgimisë kulturore. Gjithashtu, këtu janë trajtuar projektet e zbatuara për menaxhimin dhe vënien e trashëgimisë kulturore në funksion të zhvillimit të

turizmit. Trajtimi i problemeve aktuale me të cilat po përballlet aktualisht trashëgimia kulturore zënë një vend të rëndësishëm. Së fundmi, nëpërmjet përdorimit të teknologjisë GIS (Sistemi i Informacionit Gjeografik), është krijuar gjeo-informacioni i trashëgimisë kulturore të qarkut Korçë, si nevojë për një mirëmenaxhim dhe promovim të vlerave të saj.

KAPITULLI II: SKELETI TEORIK

2.1 Koncepte dhe përkufizime mbi zhvillimin e qëndrueshëm dhe turizmin

Zhvillim: është akti ose procesi i të zhvilluarit, rritja.

Zhvillimi i qëndrueshëm (Sustainable Development): zhvillim i cili takon nevojat e të tashmes pa kompromentuar aftësitë e brezave të ardhshëm për të arritur nevojat e tyre. Komisioni për Zhvillim dhe Mjedis publikoi një rezolutë e njohur edhe si Brutland Report, e cila u publikua më 1987; kjo rezolutë formalisht kërkoi të tërhiqte vëmendjen botërore për të vlerësuar keqpërdorimin e mjedisit human si edhe burimeve natyrore si edhe pasojat e këtij keqpërdorimi për zhvillimin ekonomik-social. Në zbatim të këtyre thirrjeve, vëmendja kryesore e shoqërisë në nivel global pas këtij samiti do të përqendrohej në dy ide kryesore se: mirëqenia e mjedisit, e ekonomisë dhe e shoqërisë është pazgjidhshmërisht e lidhur dhe se zhvillimi i qëndrueshëm përfshin bashkëpunim në nivel global, rajonal dhe lokal.

Zhvillim i qëndrueshëm do të thotë integrim: zhvillim në një mënyrë të tillë ku përfitojnë sektorët një shkallë më të madhe të mundshme përtej kufijve dhe midis brezave. Me fjalë të tjera, mendimet tona duhet të marrin në konsideratë impaktet e rëndësishme për shoqërinë, mjedisin dhe ekonominë, duke mos harruar që veprimet tona kanë impakte gjithkund, si edhe për të ardhmen.

Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm përdoret për të artikuluar shumë drejtime themelore të perspektivës me mënyrën sesi ne jemi të lidhur me botën që na rrethon dhe për pasojë çfarë presim ne nga qeveritë për të bërë politika që ndihmojnë dhe mbështesin pamjen e botës.

Cilat janë disa nga treguesit e zhvillimit të qëndrueshëm:

- zhvillimin e qëndrueshëm mund ta vesh re kur ka shpërndarje të përfitimeve të rritjes ekonomike tek të gjithë qytetarët;
- t'i kthesh fushat e kafta (ideja është të pajetë) në zona urbane me projekte banimi në terma ekologjike;
- të rrisësh mundësitë e edukimit së bashku, për vajzat dhe djemtë;

- ë zhvillosh procese industriale inovative me efikasitet energjie dhe pak ndotje;
- ë përfshish qytetarët dhe vendimmarrësit në procesin politikë-bërës;
- ë shfrytëzosh potencialet natyrore, historike dhe kulturore për zhvillim turistik.

Me rëndësi është të theksojmë faktin se natyra e bashkëpunimit, e ndërlidhjes dhe ndërveprimit e zhvillimit të qëndrueshëm thërret për aksione që nuk njeh kufij, pavarësisht se ata janë gjeografike apo institucionale, me qëllim që të koordinohen strategjitë dhe vendimmarrjet.

Një drejtim tjetër i zhvillimit të qëndrueshëm ka të bëjë me sjelljen e ndershme dhe barazinë e brezave, çka do të thotë që burimet pavarësisht nëse janë ekonomike, sociale apo mjedisore, duhet të përdoren dhe të shpërndahen në mënyrë të ndershme midis brezave. Jo vetëm një brez duhet të përfitojë apo të vuajë nga pasuria apo mungesa e burimeve. Zhvillimi i qëndrueshëm nuk ka të bëjë vetëm me çështje të një planeti të pastër, të shëndetshëm për brezat e ardhshëm, por gjithashtu duhet të trajtojë problemet e medikamenteve, financiare dhe kërkesat sociale të popullsisë së moshuar.

2.2 Kultura dhe trashëgimia kulturore

Kultura është përdorur shpesh në sensin e përditshëm si “mënyrë e jetesës” apo “shprehëse e artit”.⁵ Këto kuptime tashmë janë integruar së bashku duke krijuar një sistem vlerash dhe përfitimesh. Ky koncept është trajtuar gjërësisht nga antropologu britanik Edwart Burnett Tylor në *Primitive Culture* (1871), sipas të cilit; “*kultura është një tërësi komplekse që përfshin njohuritë, besimin, artin, parimet, ligjin, zakonet, dhe gjithçka tjetër të krijuar nga aftësitë e njeriut si anëtar i shoqërisë*”.⁶ Dy autorët tjerë kanë dhënë një përkufizim më krahasues të kulturës duke kombinuar një sërë elementesh kyç: “*kultura është një trashëgimi e mësuar, shoqërisht e transmetuar e objekteve, njohurive, besimit, vlerave dhe pritshmërive normative, që i mbartin anëtarët e një shoqërie për t’u përballur me probleme të përsëritura*”.⁷

⁵ Rana, R & Piracha, A., 2007, Cultural framework, Urban crisis, Culture and sustainability of cities, Edited by M. Nadarajah and Ann Tomoko, Tokyo, f.22

⁶ J. Jokilehto; Definition of culture heritage (Originally for ICCROM, 1990); Revised for CIF: 15 January 2005; ICCROM Working Group 'Heritage and Society', JJ; f.4

⁷ Goodman, N. and G.T Marx, 1978, Society Today. 3-rd edition, New York: CRM Roundam House; f. 79, (cit. Colin J.V. Zyl, The role of tourism in the conservation of cultural heritage with particular relevance for South Africa, PhD dissertation, 2005, f.4.)

Me nënshkrimin e Kartës së Venecias në 1964, u dhanë disa rekomandime në lidhje me përcaktimin e konceptit të trashëgimisë kulturore. Sipas Konventës së UNESCO-s (Neni 1), *trashëgimi kulturore konsiderohen:*

1- *Monumentet*; veprat arkitekturore, veprat skulpturore dhe të pikturuara, elementet apo strukturat me natyrë arkeologjike, mbishkrimet, vendbanimet shpelllore dhe kombinime të elementeve, të cilët kanë vlera universale nga këndvështrimi i historisë, artit dhe shkencës.

2- *Grupe ndërtesash* të ndara ose të bashkuara, të cilat për shkak të arkitekturës së tyre, homogjenitetit apo vendit që zënë në mjedis, kanë vlera të jashtëzakonshme universale nga këndvështrimi i historisë, artit dhe shkencës.

3- *Sitet*, veprat e njeriut ose veprat e kombinuara të njeriut dhe natyrës, zonat që përfshijnë vende arkeologjike, të cilat janë me vlera universale nga këndvështrimi historik, estetik, etnologjik dhe antropologjik⁸.

Sipas nenit 4 të kësaj Konvente “*Trashëgimia është detyra për të siguruar identifikimin, mbrojtjen, konservimin, prezantimin dhe transmetimin në brezat e ardhshëm të trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore*”.

Në fund të shekullit të XX (1999) koncepti i trashëgimisë kulturore i dhënë nga UNESCO dhe i pranuar ndërkombëtarisht, përfshin trashëgiminë kulturore materiale dhe jomateriale ashtu sikurse edhe mjedisin. Në Konventën e UNESCO-s në vitin 2003, trashëgimia jomateriale u përcaktua si: “*Praktikat, përfaqësimet, shprehjet, njohuritë, zotësitë, ashtu sikurse instrumentet, objektet, zonat kulturore së bashku me komunitetet, grupet dhe individët si pjesë e trashëgimisë kulturore të tyre. Kjo trashëgimi kulturore jo materiale e transmetuar brez pas brezi është krijuar nga komunitetet përgjegjëse për mjedisin e tyre, si lidhje e natyrës me historinë duke u siguruar atyre identitetin dhe vazhdimësinë ashtu sikurse promovimin e respektit për diversitetin kulturor dhe krijimtarinë njerëzore*9...”.

Një përkufizim i plotë për trashëgiminë kulturore ka dhënë studiuesja japoneze Tolina Loulanski, sipas së cilës “*Trashëgimia kulturore përfshin aspekte të kulturës materiale –site, ndërtesa, peizazhe, monumente dhe objekte ashtu sikurse kulturën jomateriale (shpirtërore)*

⁸Yahaya A., 2006, The Scope and Definitions of Heritage: From Tangible to Intangible, International Journal of Heritage Studies (Routledge)Vol. 12, No. 3, f.295.

⁹UNESCO. Convention for the Safeguarding of the Intangible Cultural Heritage. 32nd Session of the General Conference, Paris, 2003. (cit. Prof. Dr. Jukka Jokilehto, On Definitions of Cultural Heritage, Heritage Theory Teoría sobre el Patrimonio, 2008, ICOMOS JURNAL, f.21).

aspekte të cilës janë mishëruar në praktikat sociale, jetën e komunitetit, vlerat, besimet dhe format shprehëse si gjuha, artet, zejtaritë, muzika dhe vallet”.¹⁰Ajo thekson se “koncepti i trashëgimisë kulturore po evoluon, si rezultat dhe në përputhje me qëndrimet, nevojat dhe kërkesat e njerëzve drejt saj”.¹¹

Në botimet e fundit të trashëgimisë evidentohen shpjegime të këtij koncepti në *kontekstin hapësinor* (në lidhje me vendin, kalimin e kohës së lirë dhe turizmit) dhe në realitetin historik, identitetin kombëtar, planifikimin dhe ruajtjen, edukimin formal dhe informal, biznes dhe modelim¹².Elementët më karakteristik të trashëgimisë janë elasticiteti dhe dinamizmi. Ajo që e bën trashëgiminë elastike është fakti që në kuptimin e gjerë të saj përfshin “*çdo gjë që trashëgohet nga e kaluara*” dhe në kuptimin e ngushtë përfshin atë çka ka domethënie historike dhe kulturore¹³. Përkufizime të tjera e përcaktojnë kulturën si “*qëllime bashkëkohore të së kaluarës*” ose “*ajo pjesë e së kaluarës të cilën ne e kemi përzgjedhur në të tashmen për qëllime bashkëkohore, qofshin këto ekonomike, kulturore, politike apo sociale*”.¹⁴

Sipas Colin Michael Hall & McArthur identifikohen katër vlera kryesore të trashëgimisë¹⁵: *vlera ekonomike* të cilat lidhen me gjenerimin e të ardhurave që i vijnë një vendi si rezultat i shfrytëzimit të kësaj trashëgimie për qëllime turizmi dhe rekreacioni; *vlera sociale dhe kulturore*, të cilat shprehen në lidhjen e fortë shpirtërore të njeriut me vendin dhe identitetin e tij në nivel lokal dhe kombëtar; *vlera shkencore dhe educative*, të cilat shprehen në transmetimin e vlerave kulturore nga njëri brez tek tjetri, për të kuptuar më mirë nivelin e lartë kulturor që e karakterizon periudhën e ndërtimit të tyre; *vlera politike* shprehet nëpërmjet përdorimit të trashëgimisë kulturore dhe vlerave që ajo përmban nga ana e politikanëve për të promovuar vlerat historike dhe identitetin e tyre kombëtar.

¹⁰ Loulanski, T; 2006 Loulanski, T; Cultural Heritage in Socio-Economic Development:Local and Global Perspectives Environments, IDEAS, Journal Volume 34(2) 2006, f. 54-55.

¹¹ Loulanski, T; 2006 Local and Global Perspectives Environments, IDEAS, Journal Volume 34(2) 2006, f. 88

¹²Loulanski, T., 2006, Revising the Concept for Cultural Heritage: The Argument for a Functional Approach, International Journal of Cultural Property, f. 209.

¹³ Po aty, f.210.

¹⁴ Graham, Brian, Gregory Ashworth and John Tunbridge; Geography of Heritage –Power, Culture and Economy; Arnold, London 2000, f. 2, 157 (cit.në Loulanski 2006, Cultural Heritage in Socio-Economic, . f.54).

¹⁵ Hall, M., & McArthur S., 1996, The Human Dimension of Heritage Management: Different Values, Different Interests, Different Issues; f. 2-21 (cit.Duhil K. Sustainable World Heritage Site Management: Between interpretation, conservation and visitor management – case study of Bamberg, master thesis, 2005, f.8)

2.3 Kultura dhe zhvillimi

Zhvillimi mund të konceptohet në shumë mënyra. Që në fillimet e tij deri në vitin 1940, zhvillimi ishte i lidhur ngushtë me evoluimin e teknologjisë, modernizimin dhe rritjen ekonomike¹⁶. Shoqëritë e prapambetura dhe të zhytura në varfëri e kanë kërkuar zhvillimin nëpërmjet industrializimit, zhvillimit të teknologjisë bujqësore, përhapjes së arsimit modern dhe vlerave kulturore¹⁷. Në dekadat e fundit të shekullit të kaluar zhvillimi u konceptua më gjerë, veçanërisht në vitet 1980-90-të. Në një koncept të dhënë nga UNDP (1994), thuhet: *“është bërë e nevojshme që zhvillimi ekonomik së bashku me atë mjedisor, social dhe zhvillimin kulturor të konsiderohen si një zhvillim i tërë – zhvillim i qëndrueshëm”*.¹⁸

Në konferencën e Venecias, në vitin 1999, Rene Maheu, (Drejtor i përgjithshëm i UNESCO-s) u shpreh: *“Ideja e zhvillimit ka ardhur gradualisht duke u bërë më e gjerë, më e thellë dhe më e shumëllojshme në mënyrën që shkon përtej aspekteve thjesht ekonomike të përmirësimit të njerëzimit, ajo tani përqafon edhe aspektet sociale... Njeriu është kuptimi dhe fundi i zhvillimit, ai nuk është paraqitje një dimensionale e “homo economicus”, por një realitet i gjallë, një qenie humane në nevojat e pafundme të tij, potencialet dhe aspiratat e tij... Në konceptin e zhvillimit qendra e gravitetit është zhvendosur nga ekonomike në sociale dhe ne kemi arritur në një pikë ku kjo zhvendosje po fillon t’i qaset kulturës”*.¹⁹

Në literaturën e sotme, në artikuj dhe studime shkencore, si dhe në përcaktimet e bëra nga organizmat ndërkombëtare të fushës së turizmit dhe trashëgimisë, përdoren termat *turizëm kulturor* dhe *turizëm i trashëgimisë* (culture/heritage tourism). Nga këto përcaktime në pamje të parë të krijohet ideja e trajtimit të tyre si dy fusha të ndryshme. Kjo për faktin se sipas koncepteve të trashëgimisë kulturore, ajo është e përcaktuar si e tillë, ndërkohë që kultura si koncept është më gjithëpërfshirëse. Megjithatë qëllimet aktuale të politikave zhvillimore në fushën e turizmit synojnë zhvillimin e turizmit kulturor duke shfrytëzuar gjithë burimet kulturore të disponueshme.

¹⁶Richtscheid, K., The Use of Cultural Heritage in Economic and Human Development: A Comparison of Built Heritage Projects in Morocco and British Columbia, (master thesis) 2011, f.7

¹⁷ Escobar, A., 1995, Encountering Development: The Making and Unmaking of the Third World. Princeton, New Jersey: Princeton University Press, f. 4. (cit. Richtscheid, K., The Use of Cultural Heritage in Economic and Human Development..... f. 7)

¹⁸ Cituar nga Loulanski, T, në artikullin e saj (2006) f.52; United Nations Development Program (UNDP). 1994. Human Development Report 1994. Oxford University Press.

¹⁹ Po aty, f; 53

Organizata Botërore e Turizmit (WTO) e përkufizon turizmin si: *“aktivitetet e individëve gjatë udhëtimit dhe qëndrimit të tyre në një vend jashtë vendit të zakonshëm të banimit, në një periudhë më pak se një vit, për kalimin e kohës së lirë, biznes apo qëllime të tjera”*.²⁰

Në këtë Organizata Evropiane e Turizmit dhe Kalimit të Kohës së Lirë (ATLAS) e përkufizon turizmin kulturor si *“lëvizjen e njerëzve drejt atraksioneve kulturore, larg prej vendit të banimit, me qëllim mbledhjen e informacioneve dhe eksperiencave për të kënaqur nevojat e tyre kulturore”*.²¹ Studiuesja Catherine Trautmann (1994) thekson: *“Turizmi kulturor nuk është vetëm turizmi i trashëgimisë kulturore. Turizmi kulturor punon si një rrjet. Në të vërtetë ai përfshin lloje të artit, siç janë vallja, muzika, teatri...”*.²² Kështu turizmi kulturor mund të përkufizohet si: *“vizita njerëzish nga jashtë të motivuar plotësisht apo pjesërisht nga mikpritja e komunitetit, me interes në trashëgiminë historike, artistike, shkencore apo stilin e jetesës së ofruar nga një komunitet, një rajon, një grup apo një institucion”*.²³

Përfshirja në rritje e kulturës në turizëm si një komponent bazë për industrinë e turizmit është një ndryshim që ka bërë shumë autorë të sugjerojnë që rritja e tanishme e turizmit kulturor është diçka “e re” dhe e ndryshme në mënyrë cilësore dhe sasiore nga turizmi kulturor i Grand Tour. Prandaj turizmi kulturor po pëson ndryshime në të dy termet: *“në mënyrën në të cilën turistët e konsumojnë kulturën dhe në mënyrën në të cilën kultura ofrohet për konsum turistik”*.²⁴

Turizmi kulturor në mënyrë të përsëritur është identifikuar si një burim i fuqishëm ekonomik dhe social, *“një aset zhvillimi, që mund të përdoret si katalizator për zhvillim në nivel lokal, të sigurojë punësim, të gjenerojë të ardhura, rivitalizojë hapësirat urbane dhe rurale, mbrojtjen e mjedisit dhe forcimin e komuniteteve sociale”*.²⁵

Partneriteti ndërmjet ruajtjes dhe shfrytëzimit të potencialeve është në përputhje me pesë parimet e zhvillimit social-ekonomik të shekullit të XXI: *“globalizimin, lokalizimin, diversitetin,*

²⁰ Cit. në Richards, G., 1996, (ATLAS) Cultural Tourism in Europe, published by CAB international, Wallingford, UK, f.22

²¹ Po aty, f. 25

²² Trautmann, C., “Strasbourg mise sur la Culture”, Cahiers espaces Nr. 37, Paris, Espaces 1994 (cit. Karine, D., Sustainable World Heritage Site Management: Between interpretation, conservation and visitor management – case study of Bamberg, master thesis, 2005, f.11)

²³ Silberberg, T., Cultural tourism and business opportunities for museums and heritage sites, Tourism Management, 1995, 16 (5), 361-365 (cit. Karine, D., 2005, f.12)

²⁴ Po aty, f.12

²⁵ World Bank/UNESCO. 1998. *Culture in Sustainable Development: Investing in Cultural and Natural Environments. Proceedings of the Conference sponsored by the World Bank and UNESCO*, Washington 1998.

qëndrueshmërinë, përgjegjshmërinë dhe përforcon gjithashtu pesë ndjenjat e cilësisë së komuniteteve: ndjenjën e vendit, të identitetit, evolucionit, pronësisë ose ndarjes dhe ndjenjën e komunitetit”.²⁶

Parashikimet tregojnë se investimet në trashëgiminë kulturore do të rriten edhe më tej me bërjen e saj “*produkti më i rëndësishëm i shekullit të 21, përcaktues i të ardhmes së komuniteteve*”.²⁷

Turizmi kulturore është pjesë e zhvillimit të qëndrueshëm, së bashku me tre komponentët e tjerë, ekonominë, shoqërinë dhe mjedisin. Përfitime të shumta sociale dhe ekonomike mund të arrihen nga vlerësimi dhe mbrojtja e saj. Sipas studiueses japoneze Loulanski, vëmendja dhe debatet midis teoricienëve dhe praktikantëve duhet të përqendrohen jo shumë në pyetjen “*nëse*”, por në pyetjen “*se si*” trashëgimia kulturore, turizmi dhe zhvillimi mund të integrohen me sukses në mënyrë të qëndrueshme²⁸. Referuar praktikave ndërkombëtare ekzistojnë mjaft shembuj të integritit të trashëgimisë kulturore në zhvillimin social-ekonomik. Shembujt përfshijnë hapësira urbane dhe rurale, kombëtare dhe lokale nga vendet e industrializuara dhe ato në zhvillim (Angli, vendet e Bashkimit Evropian, Kanada, Australi, Japoni, vendet e Lindjes së Mesme, vendet e Afrikës Veriore, etj). Megjithatë referuar studiuesve, trashëgimia kulturore e trajtuar në aspektin e zhvillimit, mbetet ende një fushë që ka nevojë për kërkime të mëtejshme si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik.

2.4 Vlerësimi i trashëgimisë kulturore si pjesë e zhvillimit të qëndrueshëm

Ideja se njohja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore mund të jetë ekonomiksht përfituese shkon prapa në 1970, kur PNUD dhe Banka Botërore, filluan të japin fonde për mbrojtjen e mjediseve të ndërtesave dhe zhvillimin e artizanatit, duke i justifikuar në terma thjesht ekonomik²⁹. Trashëgimia kulturore gjithnjë e më shumë po njihet si e mirë publike dhe

²⁶ Rypkema, D., 1999, *Culture, Historic Preservation and Economic Development in the 21st Century*, Paper for the Leadership Conference on Conservancy and Development, Yunnan Province, China

²⁷ Ogino, Masahiro, ed. 2002. *The Sociology of Cultural Heritage, From the Louvre to Hiroshima Dome*, Tokyo: Shin-Yo-Sha. f. 277 (cit. Loulanski 2006, f.56)

²⁸ Loulanski, T; Cultural Heritage in Socio-Economic Development: Local and Global Perspectives; *Environments Journal* Volume 34(2) 2006; f.65

²⁹ UNESCO, Report of the World Commission on Culture and Development. 1995. *Our Creative Diversity*, Paris, f.182

përfitimet e saj shihen si ndërkombëtare³⁰. Ajo mund të ketë vlera ekonomike dhe joekonomike. *Përfitimet ekonomike* përfshijnë reduktimin e varfërisë dhe krijimin e vendeve të punës nëpërmjet ndërtimit, turizmit, artit dhe prodhimeve të artizantatit, bizneseve të shumëllojshme dhe mundësive për investime³¹. *Në vlerësimin joekonomik* trashëgimia kulturore konsiderohet si vlerë për edukimin dhe ndërgjegjësimin, kultivimin e identitetit, kohezionin social, zhvillimin e potencialit njerëzor si dhe ruajtjen dhe transmetimin në brezat e ardhshëm. Ndërkohë që disa studiues e shikojnë me rrezik vlerësimin e trashëgimisë kulturore në aspektin ekonomik, disa të tjerë përpiqen të japin metodat për të demonstruar përfitimet e mundshme.

Mirëmenaxhimi është çelësi për trashëgiminë kulturore që të përdoret për qëllime të zhvillimit. Banka Botërore vë në dukje se trashëgimia kulturore mund të rrisë vlerat, mund të vjelë përfitimet, ndërkohë që pasuria ruhet në mënyrë efektive. Larg nga të qenurit vetëm një detyrim për buxhetet kombëtare, trashëgimia është dhe po bëhet gjithnjë e më shumë një “vlerë e shtuar”.³² Kështu ruajtja nuk shihet si një pengesë për zhvillimin, siç ishte dikur por gjithmonë e më shumë po shihet, se mund të jetë partner në zhvillim³³. Në një vlerësim që studiuesi Randall Mason, bën për konservimin e trashëgimisë kulturore dhe vlerat ekonomike që lidhen me të, përmend thënien e Neville Agnew: “*Ne të gjithë duhet të kujtojmë se përfitimet ekonomike të trashëgimisë kulturore avullojnë, në qoftë se vlerat e tjera kulturore, sociale, estetike të saj, nuk respektohen apo humbasin*”³⁴.

Përcaktimet e koncepteve të trashëgimisë dhe turizmit kulturor në Shqipëri janë bërë në përputhje me përcaktimet e dhëna nga UNESCO dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë të trashëgimisë kulturore dhe turizmit. Referuar trajtimeve të mësipërme, në objektin tonë të studimit do të konsiderojmë trashëgimi kulturore çdo element të kulturës materiale dhe shpirtërore të trashëguar nga e kaluara, që mbart vlera kombëtare dhe lidhet me identitetin rajonal dhe lokal.

³⁰Cerneia,M., 2008 , "The Developmental Potential of Cultural Heritage Environments," in Cultural Heritage in the Arab World, edited by Fekri Hassan, Abisia de Trafford & Mohsen Youssef, f.126 Alexandria, Egypt (cit. Richtscheid K., The Use of Cultural Heritage in Economic and Human Development: A Comparison of Built Heritage Projects in Morocco and British Columbia, (master thesis) 2011, f.11

³¹ Po aty f.131

³² World Bank. 2001, Cultural Heritage & Development : A Framework for Action in the Middle East & North Africa, Washington D.C, World Bank, f.44.

³³ Loulanski, T., 2006, Cultural Heritage in Socio-Economic Development: Local and Global Perspectives. Environments, 34 (2); f 56.

³⁴Mason, R., Economics and Heritage Conservation, A Meeting Organized by the Getty Conservation Institute, December 1998, Getty Center, Los Angeles, f.11.

2.5 Vlerësimi gjeografik dhe social – ekonomik i qarkut Korçë

Qarku i Korçës ka një potencial të konsiderueshëm natyror dhe human. Pozita gjeografike, kushtet natyrore në të cilat ai ndodhet si edhe dinamika e popullsisë, kanë ndikuar në zhvillimin e dukshëm social dhe ekonomik, që nga periudhat e hershme e deri në ditët e sotme. Kjo ofertë natyrore dhe humane, si dhe zhvillimi në nivel të lartë kulturor bëjnë që sot qarku i Korçës të ketë një trashëgimi të pasur kulturore. Për këtë arsye është menduar që në këtë kapitull të bëhet një vlerësim gjeografik dhe social-ekonomik i hapësirës së studimit. Kapitulli është konceptuar në katër çështje kryesore.

Në çështjen e parë është trajtuar potenciali natyror, ku përfshihen pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të qarkut.

Çështja e dytë e kapitullit i është kushtuar organizimit administrativ dhe hapësinor në rang kronologjik nga antikiteti deri në ditët e sotme. Në vijim të kapitullit është trajtuar *çështja e potencialit human*, si evolucioni dhe dinamika e popullsisë, struktura gjinore, klasifikimi i vendbanimeve etj.

Çështja e fundit e këtij kapitulli është vlerësimi social-ekonomik i qarkut Korçë, i trajtuar në dy periudha kohore, para vitit 1990 dhe nga viti 1990 deri në ditët e sotme. Kapitulli përmbyllet me konkluzionet përkatëse.

Vlerësimi gjeografik dhe social-ekonomik i hapësirës së studimit, është mbështetur në studimet ekzistuese sipas tematikave të trajtuara, mbi bazën e metodave të hulumtimit, analizës, metoda statistikore, krahasuese etj.

2.6 Potenciali natyror i qarkut Korçë

2.6.1. Pozita gjeografike

Qarku i Korçës shtrihet në Rajonin Juglindor të Shqipërisë. Ai ka një shtrirje veri-jug 85 km dhe lindje-perëndim 42 km, me një sipërfaqe³⁵ territoriale prej 3711 km. Kjo pozitë gjeografike ka luajtur një rol përcaktues në zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor të tij. Nëpërmjet rrjetit rrugor, Korça dhe qytetet e tjera të qarkut, lidhen me kryeqendrën e vendit, Tiranën, në veri dhe qendrën e jugut Gjirokastrën.

³⁵ Të dhënat janë siguruar nga Këshilli Qarkut Korçë, (sipërfaqja e qarkut është llogaritur nga INSTAT në regjistrimin e vitit 2011. Sipas llogaritjeve sipërfaqja e përcaktuar nga Këshilli i Qarkut është 3697 km².

Pozita gjeostrategjike në të cilën ndodhet qarku i Korçës, në një zonë ndërkufitare me Greqinë dhe FYROM, ka bërë që në të, të kalojnë akse të rëndësishme komunikacioni që lidhin Shqipërinë me Ballkanin Juglindor e më gjerë. Prania e pesë pikave doganore (Qafë Thanë, Tushemisht, Goricë e Vogël, Kapshticë dhe Tre Urat) ka ndikuar në lehtësimin e lëvizjes së mallrave dhe njerëzve me drejtim të ndërsjellë midis këtyre vendeve. Në këtë kontekst forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar midis tre vendeve në fushën e turizmit, do të rriste interesin dhe fluksin e vizitorëve të huaj dhe do ta shndërronte zonën në një destinacion të zhvilluar turistik.

2.6.2. Kushtet natyrore

Bazuar në rajonizimin fiziko-gjeografik të Shqipërisë, qarku i Korçës përfshihet në pjesën jugore të Krahinës Malore Qendrore, në njësinë Gropat Juglindore dhe Malet përreth tyre³⁶. Ndërtimi gjeologjik i tij karakterizohet nga formacione të shumëllojshme gjeologjike të shkëmbinjve sedimentare, që zënë 3/4 e territorit, të përfaqësuara nga kryesisht nga terrigjenët, gëlqerorët dhe magmatikët. Dinamika e proceseve gjeologjike është pasqyruar në format atraktive të relievit (gropa, fushëgropa, lugina, male, vargmale, etj). Hidrografia e pasur me ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore (lumenj, liqene, përrenj), toka pjelloret dhe biodiversiteti i lartë e bëjnë më të larmishme ofertën gjeografike-natyrore të qarkut.

Relievi

Evolucioni gjeologjik dhe dinamika intensive e tij, që kanë karakterizuar territorin e pjesëve përbërëse të të gjitha trevave, kanë mundësuar dominimin e relievit malor me forma të çrregullta dhe të larmishme. Në kompleksitetin e formave të relievit dallohen: male, blloqe malore, malësi me reliev të ndërlikuar, vargje malore, lugina, gropa e fushëgropa, të cilat lidhen midis tyre me pragje, qafa e gryka. Në tërësi malet zënë rreth 58 % të sipërfaqes, kodrat 17 % dhe fushat 25 %.³⁷ Maja më e lartë është *Gramozi* (2523 m), i cili shtrihet në pjesën juglindore të qarkut Korçë. Lartësia mesatare e relievit arrin në 1162.48 m.³⁸ Shtrirja gjeografike e qarkut si dhe larmia e formave të relievit, kanë favorizuar praninë e

³⁶ Qiriaz, P., 2006, Gjeografia fizike e Shqipërisë, Ideart, Tiranë, f.235. Pjesë e qarkut të Korçës është edhe bashkia e Leskovikut dhe zonat rurale përreth që shtrihen në Krahinën Malore Jugore (Malësia Dangëlli-Leskovik) f.284.

³⁷ Regional development strategy, Korça region, f.15

³⁸ Belba, A., 2013, Desertacion Gjeografia e sektorit terciar, f.42

vendbanimeve të shumta, infrastrukturë lehtësuese komunikimi dhe mundësi mjaft të mira për zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit. Disa nga njësitë fiziko-gjeografike, ku janë përqendruar dhe vendbanimet më të rëndësishme janë: fushëgropa e Korçës (300 km²)³⁹, gropa e Prespës Madhe, gropa e Prespës së Vogël, gropa e Pogradecit, gropa e Kolonjës dhe lugina e Devollit të sipërm.

Klima

Qarku i Korçës karakterizohet nga një klimë mesdhetare me ndikim të dukshëm kontinental. Në formimin e klimës kanë ndikuar disa faktorë si: lartësia mbi nivelin e detit, largësia nga deti, ndikimi i grykave dhe depërtimi i masave të ftohta ajrore nga lindja, si edhe një sërë faktorësh të tjerë fiziko-gjeografik. Temperatura mesatare vjetore është 20°C, por ajo ndryshon nga njëra zonë në tjetrën. Në qytetin e Korçës temperatura mesatare vjetore arrin 10.5 °C, e korrikut 20 °C, e janarit 0,5 °C, në Voskopojë 7,5 °C, në Dardhë 8,3 °C dhe në Vithkuq 8,7 °C⁴⁰. Ndërsa minimumi i temperaturës është shënuar në Sheqeras me -26,9 °C⁴¹. Klima e luginave dallohet për ndikim të ndjeshëm kontinental, ndërsa në gropa ndryshimet klimatike kushtëzohen nga pozicioni gjeografik, lartësia mbi nivelin e detit, ekspozimi ndaj erërave që fryjnë në qafat dhe grykat e shumta.

Sasia e reshjeve është e pakët dhe ka shpërndarje të pabarabartë në njësitë përbërëse të qarkut, por edhe brenda njësisë. Në vit bien mesatarisht 600-700 mm reshje shiu.⁴² Reshjet e borës janë një fenomen i zakonshëm, të cilat arrijnë deri në 100 cm (lartësitë mbi 1000 m mbi nivelin e detit). Reshjet e borës kanë favorizuar dhe zhvillimin e sportit dimëror të skive (Dardhë, Voskopojë, Moravë). Klima e favorshme me verë të freskët e dimër me dëborë dhe me vlera kurative, ka bërë që qarku i Korçës të jetë i frekuentuar nga turistët gjatë gjithë vitit.

Pasuritë ujore

Pasuritë ujore të qarkut janë të bollshme dhe përfaqësohen nga lumenjtë, liqenet dhe përrenjtë. Rrjedhjet ujore sipërfaqësore përfaqësohen nga rrjedhja e sipërme e lumit të Devollit, Osumit dhe lumi i Dunavecit (i cili ka më tepër karakterin e një përroi). Hapësirës gjeografike

³⁹ Qiriaz, P., 2006, Gjeografia fizike e Shqipërisë, Ideart, Tiranë, f.235

⁴⁰ Belba, A., 2013, Desertacion Gjeografia e sektorit terciar, f.47

⁴¹ Po aty,

⁴² Shërbimi meteorologjik qarku Korçë

të qarkut të Korçës i përkasin dy liqene: liqeni i Ohrit dhe liqeni i Prespës. Liqenet përbëjnë një pasuri me vlera të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare.

Liqeni i Ohrit ka origjinë tektonike dhe ekzistojnë mendime të studiuesve që e përcaktojnë si liqeni më i vjetër në Evropë⁴³. Sipërfaqja e pasqyrës së ujit të liqenit është 362,6 km² nga të cilat 111.4 km² i përkasin territorit të Republikës së Shqipërisë, ndërsa 251,2 km² në FYROM⁴⁴. Temperatura mesatare shumëvjeçare e ujërave të liqenit të Ohrit është 1.4 °C më e lartë në krahasim me ato të ajrit. Kjo ndikon dhe në zbutjen e klimës së qarkut. Liqeni dallohet për speciet e rralla të peshqëve, (26 specie molusqesh) midis të cilëve për koranin, belushkën etj. Në lashtësi (sipas gojëdhënave) liqeni njihej me emrin Lyhnidas, (liqeni i Dritës). Përreth tij janë zbuluar monumente të rëndësishme arkeologjike dhe arkitekturore. Për peizazhin dhe vlerat e tij ekologjike dhe kulturore, në vitin 1979 liqeni Ohrit u shpall nga UNESCO Trashëgimi Natyrore Botërore. Kontrolli i mbeturinave të ngurta si edhe sistemimi i kanalizimit të ujërave të zeza, duke shmangur derdhjen e tyre në liqen, ka ndikuar në cilësinë e peizazhit dhe ka rritur fluksin e vizitorëve vendas dhe të huaj në sezonin e verës.

Liqeni i Prespës përbëhet nga liqeni i Prespës së Madhe dhe i Prespës së Vogël me sipërfaqe të përgjithshme të pasqyrës së ujit 329 km², prej të cilave Prespës së Madhe i përkasin 285 km², ndërsa Prespës së Vogël 44 km².⁴⁵ Origjina e formimit është e njëjtë me liqenin e Ohrit (tektoniko-karstike) dhe ushqehet nga përrenj të shumtë malorë. Në përgjithësi temperatura mesatare vjetore e ujërave të liqenit të Prespës është 1.9°C më e lartë se e ajrit, çka tregon rolin e ujërave të liqenit në zbutjen e klimës përreth.⁴⁶ Nëpërmjet rrjetit hidrologjik nëntokësor liqeni i Prespës së Madhe komunikon me liqenet e Ohrit dhe Prespës së Vogël. Këtu ndodhet ishulli i Maligradit, gjeomument me vlera të veçanta natyrore dhe vlera kulturore. Liqeni dallohet për popullatat e peshqeve, ku ndër më të njohurat përmendet krapin, mërena, cironka e Prespës, kleni, skobusi, pllotica etj.

Ekosistemi liqenor i Prespës së Vogël përbën një ekosistem specifik në jug të Prespës së Madhe me një sipërfaqe 44 km². Në ndryshim nga pjesa e Prespës greke, pjesa shqiptare e liqenit paraqitet tepër e rënduar nga ndikimi human. Derdhja e ujërave të lumit Devoll në liqen dhe përdorimi i ujërave të liqenit në periudhën e verës për vaditjen e tokave të fushëgropës së

⁴³ Qiriazi, P., 2006, f. 115

⁴⁴ Pano, N., 2008 Pasuritë ujore të Shqipërisë, Monografi, Akademia e Shkencave, “Kristalinakhi”, Tiranë f.296

⁴⁵ Po aty, f.307

⁴⁶ Pano, N., 2008, Pasuritë ujore të Shqipërisë, Monografi, Akademia e Shkencave, “Kristalinakhi”, Tiranë, f.315

Korçës, ka ndikuar në prishjen e zinxhirit ekologjik të tij. Tashmë liqeni është në fazën e kënetizimit të tij, me dominim të sedimenteve dhe kallamishteve.

Liqenet luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e banorëve të zonës përreth, ujërat e të cilëve shfrytëzohen për ujitje, peshkim dhe turizmin e banjave të diellit. Dekadat e fundit niveli i ujit edhe në liqenin e Prespës së Madhe ka pësuar ulje, çka mendohet të jetë rezultat i largimit të ujërave nëpërmjet burimeve për në liqenin e Ohrit, mbishfrytëzimit të tyre nga komuniteti për ujitje, si edhe rastisjes së periudhës të thatë me reshje të pakta. Ekzistenca e peizazhit natyror të liqenit dhe parkut të Prespës, plotësohet më së miri nga prania e kishave të shumta eremite dhe kultura shpirtërore e komunitetit që jeton aty⁴⁷. Gërshetimi i vlerave natyrore me ato kulturore materiale dhe shpirtërore, kanë rritur interesin e vizitorëve në zonë.

Rezervuari i Gjançit, është pjesë e rëndësishme e hidrografisë i cili është krijuar artificialisht në vitin 1978. Me një sipërfaqe prej 0,4 km² dhe me kapacitet 18 milion m³ (në fillim ishte 16 milion m³) ujë, është një ujëmbledhës i rëndësishëm për gjithë rajonin. Përdoret për ujitjet e tokave në fushat përreth si dhe për prodhim të energjisë elektrike me fuqi 2900 kw/orë.⁴⁸

Tokat

Qarku i Korçës ka një shumëllojshmëri tokash të cilat përfaqësohen nga tokat e kafenjta, të murrme pyjore dhe livadhore pyjore. Ato janë toka pjellore të vëna nën shfrytëzim. Në lugina takohen tokat livadhore aluvionale dhe livadhore torfike me pjellori të lartë. Nga bonifikimi i kënetës së Maliqit në vitin 1960 (e cila zinte pjesën e ulët të fushëgropës së Korçës) u përfituan 5600 ha tokë dhe u përmirësuan 7920 ha tokë të tjera. Kjo çoi në shtimin e sipërfaqes së tokës bujqësore të qarkut Korçë. Aktualisht fondi i tokës së qarkut Korçë përfaqësohet nga 324.453 ha, i ndarë sipas kategorive përkatëse. Rreth 24% të saj e zënë tokat e punueshme, 15% livadhet dhe kullotat, 35% e zënë sipërfaqet pyjore dhe 26% të tjera⁴⁹. Tokat kanë një cilësi të mirë, e cila shprehet në shumëllojshmërinë e kulturave bujqësore dhe rendimentin e lartë të prodhimit të tyre. Disa nga kulturat kryesore të cilat mbillen janë: drithërat, zarzavatet, foragjerët, panxhari i sheqerit, drurët frutore (mollë, kumbulla, dardha, ftonj, etj.

⁴⁷ Perreth liqenit të Prespës së Madhe ndodhet komuna Pustec me 9 vendbanime rurale, në të cilat jeton një minoritet maqedonas i mirëintegruar në jetën ekonomike dhe shoqërore.

⁴⁸ Të dhënat aktuale janë siguruar ngahidrocentrali i Gjançit.

⁴⁹ Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës AMT (Këshilli i Qarkut Korçë)

Biodiversiteti

Biodiversiteti i qarkut të Korçës është mjaft i larmishëm dhe përfaqësohet nga një botë e pasur bimore dhe shtazore. Sipërfaqja pyjore llogaritet në 133 760 ha, e cila sipas katizimit vertikal përbëhet nga pyjet e dushkut, ahut, pishës (pisha e zezë) dhe bredhit. Për t'u përmendur është prania e bimëve mjeksore dhe aromatike si sherebela, çaji i malit, bliri, lulkuqja etj., mbledhja dhe tregtimi i të cilave është konsideruar, në disa zona, si mundësi për sigurimin e jetesës së banorëve (treva e Kolonjës).

Nisur nga shumëllojshmëria e lartë e biodiversitetit që qarku disponon, si dhe vlerat e larta biologjike, ekologjike dhe shkencore që ato përmbajnë, një pjesë janë shpallur “Zona të Mbrojtura”.⁵⁰ Bazuar në klasifikimin e kategorive të IUCN-së⁵¹, në qarkun e Korçës janë të pranishme:

Kategoria II - Park Kombëtar (Parku i Prespës dhe Parku Bredhi Drenovës);

Kategoria III-Monumente Natyre të përfaqësuara nga gjeomonumente, biomonumente dhe hidromonumente (Guri i Kamjes, ishulli i Maligradit, zgavra e Zaverit, dushqet e Manastirit, kanioni i Virkës, burimet e Drilonit, etj);

Kategoria IV - Rezervat Natyror i Menaxhuar (Gërmenj-Shelegur- në rrethin e Kolonjës, Cangonj në rrethin e Devollit, Krastafillak dhe Pylli i Fazanëve në rrethin e Korçës);

Kategoria V - Peizazh Tokësor dhe Ujor i Mbrojtur (Liqeni i Ohrit, Pogradecit dhe Nikolica);

Kategoria VI – Zonë e Mbrojtur e Burimeve të Menaxhuara (Guri i Nikës dhe Piskal-Shqeri).

Është i rëndësishëm fakti, se ekzistenca dhe vlerësimi i trashëgimisë kulturore të qarkut, nuk mund të kuptohet i veçuar nga ekosistemet dhe peizazhet natyrore, me të cilat ndërthuret mjeshtërisht dhe estetikisht. Vitet e fundit problematika me të cilën po përballlet biodiversiteti në qarkun e Korçës, si rrjedhojë e veprimtarisë së pakontrolluar të njeriut dhe mosndërhyrjes për mbrojtjen nga faktorët natyrorë (sëmundjet), kanë çuar në dëmtime serioze të llojeve të tij. Shpyllëzimet nëpërmjet shfrytëzimit intensiv të lëndës drusore për tregti dhe përdorim ngrohje, zjarret aksidentale apo të qëllimshme, kanë çuar në zhdukjen e specieve të shumta bimore dhe shtazore. Krahas dëmtimeve të sipërfaqeve të tëra nga zjarret e vitit 2007, zjarri që zgjati për

⁵⁰ Ligji 8906 datë 06.06.2002 “Për Zonat e Mbrojtura”

⁵¹ Sistemi i klasifikimit të zonave të mbrojtura sipas IUCN (Unioni Ndërkombëtar i Ruajtjes së Natyrës) përfshin 6 kategori të tilla në Shqipëri, 5 kategori të zonave të mbrojtura ndodhen në qarkun e Korçës.

ditë të tëra në Parkun Kombëtar Bredhi i Drenovës në vitin 2012, shkatërroi 70 % të sipërfaqes pyjore të tij. (nga 1380 ha shpëtuan vetëm 380 ha).⁵² Tashmë është domosdoshmëri hartimi i një plani menaxhimi, nga strukturat përkatëse për rehabilitimin e parkut.

2.6.3. Organizimi administrativ dhe hapësinor i qarkut Korçë

Në zhvillimin social-ekonomik të një hapësire gjeografike, organizimi hapësinor dhe territorial luan një rol të rëndësishëm. Organizimi hapësinor dhe administrativ i qarkut të Korçës, gjatë periudhave të ndryshme historike, ka qenë pjesë e evolucionit të vazhdueshëm dhe të pandërprerë, të trevave të saj. Në periudhën e Antikitetit territoret e trevave të Korçës përfshiheshin në mbretërinë e parë ilire të udhëhequr nga Bardhyli⁵³. Në periudhën e Mesjetës treva e Korçës ka qenë nën zotërimin e familjes së Muzakajve⁵⁴, ndërsa nga viti 1391 deri më Shpalljen e Pavarësisë 1912, gjithë krahinat e Korçës u vunë nën qeverisjen e perandorisë turke⁵⁵. Në këtë periudhë këto u përfshinë në sanxhakun e Manastirit dhe të Ohrit⁵⁶. Në vitin 1827 Korça u bë nënprefekturë dhe më 1870 prefekturë, në të cilën përfshiheshin nënprefektura e Kosturit, Bilishtit, Kolonjës dhe krahina e Oparit⁵⁷. Popullsia e prefekturës në atë kohë numëronte 150 000 banorë.⁵⁸ Në vitet 1916-1920, Korça përmendet si kryeqytet i republikës me qeverisje shqiptare, nën kujdesin e ushtrisë franceze.⁵⁹ Pas vitit 1920 Korça dhe trevat e saj, përfshihen brenda territorit të Shqipërisë, nën organizimin administrativ të prefekturës, duke ruajtur pothuajse përbërjen territoriale aktuale.

Nga viti 1958⁶⁰ deri në vitin 1990 ndarja administrative në të gjithë Shqipërinë, përfaqësohej nga rrethe, qytete, fshatra të bashkuar dhe fshatra. Deri në vitin 1992 rrethi i Korçës përfshinte brenda tij dhe rrethin e Devollit. Pas ndarjes administrative të vitit 2001 deri në ditët e sotme, njësia bazë administrative u bë qarku i Korçës, ku në përbërje të tij përfshihen

⁵² Drejtoria Pyjore Korçë, Relacion për Parkun Bredhi Drenovës, 2013

⁵³ Në historinë e popullit shqiptar I, Mbretëria e parë ilire, f.67-72, pellgu përreth liqenit Lyhnid përmendet si krahinë e rëndësishme e kësaj mbretërie ndonëse kufijtë e saj nuk përcaktohen qartë.

⁵⁴ Gjata A., Mbi themelimin e Korçës, f.23-25. Sipas këtij autori, referuar burimeve të shkruara baza e kësaj familje ka qenë malësia e Oparit në Korçë.

⁵⁵ N.D.N Korça dhe katundet e qarkut, Kotti Korçë, f. 73

⁵⁶ Historia e popullit shqiptar I, f.516

⁵⁷ N.D.N Korça dhe katundet e qarkut, Kotti Korçë, f. 73

⁵⁸ Po aty, f.73

⁵⁹ Po aty,

⁶⁰ Atlasi Gjeografik i Popullsisë së Shqipërisë, 2003, Tiranë, f.12. Në vitin 1953 u vendosën qarqet, që në 1958u zëvendësuan me rrethet.

katër rrethe, (Korçë, Pogradec, Kolonjë, Devoll),⁶¹ bashki (Korçë, Pogradec, Maliq, Bilisht, Ersekë, Leskovik), 31 komuna dhe 344 fshatra⁶¹. Rrethi i Korçës zë sipërfaqen më të madhe të territorit me 1753 km², ku qyteti i Korçës është qyteti më i madh dhe njëkohësisht qendër qarkut.

Korça është një qytet i vjetër, i cili daton që në gjysmën e parë të shek.XV⁶². Në regjistrin turk të Përmetit dhe të Korçës, përmendet se në kështjellën e Korçës numëroheshin 26 shtëpi⁶³. Por të dhënat për disa monumente kulti në periferi ose në fshatrat afër, siç është kisha e Ristozit, në fshatin Mborje, ndërtuar në shekullin IX, e.s. tregojnë se pjesa lindore e fushës së Korçës, që përfshin edhe vendin ku ngrihet sot qyteti, mund të ketë qenë banuar edhe përpara shek. XV⁶⁴. Qyteti filloi të zhvillohej me ritme të shpejta në mesin e shek. XIX. Në vitin 1879 numëronte 1 500 shtëpi me 13 000 banorë⁶⁵. Në fillim të shekullit XX, në vitin 1923 Korça si qytet numëronte 25 600 banorë ndërsa vitin 1938 numëronte 21 200 banorë. Popullsia erdhi duke u rritur pas çlirimit të vendit dhe në vitin 1968 qyteti kishte 46 300 banorë.⁶⁶

Aktualisht me një popullsi prej 86.739 banorë⁶⁷, Korça është qendra e qarkut dhe një ndër qytetet më të rëndësishme të vendit, i dalluar tradicionalisht për rolin e saj në zhvillimin ekonomik, arsimor dhe kulturor mbarë kombëtar. Qyteza e Maliqit përbën gjithashtu një njësi administrative urbane të rrethit të Korçës.(7.733 banorë)

Pogradeci është një trevë e rëndësishme në zhvillimin social-ekonomik të qarkut, me qendër qytetin e Pogradecit, që numëron 38.637 banorë⁶⁸. Krahas peizazhit të veçantë liqenor, kjo zonë ofron trashëgimi të pasur kulturore materiale dhe shpirtërore. Qyteti identifikohet me kalanë e Pogradecit (shek.V p.e.s) dhe objekte të tjera kulturore.

Devolli është një trevë e banuar që në prehistori, gjë e cila dëshmohet nga ekzistenca e vendbanimeve të hershme si (Trajan,Ventrok, Tren, Shuec, Bilisht, Zvezdë)⁶⁹. Bilishti është qendra administrative e rrethit Devoll. Ai përmendet si qytet tregtar në shekullin XIX, me pazar

⁶¹ Sipas ndarjes administrative të vitit 2001

⁶² Selenica, E., 1982, Korça në faqet e historisë, 8 Nëntori, Tiranë, f.23 .

⁶³ Po aty,

⁶⁴ N.D.N, Korça edhe katundet e qarkut, f.91

⁶⁵ Thomo P.,2012, Korça urbanistika dhe arkitektura, Morava, Tiranë, f.32.

⁶⁶ Sheri, F., 1970, Popullsia e Shqipërisë, 8 Nëntori, Tiranë, f. 102

⁶⁷ Popullsia aktuale (2013) e qytetit sipas Zyrës së Gjendjes Civile, Bashkia Korçë.

⁶⁸ Popullsia e qytetit sipas Zyrës së gjendjes civile, Bashkia Pogradec (2013)

⁶⁹ Sipas autorit Ismet Larti ekzistojnë dy versione të emrit Devoll; Deabolis që vjen nga sllavishtja dhe që do të thotë“ku të dhemb” dhe Devoll si simbol i një populli që punon. Në gjuhën maqedonase –voll i thonë kaut, de-i thonë ec, ajs. Kau që në hershmëri ka qenë simbol i punës për shqiptarët.

Larti S. I., 1999, Të njohim Devollin,“Gama Class”, Korçë, f.36-37

dhe dyqane⁷⁰. Dekadat e fundit Bilishti (10.081 banorë)⁷¹ dhe në përgjithësi gjithë treva e Devollit është duke u zhvilluar me ritme të ndjeshme ekonomiko –shoqërore.

Kolonja është një krahinë e dëgjuar etnografike (nahija e Kolonjës), e cila njihet që në shek.XI, (vitet 1091,1108) dhe cilësohet me emrin “Kolonja Evropiane”.⁷² Prania e vendbanimeve të shumta prehistorike (Kamnik, Luaras, Shtikë, Rehovë, Vrepcë, Gradec etj), gjuha, folklori, veshjet, traditat dhe zakonet, e bëjnë këtë trevë të pasur me trashëgimi kulturore materiale dhe shpirtërore dhe me mundësi të mira për zhvillimin e turizmit. Mungesa e alternativave të punësimit, kanë ndikuar vitet e fundit në lëvizje të dukshme të banorëve, gjë e cila ka çuar në zvoglimin e numrit të popullsisë. Erseka si qendër administrative e rrethit numëron 6.829 banorë⁷³. Leskoviku është qendër e vogël urbane, në ekstremin jugor të rrethit të Kolonjës. (2.472 banorë).

Për një menaxhim më efektiv të territorit dhe popullsisë, si edhe në përputhje me standardet e vendosura nga Bashkimi Evropian për organizimin e territorit, ishte e domosdoshme një ndarje e re administrative territoriale. Zmadhimi i njësive vendore aktuale krijon shanse më të mëdha zhvillimi dhe shmangie të diferencave ekstreme në zhvillimin rajonal, duke sjellë njëherësh edhe zbutjen e varfërisë.⁷⁴


⁷⁰Po aty, f.159

⁷¹Popullsia e qytetit sipas Zyrës së gjendjes civile, Bashkia Bilisht (2013)

⁷²Prifti, B., 2010, Toskëria:Kolonja dhe Leskoviku-zakone, rite, ceremoni, “Vllamas” Tiranë, f.9 Kolonja së bashku me krahinat Korçë, Pogradec, Devoll, Gorë, Opar, Dangëlli, Shqeri dhe Leskovik përbëjnë pjesën më të madhe të nënndarjes etnografike të toskërisë.

⁷³Popullsia e qytetit sipas Zyrës së gjendjes civile, Bashkia Ersekë (2013)

⁷⁴Sheme, S., 2014, Reforma administrativo-territoriale domosdoshmëri për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve, artikull, gazeta Telegraf, f.7



2.6.4 Potenciali human i qarkut Korçë

Treva e Korçës dallohet për një popullim të hershëm dhe të vazhdueshëm që nga antikiteti deri në ditët e sotme. Evolucioni i popullsisë ka pësuar luhate të dukshme nga njëra periudhë në tjetrën, gjë e cila lidhet me migrimin e popullsisë (sidomos emigrimi i jashtëm). Në vitin 1989 Korça, Pogradeci, Devolli dhe Kolonja kishin të regjistruar në total një popull prej rreth 311 448 banorë⁷⁵. Pas vitit 1990, si rezultat i ndryshimeve politike që ndodhën në Shqipëri, këto zona u prekën masivisht nga lëvizja hapësinore e popullsisë, e cila u shoqërua me rënie të

⁷⁵Drejtoria e Statistikës së Rrethit Korçë (Tregues statistikor të popullsisë 1998)

numrit të saj. Ecuria e numrit të popullsisë banuese të qarkut⁷⁶ (ndarja administrative që prej 2001) jepet në tabelën më poshtë:

Tabelë – Ecuria e numrit të popullsisë gjatë periudhës 2001-2013

Viti	Popullsia - total	Meshkuj	Femra
2001	265 284	133 752	131 532
2002	262 015	132 187	129 827
2003	258 605	130 380	128 224
2004	254 862	128 392	126 470
2005	251 138	126 496	124 642
2006	247 399	124 605	122 794
2007	243 275	122 421	120 854
2008	239 340	120 231	119 109
2009	235 007	118 171	116 836
2010	231 254	116 245	115 009
2011	226 405	114 381	112 024
2012	221 586	111 946	109 640
2013	216 429	109 862	106 553

Burimi: INSTAT, Tiranë (www.instat.gov.al)

Një nga efektet më të rëndësishme sociale ishte lëvizja e popullsisë brenda dhe jashtë vendit si dhe ndryshimet në strukturat e saj. Sipas të dhënave mbi përmasat e migrimit në Shqipëri rezulton që në hapësirën kohore nga 1989 deri në 2001, qarku i Korçës ka një humbje popullsie prej 46 164 banorë⁷⁷.


Siç vihet re dhe nga grafiku i mëposhtëm, gjatë periudhës 1989-2001 largimi i popullsisë ka qenë më i ndjeshëm sesa gjatë periudhës 2001-2013. Vazhdimisht popullsia ka ardhur drejt rënies, çka lidhet me migrimin e banorëve për sigurimin e mundësive më të mira ekonomike

⁷⁶ Është për t'u evidentuar mospërputhja në të dhënat e treguesve të popullsisë, midis dy institucioneve përkatëse, Drejtorisë së Statistikës në rrethet dhe INSTAT, gjë e cila vështirëson interpretimin e dhënave të sakta.

⁷⁷ Regional Development Strategy, Korça Region, f.24

dhe sociale. Në këtë periudhë dallohen për humbje më të madhe të popullsisë rrethet e Kolonjës (30%) dhe Korçës (20 %) me rreth 35 000 banorë⁷⁸.

Grafiku – Ecuria e numrit të popullsisë (1989-2013)



Burimi: Drejtoria e Statistikave, Korçë⁷⁹ dhe INSTAT, Tiranë (www.instat.gov.al)

Destinacionet kryesore të migrimit të popullsisë janë drejt Greqisë, Italisë, SHBA-së dhe Kanadasë⁸⁰. Pjesa më e madhe e të emigruarve (65 %) i përkiste moshave të reja nga 20-34 vjet⁸¹. Migrimi brenda vendit u shoqërua me lëvizje të popullsisë kryesisht në drejtim të qyteteve Tiranë, Durrës, Elbasan, Berat, Fier, Vlorë etj. Një tjetër destinacion i migrimit të popullsisë është zhvendosja nga fshati drejt qytetit, por edhe fshat-fshat. Popullsia fshatare u shpërngul nga fshatrat malorë Gorë, Lekas, Moglicë, Mokër, Piskal etj, kryesisht drejt qytetit të Korçës, por edhe drejt qyteteve Pogradec e Bilisht. Vitet e fundit popullsia në zonat e thella malore është zvogëluar aq sa disa fshatra të thellë malor gati janë shpopulluar (rreth 41 fshatra rezultojnë me më pak se 200 banorë)⁸².

⁷⁸Doka, Dh., 2005, Zhvillime social-ekonomike dhe rajonale të Shqipërisë pas vitit 1990, Potsdam, f.149

⁷⁹Nga Drejtoria e Statistikës Korçë është marrë numri i popullsisë 1989.


⁸⁰Lëvizja e popullsisë nuk është evidentuar me të dhëna të sakta nga zyrat e gjendjeve civile në komuna dhe bashki

⁸¹Zefi, E., 2003, Perspektiva bazuar në treguesit kryesorë social dhe ekonomik të rajonit të Korçës, referim , Korçë , 30 Maj 2003 f.7 (cit. në Doka, Dh. 2005)

⁸²Strategjia Rajonale e Zhvillimit të Qarkut Korçë 2005-2015, f.19

Struktura gjinore e popullsisë vazhdimisht ka qenë në favor të meshkujve, me një përqindje të vogël difference. Aktualisht në qarkun e Korçës numërohen 109 862 (50.7%) meshkuj dhe 106 553 (49.3%) femra⁸³. Struktura gjinore ndryshon edhe në varësi të vendbanimeve qytet-fshat. Popullsia që jeton në qendrat urbane dominohet nga gjinia femërore në masën 1.14% kundrejt gjinisë mashkullore⁸⁴. Ndërsa në zonat rurale kemi dominim të gjinisë mashkullore kundrejt asaj femërore në masën 2%⁸⁵. (68. 347 meshkuj kundrejt 64.065 femra)

Grafiku – Raporti meshkuj-femra në qarkun e Korçës (2001-2013)



Burimi: INSTAT, 2014

Si rezultat i lëvizjeve migruese brenda dhe jashtë vendit, ndryshoi edhe raporti midis popullsisë së fshatit dhe qytetit. Si rezultat i migrimit të brendshëm nga fshatrat në drejtim të qyteteve, vitet e fundit tendenca ka shkuar drejt rritjes së popullsisë urbane, veçanërisht në qytetet Korçë, Pogradec, por edhe Bilisht. Pjesa më e madhe e popullsisë, rreth 132 427 banorë jetojnë në zonat rurale dhe 84 002 banorë jetojnë në zonat urbane, ku numrin më të madh e zë qyteti i Korçës⁸⁶.

⁸³INSTAT, Tiranë, 2014

⁸⁴INSTAT, Tiranë, 2014

⁸⁵INSTAT, Tiranë, 2014

⁸⁶INSTAT, 2014, Të dhëna mbi popullsinë sipas qarqeve

Mungesa e alternativave të zhvillimit, ka bërë që në një pjesë të mirë të zonave rurale të vazhdojë tendenca e popullsisë për t'u larguar në drejtim të qytetit, veçanërisht të rinjtë. Kjo braktisje është shoqëruar me probleme në infrastrukturë, shërbime (pothuajse nuk funksionojnë) dhe mjedis duke shtuar përpara institucioneve qendrore dhe vendore nevojën e analizimit të resurseve të territorit dhe rishikimin e mundësive për rijetëzimin e këtyre zonave. Problem paraqesin edhe qytetet e vogla si Maliqi, Erseka, Leskoviku, që ndonëse dallohen për resurse natyrore dhe kulturore, që mund të integrohen në zhvillimin social ekonomik të komunitetit, përballen sot me vështirësi të tilla deri në largimin e banorëve nga këto zona.

Aktualisht qarku i Korçës ka një popullsi prezente prej rreth 216 429 banorë dhe 80 932 banesa⁸⁷. Dendësia mesatare e popullsisë së qarkut është rreth 59⁸⁸ banorë për km². Dendësinë më të madhe të popullsisë për njësi të sipërfaqes e kanë rrethet Pogradec dhe Korçë⁸⁹ respektivisht 99 b/km² dhe 80 b/km², por edhe rrethi i Devollit me dendësi 79 b/km². Rrethi i Kolonjës ka edhe dendësinë më të vogël të popullsisë për njësi të sipërfaqes 17.91 b/km². Në qytetin e Korçës dhe Pogradecit dendësia e popullsisë është e madhe (200 banorë për km²), kurse dendësinë më të vogël e kanë fshatrat e thellë malore të komunës Lekas, Moglicë, Trebinjë, Qendër Leskovik etj.

Për sa i përket elementëve kulturorë dhe arsimorë, popullsia e gjithë trevës së Korçës karakterizohet nga tradita të pasura, të ndërthurura me elementë të civilizimit dhe qytetarisë, që kanë ndihmuar në zhvillimin e kulturës mbarëkombëtare. Ajo ka qenë gjithnjë arsimdashëse dhe punëdashëse. Këto vlera u kurorëzuan në vitin 1887 me hapjen e Shkollës së Parë Shqipe në Shqipëri dhe në vitin 1891 me çeljen e Shkollës së Vashave, ndërkohë që figura të shquara të Rilindjes Kombëtare si Naum Veqilharxhi, Mihal Grameno, Thimi Mitko, Petro Nini Luarasi, Pandeli Sotiri, Jani Vreto, Sevasti Qiriazi, Aleksandër Drenova (Asdreni), Jovan Cico Kosturi etj, kanë kontribuar në përhapjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare brenda dhe jashtë vendit.

Lidhur me objektin tonë të studimit, vlerësojmë se formimi profesional është një domosdoshmëri për sa i përket kërkesave në drejtim të zhvillimit të turizmit. Njësitë turistike kanë shumë nevoja për specialistë të mesëm të përgatitur në profesione të ndryshme si qëndistari, artizanat, kamarjer, recepsionist, guzhinier, menaxher salle, guidë etj., prandaj në

⁸⁷INSTAT, Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011, f. 133

⁸⁸INSTAT, Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011, f. 133

⁸⁹INSTAT, 2014

shkollat profesionale krahas rritjes së numrit të tyre, duhet të zgjerohen edhe specialitetet e profesioneve në përputhje me tregun turistik. Po kështu duke propaganduar nevojat dhe tendencat e rritjes së tregut turistik, ato duhet të përfshijnë një masë më të madhe nxënësish, veçanërisht vajzat në profesionin e qëndistarisë⁹⁰, si edhe të rrisin cilësinë e tyre.

Në funksion të arsimit profesional, në qytetin e Korçës funksionon pranë Zyrës Rajonale të punësimit Qendra e Trajnimit Profesional, në të cilën zhvillohen kurse për përgatitjen në profesione të ndryshme. Me synimin e përgatitjes profesionale të individëve të papunë që kanë mbaruar ose jo gjimnazin, kjo qendër i vjen në ndihmë biznesit sipas nevojave për fuqi punëtore. Në vitin 2015 nga 89 kursantë 35 ishin femra. Tëra e Korçës është një trevë me tradita të vjetra në punimet artizanale si: qëndistari, punimin e leshit, poçeri, punim të metaleve, gurit, drurit etj., kështu që do ishte me vlerë zhvillimi i kurseve në këto specialitete të kërkuara në tregun turistik.

Arsimi i lartë aktualisht luan një rol të rëndësishëm në përgatitjen me specialistë të fushave të ndryshme, të inkuadruar në zhvillimin ekonomik e social të zonës. Tregues të nivelit të mirë të arsimit, janë prania e Universitetit shtetëror “Fan S. Noli” në qytetin e Korçës, që me plot goje mund ta quajmë edhe si gjenerator social të rajonit. Në Universitetin “Fan S. Noli” ndodhen katër fakultete: Fakulteti i Bujqësisë, Ekonomisë, Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane dhe Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë. Në këtë universitet studiojnë rreth 6500 studentë gjithsej. Programet e studimit “Menaxhim Turizëm” dhe “Histori Gjeografi”, ndihmojnë në forcimin e njohurive në fushën e turizmit dhe trashëgimisë, duke ndihmuar në përgatitjen e specialistëve në këto fusha. Nisur nga tërheqja turistike dhe interesi i saj në rritje drejt trashëgimisë kulturore, pasurimi i programeve të studimit me profile më të specializuara nga këto fusha, do t’i vinte në ndihmë orientimit të zhvillimit social-ekonomik.

2.7. Zhvillimi social-ekonomik i qarkut Korçë

2.7.1. Zhvillimi social-ekonomik para viteve 1990

Pasuritë natyrore si dhe ato humane kanë bërë që Korça të jetë një zonë e zhvilluar në të gjitha periudhat kohore. Në librin “Korça dhe katundet e qarkut” në vitin 1909 autori (Nuçi

⁹⁰Qëndistaria dhe punimet e tjera të dorës janë pjesë e trashëgimisë kulturore të të gjitha trevave të Korçës, që duhen ruajtur dhe trasmetuar në brezat e ardhshëm.

Naçi) shkruan: “Kjo prefekturë është nga më të pasurat e gjithë Prefekturavet që bëjnë Shtetin Shqiptar, e që janë të gjitha nëntë-9. Si nga pasuria ashtu dhe nga qytetërimi, e nga përparimi, mbështetja pikëpamje, Prefektura e Korçës në shkallën e parë nër gjithë prefekturat e tjera, këtë s’munt t’a mohojë as një Shqiptar me gjykim të drejtë”⁹¹.

Në shekujt XVII–XVIII spikatën qendrat e para zejtaro-tregtare si: Voskopoja, Vithkuqi, Shpaska, Nikolica në rrethin e Korçës si edhe Llënga e Niça në rrethin e Pogradecit⁹², të cilat njohën një zhvillim të rëndësishëm për vendin dhe qytetërimet e asaj kohe. Voskopoja në shekullin XVIII u zhvillua me ritme të shpejta si për nga rritja e popullsisë⁹³, ashtu edhe për nga zgjerimi i aktiviteteve social -ekonomike duke marrë tiparet e një qendre urbane. Ekzistenca e shumë zejeve i dha shkas zhvillimit të shpejtë të tregtisë. Voskopojarët tregtonin jo vetëm në krahinat e vendit, por edhe në vende të ndryshme të Evropës Qendrore, Lindore dhe Jugore⁹⁴.

Zhvillimi i artizanatit të tekstileve të leshta u shoqërua me prodhimin e artikujve të ndryshëm, të preferuar në shtroje (qilima, levenxa, etj) dhe veshmbathje. Përmenden gjithashtu mjeshtrit kovaçë, jorganxhinjtë, muratorët, gurëskalitësit, lëkurëregjësit etj. Prania e objekteve të shumta të kultit (kisha) dhe objekteve me karakter kulturor si edhe stili qytetar i jetesës kanë qenë dëshmi e nivelit të lartë kulturor të zonës së Korçës.

Pas shkatërrimit të Voskopojës jeta ekonomike mori zhvillim në qytetin e Korçës. Ndikuar nga pozicioni gjeografik në kryqëzimin e rrugëve që lidhnin lindjen me perëndimin në shekullin e XIX, Korça u bë një nga qendrat e rëndësishme ekonomike dhe kulturore në Shqipërinë juglindore. Në fillimi të shekullit XX ajo figuronte si një qendër me tipare kapitaliste në zhvillim. Shprehje të këtyre marrëdhënieve u bënë ngritja e disa aktiviteteve të vogla industriale dhe fabrikave: në vitin 1923 u ngrit një fabrikë e vogël duhani, në vitin 1925 u ngrit një fabrikë alkooli në Drenovë dhe në 1934 filloi prodhimin fabrika e birrës⁹⁵. Mbështetur në traditën e popullsisë për përpunimin e lëkurëve në 1929-1930 u ngrit fabrika e lëkurëve, ndërsa në vitet 1937-1938 u ngritën disa punishte të vogla të mekanizuara për prodhimin e

⁹¹N.D.N, 1923, Korça dhe katundet e qarkut; Dhori Koti, Korçë, f.74-75

⁹²Selenica, E., 1982, Korça në faqet e historisë, Kombinati Poligrafik, Shtypshkronja e Re, Tiranë, f.24

⁹³Adhami, S., 1972, Të dhëna rreth fizionomisë urbanistike dhe arkitektonike të qytetit mesjetar, Monumentet3, Instituti Monumenteve të Kulturës, Tiranë, f.111. Popullsia numëronte 25-30 000 banorë.

⁹⁴Selenica, E., 1982, Korça në faqet e historisë, f.24

⁹⁵Selenica, E., 1982, Korça në faqet e historisë, f.71

tekstileve, ndërkohë që vazhduan të ekzistonin edhe punishtet me vegla të dorës⁹⁶. Në Mborje në këto vite funksiononte miniera e qymyrgurit ndonëse me mjete dhe forma primitive.

Gjatë periudhës 1945-1990, ekonomia e Shqipërisë cilësohet si më e izoluar dhe më e prapambetura. Në këtë periudhë fushëgropa e Korçës përbënte njësinë e dytë më të rëndësishme fiziko-gjeografike në Shqipëri për nga prodhimet bujqësore, (pas Ulërsirës Perëndimore). Gjatë kësaj periudhë rëndësia që iu dha zhvillimit të industrisë së rëndë çoi në rritjen e shfrytëzimit të burimeve të qymyrgurit dhe ngritjen e ndërmarrjeve industriale.

Industria minerare përfaqësohej nga nxjerrja e qymyrgurit si dhe hekur-nikelit në Mborje-Drenovë, Lozhan të Korçës, Alarup të Pogradecit; Bitinckë (Devoll) dhe Guri Kuq (Pogradec); Rehova (Vithkuq) dallohej për nxjerrjen e bakrit dhe po këtu u ngrit edhe uzina e pasurimit të bakrit.

Industria mekanike (1960-1990) u përfaqësua nga një sërë ndërmarrjesh të përqendruara më së shumti në qytetin e Korçës. Uzina Mekanike Bujqësore prodhonte vegla dhe pjesë këmbimi, jo vetëm për rajonin por gjithë vendin. Gjithashtu u ngrit Uzina e Preçizionit ku bëheshin veglat e dorës dhe mjetet matëse, si edhe Uzina e Stampave dhe Kushinetave. TEC-i i Korçës i ndërtuar në vitin 1970, furnizonte me avull dhe energji elektrike ndërmarrjet e mësipërme për proceset teknologjike që kryenin⁹⁷.

Industria e ndërtimit funksiononte nëpërmjet Fabrikës së Tullave dhe Fabrikës së Fajancës, (prodhim materiale ndërtimi) ndërkohë që në qytetet Korçë, Pogradec dhe Ersekë kishte ndërmarrje sharre për shfrytëzimin e lëndës drusore dhe ndërmarrje të prodhimit të mobileve.

Industria e transportit përfaqësohej nga Parku i Mallrave në qytetin e Korçës, nga ku bëhej transporti i produkteve industriale të rajonit në gjithë Shqipërinë. Zhvillim të dukshëm mori *industria e tekstileve* që përfaqësohej nga Kombinati Trikotazhit i njohur për prodhimet e tij të pambukta dhe të leshta në të gjithë vendin. Gjithashtu zona ishte e njohur edhe për përpunimin e lëkurëve dhe prodhimin e këpucëve nëpërmjet Fabrikës së Prodhimit të Këpucëve në Korçë dhe Pogradec. E mbështetur në traditat e hershme të artizanatit në gjithë zonat e qarkut të

⁹⁶Selenica, E., 1982, Korça në faqet e historisë, f.71

⁹⁷Të dhënat dhe informacionet janë siguruar nga dokumentacioni arkivor i këtyre ndërmarrjeve në arkivin e shtetit Korçë

Korçës, industria tekstile në vitin 1968, zinte 14 % të prodhimit të përgjithshëm industrial.⁹⁸ Ndërmarrja artizanale dallohej për prodhimet e shumëllojshme dhe me cilësi të lartë të qilimave, sixhadeve etj.

Rol të rëndësishëm në ekonominë e rajonit dhe vendit ka luajtur *industria e përpunimit të produkteve bujqësore*, e cila përfaqësohej nga industria ushqimore që prodhonte reçelra të ndryshme, marmalatë dhe konservonte fruta dhe perime. Kjo degë ishte e zhvilluar edhe në rrethet Kolonjë dhe Pogradec. Prania e sasisë së madhe të panxharit të sheqerit, që kultivohej në fushën e Maliqit, krijoi mundësinë që në vitin 1951 të ngrihej Kombinati i Sheqerit në Maliq, i cili funksionoi deri në vitin 1996 dhe tashmë është jashtë funksionit. Në këtë kohë u ngrit dhe TEC-i i Maliqit me qëllim prodhimin e avullit dhe energjisë në funksion të kombinatit të sheqerit.

Deri në fundin e viteve '80 struktura e ekonomisë në rrethin e Korçës dominohej nga industria e lehtë dhe ushqimore, me përjashtim të rrethit të Pogradecit ku dominonte industria e nxjerrjes së mineraleve. Në fundin e viteve '80 si në të gjithë vendin edhe kjo zonë filloi të përballej me vështirësi të dukshme në aspektin social dhe ekonomik⁹⁹. Në aspektin social, popullsia jetonte në pjesën dominuese të saj në fshat. Në vitin 1990, 67 % e popullsisë jetonte në fshat dhe vetën 33% e popullsisë jetonte në qytet¹⁰⁰. Politikat e punësimit gjithëpërfshirës nuk justifikonin praninë e mallrave të konsumit jetik dhe për rrjedhojë nivelin e jetesës dhe mirëqenies së popullsisë.

2.7.2. Zhvillimi social-ekonomik pas vitit 1990

Ndryshimet politike që ndodhën në Shqipëri në vitin 1990, ashtu si në të gjithë Shqipërinë, edhe në qarkun e Korçës patën ndikim të dukshëm në zhvillimin ekonomik. Ndërmarrjet shtetërore filluan të privatizoheshin, ndërkohë që një pjesë e madhe e popullsisë mbetën të papunësuar. Aktualisht në qarkun e Korçës kryejnë aktivitet ekonomik 3359 subjekte nga të cilat 98 në sektorin shtetëror dhe 3261 në sektorin privat. Bazën e biznesit e përbëjnë bizneset shumë të vogla 94.4% dhe të vogla 3.7%, ndërsa bizneset e mesëm dhe të mëdhenj përbëjnë

⁹⁸Bello, M., 2010, Desertacion, Rritja e konkurrueshmërisë në rajonin e Korçës dhe integrimi ekonomik ndërkufitar, f.14

⁹⁹Bello, M., 2010, Desertacion, Rritja e konkurrueshmërisë në rajonin e Korçës dhe integrimi... f.17

¹⁰⁰Drejtoria e Statistikës Korçë

vetëm 1.9%. Në sektorin ekonomik janë 13 643 të punësuar, nga të cilët 6 133 në sektorin shtetëror dhe 7510 në sektorin privat¹⁰¹. Të punësuarit në sektorin shtetëror janë kryesisht në profesionet nëpunës, drejtues dhe specialistë, ligjvënës, teknikë, punëtorë, në sektorin e shëndetësisë etj. Në sektorin privat pjesa më e madhe janë të punësuar në sektorin e ndërtimit, tekstileve (rrobaqepësi) si edhe tregti.

Shkalla papunësisë në nivel qarku në vitin 2012 është regjistruar në 10.4%, nga 10.3% në vitin 2011 dhe 10.2% në vitin 2010. Pra niveli i papunësisë është mjaft shqetësues, ku në qarkun e Korçës rezultojnë 9 474 të regjistruar si punëkërkues të papunë, nga të cilët 5 571 në rrethin e Korçës¹⁰². Më problematike papunësia paraqitet në grupmoshën mbi 45 vjet, që ka edhe numrin më të madh të të papunëve 4 295 persona. Krahësuar me vitin 2012 (9 106 të papunë) numri i punëkërkuesve të papunë është rritur me 368 persona të regjistruar si të tillë, ku 53% të të regjistruarve ishin femra.

Niveli i mirëqenies së popullsisë paraqitet i ndryshëm në zona të ndryshme të qarkut. Të ardhurat që sigurohen nga emigracioni dhe pensionet e lidhura nga shteti grek, përbëjnë një ndihmesë për një pjesë të mirë të familjeve. Këto të ardhura janë dhe vazhdojnë të përdoren kryesisht për ndërtime banesash, në bujqësi dhe në disa raste për hapjen e bizneseve. Niveli i varfërisë është i lartë, sidomos në zonat e thella malore. Numri total i familjeve në skemën e ndihmës ekonomike është 9 110 familje, nga 106 991 familje në të gjithë qarkun. Prej tyre peshën më të madhe e mban rrethi i Pogradecit, (5 422 familje) në veçanti komunat Velçan, Proptisht, Trebinjë, Udënisht, Buçimas, që kanë edhe numrin më të madh të familjeve në skemë¹⁰³. Resurset e pasura natyrore, tokat pjellore dhe sigurimi i të ardhurave nga emigracioni, janë disa nga faktorët që kanë kushtëzuar nivelin e mirëqenies së popullsisë në rrethin e Devollit dhe për rrjedhojë numrin më të vogël të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike. (203 familje) Pjesa më e madhe e popullsisë në fshat i siguron të ardhurat nga shitja e produkteve bujqësore dhe blegtorale. Problem për këtë kategori përbën mungesa e një tregu të garantuar, që në disa raste shoqërohet edhe mbetjen stok të produkteve të fshatarëve.

Zhvillimi ekonomik bazohet kryesisht në *ekonominë bujqësore* ku degët kryesore janë bujqësia, blegtoria, pylltaria dhe peshkimi, të cilat përbëjnë 30 % të produktit të përgjithshëm

¹⁰¹Të dhënat janë siguruar nga Drejtoria Rajonale e Punësimit Korçë, 2013

¹⁰²Drejtoria Rajonale e Punësimit Korçë, 2013

¹⁰³Drejtoria Rajonale e Ndihmës dhe Përkrahjes Sociale Korçë, Relacion 2012

në qarkun e Korçës¹⁰⁴. Në prodhimin e përgjithshëm bujqësor, vendin kryesor e zë dega e bujqësisë, por kjo përqindje po zvogëlohet vitet e fundit si rezultat i rritjes së prodhimit blegtoral. Në pjesën më të madhe të tokave të punueshme, janë kultivuar bimët e arave (gruri, misri), bimët industriale (duhani, panxharsheqeri), foragjeret për blegtorinë dhe perimet. Qarku i Korçës është dalluar tradicionalisht si një nga furnizuesit kryesorë të tregut me fruta dhe sidomos me mollë. Klima e favorshme, tokat pjellore dhe përdorimi me racionalitet i plehrave kimike bëjnë të mundur që prodhimet e gjithë zonës të dallohen si produkte bioorganike. Problematikë për sektorin e bujqësisë dhe për fermerët mbetet sigurimi i tregut për produktet e tyre. *Sektori i blegtorisë* ka arritur të plotësojë më së miri nevojat për ushqim të popullsisë si dhe të industrisë përpunuese. Zona rurale dallohen kryesisht për rritjen e gjedhit dhe dhenëve në fshatrat malorë.

Industria agropërpunuese është e zhvilluar kryesisht në sigurimin e lëndës së parë në vend për përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale. Sot në qarkun e Korçës, në industrinë ushqimore, sektorë prioritarë janë: industria e përpunimit të drithrave, industria e përpunimit të mishit, qumështit, përpunimit të frutave dhe perimeve, prodhimit të pijeve alkoolike, konservave, sallamit, duhanit etj. Rol të rëndësishëm luan prania e fabrikave të përpunimit të produkteve blegtorale (baxhot) të pajisura me teknologji bashkëkohore, ndërkohë që ruhet edhe tradita e përpunimeve në mënyrë artizanale.

Industria e prodhimit të alkoolit, pijeve alkoolike si verës, birrës, konjakut, prodhimi i pijeve të buta (lëngjeve) etj, furnizon tregun me produkte tradicionale,. Këtu mund të përmendim kantinën “Rilindja” dhe disa punishte tradicionale të prodhimit të verës në Pogradec dhe Leskovik. Prodhimit i “Birra Korça” me një traditë dhe eksperiencë gati shumëvjeçare, teknologji moderne dhe kapacitet 110 000 hektolitra¹⁰⁵ në vit, e njohur brenda dhe jashtë vendit, përbën një pikë të fortë për zhvillimin e qarkut.

Sektori i tekstileve, është i zhvilluar kryesisht në trajtën e ndërmarrjeve që operojnë me kapital të huaj ose sipërmarrje të përbashkëta të realizuara nga biznesmenë shqiptarë dhe grekë. Në përgjithësi këto ndërmarrje importojnë lëndën e parë (fasonë) dhe i kanë tregjet e siguruara kryesisht jashtë vendit. Ky sektor përbën edhe tregun më të madh të punësimit për gjininë femërore.

¹⁰⁴Strategjia e Zhvillimit të Qarkut Korçë 2005-2015

¹⁰⁵Birra Korça, 2014

Rol të ndjeshëm në zhvillimin e qarkut të Korçës, po merr *sektori terciar* veçanërisht *infrastruktura, transporti dhe turizmi*. Pozicioni gjeografik i qarkut (nëpërmjet pesë doganave), ofron kontakt të drejtpërdrejtë me Greqinë dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Rrjeti rrugor siguron lidhje hapësinore të qendrave urbane me qarqet e tjera dhe vendet fqinjë, sikundër edhe lidhjen me të gjitha komunat. Në infrastrukturën rrugore janë bërë investime dhe përmirësime në rrugët që lidhin qytetin e Korçës me qendrat turistike si: Pogradecin, Voskopojën, Dardhën, Liqenas, pikën turistike të Moravës etj.

Përmirësimet në infrastrukturë kanë lehtësuar jo vetëm shfrytëzimin e burimeve natyrore por kanë nxitur zhvillimin e turizmit në zonat malore me interes të veçantë. Megjithatë, zhvillimi i turizmit kërkon me domosdoshmëri një infrastrukturë me standarde bashkëkohore, që mundëson arritjen e destinacioneve në kohë reale. Gjithashtu, funksionimi i një aeroporti kombëtar dhe rajonal¹⁰⁶, si edhe ekzistenca e një pike portuale në liqenin e Ohrit, përveçse impaktit pozitiv në zhvillimin ekonomik, do të lehtësonin lëvizjen e udhëtarëve për qëllime turistike. Distanca e afërt me qytetet e Selanikut dhe Kozanit në Greqi, Ohrit dhe Shkupit në FYROM, po kështu edhe me aeroportet e qyteteve kryesore të Evropës Lindore, do ta lehtësonte lëvizjen e njerëzve dhe përmbushjen e qëllimeve të tyre turistike. Shërbimi i telefonisë fikse në qarkun e Korçës sigurohet nga Albtelekom, si dhe tre operatorë privatë, që operojnë kryesisht në zonat rurale, ndërsa telefonia celulare mundësohet nga shërbimi i dy kompanive, AMC, Vodafon, Eagle, duke siguruar sinjal të pandërprerë.

Disa nga potencialet turistike natyrore përbëjnë peizazhet atraktive malore dhe kodrinore, (Voskopojë, Dardhë, Vithkuq) peizazhet liqenore (Pogradeci, Liqenas), parqet kombëtare dhe zonat e mbrojtura, klima e freskët dhe e shëndetshme, ujërat kurative, etj. Ndërsa potencialet kulturore përfaqësohen nga vendeve arkeologjike, objekteve të shumta të kultit, traditave kulturore dhe fetare. Këto atraksione natyrore dhe kulturore ofrojnë mundësi të zhvillimit të disa llojeve të turizmit si turizmi blu, turizmi i gjelbër, turizmi kulturor, turizmi familjar etj. Vlerave natyrore dhe kulturore u bashkohen edhe traditat dhe niveli i lartë kulturor dhe i qytetarisë së popullsisë. Në funksion të zhvillimit të turizmit është ndërtuar edhe infrastruktura turistike me shërbimet hotelieri, restorante, banka, zyra të informacionit turistik etj.

¹⁰⁶Gjurmët e aeroportit ekzistojnë në fushën e Lumalasit, pranë qytetit të Korçës. Gjatë viteve 1924-1935 Korça lidhej me Tiranën në linjë ajrore. Lidhja me qytetin e Selanikut është shumë e rëndësishme dhe në këtë rast Korça do të ndërmjetësonte lidhjen midis dy porteve të rëndësishëm Durrësit dhe Selanikut.

Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore, në të cilat ndodhet qarku i Korçës, ofrojnë potenciale të shumta natyrore për zhvillimin social dhe ekonomik të tij. Prezenca në afërsi të vijës kufitare me Maqedoninë dhe Greqinë, i kanë ofruar mundësi komunikimi dhe shkëmbimi me botën e jashtme që në periudhat e hershme kohore. Prania e përbërjes së larmishme gjeologjike (gëlqeror, magmatik, terrigjen, etj) ka favorizuar ekzistencën e burimeve të shumta minerale. Relievi i shumëllojshëm (gropa, fushëgropa, lugina, male, vargmale, etj), ndikimi i klimës mesdhetare me tipare të dukshme kontinentale, si edhe pasuritë e shumta ujore kanë mundësuar zhvillimin e një biodiversiteti të pasur. Nisur nga kjo, një pjesë e konsiderueshme e tyre janë shpallur Zona të Mbrojtura, duke e bërë hapësirën gjeografike të qarkut të Korçës tërheqëse në aspektin turistik.

Zhvillimi social dhe ekonomik i qarkut të Korçës është i lidhur ngushtë me potencialin natyror dhe human të saj. Gjatë gjithë periudhave historike zhvillimi ekonomik ka qenë i bazuar në zhvillimin e bujqësisë, artizanatit, zejeve si dhe funksionimit të ndërmarrjeve të vogla të përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale. Gjatë periudhës 1945-1990 zhvillimi ekonomik u bazua në zhvillimin e industrisë së rëndë, industrisë së lehtë dhe ushqimore, ashtu sikurse edhe në zhvillimin e bujqësisë. Me ndryshimet politike që ndodhën në vitin 1990 ndryshoi dhe struktura e zhvillimit ekonomik, duke kaluar nga një zonë industriale komplekse, në një zonë me bujqësi të zhvilluar. Në ditët e sotme zhvillimi ekonomik është i bazuar në prodhimet bujqësore dhe blegtorale, zhvillimin e industrisë së lehtë dhe ushqimore si dhe në zhvillimin e turizmit.

KAPITULLI III: TRASHËGIMIA KULTURORE MATERIALE E SHPIRTËRORE SI POTENCIAL ZHVILLIMOR

Sociologjia e Turizmit në Rajonin e Korçës është me interes si rast studimor, pasi mungesa studimeve sociologjike mbi turizmin shqiptar në përgjithësi dhe atë rajonal në veçanti, mungesa e modeleve dhe eksperiencave të zbatimit të turizmit si komponent socio-ekonomik dhe socio – gjeografik, në identifikimin, listimin dhe analizimin sjellin një ekonomi të dobët kombëtare.

Zhvillimi i qëndrueshëm në thelb studiohet nga Sociologjia dhe Ekonomia. Në thelb si perceptim realist kjo mund të sjellë atë që mund të quhet “Kulturë Industriale” pasi perceptohet si e tillë. Turizmi si gjendje e të jetuarit, turizmi është i shëndetshëm, është meditative... Por kjo si gjendje na sjell dhe një aspekt tjetër nga i cili përfiton si individ dhe shoqëria, pikërisht bëhet fjalë për Biznesin Social: Aspekti, Format, Struktura.

3.1 Trashëgimia kulturore materiale

Qarku i Korçës ka një potencial të lartë të trashëgimisë kulturore. Ajo përfaqësohet nga trashëgimia kulturore materiale (monumentet arkeologjike, arkitektonike, të kultit, etnografike, etj) dhe trashëgimia kulturore shpirtërore (folklori, këngët, vallet, zejet, festat, gastronomia, etj).

3.1.1 Vlerat e trashëgimisë kulturore materiale

Trashëgimia kulturore materiale përfaqëson një bashkësi vlerash kulturore dhe historike të trashëguara, të shprehura përmes tipologjive të ndryshme arkeologjike, arkitekturore, historike, artistike etj. Në qarkun e Korçës, si pjesë e trashëgimisë kombëtare ndodhen 158 objekte kulturore , që për nga vlerat e tyre gëzojnë statusin ligjor të monumentit të kulturës. Këto evidentohen si vendbanime arkeologjike, kala, varre monumentale, banesa, ura, objekte kulturi etj. Krahas këtyre, ndodhen edhe objekte të tjera, që ndonëse kanë vlera kulturore me rëndësi kombëtare, nuk mbrohen me status të veçantë. Sipas përcaktimeve të dhëna për trashëgimisë kulturore materiale , monumentet e kulturës në qarkun e Korçës klasifikohen në:

3.1.2 Monumente arkeologjike

Në monumentet arkeologjike përfshihen vendbanimet arkeologjike të llojeve të ndryshme, objekte, dhe elementë të tjerë ndërtimesh me vlera arkeologjike, arkitekture, historike dhe kulturore që janë rezultat i gërmimeve arkeologjike. Gërmimet arkeologjike të shoqëruara me vëzhgimet në terren, kanë provuar se territoret e Shqipërisë Juglindore (Korça, Kolonja, Pogradeci dhe Devolli), kanë patur një kulturë shumë të zhvilluar në të gjitha epokat historike (prehistori, antikitet dhe mesjetë). Me gjithë praninë e një numri të madh të objekteve arkeologjike, kryesisht rrënoja, do të ndalemi në veçanti, në ato të cilat përbëjnë ose ofrojnë mundësi për t'u shndërruar në atraksione turistike; vendbanime, fortifikime (kala) dhe vendvarrime, që krahas vlerave arkeologjike, shkencore, edukative mbartin vlera të rëndësishme turistike.

3.1.3 Vendbanimet (kalatë, kështjellat, shpellat)

Vendbanimi i Kamnikut në rrethin e Kolonjës përbën vendbanimin më të hershëm të fortifikuar, i ndërtuar me ledhe guri¹⁰⁷. Rëndësia e vendbanimit të datuar nga studiuesit rreth viteve 2800-2700 p.e.s.¹⁰⁸ evidentohet më së miri nëpërmjet gjetjeve arkeologjike me vlera të rëndësishme shkencore, kulturore dhe turistike të ekspozuara në muzeun e qytetit të Ersekës.

Vendbanimi prehistorik i Maliqit (palafit) i zbuluar pranë qytetit të Maliqit, përfaqëson kulturën më të zhvilluar të vendbanimeve prehistorike shqiptare të periudhave të Neolitit të vonë, Bakrit dhe Bronzit¹⁰⁹. Banesat në këtë vendbanim kanë qenë ndërtuar në një platformë druri, të vendosura mbi trarë të ngulur në tokë¹¹⁰. Ky vendbanim i përket periudhës së neolitit rreth viteve 2600 p.e.s.¹¹¹. Qeramika që lidhet me epokën e bronzit dhe që është pagëzuar nga studiuesit me emrin “devollite”, përfaqëson një nga arritjet më të mira të artit dekorativ të

¹⁰⁷Prendi,F., 1971, Vendbanimi neolitik në fshatin Kamnik të rrethit të Kolonjës (gërmime të vitit 1970), Iliria I, Tiranë, f.13

¹⁰⁸Karaiskaj, Gj., 1981, 5000 vjet fortifikime në Shqipëri, 8 Nëntori, Tiranë, f.9

¹⁰⁹M. Korkuti., 1972,Rreth formimit të etnosit ilir, Kuvendi i studimeve Ilire, Akademia e Shkencave e RPSH, Tiranë, f.68

¹¹⁰Karaiskaj, Gj.,1978, Mbi ndërtimet prehistorike në Iliri, Monumente historike në vendin tonë, Mihal Duri, Tiranë, f.12

¹¹¹Karaiskaj, Gj., 1981, 5000 fortifikime në Shqipëri, 8 Nëntori, Tiranë, f.10

epokës së bronzit.¹¹² Materialet e gjetura (enë të ndryshme, vegla pune prej bakri dhe bronxi) paraqesin vlera shkencore, arkeologjike, kulturore, historike, edukative dhe turistike dhe së bashku me maketin e vendbanimit ndodhen të ekspozuara në Muzeun Arkeologjik të qytetit të Korçës.

Megjithëse aktualisht i pa vizitueshëm, përshtatja dhe improvizimi i banesave prej druri në këtë vendbanim, do ta shndërronin atë në një zonë arkeologjike turistike me mjaft interes për turistët e huaj. Një rast jo aq i ngjashëm nga vlerat dhe rëndësia me vendbanimin prehistorik të Maliqit, por që është shndërruar në një atraksion turistik, është muzeu i vendbanimit palafit, *Bay of Bones Museum* (1200-700 p.e.s) i ngritur në liqenin e Ohrit, pranë qytetit të Ohrit në FYROM. Po kështu një atraksion turistik përbën edhe vendbanimi neolitik bregliqenor, në fshatin Dispilio 8 km larg nga qyteti i Kosturit në Greqi, i vizitueshëm nga turistët ndërkombëtarë.¹¹³

Vlerat e trashëgimisë arkeologjike dëshmojnë gjithashtu me praninë e vendbanimeve të fortifikuara që i përkasin fazës së parë të epokës së hekurit. Kësaj periudhe i përkasin fortifikimet e Gradishtës së Shuecit, Trenit, Ventrokut, Bilishtit, Kakaçit, Gjonomadhit, Lumalasit, Bellovodës, Trajanit, muri pengues i Zvezdës, Podgorisë në Korçë dhe kalaja e Gradecit, Bejkovës, Hollmit, Barmashit, Gradec i Vrepckës dhe muri pengues porta e hekurt (Kolonjë). Në vështrimin e përgjithshëm, ndonëse këto fortifikime ruhen në formë pirgje gurësh, nëpërmjet gjetjeve në to, nxjerrin në pah aspekte të zhvillimit social-ekonomik që ka karakterizuar gjithë zonën.

Një zonë të rëndësishme ku ndërthuren vlerat natyrore me vlerat arkeologjike përbën zona e liqenit të Prespës së Vogël, e cila për nga interesi që paraqet për turistët e huaj mund të konsiderohet si zonë turistike. Disa nga objektet arkeologjike që ndodhen këtu përmendim: *Gradishtëne Shuecit* në trajtën e një ledhi gurësh në kodrën buzë liqenit dhe *kalanë e Ventrokut* mbi shpellën e Trenit, të përcaktuara nga arkeologët, si të vetmet fortifikime të këtij lloji të zbuluara në vendin tonë, të ndërtuara në pika me karakter mbrojtës dhe strategjik.

¹¹²Grup autorësh, Historia e Popullit Shqiptar I, Ilirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë Shek.XVI-vitet 20 të shek.XIX, 2002, Toena, Tiranë, f.34

¹¹³http://www.macedonianheritage.gr/Museums/Anthropological_and_Nat_History/Proistoriko_Displiou

Kalaja e Trajanit, më e madhja ndër të gjitha kalatë e njohura brenda vendit tonë, rrethon një sipërfaqe 22 ha, në lartësinë 1245 m mbi nivelin e detit¹¹⁴. Ndodhet në trajtë linje muresh tarracimi dhe ndonëse në të nuk janë kryer gërmime arkeologjike, ajo paraqet një qendër të rëndësishme paraurbane për pellgun e Korçës e më gjerë¹¹⁵.

Nëpërmjeturvejimeve sipërfaqësore shumëvjeçare është bërë e njohur gjithashtu *piktura shkëmbore e Spilesë*, e ndodhur 500 m larg shpellës së Trenit¹¹⁶, në faqen shkëmbore të masivit që zbret në bregun e liqenit të Prespës së Vogël. Vlerat kulturore dhe artistike transmetohen në pikturën e gdhendur në shkëmb, nëpërmjet një skene gjuetie me figura kalorësish mbi kua, drerë dhe zagarë.

Shpella e Trenit ndodhet në vendin që njihet si “gryka e ujku”, buzë liqenit të Prespës së Vogël dhe është një kombinim i rrallë i vlerave natyrore me vlerat materialo-shpirtërore¹¹⁷. Është formuar nga procesi i karstit, nga tretja në ujë e shkëmbinjve gëlqerorë mesozoikë, tepër të copëtuar nga shpëputje tektonike të plio-kuaternarit¹¹⁸. Sipas spelologëve që eksploruan shpellën, ajo ka dy hyrje, hyrjen kryesore me lartësi 30 m dhe një hyrjen dytësore rreth 4 m mbi kryesoren. Gjatësia e përgjithshme e saj është 293 m dhe përbëhet nga pesë “salla”, me përmasa të ndryshme. Vlerave natyrore u bashkëngjiten edhe vlerat kulturore, pasi shpella ka shërbyer si vendbanim për njerëzit e lashtë që kanë jetuar në zonën juglindore të Shqipërisë. Nga gjetjet e zbuluara prej arkeologëve (prej guri, stralli, kocke, bronz, hekuri e argjendi) veçanërisht të atyre prej qeramike dëshmohej se banorët e kësaj shpelle krahas bujqësisë, blegtorisë dhe peshkimit kanë qenë mjeshtër në punimin dhe zbukurimin e qeramikës¹¹⁹. Në brendësi të saj ndodhen konkelacione stalaktitesh dhe stalakmitesh mjaft interesante. Gjithashtu shpella është vendbanimi i një kolonie lakuriqësh që ndodhen në të.

Të gjitha këto vendbanime të fortifikuara e shpellore, së bashku me “Goricat e Trenit”, “Pavliqet” etj, të cilat ndodhen pranë Shpellës së Trenit, përbëjnë një kompleks kulturor, që ruan mbetje sipërfaqësore të ndërthurur me mjedise gjeografike me bukuri të rrallë natyrore¹²⁰ (brenda parkut ndërkufitar të Prespës). Ato kanë nevojë të eksplorojnë, studiohen dhe integrohen realisht në planet e menaxhimit të parkut dhe projektet konkrete, që po ndërmerren

¹¹⁴ Andrea, Zh., 1970 Andrea Zh; Rezultatet e gërmimeve arkeologjike të vitit 1970; Iliria I, Tiranë 1971, f 42

¹¹⁵ Karauskaj, Gj., 1981, 5000 fortifikime në Shqipëri, 8 Nëntori, Tiranë, f.23

¹¹⁶ Korkuti, M., 2008, Arti shkëmbor në Shqipëri, Mali Pleshti, Tiranë, f.80

¹¹⁷ Qiriazi, P., & Sala, S. & Aliu. S, Vendbanimi shpellor i Trenit, f.1(studim)

¹¹⁸ Po aty, f.1

¹¹⁹ Qiriazi, P., & Sala, S.& Aliu. S. Vendbanimi shpellor i Trenit, f.7 (studim)

¹²⁰ Po aty, f.9

nga organizmat shtetërore dhe ndërkombëtare. Kjo do ndikonte në rritjen e numrit të turistëve dhe nëpërmjet kësaj do të krijoheshin mundësitë për zhvillimin e komunitetit që jeton në këtë zonë. Ideja e shndërrimit të shpellës së Trenit në një muze të vizitueshëm, megjithëse kërkon investime të shumta, mbetet një mundësi reale. Po kështu, kthimi i zonës në park arkeologjik do të ndihmonte në ruajtjen e këtyre vlerave, por njëkohësisht do të rriste interesin e vizitorëve e huaj në zonë.

Treva e Kolonjës përmban gjithashtu potenciale të shumta arkeologjike si *kalaja e Luarasit* (periudha e Bronzit të vonë)¹²¹; *kalaja e Hollmit* në trajtë rrethimesh guri, që e datojnë në fazën e dytë të epokës së hekurit dhe në vijimësi gjatë periudhës Qytetare Romake shek.I-III, pas Krishtit¹²²; *kalaja e Bejkovës* ndodhet mbi njërën nga majat e vargut kodrinor (1080 m mbi nivelin e detit) që datohet në fundin e epokës së bronzit deri në periudhën e hekurit të hershëm (shek.XI-IX, para Krishtit)¹²³; *kalaja e Gradecit (Vrëpckë)* me tipare krejt të veçanta e cila daton në periudhën qytetare ilire (shek.V-IV para Krishtit)¹²⁴.

Në trevën e Pogradecit, *kështjella e Pogradecit* është dëshmi e zhvillimit të pandërprerë të vendbanimit, për periudha të rëndësishme historike. Fragmentet e qeramikës të identifikuara si prodhim vendas ilir, kanë treguar si periudhën më të hershme të banimit në kështjellën e Pogradecit (gjysma e shek. e V dhe fillimin e shek.IV p.e.s)¹²⁵. Larmia e fragmenteve të qeramikës vendase (enët e baltës, tasa, kupa, kantarë, pitosat, monedhat) dhe asaj të importuar, nxjerr në pah se banorët janë marrë me bujqësi, peshkim e zeje të ndryshme dhe kanë pasur marrëdhënie me vendbanimet fqinje. Pas zhvillimeve të vazhdueshme (shek. IV- VIII e.s) dëshmohet nga studiuesit të jetë periudha e katërt dhe e fundit e banimit në kështjellën e Pogradecit¹²⁶. Sipas studiuesve mendohet që kështjella të jetë rrënuar gjatë pushtimit bullgar. Ndonëse në gjendje të rrënuar, kështjella e Pogradecit së bashku me bazilikën e Linit, varret monumentale të Selcës dhe kategori të tjera të monumenteve të kulturës, përbëjnë një ofertë të trashëgimisë kulturore me mjaft interes në zhvillimin e sektorit turistik.

Përveç fortifikimeve të përmendura më sipër nga viti 600-1400, në Shqipëri janë ndërtuar edhe kështjella të vogla mbi maja kodrash me shpate të thepisura, me karakter mbrojtës apo që

¹²¹ Aliu, S., 2012, Tuma e Rehovës, Kotti, Korçë, f.22

¹²² Po aty, f.23

¹²³ Po aty, f.24

¹²⁴ Po aty, f.26

¹²⁵ Anamali, S., 1979-1980, Kështjella e Pogradecit, Iliria IX-X, Akademia e Shkencave, Tiranë, f.214

¹²⁶ Anamali, S., 1979-1980, Kështjella e Pogradecit, Iliria IX-X, Akademia e Shkencave, Tiranë, f.221

mbikëqyrnin rrugë e vendkalime të rëndësishme, siç ishte *kalaja e Mborjes* dhe *Podgories* në rrethin e Korçës.¹²⁷

3.1.4 Vendvarrimet (tumat)

Tumat, (vendvarrimet)ashtu sikurse vendbanimet dhe fortifikimet janë elementë të rëndësishëm të trashëgimisë arkeologjike me mjaft interes në aspektin turistik. Nga studimet e bëra nga arkeologët rezulton se zona e Korçës dhe Kolonjës është e pasur me këtë lloj trashëgimie (tumat e Barçit dhe Kuçit të zi, tumat e Prodanit, Rehovës, Shtikës dhe tuma e Kamenicës). Me studimet e tyre arkeologët, krahas të tjerave evidentojnë edhe një pjesë e rëndësishme e organizmit social të komuniteteve prehistorike, që lidhet me zakonet mortore dhe ritet e varrimit¹²⁸.

Tuma e Kamenicës, ndodhet në ekstremin juglindor të fushëgropës së Korçës, në territorin e komunës Mollaj. Gërmimet e bëra nga arkeologët në vitin 2002, kanë zbuluar një vendvarrim me përmasa më të mëdha se vendvarrimet e zbuluara më parë. Fillimet e saj datojnë në fazën fundore të periudhës së Bronzit të vonë (rreth 1250-1050/1025 B.C). Aty janë zbuluar rreth 400 varre dhe mbetje skeletore të më shumë se 430 individëve¹²⁹. Interes paraqet mënyra në trajtimin e të vdekurve dhe rasti i vendosjes së dy individëve në të njëjtin varr. Interesante paraqitet gjithashtu gjetja e skeletit të trupit të një gruaje dhe një fëmije në barkun e saj. Kjo tumë është shndërruar në një atraksion turistik të vizituar nga grupe të ndryshme vizitorësh. Vendvarrimi prehistorik është i përshtatur sipas kritereve bashkëkohore të zonave arkeologjike dhe është transformuar në një qendër të rëndësishme të informimit dhe edukimit arkeologjik. Në muzeun e tumës janë të ekspozuara larmi enësh qeramike të pikturuara dhe objekte të tjera metalike (prej bronzi, hekuri, ari, kocke, qelqi apo guri, të cilat dëshmojnë qartë për organizimin social-ekonomik dhe kulturor të komunitetit prehistorik të zonës. Ajo vizitohet në mënyrë të organizuar nga nxënës të shkollave, studentë, vizitorë vendas dhe të huaj. Vizitat janë kundrejt pagesës prej 50 lekë për studentët dhe nxënësit dhe 200 lekë për vizitorët e tjerë. Me mjaft

¹²⁷Karaiskaj Gj., 1981, “5000 vjet fortifikime në Shqipëri”, 8 Nëntori, Tiranë, f.171.Emri Mborje lidhet me ekzistencën e një tregu (emporion-treg) që së bashku me kishën dhe vendbanimet kanë përbërë qytetin që ndodhej në rrëzë të kodrës.

¹²⁸Bejko, L., 1999-2000, Zakone mortore në bronxin e vonë të Shqipërisë juglindore, Iliria 1-2, f.129

¹²⁹Bejko, L., Tuma e Kamenicës, Histori e shkurtër dhe guidë, f.10

interes për t'u vlerësuar paraqiten grupet e studentëve të huaj nga gjithë bota, të apasionuar në këtë kategori të trashëgimisë kulturore.

Tuma e Rehovës e zbuluar nga gërmimet arkeologjike (1979-1980) në rrethin e Kolonjës, përbën një tjetër objekt arkeologjik me vlera të rëndësishme edukative dhe turistike. Nga gërmimet arkeologjike krahas 285 varre janë zbuluar 650 objekte me përkatësi kohore të ndryshme (Bronxi i vonë deri Mesjetën e hershme)¹³⁰. Gjetjet e objekte në varre përbëhen nga: qeramikë, armë bronxi e hekuri dhe disa stoli prej bronxi, hekuri, argjendi, floriri, kocke, guri, qelibari etj. Këto objekte iliro-arbërore janë ekspozuar në muzeun e Rehovës¹³¹.

3.2 Monumentet arkitekturore

Monumentet arkitekturore janë pjesë e pasurisë kulturore që ruajnë vlera të veçanta të konceptimit dhe realizimit arkitekturor dhe artistik. Vendbanimet lakustre apo palafite të zbuluara në Maliq dhe Dunavec, janë monumentet më të hershme, që shënojnë fillimet e arkitekturës në vendin tonë¹³². Larmia e ndërtesave të trashëguara është një element i rëndësishëm, që pasqyron zhvillimin social-ekonomik të komunitetit dhe zonës në periudha të ndryshme kohore.

3.2.1 Varret monumentale

Shprehjen e kësaj kategorie të trashëgimisë e përbëjnë ***Varret monumentale të Selcës*** si element karakteristik i qytetit ilir në Selcën e Poshtme. Nga gërmimet e bëra në vitet 1970-1972 u zbuluan 4 varre monumentale të grupuara në dy zona, 100 m larg nga njëra-tjetra, që datojnë si kohë ndërtimi shek.III p.e.s¹³³. Duke ju referuar të dhënave të hershme historike, kjo zonë ka qenë e banuar nga fiset ilire të dasaretëve dhe Selca e Poshtme ose Pelioni¹³⁴ ka qenë qyteti kryesor i Dasaretisë. Në një prej varreve mendohet të jetë varrosur Kliti, mbreti ilir i Pelionit. Përveç varrezave të cilat janë unike në Evropë për nga mënyra e ndërtimit në shkëmb,

¹³⁰Aliu, S., 2012, *Tuma e Rehovës*, Monografi, Kotti, Korçë, f.37; Nga 285 varret 202 i përkasin periudhës së Bronzit dhe Hekurit dhe 83 Mesjetës së hershme të zhvilluar.

¹³¹Rehova si vendbanim i gërsheton vlerat e saj natyrore me vlera të shumta kulturore nëpërmjet pranisë së arkitekturës tradicionale, objekteve të kultit si dhe traditave dhe zakoneve të veçanta.

¹³²Karaiskaj, Gj., 1978, Mbi ndërtimet prehistorike në Iliri, Monumentet historike në vendin tonë, f.11

¹³³Ceka, N., 1972, Varret monumentale në Selcën e Poshtme, Kuvendi i studimeve ilire, f.457-464

¹³⁴Grup aurorësh, 2002, Historia e Popullit Shqiptar I, Ilirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë Shek.XVI-vitet 20 të shek.XIX, Toena, Tiranë, f.63

ndodhen edhe disa shkallë, një mur dhe amfiteatri. Për vlerat e larta kulturore që ato përmbajnë janë shpallur monumente kulture në vitin 1971 dhe “Zonë Arkeologjike” në vitin 2010. Varret monumentale të Selcës, të ndodhura në largësi dhe në vështirësi arritjeje nga qyteti i Pogradecit, (46 km) vizitohen spontanisht nga turistët e tërhequr nga monumentet kulturore apo dhe turistët shëtitës në natyrë.

Në rrethin e Kolonjës, ndodhen dy varre monumentale të gdhendur në shkëmb (varri i Sëndyqit-Shtikë dhe varri i Krajlit), që nuk janë monumente kulture, por janë pjesë e vlerave të trashëgimisë prehistorike të saj. *Guri i Sëndyqit – Shtikë*, ka tipin e një varri “sargofag”¹³⁵ dhe ndodhet në një kodër të vogël, 1.5 km para se të shkosh në fshatin Shtikë, komuna Mollas. *Varri i Krajlit*, është vendosur mbi një masiv gëlqeror që njihet nga banorët si “Çaushko”, 3 km larg qytetit të Leskovikut. Të dy varret ruhen të hapura, pasi u mungojnë kapakët. Ato kanë vlera shkencore, arkitekturore dhe turistike.

3.2.2 Banesat

Banesa është një tjetër element i rëndësishëm dhe i spikatur i trashëgimisë arkitekturore të qytetit por edhe fshatit. Zhvillimet social-ekonomike në Shqipëri, pas viteve 1990 e kanë transformuar hapësirën e vendbanimeve rurale dhe urbane duke cënuar karakterin identifikues të tyre. Ndonëse në qytetin e Korçës, banesat e vjetra kanë ardhur duke u pakësuar dhe në mjaft raste zëvendësuar me tipe të reja, qendra historike e qytetit ka ruajtur disa elementë të hershëm të banesës tradicionale. Në mënyrë të veçantë në qytetin e Korçës, mori një zhvillim të dukshëm banesa e hapur me hajat dhe çardak, e cila shoqëroi zhvillimin social-ekonomik të zonës në fundin e shek. XIX dhe fillimin e shek. XX. Disa nga tipet më karakteristike të banesës qytetare në zonën historike të qytetit, paraqesin vlera të veçanta në aspektin arkitekturor dhe turistik. Disa prej këtyre banesave janë godina e Mësonjëtores së Parë Shqipe, banesa e Pandeli Rados, banesa e Zengove, banesa e Vangjush Mios, banesa e Ilo Kotes, etj¹³⁶.

Godina e Mësonjëtores së Parë Shqipe, është një shtëpi dykatëshe, me dritare mbi rrugë dhe oborr të rrethuar me kangjella që ndodhet në bulevardin Shën Gjergji të qytetit të Korçës.

¹³⁵ Aliu, S., Tuma e Rehovës, 2012, Monografi, Kotti, Korçë, f.29 Këto dy varre monumentale përmenden nga arkeologu S.Aliu, sipjesë e gërmimeve arkeologjike në zonën e Kolonjës.

¹³⁶ Drejtoria e Kulturës Kombëtare Korçë, Monumentet e kulturës së qarkut, 2014

Skema planimetricke e saj është konceptuar sipas dobisë funksionale të banesës korçare¹³⁷. Në vitin 1887 kjo banesë u dhurua nga Mandi Tërpo (i zoti i shtëpisë) për mësimin e gjuhës shqipe. Ajo shërbeu si shkollë deri më 7 mars të vitit 1958, kur u shndërrua në muze të arsimit kombëtar. Arkitektura e banesës ku është vendosur muzeu, ekspozimi i dokumenteve shkollore të periudhës së çeljes së shkollës së parë shqipe dhe historiku i saj janë elementë tërheqës për vizitorët. Në stendat e Muzeut ekziston fotokopja e Abetares së parë shqipe, e shkruar nga patrioti Kostandin Kristoforidhi. Hyrja është e lirë dhe muzeu shërben gjithashtu për kryerjen e aktiviteteve kulturore si ekspozita piktorësh dhe promovime të tjera në fushën e kulturës.

Banesa e Piktorit të Popullit Vangjush Mio, është shembulli më tipik i banesës së hapur, me vlera të veçanta arkitekturore¹³⁸. Ndërtesa ka pamjen e një banesë dykatëshe, me elemente të tillë si çardaku, hajati dhe qilarët. Karakteristikë është prania e musendrave, ku mbaheshin shtrojet dhe qilimat, si edhe elementet dekorues të drurit në secilën nga dhomat. Në një nga dhomat tyre është shënuar një datë 1841 ndërkohë që një tjetër dhomë, është përdorur si studio nga piktori rreth viteve 30 të shek.XX.¹³⁹ Brenda oborrit ngrihet një ndërtesë tjetër që ka shërbyer si "mysafirane". Banesa ka vlera arkitektonike, kulturore, artistike, turistike etj. dhe shërben si muze i piktorit të mirënjohur kombëtar.

Banesa e Ilo Kotes është tepër e veçantë në pamjen e jashtme, të pasur me elementë arkitekturorë. Sipas datës të shënuar në mur mendohet të jetë ndërtuar në vitin 1842.¹⁴⁰ Banesa është dykatëshe dhe në hyrje të saj prezantohet me tre harqe. Trajtimi arkitektonik e dekorativ i tyre është i thjeshtë dhe i pangarkuar me elemente druri. Skema planimetricke i korrespondon variantit të banesave me çardak në qendër, të përhapura në qytetet e tjera të vendit, por shënon edhe futjen e tipareve të reja në arkitekturë¹⁴¹. Banesa ndodhet në oborrin e muzeut arkeologjik dhe tërheq vëmendjen e vizitorëve vendas dhe të huaj. Megjithatë ka vlera të rëndësishme kulturore, artistike, arkitekturore dhe turistike, ndërtesa vuan mungesën e ndërhyrjeve për mirëmbajtjen e saj. *Rijetëzimi i banesës nëpërmjet një rikonstruksioni të përgjithshëm dhe*

¹³⁷ Ballauri, R., 1978, Mësonjëtorja e parë shqipe e Korçës, Muzeu i Arsimit Kombëtar, Monumente historike në vendin tonë, 8 Nëntori, Tiranë, f.96-97

¹³⁸ Thomo, P., 2012, Korça, urbanistika dhe arkitektura, MORAVA, Tiranë, f.62

¹³⁹ Po aty, f.62

¹⁴⁰ Po aty, f.67

¹⁴¹ Thomo, P., 2012, Korça, urbanistika dhe arkitektura, MORAVA, Tiranë, f.70

përshtatjes për funksion turistik,¹⁴² do tërhiqte jo vetëm vizitorë por do të ruante edhe vlerat e saj.

Godina e Liceut të vjetër është ndërtuar në fund të shek. XIX dhe fillim të shek. XX. Është një godinë dy katëshe, e pajisur me bodrume. E gjithë godina është e ndërtuar prej guri, me fashaturë dhe dyshe me prej druri. Nisur nga vlerat e larta arkitekturore dhe kulturore që ajo përmban është shpallur monument kulture në vitin 1973. Aktualisht kjo godinë kryen funksion arsimor (shkollë e mesme pedagogjike).

Zhvillimi social- ekonomik i qytetit të Korçës në fillim të shek. të XX, gjendet i pasqyruar në prezencën dhe huazimin e disa elementëve të veçanta të arkitekturës, të sjella nga vende të tjera. Shembull tipik paraqet *banesa rumune*, që për sa i përket aspektit arkitekturor ka elementë të ndryshëm nga banesa tradicionale korçare, e mbingarkuar me kolona, harqe, relieve me suva etj. E njëjta pamje vërehet edhe në ndërtesën e bibliotekës “*Thoma Turtulli*”, ku ndeshemi me zbukurime të stilit antik, jo fort të zakonata për banesën tipike Korçare.

Në qytetin e Pogradecit dallohet *lagja Toplec*, si një nga lagjet më të vjetra me kalldrëm. Kisha e vjetër e qytetit, banesa e Mitrush Kutelit, Lasgush Poradecit dhe familjeve të tjera me tradita kulturore qytetare janë pjesë të trashëgimisë arkitekturore të qytetit.

Krahas banesës qytetare, me tipare të veçanta arkitekturore, të transmetuara deri në ditët tona, janë dhe *banesat e fshatit*. Në zonën e Korçës dallohet tipi i banesës dardhare, dy-trekatëshe e ndërtuar me gurë dhe çati me rrasa guri (plloça), i cili është ruajtur edhe në ndërtimet e reja. Po kështu, banesat në fshatin Voskopojë janë të ndërtuara me gurë, sipas traditës së ndërtimit të shtëpive të vjetra voskopojare. Fakti që Voskopoja është shpallur “Qendër Historike”, nga Instituti Monumenteve të Kulturës, ka kushtëzuar respektimin e fizionomisë urbanistike të saj dhe karakteristikave të ndërtimeve të reja. Gjithashtu fshatrat Vithkuq dhe Boboshticë kanë ngjashmëri në arkitekturë dhe tiparet e banesës. Ndërkohë tipi i banesës me gur dhe çati me rrasa guri, është i pranishëm edhe në fshatra të tjerë si Qytezë, Sinicë, në rrethin e Devollit, Niçë, në rrethin e Pogradecit etj.

Elementë të tilla si hajati, çardaku, çatia me rrasa guri, oxhaku, vatra, oda e miqve, qilari, portat e gdhendura, sofatet janë gjithashtu karakteristika të banesës së Rehovës, Borovës, Qafëzezit, Vodicës, Postenanit etj., në trevat e Kolonjës dhe Leskovikut. Përveç kuptimit

¹⁴²Më konkretisht një ide do të ishte, funksionimi i banesës si muze etnografik, duke përshtatur ambjentet me objekte tradicionale të trevës së Korçës. Nëpërmjet një bashkëpunimi të sektorit publik me atë privat, shumë vende kanë patur sukses me këtë.

material këto elementë mbartin kuptim figurativ shpirtëror. Fjala “oxhak”, “portë” dhe “derë”, (familje me oxhak; është prej dere;) nënkuptonin gjendjen ekonomike të familjes, pozitën shoqërore dhe emrin e mirë në fshat dhe jashtë tij¹⁴³.

Tipi kullë i banesës krahas funksionit të banimit ka edhe karakter mbrojtës. Në qarkun e Korçës kulla haset në fshatrat Turan, Malavec dhe Dishnicë. Sipas studiuesve ndërtimi i kullave lidhet me një periudhë historike të veçantë, atë të sistemit të çifligut në Shqipëri (XVII-XVIII).

3.2.3 Pazari, hanet e qytetit të Korçës

Në organizimin hapësinor të një qyteti, *tregu apo pazari* luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin social-ekonomik të tij, nëpërmjet lëvizjes së njerëzve, shkëmbimit të mallrave dhe kulturës¹⁴⁴. Korça dhe pazari me arkitekturën e tyre shprehin qartë natyrën zejtaro-tregtare të zhvilluar të këtij qyteti¹⁴⁵. Pazari arriti kulmin e fuqisë së tij gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX, që përkon edhe me zhvillimin e vrullshëm të qytetit¹⁴⁶. Në gjendjen e sotme pazari ruan ato pjesë që u rindërtuan pas zjarrit që e dogji në vitin 1879¹⁴⁷. Për sa i përket organizimit hapësinor të tij, fizionomia e pazarit dallohet për elementë të pasur arkitekturorë. Po të shikojmë hapësirën e zonimit të pazarit vihet re një ndarje funksionale e njësive prodhuese dhe tregtuese, nga ndërtesat që shërbenin për pushim (hanet). Sipas dëshmimeve dyqanet dhe aktivitetet prodhuese e tregtare kanë qenë të përqendruara sipas zejeve (kovaçinjeve, kallajxhinjeve, tregtarëve të mishit, tregtarëve e bulmetit, këpucarët, rrobaqepësit, etj). Në pamjen e sotme dyqanet dykatëshe, në arkitekturën e jashtme dhe të brendshme, ruajnë elementët dekorativë si qemerët, harqet, kangjellat, qepenat etj.

Pazari i qytetit të Korçës tërheq vëmendjen e vizitorëve për arsye të funksionit të tij, vlerave arkitekturore dhe organizimin hapësinor të tij. Ka vite që i është nënshtruar procesit të rikonstruksionit, për ta shndërruar në një qendër tregtare tradicionale. Megjithatë i vjetër dhe

¹⁴³ Prifti, B., 2010, Toskëria, Kolonja dhe Leskoviku, në vështirim etnografik, Vllamasi, Tiranë, f.85

¹⁴⁴ Thomo, P., 2012, Korça, urbanistika dhe arkitektura, MORAVA, f.201

¹⁴⁵ Riza, E., & Strazimiri, B., 1972, Vështirim mbi arkitekturën e qytetit të Korçës, Monumentet 3, Instituti Monumenteve të Kulturës, Tiranë, f.120

¹⁴⁶ Po, aty, f.119-120. Në fillim të shek. të XIX Korça kishte 3000 banorë e 450 banesa, ndërkohë në vitin 1959 numëronte 10000 banorë.

¹⁴⁷ Thomo, P., 1978, Mbi urbanistikën dhe arkitekturën e qytetit të Korçës, Monumente historike në vendin tonë, 8 Nëntori, Tiranë, f.5

me vlera të rëndësishme, po aq sa pazaret e vendeve fqinje, Strugës, Shkupit, Prizrenit, Gjakovës, ndonëse ato me kohë funksionojnë si qendra tradicionale tregtare dhe turistike, pazari i qytetit të Korçës ende vuan nga mungesa e vizionit dhe mirëmenaxhimit nga ana e institucioneve përkatëse.

Përveç dyqaneve dhe ndërtesave të tjera, vlera të rëndësishme paraqet edhe prania e haneve. Ato ndodhen brenda pazarit dhe shërbenin si vende takimi për tregtarët dhe vend çlodhës dhe fjetës për njerëzit që vinin nga larg në pazar, për të tregtuar apo për të blerë. Sipas studiuesve mendohet të kenë qenë 15-16 hane, kurse sot më tipikët dhe më me interes paraqiten hani i Elbasanit, hani i Gjelit dhe hani i Manastirit, të cilët për vlerat e tyre arkitekturore, janë shpallur monumente kulture.

Hani i Elbasanit paraqet interes nga turistët për sa i përket kompozimit planimetrik dhe ndërthurjes së elementëve arkitekturorë e dekorative. Në oborrin e brendshëm është i veshur me kalldrëm, ashtu sikurse gjithë rrugët e pazarit dhe rrethohet me ndërtime dykatëshe. Po këtu gjendet një pus. Në katin e dytë dallohen, nëpërmjet një korridori përshkues, dyert e odave të fjetjes.

Hani i Manastirit ndodhet pranë hanit të Elbasanit me hyrje nga pjesa kryesore e pazarit. Nga ana ndërtimore ai përfaqëson një periudhë më të vonë, e cila ka sjellë të reja kryesisht në teknikë e në material ndërtimi si dhe në mbylljen e njësive të hapura, por ka trashëguar skemat e vjetra kompozicionale¹⁴⁸. *Po ti kthehemi funksionit të haneve, ato kanë shërbyer si bujtëse për të gjithë ata që vinin në qytet dhe zonën e Korçës, për tregti apo edhe për qëllime të tjera. Tashmë me gjithë rikonstruksionin e pazarit, ato duken larg përshtatjes së tyre për këtë funksion.*

Urat janë objekte me vlera arkitekturore që janë trashëguar nga shekujt e kaluar. Disa prej këtyre urave janë shpallur monumente kulture si ura e Golikut në Pogradec, ura e Kovaçit në Voskopojë, ura e Zotos në Vithkuq etj.

¹⁴⁸Thomo, P., 1978, Mbi urbanistikën dhe arkitekturën e qytetit të Korçës, Monumente historike në vendin tonë, 8 Nëntori, Tiranë, f.256

3.3 Monumente historike

Zona e Korçës trashëgon objekte me vlera të rëndësishme kombëtare e më gjerë, dorëshkrime, libra dhe periodikë, që ruhen në muzetë e qytetit të Korçës, Pogradecit dhe Ersekës. Ato mund të konsiderohen si institucionet edukative, që udhëheqin promovimin e trashëgimisë kulturore por njëkohësisht edhe institucionet e konservimit të saj.

3.3.1 Muzetë

Trashëgimia historike e qarkut të Korçës ruhet në muzetë e ndërtuar në qytetin e Korçës, Pogradecit, Ersekës, ndër të cilët do të përmendim për vlerat e tyre:

Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar është hapur në vitin 1980 dhe ndodhet në qendrën historike të qytetit të Korçës. Ekspонатet dhe fondet e pasura të tij me objekte historike, kulturore e artistike, që lidhen kryesisht me trashëgiminë e krishtere bizantine dhe pasbizantine, janë shembuj të një pasurie e larmie vlerash të paçmuara¹⁴⁹. Ekspozimi i tyre është realizuar pjesërisht në sallën e ekspozitës me rreth 200 objekte arti, çka paraqesin vetëm një pjesë të veprave më të mira mesjetare, nga autorë anonime apo të identifikuar. Kështu midis tyre dallohen ikonat e shek.XIII-XIV, duke vijuar më pas me kryemjeshtër si Oufri, Nikolla, Onufër Qiprioti, Simoni i Ardenicës, Kostandin Jeromanaku, vëllezërit Zografi, David Selenicasi etj. Në mes të këtij koleksioni janë rreth 150 autorë ikonografë shqiptare dhe të huaj të zbuluar deri më sot.

Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar është nga objektet më të vizitueshëm në qytetin e Korçës, veçanërisht nga turistët ndërkombëtarë. Ekspozita e muzeut është vizituar nga ekspertë të fushës së artit mesjetar dhe restaurimit, nga një numër i konsiderueshëm artdashësish, pelegrinësh, studentësh, nxënësish vendas dhe të huaj. Në vitin 2009 muzeu u vizitua nga 3180 vizitorë vendas dhe të huaj, ndërkohë që në vitin 2012 numri i vizitorë ishte 4652, prej të cilëve 1534 vizitorë vendas dhe 3118 vizitorë të huaj.¹⁵⁰ Prezantimi i vlerave për vizitorët e huaj bëhet nga dy specialistë të muzeut, kryesisht në anglisht dhe italisht, por nuk mungon edhe në gjuhë

¹⁴⁹Drejtoria e Rajonale e Kulturës Kombëtare, 2013,Në veçanti koleksioni ikonografik që ky muze posedon, është një nga më të mëdhenjtë në numër (rreth 6 500) dhe po aq i bukur dhe i krahasueshëm me të gjithë artin tjetër bizantin e pasbizantin, të krijuar në territoret finje të inkuadruara në ish perandorinë bizantine

¹⁵⁰Muzeu i Artit Mesjetar. Të dhënat përfshijnë edhe vizitorët e regjistruar në Muzeu i Arsimit.

të tjera. Aktualisht pritet të inagurohet edhe ndërtesa e re e Muzeut të Artit Mesjetar, e lokalizuar në një nga zonat me të frekuentuara në qytet.

Të ardhurat e siguruara (hyrja realizohet nëpërmjet biletës me vlerë 200 lekë) nuk administrohen nga muzeu për nevojat e tij, por kalojnë në buxhetin e ministrisë përkatëse.

Muzeu Arkeologjik, u krijua në vitin 1985, por formë të plotë mori pas vitit 1990. I vendosur në një ndërtesë karakteristike korçare, të fillimit të shek XIX, muzeu Arkeologjik i përket prehistorisë së zonës juglindore dhe është i veçantë në llojin e vet. Këtu janë të ekspozuar 1200 objekte autentike të zbuluara nga gërmimet arkeologjike në shumë vendbanime prehistorike, që tregojnë zhvillimin e kulturës në Shqipërinë Juglindore, që nga mijëvjeçari i gjashtë para Krishtit deri në shek.VI. Me mjaft interes paraqiten maketet e disa vendbanimeve të rëndësishme prehistorike si: Maliqi, Dunaveci, Trajani, etj. Ky muze vizitohet nga nxënës, vizitorë vendas dhe të huaj. Në vitin 2012 muzeu u vizitua nga 3760 vizitorë vendas dhe të huaj. Hyrja në muze është kundrejt biletës prej 200 lekë. *Me gjithë interesin e konstatuar të vizitorëve të huaj, gjendja dhe mirëmbajtja e tij, lë për të dëshiruar dhe nuk i përgjigjet vlerave arkeologjike dhe arkitekturore që ky muze posedon.*

Muzeu Kombëtar i Arsimit, është ngritur në godinën ku më 7 mars 1887 u hap Shkolla e Parë Shqipe ose “Mësonjëtorja”. Arkitektura e banesës ku është vendosur muzeu, ekspozimi i dokumenteve shkollore të periudhës së çeljes së shkollës së parë shqipe dhe historiku i saj janë elementë tërheqës për vizitorët. Në stendat e Muzeut ekziston fotokopja e Abetares së parë shqipe, e shkruar nga patrioti Kostandin Kristoforidhi. Vizitohet nga nxënës, student, vizitorë vendas dhe të huaj.

Muzeu Historik i rrethit të Kolonjës, në qendër të qytetit të Ersekës, është një ndër muzetë e parë të hapur në shkallë republike (shkurt 1962), që e ruan fizionominë e tij edhe në ditët e sotme duke i shpëtuar shkatërrimeve të viteve të tranzicionit. Triptiku në fasadën e tij, veprë e skulptorit Vasiliev Nini, pasqyron etapat e zhvillimit historik të trevës së Kolonjës, që në prehistori dhe deri në fund të periudhës së diktaturës. Në katin e parë, është pozicionuar në një mjedis të veçantë “oda e miqve” ose “oda kolonjare”, ku shpalosen traditat e kësaj treve. Kjo pëlqehet shumë nga turistët vendas dhe të huaj që e vizitojnë atë. Muzeu mbart vlera të rëndësishme arkeologjike, kulturore, artistike dhe turistike, por vizitohet shumë pak. Në vitin 2012 ai u vizitua nga 110 vizitorë, kryesisht ndërkombëtarë, të cilët janë pjesë e itinerarit Korçë-Ersekë-Leskovik-Përmet-Gjirokastrë.

Muzeu Historik i qytetit të Pogradecit mbart vlera të rëndësishme historiko-kulturore dhe ndonëse në numër të vogël vizitohet nga vizitorë vendas dhe të huaj që vijnë në qytetin e Pogradecit.

Muzeu "Bratko", është çelur në vitin 2003, si dhuratë e një shqiptari, Dhimitër Borja, artist, fotograf dhe mbledhës i artit aziatik dhe të antikitetëve. Muzeu Bratko është një muzeu oriental, kryesisht me vepra arti nga vendet në të cilat ka qenë vetë dhuruesi. Veprat e artit që ndodhen në muze janë vepra (rreth 430) si piano, altar kinez, veshje për gra japoneze, rripa kineze, shpate indoneziane, piktura japoneze, fotografi të ndryshme të bëra nga dhuruesi gjatë misionëve të tij. Ndonëse i vendosur në një ndërtesë tërësisht të ndryshme nga ndërtimet tradicionale, pëlqehet të vizitohet për shkak të natyrës së tij të veçantë.

Shtëpia muze e piktorit Vangjush Mio, përbën një tjetër atraksion turistik (monument kulture) me një fond pikturash të ekspozuara me larmi peizazhesh, natyrë të qetë si dhe shumë vizatime, të cilat janë të njohura për stilin e veçantë të realizimit. Vangjush Mio është piktori i parë shqiptar i peizazhit që ka hapur ekspozitën e parë në Tiranë në 1920. Vizitohet nga të pasionuarit e peizazhit dhe pikturës.

3.3.2 Dorëshkrimet

Krahas monumenteve arkeologjike dhe arkitekturore, ekzistenca e burimeve dokumentare të shkruara, janë një element i rëndësishëm i trashëgimisë sonë, që dëshmojnë për zhvillimin shoqëror, historik dhe kulturor të trevave të veçanta dhe gjithë Shqipërisë. Një vend të veçantë dhe një pasuri të çmuar përbëjnë dorëshkrimet bizantine dhe postbizantine të njohur si *Kodikët e Shqipërisë*. Janë një fond prej 100 kodikësh, të cilët ruhen në Arkivin Qendror Shtetëror, si një pasaportë kulturore e padiskutueshme e identitetit dhe krenarisë sonë kombëtare. Në këtë pasuri një vend të rëndësishëm krahas Kodikëve të Beratit, zënë edhe kodikët e Korçës.

Kodiku i Metropolisë së Korçës dhe Sefalosforit i vitit 1676, i hulumtuar nga mjaft studiues brenda dhe jashtë vendit, ka hedhur dritë mbi veprimtarinë ekonomike, shoqërore dhe kulturore të trevës së Korçës në shekujt XVIII-XIX¹⁵¹. Po kështu më vlera paraqiten gjithashtu *kodiku i Voskopojës* si dhe *kodiku i Korçës 93* (Katërunjëllëshi i shek.X), i cili dëshmon për lidhjen në

¹⁵¹ Kod.Korçës dhe Sefalosforit, 1981, Tiranë, f.1

përgjithësi të mjedisit të Shqipërisë së sotme me kryeqendrën kulturore të Bizantit¹⁵². Promovimi së fundmi në qytetin e Korçës, i botimit të parë faksimile i Kodikut të Korçës 93, bëri të njohur vlerat shkencore, artistike, historike dhe fetare të kësaj trashëgimie.

3.4 Monumete të kultit

Në qarkun e Korçës rrethanat historike kanë bërë të mundur të kultivohen dhe bashkëjetojnë tre komunitete fetare kryesore: të krishterë, myslimanë dhe bektashinj. Gjurmët kulturore të këtyre besimeve janë pasqyruar në ndërtesat e kultit si edhe në objektet e ndryshme fetare të cilat, përveç se janë dëshmi e kultivimit të besimit fetar përfaqësojnë edhe vlera të jashtëzakonshme artistike dhe kulturore për qarkun dhe për gjithë trashëgiminë kulturore. Nisur nga vlerat që ato përmbajnë një pjesë e tyre janë shpallur monumete kulture të kategorisë së parë (njëzet e shtatë kisha, një xhami, 3 teqe dhe një tyrbe).

3.4.1 Objektet e kultit kristian (kishat)

Materiale dokumentare të kodikëve si edhe burimeve të tjera të shkruara, shprehin zhvillimin e jetës kulturore të Korçës dhe trevave të saj edhe nëpërmjet ngritjes së një morie veprash kulti me vlera arkitekturore dhe artistike¹⁵³. Përveç rëndësisë që paraqesin në aspektin religjioz (fetar), objektet e kultit janë në qendër të interesit të vizitorëve vendas dhe të huaj. Disa nga objektet e kultit kristian të shpallura monumete kulture janë:

Kisha trekonshe e Linit (Bazilika) Pogradec, është një nga ndërtimet e kultit që ruhen në Shqipëri, e rëndësishme për nga vlerat që mbart. I gjithë kompleksi i ka dyshemetë të shtruara me mozaikë, gjurmët e të cilëve flasin qartë për vlerat artistike të monumentit. Në mozaikët e kësaj bazilike motivi më i përdorur është ai i pjergullës¹⁵⁴, krahas luleve, shpendëve si edhe disa motiveve më pak të përdorura në mozaikët e tjerë të Shqipërisë si, lepujt dhe bletët. Ngjyrat mbizotëruese të tyre janë: e bardha, e zeza dhe e kuqja, por janë përdorur edhe ngjyra të tjera si kafja, jeshilja, e verdha dhe portokallia. Duke patur parasysh afërsinë planimetrike, vendndodhjen e tyre, ngjashmërinë stilistike të mozaikëve dhe të përmbajtjes së skenave të

¹⁵² Kodiku i Korçës 93 (botim faksimile)

¹⁵³ Kod.Korçës dhe Selaforit, f.33

¹⁵⁴ Anamali, S.,&Adhami, S., 1974, Mozaikë të Shqipërisë, 8 Nëntori, Tiranë, f.14

tyre, mendohet se kisha trikonshe e Linit duhet të jetë ndërtuar në fillim të shek. VI¹⁵⁵ dhe është restauruar në vitet 2008-2009. Ajo përbën një objekt të vizitueshëm nga turistët e huaj.

Kisha e Shën Jovanit (Boboshticë) Korçë, dallohet për pamjen e jashtme të ndërtimit të saj dhe vlerat artistike të veçanta në mjediset e brendshme, ku të bien në sy muret e veshura me piktura murale. Nisur nga teknika dhe materialet e ndërtimit, studiuesit mendojnë se kisha daton në gjysmën e dytë të shek. XIV.

Kisha e Shën Mitrit në Bezmisht, ndodhet veri të fshatit me të njëjtin emër, buzë liqenit të Prespës, në të cilin ndodhen gjithashtu shpella eremite, që ruajnë piktura të periudhës së para pushtimit turk¹⁵⁶. Mbi bazën e teknikës së ndërtimit kualsonazh, sipas studiuesve mendohet se kisha është ndërtuar gjatë gjysmës së dytë të shek. XIV¹⁵⁷.

Kisha e Shën Mërisë në ishullin e Maligradit, ndodhet në ishullin e vogël me të njëjtin emër, në Liqenin e Prespës së Madhe. Është ndërtuar në një shpellë të shkëmbore e hapur nga liqeni. Në kishë hyhet nëpërmjet një porte dykanatëshe druri të gdhendur. Sipas mbishkrimeve kisha i është nënshtruar ndryshimeve. Mendohet që fillimisht data e ndërtimit të kishës të jetë viti 1345¹⁵⁸, ndërkohë që në vitin 1369 kishën e rindërton Kesar Novaku¹⁵⁹. Pikturat murale kanë vlera artistike, fetare dhe turistike.

Kisha e Ristozit në Mborje, është ndërtuar në fshatin Mborje në juglindje të qytetit të Korçës. Në arkitekturën e saj kisha paraqitet mjaft kompakte, ndërsa muratura e kishës është e përbërë nga gurë të papunuar, me copëra tjegullash të vendosura njëra mbi tjetrën ndërmjet gurëve, po jo gjithandej¹⁶⁰. Sipas burimeve të shkruara mendohet që kisha të jetë ndërtuar gjatë shekullit të XIV¹⁶¹. Vizitohet nga mijëra vizitorë në rastet e festave fetare, por edhe nga turistët të huaj. Ndonëse monument me vlera të rëndësishme kulturore, aktualisht vuan mungesën e ndërhyrjeve për restaurimin e saj.

Kisha e Shën Triadhës në Lavdar të Oparit, ndodhet në fshatin Lavdar të komunës Lekas në rrethin e Korçës. Kisha është ndërtuar në shek. XV nga Ana, e bija e sundimtarit të

¹⁵⁵ Meksi, A., 2004, Arkitektura e kishave të Shqipërisë (shekujt VII-XV), EUGEN, Tiranë, f.31

¹⁵⁶ Po aty, f.178

¹⁵⁷ Po aty, f.178

¹⁵⁸ Goce Angelicin Zura, 2004, The cave churches in the Ohrid-Prespa region (R.Macedonia, R.Albania, R.Greece) "IRIS", Struga, f.190

¹⁵⁹ Po aty, f.190

¹⁶⁰ Meksi, A., 2004, Arkitektura e kishave të Shqipërisë (shekujt VII-XV), EUGEN, f.212-213

¹⁶¹ Po aty, f. 221

Gjirokastrës, Gjin Zenevisit, e ëma e Gjin Muzakës dhe gruaja e II Muzakës Andre¹⁶². Dallohet për një arkitekturë të veçantë, por ishte krejtësisht e dëmtuar nga ndryshimet në kohë. Në vitin 2013 kisha u restaurua nga Drejtoria e Kulturës Kombëtare Korçë, duke nxjerr në pah një monument kulture me vlera të jashtëzakonshme.

3.4.2 Kishat e Voskopojës

Voskopoja që përmendet në kohën e lulëzimit të saj për shkolla dhe institucione kulturore, (shek. XVIII) përmendet midis të tjerave për numrin e bazilikave, me elementë arkitekturorë dhe artistikë me vlera unike, që përbëjnë sot dëshminë e qytetërimit mesjetar. Manastiri Shën Prodhomit, Bazilika e Shën Kollit, Bazilika e Shën Thanasit, Bazilika e Shën Mërisë, Bazilika e Shën Mëhillit dhe Shën Dëllisë. *Manastiri i Shën Prodhomit* është ndërtuar në shekullin e XVII, në vitin 1632¹⁶³, kur fshati i Voskopojës po merrte fizionominë e një qendre të rëndësishme zejtaro-tregtare. Këtu ndodhet edhe kisha trekonëshe, e dallueshme nga stili bizantin në formë kryqi. Muret janë të veshura me piktura murale dhe ndonëse aktualisht rezultojnë të dëmtuara dallojnë qartë elementët e gdhendur me vlera të veçanta artistike. *Bazilika e Shën Kollit* është një nga pesë bazilikat më madhështore të ndërtuara në Voskopojë dhe që ruhet fare mirë edhe në ditët tona. Nga mbishkrimi që ndodhet në pjesën perëndimore të saj, studiuesit dëshmojnë se kishën e ka pikturuar D.Selenicasi me dy ndihmësit e tij¹⁶⁴. Kisha është ndërtuar në vitin 1721 dhe është pikturuar në vitin 1726¹⁶⁵. Pikturat murale mbartin vlera të pakrahasueshme artistike, fetare dhe turistike.

Bazilika e Shën Thanasit i përket periudhës pasbizantine dhe sipas mbishkrimeve rezulton, që kisha të jetë ndërtuar në vitin 1724¹⁶⁶. Pikturat murale në këtë kishë ndonëse të dëmtuara, ruhen më mirë se në kishat e tjera. *Kisha e Shën Gjergjit në Shipskë*, gjendet në hyrje të fshatit, rreth 5 km larg Voskopojës. Nga arkitektura dhe teknika e ndërtimit, mendohet të jetë ndërtuar në mesin e shek. XVII, çka e bën atë një nga shembujt më të hershëm të këtij tipi bazilikal,

¹⁶²Meksi, A., 2004, Arkitektura e kishave të Shqipërisë (shekujt VII-XV), EUGEN, f. 221

¹⁶³Adhami, S., 2008, Voskopoja e Ilustruar, MirgeerAlb, Tiranë, f.19

¹⁶⁴Nalibali, H., 1971, Rreth krijimtarisë së piktorit D.Selenicasi, Monumentet 1, “Mihal Duri”, Tiranë, f.119

¹⁶⁵Po aty, f.119

¹⁶⁶Adhami, S., 2008, Voskopoja e Ilustruar, MirgeerAlb, Tiranë, f.51

gjatë periudhës post-bizantike¹⁶⁷. Restaurimi tërësor dhe pastrimi i pikturave ka nxjerr në pah vlerat kulturore, fetare, artistike dhe turistike të kishës.

Prej disa vitesh kishat e Voskopojës me vlerat e tyre kanë zgjuar interesin e turistëve të huaj dhe vizitorëve vendas. Vizitat në këto objekte kulti bëhet me bileta kundrejt një pagese modeste. Në kishën e Shën Kollit në qendër të fshatit, kryhen ritet dhe ceremonitë fetare të komunitetit të zonës dhe prifti kryen gjithashtu rolin e shpjeguesit të vlerave të kishës për vizitorët. Kishat janë monumente kulturore dhe mbrohen me legjislacion të veçantë, ashtu sikurse menaxhohen nga institucionet përkatëse, puna e të cilave në këtë drejtim nuk paraqitet në nivelin e duhur.

Vithkuqi radhitet krahas Voskopojës për praninë e kishave dhe madhësinë e vlerave të tyre. *Kisha e Shën Mëhillit Vithkuq*, gjendet në veriperëndim të Vithkuqit, në anën e djathtë të rrugës që të çon në fshatin Shtyllë, pranë varrezave të vjetra, jo shumë larg nga qendra. Nga mbishkrimet që gjenden në të, mendohet të jetë ndërtuar në fund të shek. XVII dhe fillim i shek.XVIII. Brenda saj muret janë të veshura me piktura murale me vlera të çmuara artistike. *Manastiri i Shën Pjetrit dhe kisha e Shën Kozmait (qimitiri)* gjendet në një kodër të pjerrët, pa arritur në fshatin Vithkuq. Është ndërtuar në vitin 1709 dhe është pikturuar nga brenda në 18 Maj 1750¹⁶⁸. Arkitektura dhe urbanistika e ndërtimit është e veçantë. Edhe këtu të bien në sy pikturat e vëllezërve Zografi, të cilët pikturuan kishën e manastirit. Është një ansambël kishtar me kupolë ndriçimi me fanare dhe oborr të brendshëm. Në krah të Shën Pjetrit është edhe kisha e Shën Kozmait dhe Damianit, e cila është e një natyre të veçantë. Emërtohet ndryshe dhe qimitir, pasi në të ruhen eshtrat e të vdekurve. Ka vlera shkencore, kulturore, fetare, turistike etj. *Kisha e Shën Mërisë dhe kisha e Shën Gjergjit*(monumente kulture) ndodhen gjithashtu në fshatin Vithkuq dhe mbartin vlera të rëndësishme arkitekturore, artistike, fetare dhe turistike.

Kisha e Shën Marenës, ndodhet në veri të fshatit Llëngë, në rrethin e Pogradecit. Ndonëse është ndërtuar e re, vendndodhja e saj në një zonë me bukuri dhe monumente natyrore i jep krahas të tjerave vlera kulturore dhe turistike.

Katedralja Ringjallja e Krishtit është ndërtuar në vitin 1994 dhe shërben për kryerjen e të gjitha riteve fetare të besimtarëve të krishterë ortodoks. Ndonëse e re dhe nuk gëzon statusin e monumentit të kulturës, ajo përbën një nga simbolet kulturore të qytetit të Korçës me vlera

¹⁶⁷Kallamata, K., *Kisha e Shën Gjergjit Shpiskë*, guidë-fletëpalosje

¹⁶⁸Papakozma, A., 1983, *Manastiri Shën Pjetër e Pavli në Vithkuq, datimi, urbanistika, arkitektura, mjeshtrit e ndërtimit; "Mihal Duri", Tiranë, f.78-79*

artistike në arkitekturën e jashtme dhe zbukurimet e brendshme murale të saj. Në vazhdim të traditës së pikturimit të kishave, është për t'u evidentuar fakti se besimtarët ortodoksë janë duke kontribuar në veshjen e brendshme me piktura murale. *E ndodhur në qendër të qytetit katedralja është objekti kulturor që vizitohet dhe vlerësohet nga të gjithë turistët e huaj dhe vizitorët që vijnë në qytetin e Korçës.*


3.4.3 Objektet e kultit mysliman

Objektet e kultit mysliman përfaqësohen nga xhami apo teqe, të cilat për vlerat arkitektonike dhe artistike që mbartin, janë të shpallura monumente kulture. Disa nga këto objekte mund të rendisim:

Xhamia e Iliaz Bej Mirahorit në qytetin e Korçës është më e vjetra e këtij tipi në vendin tonë (xhami me sallë të mbuluar me kupolë). Sipas mbishkrimit të vonë (1872-1873) mbi portën e hyrjes, xhamia është ndërtuar në vitin 1495-6, (901H) nga Iliaz Beu, me origjinë nga Panariti, Mirahor, komandant i stallave të Sulltan Bajazitit të II ¹⁶⁹. Xhamia përbëhet nga sala e lutjeve, portiku tri pjesësh dhe minarja ¹⁷⁰ dhe mendohet të jetë ndërtuar mbi rrënojat e kishës së Shën e Premtes në fshatin Peshkëpi, fare pranë qytetit të Korçës. Për nga arkitektura është vlerësuar si ndërtim nga më të arriturit, që ndonëse e vogël është një ndërtesë monumentale. Studiuesit e krahasojnë atë me mjaft xhami bashkëkohore të Stambollit. Por teknika e ndërtimit të mureve, ndryshon tërësisht nga ndërtimet turke, gjë që flet për një traditë ndërtimore vendase.

¹⁶⁹Frashëri, Gj., & Dashi, S., 1978, Karakteristika arkitektonike të disa xhamive të vendit tonë, *Monumente historike në vendin tonë; "Mihal Duri"* Tiranë, f.42

¹⁷⁰Meksi, A., 2007 Arkitektura e xhamive të Shqipërisë (shekujt XV-XIX), UEGEN, Tiranë, f.39



Harta – Monumentet e kulturës të qarkut Korçë

Gjendja e mirë arkitekturore pas restaurimit e ka kthyer në një objekt atraktiv për vizitorët e huaj.

Teqeja e Qesarakës-Kolonjë, ndodhet rreth 50 km larg nga qyteti i Korçës dhe rreth 30 km nga qyteti i Ersekës në fshatin me të njëjtin emër. Kjo teqe mendohet se është ndërtuar në vitin 1600 dhe themelues i saj ka qenë Haxhi Babai nga Irani¹⁷¹. Teqeja e Qesarakës është një kompleks i përbërë nga dy ndërtime: varri monumental (mauzoleu) që quhet tyrbe dhe konaku, që është banesa apo rezidenca ku jeton Babai. Ndërhyrjet restauruese kthyen tipologjinë dhe arkitekturën e kohës, duke i dhënë autoritetin që i kishte munguar dhe njëkohësisht, duke e bërë më interesante dhe më tërheqëse për besimtarët dhe vizitorët. Me restaurimin e teqesë, Urdhri i Dervishëve Bektashi në Shqipëri¹⁷², ka një monument historik të konservuar me të gjitha vlerat e tij shkencore, arkitektonike, fetare dhe turistike. *Teqeja e Turanit* e ngritur në vitin 1827 përbën gjithashtu, një monument kulture të rëndësishëm për besimtarët myslimanë por edhe për vizitorë të ndryshëm.

3.5 Monumentet artistike

Gjurmet e artit figurativ në Shqipëri janë të hershme, që në periudhën e neolitit me zbulimin e qeramikave, terrakotave, zbulimeve me metal etj¹⁷³. Lulëzimi i qyteteve ilire solli edhe zhvillimin e artit ilir me pikturimin e qeramikës, skulpturën, mozaikët dhe afresket. Në qarkun e Korçës trashëgohen një mori veprash arti si mozaikë, afreske, ikona, piktura, skulptura, fotografi artistike etj, vlerat e të cilave nuk mund të kuptohen jashtë ambienteve të cilave u përkasin. Këto në pjesën më të madhe të tyre ruhen në muzetë e qytetit të Korçës, Ersekës dhe Pogradecit.

3.5.1 Piktura murale

Në periudhën e mesjetës arti i pikturës gjeti shprehjen më të lartë artistike. Piktore të shquar të shekullit të XVIII si David Selenicasi, Kostandin Shpataraku, Vëllezërit Kostandin

¹⁷¹ Kallamata, K., *Teqeja e qesarakës, guide-fletëpalosje*

¹⁷² Po, aty

¹⁷³ Dollma, M., 2011, *Trevat Shqiptare, Dajti 2000*, Tiranë, f.93

dhe Athanas Zografi, familja Katro, pikturuan kishat në Shqipëri dhe vendet fqinje. Përveç vlerave arkitekturore dhe fetare kishat e Voskopojës, Vithkuqit, Boboshticës, Prespës dhe gjithë kishat e tjera në qarkun e Korçës, dallohen edhe për vlerat artistike të pikturave murale, ikonostaseve dhe ikonave. Pikturat paraqesin tema të shumta të trajtuara me kontekst fetar. Veprat më të çmuara të këtij fondi pikturash të artit bizantin dhe pasbizantin ruhen në Muzeun e Artit Mesjetar në qytetin e Korçës. Disa prej këtyre pikturave murale do të përmendim: “*Ava Shëruesi*”, “*Lindja e Krishtit*”, “*Shërimi i barinjve të vjetër*” piktura të shek.XVIII, nga David Selenicasit në kishën e Shën Kollit. Në manastirin e Shën Prodhomit në narteksin e kishës gjejmë piktura murale shenjtorësh të piktorit vendas Andon Shipska (Jeromonaku) ashtu sikurse afreske shenjtorësh në kishën e Shën Mëhillit. Në kishën e Shën Gjergjit në Shpëskë, gjatë restaurimit u zbulua vazhdimi i pikturës murale “*Gjyqi i fundit*”¹⁷⁴. Tradita e pikturës murale vazhdon ende edhe në kishat e ndërtuara kohët e fundit. Kështu katedralja “*Ringjallja e Krishtit*”, kisha e Shën Thanasit dhe kishat e tjera në qytetin e Korçës vazhdojnë të zbukurohen me piktura murale. Përveç pikturave murale vlera artistike më të rëndësishme përbëjnë edhe *ikonat dhe ikonostaset* të cilat i gjejmë të pranishme në pothuajse të gjitha kishat (Voskopojës, Maligradit, Vithkuqit, Boboshticës, Mborjes etj). Ikonat më të çmuara ruhen në Muzeun e Artit Mesjetar (veprat e ikonografit të shquar Jeromonak Kostandini). Veshja e tipareve të shenjtorëve në skenat e spiritualizmit fetar, me pamje që i afrohej jetës reale, është një element i pasqyrimit të zhvillimit social-ekonomik të kohës në art. Një pasqyrim të tillë e gjejmë tek skena e “mbjellësit të farës” e piktorit David Selenicasit¹⁷⁵. Krahës monumenteve me karakter religjоз, **skulptura** është një gjini artistike që ka gjetur mishërimin e vet edhe në qarkun e Korçës me vepra të realizuara nga mjeshtrat e skulpturës kombëtare. Në gjithë fondin e kësaj gjinie, vetëm dy prej tyre që ndodhen në qytetin e Korçës kanë statusin e “Monumentit të Kulturës”: *Monumenti i Luftëtarit Kombëtar* ose siç njihet ndryshe “Ushtari i panjohur”, që ndodhet në zonën këmbësore të qytetit, i ndërtuar me mjeshtëri nga Odhise Paskali në vitin 1932. Monumenti mishëron vlerat atdhetare të një krijimi realist por edhe vlera artistike dhe turistike. *Monumenti i Themistokli Gërmenjit* gjithashtu monument kulture, ndodhet brenda lulishtes me të njëjtin emër dhe është ndërtuar në 1932, përsëri nga mjeshtri Odise Paskali¹⁷⁶.

¹⁷⁴ Kallamata, K., Kisha e Shën Gjergjit, Shpëskë, guide-fletëpalosje

¹⁷⁵ Adhami, S., 2008, Voskopoja e Ilustruar, MirgeerAlb, Tiranë, f.37

¹⁷⁶ Drejtoria e Politikave të zhvillimit dhe projekteve strategjike, Bashkia Korçë

Me vlera kulturore paraqiten edhe disa monumente të tjera si: *Monumenti "Koci Bako"* ndërtuar nga Dhimitër Çani (1950); *monumenti "Naim Frashëri"*, në rrugën "28 Nëntori" ndërtuar nga Avni Bilibili më 1956; *monumenti "Partizani"* pranë varrezave të dëshmorëve ndërtuar (1969) nga Avni Bilibili, Piro Dollaku e Ilia Xhano; *monumenti "Mihal Grameno"* (1969) nga Montas Dhrami; *monumenti "Naum Veqilarxhi"* (1974); *Obelisku ABC* në oborrin e muzeut "Mësonjëtorja e Parë Shqipe" ndërtuar nga Naumaq Mara (1987); busti "*Tre kokat*" (Naum Veqilarxhi, Thimi Mitko dhe Asdreni) ndërtuar nga Vladimir Topi, Avni Bilibili dhe Vladimir Kaçaku¹⁷⁷ (2002); *monumenti "Mitrush Kuteli"* dhe "*Lasgush Poradeci*" në qytetin e Pogradecit.

3.5.2 Fotografia

Krahas gjinive të përmendura më sipër, fotografia është një gjini tjetër artistike që përmendet në trevën e Korçës, në gjysmën e dytë të shekullit të XIX¹⁷⁸. Në fillim të shekullit të XX (1923) në Korçë u çel studioja e fotografit Kristaq Sotiri, ndërkohë që në qytet kishte edhe studio të tjera fotografësh të njohur. Tradita e fotografisë dëshmohet në organizimin e herëpashershëm të ekspozitave të fotografive dhe ekzistencën e disa studiove fotografike në qytetin e Korçës dhe të Pogradecit.

3.6 Trashëgimia etnografike

Me veshjet popullore, prodhimet e artizanatit në dru, gur, tekstile, qëndisje dhe thurje si dhe punimet prej metali, trashëgimia etnografike përbën një pjesë të trashëgimisë kulturore shqiptare, me vlera të pazëvendësueshme. Është për t'u vlerësuar ekzistenca e disa krahinave me etnografi të pasur si: Korça, Opari, Prespa, Devolli, Kolonja, brenda hapësirës sonë të studimit, çka e bëjnë të larmishme jo vetëm në aspektin studimor por edhe turistik.

¹⁷⁷ Bashkia Korçë, Guida e Korçës, 2011

¹⁷⁸ Ziko. V., 2012, Korça, qyteti dhe kujtime, Kotti, Korçë, f.179

3.6.1 Veshjet popullore

Veshjet popullore në përgjithësi dhe kostumet popullore në veçanti, vlerësohen të jenë një thesar i traditave të kulturës popullore shqiptare. Uniteti ekonomik dhe shoqëror i një zone, ka sjellë afrime edhe në veshjen e krahinave, që bëjnë pjesë në këtë unitet¹⁷⁹. Ato konsiderohen si objekte etnografike të përdorimit të përditshëm ose në raste festash, të përbëra prej materialeve të tilla si liri, leshi, lëkura, pambuku, mëndafshi, etj. Nëpërmjet studimit të veshjeve popullore shqiptare, ne njihemi jo vetëm me një aspekt shumë të rëndësishëm të mënyrës së jetesës, por edhe me aspekte të tjera si zhvillimi ekonomik, shoqëror, kulturor e artistik i fshatrave e qyteteve në zonat e ndryshme, ku këto veshje janë mbajtur. Trashëgimia dhe ruajtja e kostumeve popullore të zonave të veçanta të trevave të Korçës, fshatit dhe qytetit, është një element mjaft i rëndësishëm për t'u vlerësuar. Referuar morisë së studimeve arkeologjike, historike dhe kulturore studiuesja dhe etnografia Andromaqi Gjergji ka bërë klasifikimin e veshjeve popullore shqiptare të burrave dhe grave, nga ku do të prezantojmë tipet kryesore të tyre në zonën e Korçës.

Veshja e burrave me fustanellë, ku *fustani* është elementi më karakteristik i këtij tipi veshjeje, i përmendur në disa dokumente të shekullit të XIV¹⁸⁰. Fustanella është e bardhë, me material prej pëlhure të pambuktë, që punohej në shtëpi ose ishte e fabrikuar. Shoqërimi me elementë të tjerë si: këmisha, jeleku, brezi, kalcet e shajakut dhe opingat prej lëkure, plotësonin më së miri prezencën e saj në disa zona të qarkut, në veçanti në zonën malore të Korçës (Dardhë), Kolonjës dhe Devollit. Në shkrime të ndryshme dëshmohet të ketë qenë e pranishme deri në vitet 1920, kryesisht në raste festash. Prania e kësaj veshje tipike shqiptare tek grekët apo popuj të tjerë ballkanas, dëshmon për rolin aktivdhënës të kulturës sonë materiale¹⁸¹, në elementin kulturor të veshjes së fqinjëve tanë. *Kostumi me këmishë të gjatë e dollama (cibun)* krahas këmishës së gjatë, që ishte elementi kryesor, cibuni, mëngorja dhe kalcet ishin mjaft të pranishme dhe të përdorshme. Kjo veshje e burrave ishte karakteristike për zonën e Korçës, të Kolonjës dhe fshatrat e Prespës¹⁸² dhe ndryshe nga veshja e përditshme në ditët e festave karakterizohej nga prania e qëndismave dhe stolive. *Veshja me poture* ndonëse në përhapje të

¹⁷⁹Gjergji, A., 1978, Klasifikimi i veshjeve popullore shqiptare, Etnografia IX, Tiranë, f.6

¹⁸⁰Gjergji, A., 2001, "Ligjerata për etnologjinë shqiptare", Tiranë, Extra f.118. Në një dokument të vitit 1335 fjala "fustan" është përdorur pikërisht për kuptimin e këtij fundi. (po aty, f.135)

¹⁸¹Gjergji, A., 1978, "Klasifikimi i veshjeve popullore shqiptare", Etnografia Shqiptare IX, Mihal Duri, Tiranë, f.10

¹⁸²Po aty, f. 13

kufizuar, u përdor pas veshjes me fustanellë¹⁸³ në malësitë e Korçës dhe Kolonjës. Festja e bardhë, e zezë ose e kuqe ishte një element i rëndësishëm që shoqëronte veshjen e burrave të fshatit dhe të qytetit.

Veshja e grave me këmishë të gjatë dhe një përparse, është një tip mjaft i përhapur veshjeje në disa zona të qarkut të Korçës, Dardhës, Gorës, Oparit në Korçë dhe Kolonjës. Një vend më vete në këtë tip veshje zë veshja e grave ish ortodokse të Mokrës¹⁸⁴ (Pogradec). E gjendur në disa variante, në pamjen e jashtme këmisha e gjatë shtrëngohej pas belit me një brez të zbukuruar. Përsipër veshja shoqërohej me një lloj dollmaje e zbukuruar në fund me qëndisje. Kjo veshje shfaqet me elemente më të zhvilluar në veshjen e gruas dardhare në rrethin e Korçës¹⁸⁵.

Karakteristikë për trevat e Korçës janë edhe *veshjet e modës qytetare* për burra dhe gra, të pranishme atje ku kushtet e zhvillimit ekonomik ishin pjekur për një asimilim të tillë. Përmendet *veshja me dollma të gjatë e xhybe me gëzof*, që mbanin burrat ortodokse të qytetit të Korçës, të Voskopojës që nga shekulli i XVIII deri në shpalljen e Pavarësisë¹⁸⁶. *Veshja me origjinë qytetare* ishte ajo që mbanin gratë ortodokse të qytetit të Korçës në çerekun e fundit të shek. XIX¹⁸⁷, e përfaqësuar nga fustane të gjera të shoqëruara me një xhybe cohe të zezë, me gëzof te qafa e me shami të zezë në kokë. Veshjet ndryshonin nga fshati në qytet. Burrat e fshatit në zonat malore e plotësonin veshjen e tyre me guna me kapuç kryesisht në stinën e dimrit.

*Veshjet popullore të burrave dhe grave dallohen për kryerjen e funksioneve të ndryshme siç janë*¹⁸⁸: veshjet e përditshme ose për punë, kryesisht praktike dhe të punuara me materiale të lira; veshje sipas moshës, seksit e gjendjes civile; veshje të mira ose për të dalë. Veshjet e grave ishin të zbukuruara me qëndisma dhe stoli metalesh të çmuara dhe shoqëroheshin me byzylykë, breza metalikë, kollanë, unaza etj. kryesisht të përdorshme në raste të veçanta dhe festash. Krahas elementeve të përmendur më sipër, një element po aq i rëndësishëm që shoqërojnë këto veshje janë *opingat e lëkurës me ose pa xhufka*, të cilat paraqiten në variante të ndryshme si tek burrat dhe tek gratë.

¹⁸³ Po aty, f.18

¹⁸⁴ Po aty, f.29

¹⁸⁵ Gjergji, A., 1978, "Klasifikimi i veshjeve popullore shqiptare", f.31

¹⁸⁶ Po aty, f. 39

¹⁸⁷ Po aty, f.41

¹⁸⁸ Gjergji, A., 2001, "Ligjërata për etnologjinë shqiptare", f.126-128

Të gjithë elementët e përmendur më sipër ruhen në mënyrë individuale në shtëpi apo janë pjesë dekorative e restoranteve apo bareve kryesisht të fshatit por edhe qytetit.

Është për t'u evidentuar mungesa e muzeve etnografik në zonat përkatëse, që dikur kanë ekzistuar. *Nisur nga vlerat e rëndësishme që mbart kjo pjesë e trashëgimisë, mendojmë se ngritja e një muzeu etnografik rajonal me veshjet popullore dhe objekte të mbledhura nga të gjitha krahinat e Korçës, do të zgjeronte ofertën turistike të trashëgimisë kulturore dhe njëkohësisht do ta ruante këtë nga dëmtimet e kohës.*

3.6.2 Artizanati dhe punimet tekstile

Populli shqiptar krahas veshjeve popullore ka trashëguar edhe një art popullor të zhvilluar dhe të larmishëm me elementë të arrirë në disa fusha si, qeramika, punimi i gurit dhe drurit, tekstilet dhe qëndisjet popullore, si dhe punimin e metalit dhe të argjendit¹⁸⁹. Në zonat e Korçës, kjo krijimtari është transmetuar brez pas brezi dhe ruhet ende në ditët tona, si pjesë e pandarë e gjithë trashëgimisë kulturore materiale.

Artizanati në këtë zonë ka origjinë të hershme, që me prodhimin e sendeve të domosdoshme për jetesë, gjë të cilën e njohim nëpërmjet gjetjeve të shumta të objekteve arkeologjike (vegla pune, enë prej balte, stoli dhe byzylykë). Këto spikatin për shumëllojshmëri elementesh, forma dhe paraqitje estetike, që gjenden të ekspozuara në muzeun Arkeologjik dhe muzeun e rrethit të Kolonjës. Duke vazhduar në mënyrë të pandërprerë gjatë gjithë kohërave, artizanati përbën një nga pikat e forta të ruajtjes së identitetit dhe mundësi reale të integritetit të kësaj tradite në zhvillimin e turizmit. *Qeramika dhe punimet e baltës* kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mënyrën e jetës së banorëve të lashtë. Përveç funksionit dhe teknikës së tyre të prodhimit, ato mbartin edhe elemente artistikë zbukurues, si shprehje të nivelit kulturor. Enët e ujit, bardhakët, shtamat me forma të larmishme dhe me ndonjë zbukurim, që prodhoheshin në Bradvicë të Korçës, furnizonin pellgun e Devollit, fshatra të ish Rep. Maqedonisë dhe Greqisë Veriore¹⁹⁰. Tradita vazhdon nëpërmjet ekzistencës së punishteve të qeramikës në qytetin e Korçës dhe në zona të tjera të qarkut.

¹⁸⁹ Po aty, Arti i zbatuar popullor, f.144

¹⁹⁰ Onuzi, A., 1978, Disa të dhëna mbi punimin e baltës në fshatin Bradvicë (Korçë) dhe në qytetin e Kavajës, Etnografia shqiptare IX, Mihal Duri, Tiranë, f.313

Punimet e drurit kanë zënë një vend të rëndësishëm në shek. XVIII-XIX, ku u përdorën gjerësisht në ndërtimet e jashtme dhe të brendshme të banesave qytetare dhe fshatare¹⁹¹. Motivet e përdorura në gjininë e artit të thandrimin në dru dhe ekzekutimi i tyre, për dekorime të ndryshme të brendshme në objektet e kultit dhe banesat dëshmojnë qartë, për nivelin artistik të këtyre punimeve të artit popullor. Dritaret, kanapet, dollapët në mur, shkallët e brendshme, tavane të skalitur me shije dhe orendi të tjera prej druri janë ende dëshmi e tipit të banesës së vjetër. Perfeksionimi i punimeve të drurit e gjen shprehjen e tij në objektet dhe punimet e brendshme të kishave ortodokse si ikonostaset dhe ikonat. Krahës atyre që gjenden në Muzeun e Artit Mesjetar, kishat e Voskopojës, por edhe kishat e tjera janë të pasura me këto objekte me vlera artistike.

Gdhendja dhe *punimi i gurit* është një traditë e hershme shekullore. Qyteti i Korçës dhe shumë fshatra kanë trashëguar rrugicat e shtruara me kalldrëm dhe shtëpitë e ndërtuara me gur. Mund të përmendim gjithashtu gdhendjen e kolonave në banesat e qytetit, sofateve e çezmave nga mjeshtrit polenakë në fshatin Polenë, Progër të rrethit të Devollit, mjeshtër të kolonjarë të përpunimit të gurit të njohur edhe jashtë vendit etj. Po kështu vazhdon tradita e ndërtimit të oxhakëve, në pjesën më të madhe për përdorim funksional por edhe për dekorim të ambienteve të brendshme.

Punimi i metalit të hekurit është gjithashtu një traditë shekullore. Rrethimi i banesave me kangjella prej metali të zbukuruara me elemente, është element i rëndësishëm tradicional dhe qytetarie. Mjeshtër të punimit të hekurit realizojnë punime të atij niveli që po gjejnë përdorim jo vetëm në mjediset rrethuese por edhe brenda ambienteve të banesave apo lokaleve. Në përpunimin e metalit një vend të rëndësishëm ka zënë edhe *punimi i argjendit*. Argjendarët e Voskopojës dalloheshin për punimet cilësore. Po kështu zbukurimet e argjendit si pafta, breza, gjerdanë dhe stoli të tjera zbukuronin veshjen e gruas në krahina të ndryshme të qarkut të Korçës. Fondi i artit tonë mesjetar tërheq vëmendjen edhe për punimin e kapakëve që shërbenin për mbështjelljen e librave, disa të tillë i disponon muzeu i Artit Mesjetar¹⁹². Karakteristikë për trevën e Korçës është dhe *punimi i mermerit*, me të cilin zbukurohen fasadat e ndërtimeve të veçanta me elemente të arkitekturës moderne.

¹⁹¹Gjergji, A., 2001, "Ligjërata për etnologjinë shqiptare", f.152

¹⁹²Bilbili, A., 1983, Kapakë ungjilli nga Voskopoja dhe vlerat e tyre artistike; Monumentet 1; "Mihal Duri", Tiranë, f.105

Punimi i lëkurës ka qenë dhe është traditë për qytetin e Korçës dhe rrethinat. Ka një fabrikë të prodhimit të këpucëve që punon për tregun vendas. Ekzistojnë edhe një sërë *punimesh tekstile* artizanate dhe specialitetesh lokale karakteristike, si për shembull qilimat e punuara me dorë, batanijet karakteristike, punimet me thurje (punimet me shtiza), qëndistaria në zonat e Pogradecit, Kolonjës etj. Niveli artistik i qilimave të punuara në qarkun e Korçës (sidomos i qytetit të Korçës) është nga më të arrirët¹⁹³. Skemat e përdorura në tekstilet e kësaj zone kanë një kulturë e sens artistik më të zhvilluar për sa i përket kompozimit të ngjyrave, gjë që i dallon menjëherë tekstilet e Korçës nga ato të zonave të tjera. Dallohen sidomos qilimat dhe velenxat, me motive dhe ngjyra të larmishme. Përdorimi i ngjyrave veç funksionit estetik, shprehte edhe momentet e jetës, gëzimet dhe hidhërimet, gjendjen shoqërore etj. Kjo gjë duket qartë edhe në veshjet, sidomos ato të grave dhe vajzave. Pothuajse në çdo shtëpi të qytetit të Korçës, Ersekës, Devollit, Pogradecit, por edhe fshatrat hasen “qilimat me rrotë”, “me xhami”, “me dhisk me trëndafila”, “me simite” si dhe shkorsat, udhkat si dhe kuvertat me thekë. Velenxat dallohen për ngjyrat e ndezura, në veçanti përdorimi i të kuqes. Këto shtrihen në raste festash, gëzimesh dhe hidhërimesh.

Qëndisjet, tantellat, copat e thurura, mbulesat e krevatëve dhe qëndisje të tjera dekorative të bardha apo me ngjyra, të punuara me mjeshtëri artistike janë pjesë e çmuar e trashëgimisë së komunitetit të zonës. Qëndistaret zbukuronin krahas të tjerave edhe veshjet e burrave dhe të grave si këmisha, jelekë, përparje etj. Veglat e prodhimit artizanal si furka, druga, motovila, qerthulli, shtijat, tezgjahu ishin baza e artizanatit familjar. Ato ruhen ende kryesisht në fshatrat kulturore. *Megjithatë, sektori i artizanatit në tërësi dhe i punimeve tekstile në veçanti nuk është edhe aq i mirëorganizuar dhe nuk ekzistojnë shumë mundësi për turistët, për të blerë punimet e dorës karakteristike dhe tradicionale të zonës.*

3.6.3 Zejtari të e ndryshme tradicionale

Artizanati dhe zejet tradicionale janë gjithashtu pjesë e trashëgimisë shpirtërore kombëtare shqiptare. Ato dëshmojnë për botën dhe krijimtarinë e pasur shpirtërore të komunitetit i cili i ka krijuar, i ka ruajtur me dashuri dhe krenari dhe përpiqet t'i transmetojë ato në brezat e

¹⁹³ Onuzi, A., 1989, Përdorimi i ngjyrosësve natyrorë dhe kimike në tekstilet tona popullore, Etnografia 16, Akademia e Shkencave, Tiranë, f.189

ardhshëm. Voskopoja dallohej për prodhimin e shajakut për eksport, Dardha për punimin e drurit, Bradvica për punimin e enëve prej balte, Progri për ndërtimin e banesave dhe Opari për punimin e gurit e për shtrimin me kalldrëm etj. *Veglat e punës* kanë qenë të shumëllojshme në varësi të natyrës së punës. Pothuajse në të gjithë zonën rurale përdoreshin të njëjtat vegla të ndërtuara kryesisht prej druri dhe metali. *Parmenda* ishte mjete kryesor që lëronte tokën, ndërkohë që përdoreshin edhe mjete të tjera si shati, kazma, lopata, qylyku, piroi, kosa etj. Tashmë ato ruhen si sende relike në banesat rurale.

Veglat muzikore përbëjnë një zeje të veçantë në pamjen e përgjithshme të zejtarisë shqiptare. Në rrugë artizanale kanë qenë prodhuar dhe ende prodhohen vegla si gajde, fyelli, dajre, lauri, buzuk, mandolinë, etj. *Fyelli* është vegël e përdorur nga barinjtë në të gjithë Shqipërinë. Ka gjetur përdorim të gjerë në të gjithë zonën malore të Korçës. Ai është i ndërtuar nga një gyp druri apo dhe metali me vrima për të krijuar melodinë. *Klarineta* përdoret në ditët e sotme dhe është një nga instrumentet më të rëndësishme të muzikës popullore. *Buzuku* është një lloj mandoline me 6-10 tela të cilës i bihet me pendë¹⁹⁴. Është i përhapur në trevat e zonës së Korçës dhe Leskovikut. *Gajdja* është e ndërtuar me lëkurë keci, qengji etj. që mbushet me ajër. Ka një tytë druri për ta fryrë, një tytë tjetër me vrima që lëvizin gishtat dhe një të tretë pa vrima që shërben për të krijuar ison.¹⁹⁵ Luhet në zonën e Pogradecit, Korçës dhe Kolonjës. *Lahuta* përbëhet prej druri, me bisht të gjatë dhe me tela. Ka qenë mjaft e përhapur në trevën e Korçës dhe vazhdon edhe sot të jetë pjesë e sazeve të muzikës popullore. Po kështu *kitara* është e ndërtuar prej druri dhe është instrument i përhapur në të gjitha zonat e qarkut të Korçës. Ajo përbën simbolin e këngës qytetare korçare dhe është pjesë e trashëgimisë së saj.

3.7 Trashëgimia kulturore shpirtërore

Konventa për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (UNESCO, 2003) e përcakton trashëgiminë kulturore jomateriale (shpirtërore) si: “*Praktikat, përfaqësimet, shprehjet, gjuhën, njohuritë, aftësitë si dhe instrumentet, objektet, artefaktet dhe hapësirat kulturore që lidhen me to, të cilat komunitetet, grupet dhe në disa raste individët i njohin si pjesë të trashëgimisë së tyre kulturore. Kjo trashëgimi shpirtërore e transmetuar brez pas brezi është e rikrijuar në vazhdimësi nga komunitetet dhe grupet, në harmoni me mjediset dhe*

¹⁹⁴Zheji, Gj., 1998, *Folklori shqiptar, Argeta-LMG, Tiranë, f.229*

¹⁹⁵Po aty, f. 230

*historinë e tyre dhe u jep atyre ndjenjën e identitetit dhe vazhdimësisë ashtu sikurse promovon respekt për diversitetin kulturor dhe krijimtarinë njerëzore. Kjo përfshin traditat gojore dhe shprehjet, gjuhën, artet performuese, praktikat sociale, ritualet, ngjarjet festive dhe punimet tradicionale”.*¹⁹⁶

Shqipëria është e përfaqësuar në trashëgiminë kulturore botërore, krahas asaj materiale, edhe me trashëgiminë kulturore shpirtërore. Në vitin 2005 “Iso-polifonia popullore shqiptare shpallet “Kryevepër e Trashëgimisë Gojore të Njerëzimit”, e mbrojtur nga UNESCO. Ndonëse në kulturën shpirtërore të qarkut Korçë, nuk ka elementë të mirëfilltë të trashëgimisë shpirtërore të mbrojtur me statusin e trashëgimisë shpirtërore kombëtare, këtu gjejmë vlera të cilat janë transmetuar brez pas brezi deri në ditët tona dhe kanë nevojë të vlerësohen dhe të mbrohen.

3.7.1 Folklori (këngët dhe vallet)

*“Kultura popullore e një kombi është një element i rëndësishëm, i cili bën të mundur përcaktimin e karakteristikave zakonore, gjuhësore të tij, e mendësisë dhe prirjes për ruajtjen e identitetit si bashkësi e qëndrueshme historike, ekonomike e shoqërore”.*¹⁹⁷

Vendndodhja gjeografike, ekzistenca dhe prania e kulturës së hershme materiale, (veçanërisht etnografia e pasur), zhvillimi social ekonomik, shkëmbimet kulturore me zonat përreth, mund të cilësohen si faktorë që kanë ndikuar në formësimin e një identiteti dhe kulture shpirtërore të përbashkët. Nga ky këndvështrim trevat e qarkut të Korçës, së bashku me trevat e tjera në jug të Shkumbinit janë pjesë përbërëse e krahinës së toskërisë¹⁹⁸ dhe e *folmja e Korçës* dhe krahinave të saj i përket nëndialektit të toskërishtes veriore të dialektit toskë. *Gjuha e folklorit* si themel i trashëgimisë shpirtërore të kombit tonë, në këtë hapësirë i ka qëndruar besnike gjuhës së folur popullore, duke ruajtur veçoritë e veta në kuadër të gjuhës letrare shqipe. Në qoftë se do të bënim një përqasje të shtrirjes së *izoergeve (të dhënave etnografike)* dhe *izoglosave*¹⁹⁹, në ekuivalentimit e këtyre arealeve, evidentohen areale të vogla që krahas

¹⁹⁶ International Journal of Heritage Studies, f. 299

¹⁹⁷ Maxhe, A., 2010, E folmja e Devollit, Desertacion, f.154

¹⁹⁸ Gjinari, J., Shkurtaj, Gj., 2009, Dialektologji, Libri Universitar, Tiranë, f.158

¹⁹⁹ Po aty, f. 61-62 Izoerget janë vijat që tregojnë shtrirjen në hartë të dukurive në lidhje me kulturën materiale apopunëve tradicionale, kurse izoglosët tregojnë shtrirjen e dukurive gjuhësore.

ngjashmërive, kanë tipare të veçanta në të folmen e tyre si Strelca²⁰⁰ brenda krahinës së Gorës, fshatra në krahinën e Devollit, etj

Në të folmen e Korçës, Kolonjës dhe Pogradecit, për të gjitha kategoritë e foljeve më të përhapura janë format “-nja”, “-nje”, “-te” për vetat e njëjësit: *qepnja, qepnje, qepte*²⁰¹. Ndërkohë që në të folmen e Devollit folja e zgjedhimit të tretë shoqërohet me bashtingëlloren “nj” si mbaresë: *lironj, dëgjonj, kallëzonj, gdhinj, thyenj*, etj²⁰². Po kështu karakteristikë është edhe përdorimi i ndajfoljeve dhe parafjalëve: *këtuckë (këtu), njëdizaj (një ditë), javash (avash), tashti, prëmë, ndënë, gjende (përsëri)* etj. Ndërkohë që përdoren shprehjet: *ardhmë de Korçë (në), dë mëngjes (në), pe asaj që thua ti (prej), de vinj (po vij)*, etj²⁰³.

Afërsia kufitare me fqinjët grekë dhe sllavë dhe marrëdhëniet ekonomike, sociale dhe kulturore me ta, kanë patur ndikimin e tyre edhe në të folmen e këtyre zonave çka dëshmohet nga përdorimi i prapashtesave me origjinë sllave (*djalkë, dyshkë, kulaçka, petka, shamiçkë, rosnicka, doçka*, etj). Në të folmen e Kolonjës dhe Leskovikut foljet ndihmëse *kam* dhe *jam* në vetën e tretë njëjës bëjnë *keshe, jeshe*²⁰⁴, por mungojnë prapashtesat sllave. Gjuha e folur e krahinave të Korçës, Devollit, Kolonjës është shumë e pasur me frazeologji dhe shprehje të tjera gjuhësore.

Omonimia e Korçës si hapësirë studimi është e lidhur ngushtë krahas të tjerave edhe me përkatësinë fetare të banorëve të saj. Emrat e besimtarëve ortodoksë të fshatit dhe qytetit janë ndikuar edhe nga emrat ortodoksë grekë: Jorgo, Jorgji, Dhimitër, Vasillaq, Stavri, Soriraq, Panajot, Kostaq, Anesti, Sofia, Maria, Limjadhë, Eleni etj. Emrat myslimanë kanë patur ndikim nga emrat me prejardhje myslimane si: Bujar, Pëllumb, Bashkim, Fatmir, Arben, Esmë, Hatixhe, etj.

Për sa i përket termit “*folklor*” është një term që sot përdoret në të gjithë botën për të treguar thesarin e traditave të një populli²⁰⁵. Si shprehje e ndjenjave, mendimeve, folklori

²⁰⁰ Dialektologjia Shqiptare V, Akademia e Shkencave, Tiranë, f.272-273, “Strelca është fshat i krahinës së Gorës, ku takohen tre krahina Opari, Gora dhe Vërça. Krahas ngjashmërive me të folmet lindore të toskërishtes veriore (fushë Korçë, qyteti i Korçës, Devoll) ka dhe ndikime të toskërishtes së brendshme (Opar, Skrapar, Berat) dhe ndikimeve të folmeve kalimtare”.

²⁰¹ Dialektologjia Shqiptare V, Akademia e Shkencave, Tiranë, f.226

²⁰² Gjinari, J., 1960, Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria e Shkencave Shoqërore, Nr.4, Tiranë, f.116

²⁰³ Po aty, f.119

²⁰⁴ Prifti, B., 2010, Toskëria, Kolonja dhe Leskoviku, Vllamas, Tiranë, f.19

²⁰⁵ Zheji, Gj. 1998, Folklori shqiptar, Argeta-LMG, Tiranë, f. 5

nëpërmjet gjuhës së goditur të krijimtarisë popullore, kërkon të transmetojë mbresa dhe emocione tek dëgjuesit²⁰⁶. Në trashëgiminë shpirtërore përfshihen këto tipologji të folklorit²⁰⁷: *folklori gojor* (tekst i krijimit popullor, i pashoqëruar me muzikë që lexohet ose tregohet); *folklori instrumental* (krijim muzikor popullor i luajtur me vegla muzikore popullore); *folklori vokal* (krijime popullore të kënduara ose të interpretuara me tekst dhe muzikë); *folklori koreografik* (valle apo krijime që kërcëhen me ose pa muzikë)

Ruajtja e tipareve autentike të gjuhës së folklorit, në zonat e qarkut të Korçës ka gjetur format e shprehjes së vet artistike, në elementet e pasur të folklorit popullor. Gojëdhënat, përrallat, lodrat e këngët e fëmijëve, gjëgjëzat, anekdotat, këngët e dashurisë (serenadat), këngët lirike, ritet e lindjeve, dasmave, vdekjeve, nofkat apo llagapet, fjalët fluturake, festat pagane, festat fetare, vallet, instrumentet popullore, janë thesare të ruajtura dhe transmetuara me fanatizëm deri na ditët e sotme. *Anekdotat* (barxeleta) janë pjesë e krijimtarisë popullore të zonës²⁰⁸, ku spikatin humori dhe satira e hollë. Të mbushura me karaktere dhe personazhe të shumëllojshëm ato mbahen mend gjatë dhe vazhdojnë të tregohen edhe sot e kësaj dite. Një element i folklorit janë nofkat ose “*llagapet*”²⁰⁹, të njohura ndryshe edhe si emri i dytë. Ajo vendoset në formën e shakasë, për ndonjë mangësi apo tipareve të veçanta fizike, sjelljes, mënyrës së të folurit, të të ecurit, të të veshurit, profesionit, pozicionit shoqëror të personit të cilit i përket nofka. Emri i personit shoqërohet me një nofkë si: këpucari, mullixhiu (mbi punën që bënte), qorri (kur nuk shikonte mirë nga sytë), buti (kur ishte i shëndoshë), topalli (kur çalonte), por edhe epitete kafshësh si: pula (karakter i butë), ujku (karakter i fortë), gallofi (për nga tiparet) etj. Fjalët e urta popullore apo *fjalët fluturake*²¹⁰, janë të përhapura dhe të përdorshme në të gjithë zonën në trajtë proverbash, idiomash dhe aforizmash. Disa prej tyre janë: “*Bjeri derës që të dëgjojë deriçka*”; “*e ka ujin në misër, e ka kripën e thatë (e ka vënë në terezi)*”; “*si fle karari*”, “*sikur ka gëlltitur okllainë*”, “*erdhi duarthatë*” etj.

3.7.2 Këngët folkloristike

²⁰⁶Gjinari, J., Shkurtaç, Gj., 2009, Dialektologjia, Libri Universitar, Tiranë, f.71

²⁰⁷Tole, V., Enciklopedia e Iso-Polifonisë Popullore Shqiptare, UEGEN, Tiranë, f. 95

²⁰⁸Ziko, V., 2012, Korça-Qyteti dhe kujtime; Kotti, Korçë, f. 284

²⁰⁹Po aty, f. 344

²¹⁰Po aty, f.350

Këngët folkloristike lindin njëherësh si tekst dhe si melodi duke përbërë një unitet, të cilat kur ekzekutohen bashkarisht transmetojnë një forcë estetike dhe emocionale të këngës²¹¹. *Muzika popullore* qytetare korçare dhe e rrethinave bën pjesë në *iso-polifoninë* toske dhe është pjesë e *iso-polifonisë shqiptare*. Kjo muzikë arriti kulmin e saj në gjysmën e dytë të shekullit të XX, ku spikatën folklori vokal, instrumental dhe koreografik. *Veglat muzikore* shoqëruese të muzikës popullore janë sazeja, klarineta, firzamonika, lahuta, violina dhe dajreja. Këngët i këndohen kryesisht punës dhe dashurisë. Ato përfshijnë këngët e dasmave, këngë të burrave, këngë të grave, këngë të fshati dhe të qytetit. Shumica e këngëve popullore janë polifonike për nga natyra dhe karakterizohen nga i kënduari me zë melodios dhe shprehës. Përveç, Korçës dhe Devollit, Leskoviku ka qenë qendra kryesore e zhvillimit të sazeve dhe muzikës me saze në gjithë Shqipërinë e Jugut²¹².

Serenata korçare me kitarën dhe mandolinën, i ka fillimet e saj në gjysmën e dytë të shek.XIX dhe përbën një pasuri me vlera për gjithë muzikën qytetare. Ajo ka kultivuar një kulturë të re, një moral të ri qytetar, një etikë të re të ndjenjave intime; ajo hapi dyert e emancipimit shoqëror e afrimit me botën e qytetëruar Evropiane²¹³. Ky simbol kulturor shpirtëror këndohet sot jo vetëm në Korçë por në gjithë Shqipërinë.

Në qershor të vitit 1928 u formua shoqëria “Lyra”, e cila në bazë të saj kishte dy formacione muzikore: korin dhe orkestrën²¹⁴. Në qoftë se do ta quanim trashëgimi shpirtërore, korin Lira, do të thoshim trashëgimi shpirtërore me këngëtarë që këndojnë prej katër brezash²¹⁵. “Kori Lira”, numëron në gjithë repertorin e tij mbi 200 këngë patriotike, lirike e satirike, të cilat interpretohen brenda dhe jashtë vendit. Disa nga këngët e njohura si: “*Këto shkronja janë të arta ne i duamë*”, “*Sot lipset me flamurë malit të dalimë*”, “*o Trima luftëtarë, ju bijtë e Skënderbeut, kërkoni, ju shqiptarë lirinë e mëmëdheut*”, “*Duam më shumë Shqipërinë, që t’i vejë puna mbarë e përjetë ta ketë lirinë*”, janë krenaria dhe pasuria jo vetëm e një treve apo komuniteti, por e gjithë vendit dhe kombit.

Serenata Korçare dhe Kori Lira janë pjesë e trashëgimisë kulturore shpirtërore me vlera lokale, rajonale dhe kombëtare, prandaj meritojnë të vlerësohen dhe mbrohen me statusin

²¹¹Zheji, G., 1998, Folklori Shqiptar, Argeta-LMG, Tiranë, f.29

²¹²Tole, V., 2007, Enciklopedia e Iso-Polifonisë Popullore Shqiptare, UEGEN, Tiranë, f. 179

²¹³Ziko, V., 2012, Korça-Qyteti dhe kujtime; Kotti, Korçë, f. 82

²¹⁴Tole V., 2007, Enciklopedia e Iso-polifonisë popullore shqiptare, UEGEN, Tiranë, f.240

²¹⁵Ziko, V., 2012, Korça-Qyteti dhe kujtime; Kotti, Korçë f. 215-216

“Kryevepër e Trashëgimisë Shpirtërore Kombëtare”, krahas Eposit të Kreshnikëve, Ahengut Shkodran etj.

3.7.3 Vallet

Vallet janë fusha e ndërthurja së muzikës me koreografinë popullore. Secila nga krahinat e hapësirës së studimit, përfaqësohet me muzikën dhe vallen e vet që e karakterizon. Vallet luhen me trup, me këmbë, duar dhe me shprehjen e fytyrës sipas karakterit të saj. Vallet luhen nga gratë dhe nga burrat, por ato mund luhen edhe vetëm nga gratë ose vetëm nga burrat sipas llojit të tyre. Në trevat e Korçës gjejmë të mishëruara vallet lirike të dashurisë, dasmave dhe vallet epike të burrave. Përmenden vallja leskoviçare, vallja devolliçe e burrave, vallja kolonjare e grave, vallja dardhare e vajzave etj. Interpretimi i tyre në rastet e festave dhe eventeve, me kostumet popullore të trevave përkatëse, nxjerr më së miri në pah vlerat e tyre artistike dhe plotëson tërësisht ofertën turistike kulturore.

3.8 Festat dhe frekuentimi turistik

*Festat janë elementi më popullor i atraksioneve shpirtërore dhe zakonisht janë në formën e festimeve apo të ngjarjeve historike, që banorët lokalë dëshirojnë t'i ndajnë me komunitetit e zonës në tërësi dhe me vizitorët, qofshin vendas apo të huaj*²¹⁶. Nisur edhe nga traditat në këtë gjini të trashëgimisë, qarku i Korçës po gëzon një reputacion si rajoni i festivaleve dhe i ngjarjeve – veçanërisht qyteti i Korçës i njohur ndryshe edhe si <<**Qyteti i Festave**>>.²¹⁷

Disa nga festimet e trashëguara, përfaqësojnë traditat e hershme në kulturën e zonës, të cilat e identifikojnë dhe dallojnë nga zonat e tjera të Shqipërisë, por edhe të rajonit. Nëpërmjet tyre komuniteti promovon vlerat e trashëguara shpirtërore dhe njëkohësisht siguron vazhdimësinë e transmetimit të tyre për brezat e ardhshëm. E veçanta e gjithë qarkut qëndron në praninë e festimeve të shumta fetare (religjoze), çka mund të shërbejë si një mundësi e mirë për zhvillimin e turizmit religjuz. Pjesëmarrja në ditët e organizimit të festave është e larmishme, ku krahas banorëve vendas edhe vizitorëve nga vende të tjera të Shqipërisë, është

²¹⁶ Van Zyl, C.J., 2005, The role of tourism in the conservation of cultural heritage with particular relevance for south Africa, phd, dissertation, pdf, f.187

²¹⁷ Promovim i Bashkisë Korçë

ngjallur interesi i vizitorëve të huaj që vizitojnë Shqipërinë në këtë periudhë. Pavarësisht përmasave të këtyre eventeve dhe festimeve, ndër më të rëndësishmet për nga impakti social-ekonomik që ato kanë, do të përmendim:

Festa e Karnavaleve (28-29 Maj), me paraqitje teatrale dhe muzikore, e zhvilluar që para viteve '40, është kthyer tashmë në një traditë të përvitshme festimi në qytetin e Korçës. Përfshirja në të e grupeve nga Shqipëria, Maqedonia, Italia, Mali i Zi dhe Greqia, me trupat e tyre të zbukuruara me ngjyra të larmishme, maska dhe kapele, e bëjnë të larmishme performancën, në rrugët e qytetit në prani të mijëra banorëve dhe vizitorëve të ardhur për këtë event. Rreth 20.000 vizitorë (e përlogaritur nga bashkia) ishte numri i pjesëmarrësve në këtë festë në vitin 2012. Në vazhdimësi të traditës së tyre, karnavalet festohen me origjinalitetin e tyre, njëkohësisht edhe në fshatin Polenë në prani të qindra vizitorëve.

Festa e Birrës, (14-18 Gusht) që prej vitit 2007 është kthyer në një traditë të përvitshme në sezonin turistik të verës. Festa përbën eventin me impaktin më të madh social, ekonomik dhe kulturor në qarkun e Korçës. Gjatë ditëve festive sipas të dhënave të Bashkisë, qyteti vizitohet nga dhjetëra mijëra (60-80 000) vizitorë, jo vetëm nga Shqipëria, por edhe vizitorë të huaj nga rajoni dhe bota. Në vlerësim të promovimit të vlerave kulturore, në vitin 2010 Festa e birrës u nderua me çmimin e “Turizmit Shqiptar 2010”, akorduar nga Ministria e Turizmit, Rinisë dhe Sporteve. Në këtë event së bashku me “Birra Korça” dhe firmat e tjera të produkteve të zonës marrin pjesë edhe marka të tjera produktesh, të cilat përveç shitjeve promovojnë edhe produktet e tyre. Në vitin 2013, festa u organizua për pesë ditë me radhë dhe e drejta e promovimit ju dha gjithashtu, një firme nga Serbia²¹⁸. Ndërsa në vitin 2015 sipas të dhënave të Bashkisë Korçë numri i vizitorë arriti në 85 mijë.

Festa e lakrorit, (7 shtator) mbështetur në traditën e një prej produkteve të gatimit tradicional të zonës, është kthyer në një organizim të përvitshëm të tërheqjes së vizitorëve në qytetin e Korçës. Duke respektuar gjithashtu traditën e “amvisave”, një grup grash korçare në mënyrë të organizuar përgatisin në natyrë lakrorë (piqen në saç) me gjellë të ndryshme, të cilët porositen dhe u serviren vizitorëve kundrejt pagesës.

Panairi i poçerisë organizohet në qendër të qytetit të Korçës, gjatë gjithë javës së Pashkës Ortodokse. Panairi lidhet me traditën e vjetër të punimit të baltës si edhe traditën e hershme të

²¹⁸Sipas kontaktimeve të bëra, këmacet, kollofacet apo produkte të tjera, që janë identifikuese dhe tradicionale vetëm në zonën e Korçës, u përgatitën dhe u tregtuan nga kjo firmë, ndonëse lënda e parë u mor nga firmat sallameri të qytetit të Korçës.

besimtarëve ortodoksë për “blerjen e baltës” gjatë javës së pashkës, veçanërisht ditën e premtë të ashtuquajtur “e premtja e zezë”. Artizanë dhe tregtarë të ndryshëm jo vetëm të zonës, ekspozojnë dhe tregtojnë produktet e tyre, që blihen jo vetëm nga besimtarët por edhe vizitorët e tjerë.

Festa e liqenit, dhe festa e verës (dhjetor) në qytetin e Pogradecit janë shndërruar në tradita të festimeve që shoqërohen me pjesëmarrjen e një numri të madh vizitorësh nga Shqipëria dhe rajoni. Festa shoqërohet me panaire të produkteve tradicionale të gjithë zonës së Pogradecit.

Festivali Folklorik i Prespës (11 Tetori) dhe Java verore kulturore e Prespës (02-10 Gusht), Dita e Verës në Prespë (Dhjetor), janë festa të organizuara nga minoriteti maqedonas në komunën e Liqenasit që mbledhin në këto ditë mijëra vizitorë. Atmosfera festive shoqërohet me shprehjen e traditave, zakoneve dhe promovimin e produkteve origjinale të komunitetit maqedonas.

Krahas festave pagane qarku i Korçës dallohet dhe për numrin e madh të festave fetare, sidomos atyre të krishtera. Disa nga këto festa janë: Festa e Shën Prodhomit më 24 Qershor, në Voskopojë; Festa e Shën Mërisë më 15 Gusht, në Boboshticë dhe në Voskopojë; Festa e Shën Mërisë më 16 Gusht, në fshatin Dardhë; Festa e Satrivaçit më 1 Korrik, në fshatin Hoçisht të rrethit Devoll; Festa e Ristozit dyzetë ditë pas pashkëve, në Mborje të Korçës; Festa e Shën Thanasit më 18 Janar, në qytetin e Korçës; Festa e Shën Gjergjit në Dardhë, pas festimit të pashkës sipas kalendarit ortodoks; Festa e Shën Pjetrit në Vithkuq; Festa e Pashkëve në qytetin e Korçës, sipas kalendarit ortodoks; Festa e Krishtlindjeve më 25 Dhjetor.

Dita e verës festohet në 1 Mars, për besimtarët ortodoksë dhe 14 Mars për besimtarët myslimanë. Ndezja e zjarreve, veroret dyngjyreshe (kuqe dhe të bardhë), përgatitja e kulaçit me sheqer, fiqtë e thatë, vera e kuqe, vezët e kuqe (për besimin mysliman), degët e këputura me sythet e porsaçelura, janë elementë që shoqërojnë këtë festë. *Rosicat* është festë e besimtarëve ortodoksë tradicionale për fshatin Boboshticë. Festohet ditën e tretë pas fluturimit në qiell të Krishtit, “kur Shën Maria thirri shoqet dhe gatuan një drekë për të festuar”. Gratë e fshatit të vjetra dhe të reja, të veshura me kostumet tradicionale të zonës, pasi kanë kryer ritet fetare në kishën e Shën Mërisë, nisen drejt rrugicave të fshatit. Me këngë në gojë dhe me kërcime ato trokasin shtëpi më shtëpi duke uruar shëndet dhe mbarësi si dhe duke mbledhur ushqime (miell, vezë, gjalpë, sheqer), me të cilat përgatisin një drekë të madhe ku do të ftojnë gjithë fshatin dhe

vizitorët. Është festë sa e krishterë aq edhe pagane, sepse lidhet edhe me ardhjen e verës, çeljen e luleve dhe gatuhet vetëm brumë, pasi fshati e ka jetën të lidhur me grurin dhe blegtorinë.

Nisur nga numri i madh i produktit kulturor, në qarkun e Korçës organizohen disa festivale apo konkurse²¹⁹ siç janë: *Festivali i Ushqimit* organizohet gjatë sezonit turistik të verës (Qershor-Shtator). Çdo ditë të mërkurë hahet ushqim tradicional i mirë dhe më çmim të lirë në restorantet dhe tavernat që janë pjesë e këtij eventi; *Konkursi Ndërkombëtar i Fotografisë “Sotir”*, organizohet për nder të fotografit të madh korçar Kristaq Sotir dhe traditës së fotografisë së ndërtuar prej tij. Konkursi mbledh në qytetin e Korçës fotografë nga vende të ndryshme të botës të cilët ekspozojnë dhe konkurojnë me punimet e tyre që ekspozohen në galerinë “Guri Madh”; *Kolonia Ndërkombëtare e Piktorëve “Ditët e Mios”*, zhvillohet çdo vit në qytetin e Korçës nën emrin e piktorit të madh Vangjush Mio. Prania e piktorëve nga Shqipëria dhe vende të tjera jashtë saj vendos jo vetëm lidhje të komunikimit midis artistëve, por njëkohësisht promovon dhe vlerat e qytetit dhe gjithë qarkut të Korçës; *Panairi i fundvitit* përbën një lloj festimi në ditët e fundit të vitit, i shoqëruar me panair të produkteve të zonës. *Simpoziumi Ndërkombëtar “Skulptura e Parkut”* është një event në kuadër të traditës së hershme të punimit të gurit dhe mirëpret çdo vit në qytetin e Korçës, skulptorë nga vende të ndryshme të botës të cilët marrin pjesë me skulpturat e tyre si simbolikë për qytetin.

Nëse do të bënim një analizë të asaj çka evidentuam më sipër, mund të themi se organizimi i eventeve kulturore dhe festave fetare në qarkun e Korçës, pavarësisht përmasave të tyre, kanë një impakt të rëndësishëm në zhvillimin social-ekonomik dhe kulturor të të gjithë zonës

. Krahas promovimit të vlerave kulturore, angazhimi i disa komponentëve të sektorit turistik (njësitë akomoduese, transporti, shërbimet, ushqimi etj.) bën të mundur që e gjithë ekonomia lokale të mund të sigurojë përfitime ekonomike.

Ngaurvejimi që kemi bërë në ditët festive të festës së birrës, dy vitet e fundit kapacitetet akomoduese të qytetit të Korçës dhe rrethinave kanë qenë të rezervuara krejtësisht që më parë, madje në këtë sezon kërkesat kanë qenë mbi këto kapacitete. Konsumi i sasive të birrës dhe produkteve të tjera tradicionale ka sjellë përfitim të konsiderueshëm ekonomik për bizneset që marrin pjesë në këtë event.²²⁰ Të ardhurat financiare të siguruara nga këto, por edhe festime të

²¹⁹Të gjitha këto evente organizohen nga Bashkia e qytetit të Korçës

²²⁰Nga evidencimi në terren në vitin 2013 Birra Korça tregtoi 100 fuçi me birrë (5000 litra) çdo ditë të festës. Në totalë pesta ditët e festës u tregtuan 100 000 gota me birrë, ndërsa çmimi i një gotë birre shkonte 50 lekë. Në një llogaritje të thjeshtë xhiroja financiare arriti shifrën 5 000 000 lekë.

tjera, qarkullojnë në të gjithë hapësirën e qarkut të Korçës dhe më gjerë, duke sjellë kështu përfitime direkte dhe indirekte në komunitetin e zonës.

Në ditët e panaireve (poçerisë, ushqimit, panairit të fundvitit (dhjetor) dhe në ditët e festave fetare, banorët vendas vetëpunësohen duke shitur produkte tradicionale të zonës. Ky është një kontribut, që pak a shumë ndikon në rritjen e të ardhurave dhe mirëqenies së tyre.

Po kështu përfitimet llogariten edhe në aspekte të tjera si ato të promovimit të destinacionit turistik përmirësimin e infrastrukturës, veçanërisht asaj që lidhet me shërbimet turistike. *I rëndësishëm është aspekti i forcimit të identitetit dhe krenarisë lokale të vetë komunitetit, por edhe komunitetit karshi vizitorëve.* Kjo ndjenjë për shkak edhe historisë dhe vlerave që i kemi përmendur, është shumë e kultivuar në qytetin e Korçës.

Aktualisht nuk është bërë ndonjë studim apo kërkim, për të parë realisht efektet social-ekonomike të festave apo eventeve të tjera në këtë destinacion. Kjo kërkon angazhim dhe do të ishte një fushë studimi me mjaft interes për hartuesit e politikave të zhvillimit apo studiuesit që paraqesin interesin e tyre në fushën e trashëgimisë kulturore dhe të turizmit të lidhur me të.

3.8.1 Traditat

Trashëgimia shpirtërore është e pasur edhe me tradita dhe zakone, rite dhe ceremoni që kanë të bëjnë me lindjet, martesat dhe vdekjet. Një aspekt të rëndësishëm kulturor, përbën mënyra e jetesës brenda dhe jashtë ambientit të banimit. Mobilimi i banesës dallohet në fshat dhe në qytet, për orendi të veçanta, sipas funksioneve që kryenin mjediset përkatëse të banimit. “*Oda e miqve*”, dallohet për përdorimin e elementëve tradicionalë të zbukurimit, si sixhadet, velencat që mbulonin minderët, jastëkët, mobiljet e vjetra, në disa raste të sjella nga vendet fqinje, enë metalesh të zbukuruara, porcelane dhe tantella e mbulesa të punuara me dorë. Disa prej këtyre elementeve i gjejmë edhe sot të ruajtura në banesën dhe mënyrën e jetesës së qytetit.

E krahasuar me të njëjtin ambient të banesave të qytetit të Gjirokastrës, Beratit dhe Shkodrës, në këto të fundit elementët dekorues janë më të pasur në orendi dhe në ngjyra. Karakteristike këtu janë gdhendjet dhe daltimet e shumta të drurit në tavane si edhe dekorimi i oxhakëve, madje këta të fundit ndryshojnë edhe nga forma²²¹.

²²¹Ky konstatim bëhet nga vetëautorja pasi ka vizituar banesat dhe ambientet e tyre të brendshme.

Një nga traditat që vlen për t'u përmendur janë *mikpritja dhe qytetaria* korçare. Të vlerësuara pozitivisht në opinionet e turistëve të huaj, mund të themi se janë dy pika të forta të tërheqjes turistike në qarkun e Korçës.

3.8.4 Kulinaria tradicionale

Gastronomia gjithashtu, është pjesë e trashëgimisë kulturore dhe shumë pak njerëz mund ta pranojnë si të tillë²²². Gastronomia franceze, meksikane, mesdhetare janë pranuar tashmë si trashëgimi kulturore botërore. Si pjesë e jetës dhe traditave sociale ajo konsiderohet si resurs dhe element vital i gjithë komponentëve turistikë. Në pothuajse çdo destinacion, sot shërbimi i ushqimit është i rëndësishëm po aq sa akomodimi²²³. Është një pritshmëri e përgjithshme për pjesën më të madhe të turistëve të kenë mundësi të provojnë gatimet tradicionale të kuzhinës lokale²²⁴.

Pa dyshim që trashëgimia kulturore e qarkut të Korçës nuk do të mund të kuptohej pa gastronominë e veçantë dhe të shumëllojshme. Si pjesë e traditës mbarë shqiptare në fushën e trashëgimisë kulturore ajo është e lidhur ngushtë me elementët etnografik, traditat, zakonet dhe mjedisin karakteristik të vetë zonës. Përgatitja e zahireve është traditë e hershme e gjithë trevës së Korçës, fshatit dhe qytetit. Zgjatja e periudhës së dimrit shtron domosdoshmërinë e grumbullimit të ushqimeve dhe përgatitjes së tyre, që në fund të stinës së verës dhe fillimit të vjeshtës. Në këtë periudhë përgatiten petkat, trahani i ëmbël dhe i thartë, oshafkat, reçelrat, turshitë nga më të thjeshtat deri tek të mbushurat. Nga fundi i vjeshtës përgatitet pastërmaja, llukanikët e kollofacet. Nxjerrja e verës dhe rakisë shoqëron përgatitjen e zahireve, të cilat ruhen në ambiente të posaçme (bodrume apo qilarë) të shtëpive private të fshatit por edhe qytetit. Kuzhina tradicionale pëlqehet dhe preferohet në të gjithë vendin për freskinë dhe cilësitë e veta organike. Çdo trevë e qarkut përmendet për specialitetin dhe llojshmërinë e gatimeve.

Qyteti i Pogradecit si edhe fshatrat e pozicionuara përgjatë liqenit të Ohrit si Tushemishti, Pojska, Lini ofrojnë gatimin e peshkut të koranit, troftës, belushkës, ngjalës etj. Në fshatrat e

²²²Fooladi, E., Food accepted as culture heritage-food is surely culture, <http://www.fooducation.org/2011/01/food-accepted-as-cultural-heritage-food.html>

²²³Van Zyl, 2005, The role of tourism in the conservation of cultural heritage with particular relevance for south Africa, phd, dissertation, pdf, f. 186

²²⁴Po aty, f.186

liqenit të *Prespës* gatuhet tava tradicionale e krapit, si dhe lloje të tjerë peshqish si mërena, cironkat të njoma dhe të thata. Këto shoqërohen me turshitë me gjizë dhe llojin e veçantë të byrekut. Prania e varieteteve tradicionale të rrushit (vranec, smederefka) është e lidhur ngushtë me prodhimin e verës, që përbën një produkt origjinal të zonës.

Në *Voskopojë* mjedisi gërshetohet me gatimet tradicionale, si një nga produktet lokale të frekuentuara nga turistët. Ofrohet mishi i qengjit në hell, i veçantë në shijen e tij, lakrorët në saç, turshitë dhe rakia e kumbullës. Fshati i *Dardhës* dallohet për specialitetin e tij, lakrorin me dy petë në saç, i përgatitur me gjellë të ndryshme. Veç kësaj përmenden piperkat me gjizë, gatimi e ligavecëve (kërmijve) dhe rakia e kumbullës së Dardhës. *Boboshtica* është një fshat që dallohet në tërësi për gatime tradicionale të mishit dhe të brumërave. Veçanërisht e spikatur është nxjerrja e rakisë së manit me vlera të shëndetshme, traditë e favorizuar edhe nga prania e drurëve të manit. Treva e *Kolonjës* përmendet për rritjen natyrale të gjedhit dhe të dhenve, produktet e mishit të cilëve janë të pëlqyera dhe të kërkueshme nga konsumatorët. Përmendim gjithashtu verën e Leskovikut e cila nxirret në punishte tradicionale, duke mos i humbur vlerat ushqyese.

Megjithëse këto gatime nuk përgatiten në mënyrë të veçantë për turistët, ato përbëjnë një produkt turistik të kërkuar dhe mjaft të pëlqyer. Frekuentuesit e tyre në pjesën më të madhe janë vizitorët vendas nga zonave të ndryshme të Shqipërisë. Nuk mungon frekuentimin nga turistët e huaj që vijnë në destinacion. Nga anketimi i bërë, në opinionet e tyre rreth ushqimit, vlerësohet shija e veçantë dhe çmimet e mira të produkteve. Nëse nisemi nga frekuentimi gjithëvjeter i restoranteve me gatime tradicionale, në qarkun e Korçës do të përmendnim disa nga më rëndësishmit: taverna “*Voskopoja*”, restorant “*Akademia*”, në fshatin Voskopojë; taverna “*Antoneta*”, taverna “*Vila Melko*”, taverna “*Tomasi*”, në Boboshticë; taverna “*Mihallari*” dhe restorant “*Dardha*”, në Dardhë; taverna “*Ilo*”, taverna “*Aleksandër*”, taverna “*Vangjeli*” në Zaroshkë; restorant “*Milenium*”, restorant “*Kashta*”; Vila “*Art*”; restorant “*Paradise*” në Tushemisht; taverna “*Sidheri*”; taverna “*Vasili*”; taverna “*Antel*” në Korçë; restorant “*Ylli*”; restorant “*Teo*” në Kamenicë etj.

Është për t’u evidentuar fakti, që në përgjithësi restorantet e fshatrave ofrojnë gatime tradicionale, ashtu sikurse mund të evidentojmë në disa raste tendencën e përfshirjes së gatimeve ndërkombëtare, ku në restorantet e qytetit të Korçës, kjo është mëse e pranishme.

Cilësia e shërbimit që ofrohet në ambientet e ngrënies, cilësia e përgatitjes dhe servirja e gatimeve në përgjithësi vlerësohet e kënaqshme.

KAPITULLI IV: TURIZMI KULTUROR DHE MUNDËSITË E TIJ PËR ZHVILLIM SOCIAL – EKONOMIK NË QARKUN E KORÇËS (QASJE EMPIRIKE)

Analiza e pyetësorëve të realizuar në rajonin e Korçës na jep të dhëna se ka potenciale të rëndësishme historike dhe kulturore, që ofrojnë mundësinë e zhvillimit të qëndrueshëm. Ndonëse me traditë të hershme në zhvillimin e turizmit natyror, kohët e fundit po vihet re rritja e interesit të vizitorëve në drejtim të vlerave të trashëgimisë kulturore. Bazuar në këtë tendencë, u pa e nevojshme që në kuadër të këtij studimi, të zhvillohen disa anketime për të parë konkretisht se si vlerësohet kjo, nga tre grupet e interesit të lidhur drejtpërdrejtë me zhvillimin e turizmit kulturor.

4.1 Roli i turizmit në promovimin e destinacionit turistik

Në promovimin dhe tërheqjen kundrejt destinacionit, një rol të rëndësishëm luan edhe imazhi që ai ka ose siguron për vizitorët apo turistët e huaj. Sipas Roger Doswell, *“imazhi i një destinacioni është mënyra se si ai e projekton veten dhe mënyra se si ai shihet nga tregjet e tij”*²²⁵. Përkufizime të tjera e përcaktojnë atë si *përshtypje e përgjithshme me përmbajtje emocionale*²²⁶. Po ashtu dy autorë të tjerë, janë të mendimit se *“imazhi është një shprehje njohurish, përshtypjesh, paragjykimesh, imagjinatash dhe mendimesh emocionale që një person ka rreth një objekti apo vendi të caktuar*²²⁷.

Në kuptimin e thjeshtë, imazhi që një grup vizitorësh apo turistësh krijojnë për një vend, ka të bëjë me mendimet, idetë dhe përshtypjet e tyre rreth këtij vendi. Në këtë këndvështrim ai paraqitet i ndryshëm në njerëz të ndryshëm. Çdo vend ka një imazh, që në fund të fundit mund të jetë produkt i historisë, ndikimeve kulturore, miteve dhe legjendave si edhe i ndikimeve dhe marrëdhënieve ndërkombëtare²²⁸. Prandaj ai është koncepti më i rëndësishëm në zgjedhjet e

²²⁵Doswell, R., 2000, Tourism How effective the management makes the differences, Butterworth-Heinemann, London, England, f.51

²²⁶Dichter, E., 1985, What is an image? Jurnal of consumerresearch, Vol.13, f. 455


²²⁷Lawson, F., & M.Baud-Bovy, 1977, Tourism and recreational development, London Architectural Press, f.37, cit.në Sérgio Dominique Ferreira Lopesi, Destination image: Origins, Developments and Implications, 2011, PASOS, Vol. 9, f. 305-315. www.pasosonline.org

²²⁸ Doswell, R., 2000, Tourism How effective the management makes the differences, Butterworth-Heinemann, London, England, f.51

bëra nga turistët²²⁹, por studiuesit paralajmërojnë se është e vështirë për turistët të krijojnë një imazh të qartë për një destinacion pa e vizituar më parë atë. Në këtë kontekst janë tre faktorë që do të ndikojnë në imazhin e tyre rreth një destinacioni turistik; motivet e turizmit, ndryshimet demografike dhe informacionet rreth destinacionit²³⁰. Lidhur me faktorin e fundit, burimet e informacionit janë revistat, mendimet e opinionistëve të famshëm, televizioni dhe interneti²³¹. Po këtu do të përmendnim edhe guidat dhe materialet e tjera promovuese.

Ky argumentim përbën vetëm njërin aspekt, pasi mendojmë se imazhi i vizitorëve ose turistëve krijohet edhe nga kontakti me destinacionin. Në këtë këndvështrim ai ose e përforcon imazhin fillestar të krijuar ose krijon një imazh të ri krejt të kundërt.

Në qoftë se do të analizojmë zonën tonë të studimit, në raport me zona të tjera të frekuentuara brenda Shqipërisë, do të shpreheshim pozitivisht, për sa i përket tërheqjes që ka destinacioni për vizitorët vendas. Por në rast se këtë do ta shikonim kundrejt tërheqjes së turistëve ndërkombëtare, imazhi i qarkut të Korçës, do të shihej në dy këndvështrime. Nisur nga fakti që këta turistë janë pjesë e turistëve të huaj që vizitojnë Shqipërinë, fillimisht ai është i lidhur me imazhin e përgjithshëm të Shqipërisë kundrejt tyre.



Figurë. Imazhi turistëve për destinacionin e vizituar

Ndërkohë që promovimi i vlerave dhe përfshirja e destinacionit në turet e organizuara brenda Shqipërisë, do të ndikonte në krijimin e imazhit për hapësirën konkrete.

²²⁹(Mayo, 1973; Govers and Go, 2003)cit.në Sérgio Dominique Ferreira Lopesi, Destination image: Origins, Developments and Implications, 2011, Vol. 9, f. 305-315. www.pasosonline.org

²³⁰Beerli and Martin, 2004, cit.në Sérgio Dominique Ferreira Lopesi, Destination image: Origins, Developments and Implications, 2011, PASOS, Vol. 9, f. 305-315. www.pasosonline.org

²³¹ Po aty

Në anketimin e zhvilluar me turistët e huaj, *pritshtëria para vizitës dhe realizimi i kënaqësisë pas saj*, janë dy elementë krahas të tjerëve që na kanë ndihmuar të krijojmë një ide, mbi imazhin real që përcjell destinacioni, lidhur me atraksionet kulturore dhe disa komponentë të tjerë turistike²³². Një gjë e tillë na ndihmon të evidentojmë problemet që kemi në këtë drejtim si edhe të përcaktojmë teknikat dhe instrumentet për të përmirësuar gjendjen e tyre në përputhje me kërkesat e turistëve.

Fatkeqësisht materialet promovuese të zonave kulturore të qarkut si Korça, Voskopoja, Dardha, Vithkuqi etj, përveç informacioneve turistike të pakta që ofrojnë, vuajnë nga pasaktësia dhe përshkrimet superlative. Kjo mund të përcaktohet edhe si një nga arsyet e zhgënjimit të turistëve të huaj, por pse jo edhe vizitorëve vendas në lidhje motivacionet e tyre kulturore të përzgjedhjes së destinacionit. (Evidentimi është real, i vjelë nga mendimet e të ardhurve vendas dhe të huaj në fshatin e Voskopojës. e shtunë 21.08.2013) *Promovimi i produkteve kulturore të ofruara këtu, duhet të bëhet në përputhje me origjinalitetin dhe gjendjen e tyre aktuale, në të kundërt kjo do të ndikojë negativisht dhe do t'i shfaqë këto efekte shumë shpejt.*

Për një turizëm të suksesshëm krahas ofertës primare, është i rëndësishëm zhvillimi i infrastrukturës mbështetëse si: njësi të akomodimit, sektori i ushqimit, infrastruktura rrugore, e transportit dhe shërbime të tjera plotësuese që lidhen indirekt me turizmin.

Zonat kulturore (qyteti i Korçës dhe fshatrat përreth) janë tashmë pjesë e marketingut të produktit kulturor. Ato janë të përfshira në itineraret turistike të vizitorëve vendas dhe turistëve ndërkombëtarë. Si të tilla duhet t'i kushtojnë rëndësi ruajtjes së mjedisit tradicional, origjinalitetit të produkteve që ofrojnë dhe njësisë të akomodimit në përputhje me kërkesat e turistëve.

Nga sa parashtroam më sipër, qarku i Korçës me zonat përbërëse të tij mund të konsiderohen si një destinacion turistik në zhvillim. Në këtë këndvështrim imazhi i destinacionit, si rrjedhojë e promovimit të produkteve turistike, është përgjithësisht pozitiv, por ky imazh nevojitet të forcohet dhe më tej, nëpërmjet ruajtjes së trashëgimisë kulturore, koordinimit të sektorit publik dhe privat dhe promovimit real të produkteve turistike.

²³² Më konkretisht këtë do ta shikojmë në analizën e pyetësorit të turistit. (kap.IV)

Në këtë kapitull, jepet një analizë e hollësishme e anketimeve të realizuara në terren. Në *çështjen e parë* jepen të dhëna të përgjithshme mbi mënyrën e realizimit të anketave apo pyetësorëve, metodat e përdorura dhe zgjedhja e target-grupeve. Në *çështjen e dytë* është bërë analiza e anketimeve me turistët e huaj, ku analizohen të dhënat e përgjithshme, opinionet rreth pushimeve dhe vlerësimi i tyre për trashëgimisë kulturore të zonës. Në *vijim në çështje e tretë* të kapitullit është analizuar anketa e realizuar me komunitetin lokal (banorët e zonës), ku krahas të dhënave të përgjithshme, social-ekonomike të të anketuarve përfshihen njohuritë mbi trashëgiminë kulturore të zonës së tyre si edhe ndikimi i zhvillimit të turizmit në të ardhurat e tyre ekonomike. Ndërsa *çështja e katërt* e kapitullit vijon me target grupin e tretë të të anketuarave, që janë njësitë turistike. Në këtë çështje analizohen të dhëna të përgjithshme të njërive, shërbimet që ato ofrojnë dhe stafi i aktiviteteve turistike. *Çështja e fundit* e kapitullit është ndikimi i zhvillimit të turizmit kulturor në zhvillimin social-ekonomik të zonës. Kapitulli përmbyllet me konkluzionet përkatëse.

Metodologjia e përdorur në trajtimin e këtij kapitulli konsiston në kërkimin në terren, të realizuar nëpërmjet metodave të anketimit dhe intervistave, që kanë siguruar të dhëna sasiore dhe cilësore. Analiza dhe përpunimi i tyre është bërë nëpërmjet Software SPSS.

4.2. Metodologjia e anketimit

Qarku i Korçës është një ndër zonat me frekuentim turistik gjithëvjetor. Kjo është e bazuar në trashëgiminë e pasur kulturore si dhe pasuritë natyrore që ofron zona. Për analizimin e zhvillimit të turizmit kulturor në qarkun e Korçës janë realizuar anketime me turistët që vizitojnë zonën si dhe komunitetin lokal të saj. Në sektorin turistik përdorimi i anketimeve është një metodë efikase për mbledhjen e të dhënave statistikore dhe për të testuar vërtetësinë e çështjeve të ngritura në lidhje me zhvillimin e këtij sektori.

Rezultatet e anketimeve kanë nxjerrë në pah interesin që paraqet hapësira e studimit në aspektin e turizmit kulturor, si motivacioni kryesor i tërheqjes turistike dhe nevojën e përmirësimit të menaxhimit të trashëgimisë kulturore, në funksion të zhvillimit të këtij lloji turizmi. Për të arritur objektivat e kërkimit janë hartuar dhe realizuar 200 pyetësorë nga të cilët 100 përfshinë komunitetin lokal, 80 turistët e huaj dhe 20 pyetësorë për njësitë turistike. Anketimi është realizuar në disa zona pilot të qarkut Korçë (Korçë, Voskopojë, Dardhë,

Vithkuq, Pogradec, etj), të cilat ofrojnë një potencial të lartë të trashëgimisë kulturore dhe janë më të frekuentuarat nga turistët vendas dhe ato të huaj.

Pyetësorët janë realizuar në tre target grupe: komunitetin lokal të zonës, turistët që vizitojnë zonën dhe njësitë turistike të qarkut Korçë. Tipet e pyetjeve të përfshira në pyetësor janë pyetje të mbyllura ose të koduara, pyetjet e hapura dhe kombinim i të dyjave (për më shumë rreth llojeve të pyetjeve i gjeni në aneks). Në rastin e parë pyetjet janë ndërtuar në formë të tillë që i anketuari zgjedh një alternativë nga përgjigjet e listuara si në rastin e pyetjes 5 në pyetësorin e komunitetit “A mendoni se potencialet kulturore ndihmojnë në zhvillimin e turizmit në zonë?”, ku alternativat e përzgjedhjes së përgjigjes janë 1.pak; 2.aspak; 3.mjaftueshëm, 4.shumë. Në të tre anketimet janë përfshirë pyetje të cilat lejojnë më shumë se një zgjedhje.

Pyetjet e hapura janë përgatitur pa përgjigje të përzgjedhur dhe të anketuarit mund të përgjigjen mbi bazën e njohurive individuale si në rastin e pyetjes 8 tek pyetësori i turistit, “Çfarë arsimi është i nevojshëm në fushën e turizmit?”. Përparësitë e pyetjeve të hapura qëndrojnë në faktin se përgjigja nuk është e përgatitur për t’u zgjedhur dhe formulimi i përgjigjes fjalë për fjalë nga anketuesi përbën një burim më të pasur informacioni, se ai që sigurohet në pyetjet e koduara.

Për realizimin e anketimeve është zgjedhur periudha Qershor-Gusht (viti 2014), e cila përkon me kulmin e sezonit turistik, periudhën e pushimeve dhe prurjet e mëdha turistike, veçanërisht të turistëve të huaj, që janë objekt i kërimit. Përzgjedhja e të anketuarve është bërë në mënyrë të rastësishme si në zonat urbane ashtu dhe në ato rurale. Pyetësori i turistit është përkthyer në gjuhën angleze, i njëjtë me versionin origjinal të hartimit të pyetësorit në gjuhën shqipe. Numri i turistëve të anketuar është 80 turistë, mbi moshën 18 vjeç. Përzgjedhja ose kampioni i turistëve është gjetur në mënyrë të rastësishme, pa ndjekur ndonjë rregull të caktuar. Kjo edhe për faktin se, numri i turistëve ndërkombëtarë në destinacion nuk është i madh dhe gjatë gjithë ditëve. Jemi përpjekur që të mos bëhet dallime në përzgjedhjen e kampionit burrë apo grua, të rinj apo të vjetër duke synuar një gjithëpërfshirje të të anketuarve.

Përveç anketimit, një nga metodat e përzgjedhura gjithashtu për vjeljen e informacionit ishin edhe diskutimet jo formale të bëra me banorë, turistë dhe drejtues të njësive të biznesit (hotele). Procesi i kërimit u shoqërua me foto të shumta në hapësirat e përfshira në anketim,


me qëllim demonstrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe aktiviteteve kulturore që lidhen me to.

4.2.1 Analiza e të dhënave nga anketimet e turistëve

Kjo analizë konsiston në paraqiten e të dhënave të profilit dhe qëndrimit të turistëve në drejtim të tërheqjes ndaj trashëgimisë kulturore. Turistët ndërkombëtarë janë një nga grupet e interesit që ndikojnë në përcaktimin dhe perspektivën e tipit të turizmit që zhvillohet. Vlerësimet dhe kënaqësia mbi eksperiencat e tyre janë tregues të rëndësishëm për suksesin e zhvillimit të turizmit në hapësirën tonë të studimit. Nga 80 pyetësorë të realizuar, 79 janë konsideruar të vlefshëm. Pyetësori është strukturuar në tre grup-pyetjesh²³³: të dhëna të përgjithshme (sociale dhe ekonomike), opinionin rreth pushimeve dhe vlerësimi i trashëgimisë kulturore të qarkut.

Analiza e pyetësorit fillon me kombësinë dhe vendin e prejardhjes së turistëve. Sipas treguesve të të anketuarve, grupi i turistëve të huaj që vizitojnë destinacionin paraqitet i larmishëm, ku përqindjen më të madhe e zënë turistët me kombësi italiane (16%), të ndjekur nga ata me kombësi gjermane (14%), kombësi greke (13%), kombësi angleze (8%) dhe kombësi franceze (8%). Gjithashtu me përqindje më të vogël janë turistët me kombësi amerikane, maqedonase, çeke, etj

Grafiku - Prejardhja e turistëve të huaj




²³³ Skema e pyetësorëve është ndërtuar sipas një përpunimi të skemave të pyetësorëve të përdorur për këto lloje studimesh. (Qirici, E., Turizmi i qëndrueshëm, ekoturizmi modeli ideal i tij, Desertacion 2009)

Karakteristikat demografike të turistëve dalin në pah nëpërmjet analizës së disa elementëve si gjinia, mosha, të ardhurat, niveli i edukimit, zënia me punë dhe statusi civil. Për sa i përket gjinisë rreth 58% e të të anketuarve i përket gjinisë mashkullore dhe 42% asaj femërore. Kjo jo në mënyrë të përzgjedhur por si rezultat i rastisjes së tyre më të madhe në periudhën e anketimit.


Për sa i përket moshës së turistëve pjesa më e madhe e tyre (48%) i përkasin grupmoshës 41-60 vjet, e cila mund të shpjegohet edhe me faktin se kjo moshë është e tërhequr ndaj atraksioneve dhe eventeve kulturore, ku mund të përfshihen edhe të apasionuar apo studiues të trashëgimisë kulturore.

Grafik – Mosha e turistëve



Grupmosha mbi 61 vjeç zë 34% të të anketuarve, ndër të cilët pjesën më të madhe brenda grupit e zënë turistët e dalë në pension. Ky grup udhëton më së shumti me agjenci turistike nën drejtimin e guidave të agjencisë dhe e preferon destinacionin për panoramën dhe objektet kulturore të qytetit të Korçës dhe Voskopojës. Prania e grupmoshës së re 18-40 (18%) i përket turistëve të pavarur, të cilët udhëtojnë të tërhequr nga objektet historike dhe përjetimi i eksperiencave në komunitetet lokale. Po këtu përfshihen edhe grupe ekspeditash të studentëve nga vende të ndryshme të botës të tërhequr pas kërkimeve në objektet arkeologjike.


Grafik – Të ardhurat mujore të turistëve




Një tregues tjetër socio-demografik që kontribuon në përfshirjen e njerëzve në lëvizje turistike janë edhe të ardhurat. Nga anketimi ka rezultuar se përqindjen më të madhe në këtë tregues, e zënë personat me të ardhura mujore 1500-2000 €/muaj (33%), ndërkohë që personat me të ardhura 1 501 - 2 000 €/muaj përbëjnë 27%, atë me 501-1000 €/muaj zënë 13% dhe mbi 2000 €/muaj zënë 10%. Vetëm 5% e të anketuarve kanë të ardhura mujore nën 500 €, ndërsa 12% e të anketuarve nuk i kanë deklaruar të ardhurat e tyre. Kjo lidhet me faktin se disa prej tyre, në veçanti studentët mund të jetojnë me të ardhurat nga familja, një pjesë nuk duan t'i bëjnë prezent përpara intervistuesit, por disa mund të kenë probleme në ndryshimin e monedhave të tyre në € dhe \$. Për sa i përket statusit civil të të anketuarve 38% kanë pohuar se janë të martuar me fëmijë, (graf.1, aneks 4) ndërkohë që 29% janë vetëm (beqar).

Po të analizojmë treguesin e nivelit të arsimimit, rezulton se grupi i turistëve që kanë vizituar destinacionin ka nivel të lartë arsimimi. Më shumë se gjysma e të intervistuarve kanë diplomë universiteti Bachelor, ndërkohë që 25% kanë diplomë Master Shkencor dhe Doktoraturë dhe vetëm 20% e tyre kanë pohuar se kanë arsim të mesëm. Më shumë se gjysma e të intervistuarve (67%) janë në marrëdhënie pune, të ndjekur nga 19% që janë në pension dhe 11% janë studentë.


Grafiku - Niveli i edukimit



Grafiku - Punësimi




Grafiku – Përqindja e frekuentimit të zonës



Për sa i përket pyetjes se sa herë e kanë vizituar qarkun, 75% e të anketuarve janë turistë që vijnë për herë të parë, 19% e vizitojnë atë për herë të dytë, 2% për herë të tretë, ndërkohë që 4% nuk kanë dhënë përgjigje. Turistët e rikthyer për herë të dytë dhe të tretë shprehen se rikthimi i tyre lidhet me çështje pune dhe takim me miq të tyre (të huaj), që jetojnë prej disa vjetësh në Korçë.


Turistët e ardhur në Korçë qëndrojnë për një kohë të caktuar. Nga pyetja drejtuar atyre, se sa ditë do të qëndrojnë në destinacion, rreth 53% e tyre janë përgjigjur se do të qëndrojnë 1 natë, 37% do të qëndrojnë 2-5 ditë dhe 2 % më shumë ditë. Rëndësia e kësaj pyetje qëndron në faktin se sa më e madhe të jetë koha e qëndrimit të tyre, aq më të mëdha do të jenë shpenzimet e bëra nga turistët dhe aq më të mëdha do jenë dhe përfitimet që vijnë nga qëndrimi i tyre.

Grafiku – Përqindja sipas kohës së qëndrimit



Në funksion të qëndrimit të turistëve të huaj në zonën e studimit, funksionojnë disa lloje të njësive të akomodimit, ndërkohë që 58% e tyre janë akomoduar në hotele, 26% në shtëpi fshati, dhe 11% në dhoma private. Nga të anketuarit 2% e tyre nuk kanë qëndruar në destinacion gjatë natës (kanë qenë turistë 1 ditor).

Grafiku – Llojet e akomodimit




Lidhur me qëllimin primar të vizitës në qarkun e Korçës, sipas alternativave të propozuara turistët paraqiten disa zgjedhje. Kështu alternativa e lidhjes së kulturës dhe traditave lokale është zgjedhur nga 51.9% e tyre (40 të intervistuar), ndërkohë që monumentet dhe objektet kulturore kanë përbërë qëllimin e vizitës për 48.1% (37 të intervistuar); 33 persona ose 42,9% kanë zgjedhur krahas alternativave të tjera edhe lidhjen me natyrën dhe 21 persona ose 27.3% kanë patur qëllim edhe festimet e ndryshme.

Tabela - Qëllimi primar i vizitës në qarkun e Korçës

	Përgjigjet		Rastet
	Numri	%	Rastet
Jeta e natës, argëtime	3	2.1%	3.9%
Të tjera	8	5.6%	10.4%
Festime të ndryshme	21	14.8%	27.3%
Lidhja me natyrën	33	23.2%	42.9%
Monumentet dhe objektet e kulturës	37	26.1%	48.1%
Lidhja me kulturën dhe traditat locale	40	28.2%	51.9%
Total	142	100.0%	184.4%

Grafiku - Qëllim primar i vizitës në qarkun e Korçës



Siç vihet re nga grafiku i mësipërm rezulton se turistët e huaj vlerësojnë më shumë lidhjen me kulturën dhe traditat lokale si dhe monumentet dhe objektet e kulturës sesa lidhjen me natyrën, festimet apo jetën e natës. Kjo tregon se tërheqja dhe interesi i tyre ndaj vlerave të objekteve kulturore dhe historike është i lartë.

Po të shikojmë më të specifikuarat zgjedhjet për të vizituar destinacionin 64 prej të intervistuarve ose 81% e tyre kanë pohuar se e kanë zgjedhur për të parë fshatrat tradicionale turistike (Voskopojë, Dardhë etj.). Po ky grup prej 79.7% ka pohuar mundësinë për të vizituar


objektet historike dhe kulturore dhe për të parë qytetin (Korçën). Një nga zgjedhjet që vlen për t'u konsideruar krahas të tjerave është ushqime speciale lokale dhe vende të mira për të ngrënë, e zgjedhur në masën 62% (49). Gastronomia dhe ushqimet tradicionale janë një element tjerër i rëndësishëm kulturor, që vlerësohet nga vizitorët vendas, por në këtë rast edhe nga ata të huaj.

Tabela - Arsytet e zgjedhjes së destinacionit

		Përgjigjet		Rastet
		Numuri	%	Rastet
\$ Q6a	Të tjera	2	0.4%	2.5%
	Mundësi hyrjesh, distancë e shkurtër me vendi nga vini	19	4.2%	24.1%
	Mikëpritja e komunitetit (banorëve)	32	7.1%	40.5%
	Shijoj natyrën, klimën e shëndetshme	35	7.8%	44.3%
	Destinacion i qetë (jo shumë i populluar)	40	8.9%	50.6%
	Mundësi për aktivitete kulturore (festime)	42	9.3%	53.2%
	Shërbime të mira dhe çmime të mira	42	9.3%	53.2%
	Ushqime speciale lokale dhe vende të mira për të ngrënë	49	10.9%	62.0%
	Shoh qytetin	63	14.0%	79.7%
	Mundësi për të vizituar objekte historike/kulturore	63	14.0%	79.7%
	Shikoj fshatrat (tradicionale) turistike	64	14.2%	81.0%
	Total	451	100%	571%

Krahas zgjedhjeve me motivacion kulturor një pjesë e mirë (35) 44.3% e të ardhurve e kanë zgjedhur destinacionin edhe për shijimin e natyrës dhe klimën e shëndetshme. Gërshetimi i vlerave kulturore me vlerat e pasura natyrore, e plotëson më së miri ofertën turistike të qarkut të Korçës dhe për rrjedhojë edhe rritjen e interesit të vizitorëve dhe turistëve në drejtim të tij.

Grafiku - Arsyet e zgjedhjes së destinacionit




Nga sa mund të shihet nga të dy grafikët e mësipërm, mund të shprehemi se *motivacioni kulturor*, përbën motivacionin kryesor të vizitës së turistëve të huaj dhe zgjedhjes së destinacionit të qarkut të Korçës.

Lidhur me gjetjen e informacionit për të zgjedhur destinacionin 35 prej tyre ose 45.5% kanë pohuar nga guidat dhe broshurat, 31 ose 40.3 % nga interneti, 16 ose 20.8% nga agjencitë turistike dhe miqtë dhe vetëm 14 prej tyre ose 18.2% nga mbresat apo përshtypjet e mëparshme. (Këta i përkasin grupit të vizitorëve, që e vizitojnë për herë të dytë destinacionin.)

Tabela – Informacioni për zgjedhjen e destinacionit


		Përgjigjet		Rastet
		Numuri	%	Rastet
\$	Të tjera	2	1.8%	2.6%
Q/a	Mbresa personale nga vizita e kaluar	14	12.3%	18.2%
	Nga miqtë	16	14.0%	20.8%
	Agjenci turistike	16	14.0%	20.8%
	Nga internet	31	27.2%	40.3%
	Nga guidat, broshurat	35	30.7%	45.5%
Total		114	100.0%	148.1%

Grafiku - Informacioni për zgjedhjen e destinacionit




Po të analizojmë aksesin e udhëtimit 30% janë shprehur se kanë udhëtuar me transport publik, 22% me aeroplan dhe autobus, 20% me transport tour operator dhe 18% me makinat e tyre. Të pyetur se me cilët kanë qënë të shoqëruar në udhëtim, përgjigja dominuese ka qënë me shokë dhe miq 28% kanë udhëtuar me bashkëshortin ose bashkëshorten, 15% vetëm dhe 13% kanë pohuar se janë shoqëruar nga fëmijë.

Grafiku - Mjetet e udhëtimit




Grafiku – Shoqërimi në udhëtim



Për sa i përket shpenzimeve 34% e të anketuarve kanë pohuar se shpenzimet e tyre gjatë qëndrimit ishin 100-300 €/€, ndërkohë që vetëm 3% tyre kanë pohuar se kanë shpenzuar mbi 1000 €/€. Në shpenzimet e tyre gjatë qëndrimit në destinacion, 57% e të intervistuarve kanë përfshirë vetëm veten, 29% kanë përfshirë 2 persona (ky është grupi që ka udhëtuar në çift) dhe vetëm 5% kanë përfshirë 4 persona. (shih graf.2, aneks 4)


Grafiku - Shpenzimet e bëra në destinacion



4.2.2. Atraksioni Korçar

Kjo analizë konsiston në vënien përballë të opinioneve të turistëve rreth komponentëve të ofertës turistike të krahasuar me vlerësimin e bërë nga këndvështrimi i kënaqësisë së turistëve për elementët konkret në destinacion.²³⁴ Të pyetur se sa të kënaqur janë ata me pushimet, 89% e tyre shprehen të kënaqur për gjithë pushimet që kanë kaluar dhe vetëm 9% janë shprehur mesatarisht të kënaqur


Grafiku - Vlerësimi i pushimeve në tërësi



Për sa i përket analizës së vendndodhjes së destinacionit (distancës nga vendi prejardhjes drejt vendit turistik) 43% e konsiderojnë të rëndësishme, ndërkohë që 44% të tjerë e konsiderojnë mesatarisht të rëndësishme. Po të shikojmë vlerësimin e këtij komponenti për zonën tonë të studimit 51% janë mesatarisht të kënaqur (në këtë rast kjo nuk është pozitive) ndërkohë që 42% shprehen të kënaqur. Lidhur me këtë, mund të komentojmë se kohëzgjatja e udhëtimit dhe gjendja jo e mirë e infrastrukturës në disa pjesë të saj ka ndikuar në vlerësimin e bërë.


²³⁴Në interpretimin e të dhënave përqindja e përzgjedhjeve shumë i kënaqur dhe i kënaqur, janë llogaritur si një regues i vetëm (i kënaqur). Po kështu edhe përzgjedhjet e tjera të të njëjtit kontekst.

Grafiku - Vendndodhja/distanca e destinacionit (nga aeroporti)



Lidhur me mundësitë e transportit dhe gjendjen e mirë të rrugëve 85% e vlerësojnë të rëndësishëm dhe 5% aspak të rëndësishëm, ndërkohë që për destinacionin konkret 65% janë mesatarisht të kënaqur me këtë tregues dhe vetëm 15% janë të kënaqur. (graf.5, aneks 4) Këto të dhëna tregojnë se kohëzgjatja e udhëtimit dhe gjendja jo e mirë e infrastrukturës në disa pjesë të saj ka ndikuar negativisht në opinionin e turistëve, mbi vlerësimin e transportit dhe gjendjes së tij.


Grafiku - Vlerësimi mbi gjendjen e rrugëve




Lidhur me sinjalistikën rrugore 89 % e të anketuarve e vlerësojnë këtë tregues të rëndësishëm dhe vetëm 1% të parëndësishëm. Ndërsa nga vlerësimi i mundësive të informimit dhe sinjalistikës në destinacionin konkret, 65% janë mesatarisht të kënaqur dhe vetëm 15 % janë të kënaqur. (graf.6/7, aneks 4) Nga kjo situatë shtrihet domosdoshmëria e përmirësimit të sinjalistikës rrugore në standardet bashkëkohore. Pyetjes se sa i rëndësishëm është vendparkimi pranë akomodimit 68% e konsiderojnë atë rëndësishëm në një destinacion turistik dhe për 31% janë përgjigjur mesatarisht dhe aspak i rëndësishëm. Për sa i përket kënaqësisë së turistëve me këtë element 79% e tyre janë shprehur të kënaqur. (aneks4, graf. 8/9)

Lidhur me rëndësinë e informacioni turistik/ harta, në drejtim të një destinacioni turistik 94% e vlerësojnë të rëndësishëm dhe 6% mesatarisht të rëndësishëm. (grafiku 23) Për informacionin turistik në zonat e qarkut të Korçës, 65% janë mesatarisht të kënaqur dhe vetëm 24% janë të kënaqur. (grafiku 24) Referuar kësaj, por edhe konstatimeve të bëra mbi këto tregues, shtrojmë domosdoshmërinë e pasurimit dhe rivlerësimit informacioneve turistike të lëvruara për turistët.

Grafiku - Rëndësia e informacioni turistik




Grafiku - Vlerësimi mbi informacionin turistik (hartat turistike)




Mjedisi dhe cilësia e tij (pastërtia) konsiderohet i rëndësishëm për 93% e të anketuarve, ndërkohë që 66% janë të kënaqur me cilësinë e mjedisit në destinacionin.

Grafiku - Rëndësia e pastërtisë së mjedisit




Grafiku – Vlerësimi i turistëve mbi pastërtinë e mjedisit



Për 77% të turistëve të anketuar mikpritja e komunitetit në destinacionin që ata vizitojnë është e rëndësishme. 74% e turistëve që kanë si destinacion Korçën shprehen se janë të kënaqur nga mikpritja korçare, ndërsa 26% e tyre shprehen se janë mesatarisht të kënaqur. Vlerësimi ndaj këtij treguesi është pozitiv, pasi siç e kemi shprehur edhe më sipër mikpritja dhe qytetaria janë elementë karakterizues të komunitetit të të gjitha trevave të qarkut të Korçës. Për sa i përket elementit të sigurisë publike 98% e vlerësojnë të rëndësishëm për një destinacion që vizitojnë dhe të shprehur konkretisht 88% janë të kënaqur me gjendjen e sigurisë në qarkun e Korçës.


Grafiku - Rëndësia e mikpritjes/ vlerësimi i turistëve mbi mikpritjen



Për sa i përket elementit të sigurisë publike, 98% e vlerësojnë të rëndësishëm për një destinacion që vizitojnë dhe të shprehur konkretisht, 88% janë të kënaqur me gjendjen e sigurisë në qarkun e Korçës.


Mundësitë që ofrohen për t'u argëtuar në një zonë të vizituar vlerësohen të rëndësishme për 77% të turistëve dhe për hapësirën konkrete 59% janë mesatarisht të kënaqur dhe 13% e tyre të pakënaqur. Ndonëse në qytetin e Korçës zhvillohen aktivitete të ndryshme kulturore, duhet të zgjerohet gama e aktiviteteve argëtuese në veçanti gjatë sezonit të verës, kur destinacioni frekuentohet më së shumti nga turistët e huaj.

Grafiku - Vlerësimi mundësive për të bërë aktivitete zbavitëse



Për sa i përket eventeve kulturore dhe festimeve 74% i vlerësojnë si të rëndësishme në një destinacion kulturor. 39% e tyre janë të kënaqur me praninë e tyre në qarkun e Korçës dhe 12% janë të pakënaqur. Edhe këtu mund të shprehemi për një organizim më të mirë të tyre.


Grafiku - Evente kulturore/festime



Vlerësimi i akomodimit dhe shërbimit


Lidhur me akomodimin si një nga komponentët e rëndësishëm të turizmit, atmosfera e brendshme dhe elementët që lidhen me të janë të rëndësishëm për pjesën më të madhe (77%) të anketuarve dhe 50% prej tyre janë të kënaqur me këtë tregues në zonën e qëndrimit.

Grafiku - Vlerësimi dhe performanca e atmosferës së brendshme



Shërbimet që lidhen me akomodimin vlerësohen të rëndësishme për 91% të turistëve dhe 60% shprehen të kënaqur me shërbimet në njësinë e akomodimit ku kanë qëndruar. Ndërsa për sa i përket çmimeve të lidhura me cilësinë e shërbimeve 80% i konsiderojnë të rëndësishëm dhe 61% shprehen të kënaqur me kombinimin e të dyjave. Vetëm 3% janë pak të kënaqur.


Grafiku -Vlerësimi dhe performanca e shërbimeve



4.2.3 Kulinaria

Po kështu ushqimi përbën një tregues tjetër të turizmit mjaft të vlerësuar në një destinacion turistik, ndërkohë që ekziston një grup turistësh që janë të apasionuar ndaj gatimeve dhe shijeve tradicionale. Lidhur me atmosferën e brendshme të restoranteve apo vendeve të tjera të ngrënies 92% e vlerësojnë të rëndësishme. Në zonën e vizituar 84% shprehen të kënaqur dhe 15% mesatarisht të kënaqur.


Grafiku - Vlerësimi dhe performanca e atmosferës së brendshme të restoranteve apo vendeve të ngrënies



Po kështu shërbimi i lidhur me ushqimin dhe njësitë e ushqimit konsiderohet për 99% të anketuarve si i rëndësishëm dhe 77% e tyre janë të kënaqur me këtë komponent. Për sa përket

kësaj konstatojmë se restorantet apo njësitë e tjera të lidhura me ushqimin në zonat e frekuentura nga turistët në qarkun e Korçës, shfaqin elementë pozitivë dhe të kënaqshëm krahasuar me zona të tjera turistike. Sigurisht një prej elementëve që vlerësohen këtu është edhe çmimi i lidhur me shërbimin dhe në këtë pikë 81% e konsiderojnë këtë komponent të rëndësishëm. Konkreisht 74% janë shprehur të kënaqur me çmimin e shërbimit që lidhet me njësitë e ushqimit në zonën e vizituar.

Grafiku – Rëndësia dhe vlerësimi i çmimit lidhur me shërbimin



Një element i rëndësishëm për turistët është menya apo llojshmëria e ushqimeve që shërbehen në një destinacion turistik. Shumë vende në botë e kanë ushqimin pjesë jo vetëm të origjinalitetit dhe identitetit, por edhe ofertës së tyre turistike. 96% e të anketuarve e konsiderojnë të rëndësishëm dhe 84 % të tyre janë në kënaqur me menynë e ushqimit që ofrohet në destinacion. (graf.19/20, aneks 4)


Së bashku me llojshmërinë e ushqimeve e rëndësishme është edhe përgatitja e tyre, të cilën, 94% e të anketuarve e konsiderojnë të rëndësishme. Nga këta 84 % shprehen të kënaqur me përgatitjen e ushqimit. Ushqimi dhe përgatitja e tij e bëjnë qarkun e Korçës të preferuar, sidomos zonat rurale të tij.(graf.21/22, aneks 4)

4.2.4 Veçanëtitë e territorit

Vlerësimi mbi territorin është përfshirë në pyetësor jo vetëm se ai konsiderohet një element tërheqës për turistët, por edhe për faktin se për zonën e Korçës, ekziston një tërheqje e tillë kundrejt elementëve të pasur natyror. Ndonëse pjesa më e madhe e turistëve, kanë si motivacion kryesor kulturën, gërshetimi i saj me elementë të pasur gjeografik natyror, e bën më


të preferuar destinacionin. Në këtë këndvështrim qarku i Korçës është i tillë. Kjo konstatohet dhe nga vlerësimet dhe opinionet që kanë dhënë turitët e huaj të pyetur rreth territorit, ku 76 % i vlerësojnë resurset e pasura natyrore si të rëndësishme dhe 51% janë të kënaqur me praninë e tyre.

Grafiku - Vlerësimi i resurseve natyrore



Për sa i përket kushteve klimatike rreth 48% e tyre e vlerësojnë klimën e shëndetshme si një element të rëndësishëm, ndërkohë që 72% janë shprehur të kënaqur me klimën në qarkun e Korçës. Realisht ky element është një tjetër pikë e fortë për tërheqjen e vizitorëve. Klima e freskët malore preferohet nga grupe të caktuara vizitorësh për efektet e saj kurative. Ndërsa për sa i përket rrugëve turistike 65% e të anketuarve e vlerësojnë si një komponent të rëndësishëm për turistin. Ajo që bie në sy është se këtë shërbim asnjë nga të anketuarit nuk shprehet i kënaqur plotësisht. 80% e tyre janë shprehur se mesatarisht të kënaqur, ndërsa pjesa tjetër janë të pakënaqur me rrugët turistike.


Grafiku - Vlerësimi i rrugëve turistike



Lidhur me popullimin e destinacioneve të frekuentuara 68% i vlerësojnë destinacionet jo shumë të populluara dhe kjo shpjegon edhe faktin që 80% e tyre janë shprehur të kënaqur me qytetin dhe zonat e tjera të vizituara në qarkun e Korçës.


Pyetjes nëse do ta vizitoni përsëri destinacionin, 40% e të anketuarve janë shprehur pozitivisht se do t'i pëlqente, ndërkohë që kjo përqindje mund të konsiderohet edhe më e lartë, po t'i referohemi edhe grupit të të anketuarve që janë përgjigjur ndoshta. Për t'u marrë në konsideratë është përqindja e të anketuarve (32%) që janë përgjigjur se nuk do ta vizitojnë më. Lidhur me këtë përqindje në disa raste përgjigja është argumentuar me faktin se “nuk kam më gjera për të parë”.

Grafiku - A mendoni ta vizitoni përsëri destinacionin?



Në vazhdim pyetjes se, “nëse do t’ia rekomandonin destinacionin për t’a vizituar miqve apo të afërmve?”, 37% janë shprehur pozitivisht dhe përqindja e kësaj kategorie rritet edhe nga 40% e të anketuarve që janë përgjigjur “do ta mendoj, pse jo”. Ndërsa 23% e të anketuarve janë shprehur se nuk do t’ia rekomandonin destinacionin e vizituar miqve dhe të afërmve të tyre. Sigurisht kjo përqindje (18 persona) nuk është për të mos u marrë në konsideratë në lidhje me numrin total të të anketuarve.


Grafiku - Do t’ia rekomandonit miqëve dhe të afërmve tuaj?



4.2.5 Vlerësimi i trashëgimisë kulturore të qarkut


Ky vlerësim është bërë nëpërmjet krahasimit të dy komponentëve të rëndësishëm, pritshmërisë dhe kënaqësisë së turistëve në lidhje me vizitën e tyre në qarkun e Korçës. Kështu pritshmëria për ndërtesat historike apo muzetë për 49% të anketuarve ka qenë e lartë ndërkohë që 47% e tyre janë shprehur të kënaqur me këtë element kulturor. Në këtë rast është specifikuar kënaqësia për Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar, ashtu sikurse është pohuar e kundërta për të tjerë të vizituar.

Grafiku – Pritshmëria/ kënaqësia për ndërtesat historike/muzetë




Në lidhje me fshatrat kulturore të qarkut të Korçës (Voskopojë, Dardhë, Prespë etj) për 49% e të anketuarve pritshmëria ka qenë mesatarisht e konsiderueshme ndërkohë për ata që kanë vizituar dhe qëndruar në këto fshatra 65% janë shprehur të kënaqur. Për sa i përket pamjes tradicionale të fshatrave pritshmëria ka qenë e lartë për 52% të të anketuarve ndërkohë që 62% e tyre janë shprehur të kënaqur me këtë element.

Grafiku - Pritshmëria dhe kënaqësia për pamjen tradicionale të fshatrave




Për elementin e arkitekturës së vendbanimeve në tërësi pritshmëria ka qenë e lartë për 52% të turistëve të pyetur dhe 66% prej tyre janë shprehur të kënaqur me këtë element.

Grafiku - Pritshmëria për arkitekturën




Grafiku - Kënaqësia për arkitekturën




Lidhur me eventet dhe festimet pritshmëria ka qenë e lartë për 43% të turistëve dhe 36% janë shprehur të kënaqur, me arritjen e këtij elementi. Një përqindje të lartë (46%) e zënë personat mesatarisht të kënaqur, ndërkohë që 42% kishin këtë pritshmëri. Ndonëse qyteti njihet si qyteti i festimeve të shumta, përqindjet e ulëta të kënaqësisë së realizuar mbi këtë komponent, mund të shpjegohen me rastisjen e një pjese të të anketuarve në ditët pa evente apo festime konkrete (përjashtuar festën e birrës gjatë së cilës ka patur anketime në qytetin e Korçës). Këtu shprehja e kënaqësisë nuk jepet vetëm për festimet e shumta por edhe për kënaqësisë që realizohet nga organizimi i tyre.

Grafiku - Pritshmëria për festimet/eventet




Grafiku - Kënaqësia për festimet/eventet



Pritshmëria për objektet fetare, në veçanti për kishat, është e lartë për 57% të turistëve ndërkohë që kënaqësia është arritur për 76% të atyre që i kanë vizituar ato. Këtu vlen për t'u theksuar prania e shumë e kishave dhe vlerave që mbartin, ashtu sikurse dalin në pah edhe nuanca pakënaqësie për një pjesë të turistëve që vlerësojnë edhe gjendjen e tyre. (vlerësohet Katedralja Ringjallja e Krishtit në qytetin e Korçës dhe kishat e Voskopojës)


Lidhur me ushqimin 48% e të anketuarve kanë patur një pritshmëri të lartë, (këtu mund të përfshihen ata që e kanë vizituar zonën më parë dhe të tjerë). Po kështu 46% nuk rezultojnë të kenë patur pritshmëri pozitive (mesatarisht). Kënaqësia për ushqimin është shprehur nga 84% e të tyre. Kjo është për t'u vlerësuar. Ka nga ata që nuk e kanë shijuar kënaqësinë për këtë element (11%).

Grafiku - Pritshmëria/kënaqësia për ushqimin




Pritshmëria për qendrat e informacionit turistik nuk është shprehur në sensin pozitiv, 40% e të anketuarve kanë pasur një pritshmëri mesatare dhe pa ndonjë ndryshim të dukshëm shprehet edhe në kënaqësinë e të anketuarve lidhur me këtë komponent të rëndësishëm turistik. Prej tyre vetëm 26% janë shprehur të kënaqur. Në qytetin e Korçës funksionon vetëm një zyrë informacioni turistik, po kështu edhe në qytetin e Pogradecit dhe në Voskopojë.

Grafiku - Pritshmëria/ kënaqësia për qendrat e informacionit




Interesante për t'u evidentuar paraqitet pritshmëria e turistëve për mjedisin përreth/njerëzit. Nëse pritshmëritë kanë qënë më së tepërmi në vlera mesatare (57%), kënaqësia për të element ka shprehje shumë pozitive me 80%. Siç e kemi theksuar popullsia e gjithë zonave urbane apo rurale të qarkut të Korçës karakterizohen nga dy elementë të rëndësishëm si mikpritja dhe qytetaria.

Grafiku - Pritshmëria/kënaqësia për mjedisin përreth/njerëzit




Pritshmëria për paketat turistike ka qënë e lartë më së pari për grupin e të anketuarve (30%), që kanë vizituar destinacionin si pjesë e përfshirjes në paketat e udhëtimit nëpër Shqipëri. Ndërkohë që 28% e tyre janë shprehur të kënaqur lidhur me këtë, 6% e të anketuarve janë shprehur të pakënaqur. Lidhur me guidat të cilat përbëjnë një nga mjetet kryesore të informacionit mbi destinacionin që është vizituar, pritshmëria ka qënë e lartë për 40% të të anketuarve. Krahasuar me kënaqësinë e përftuar nga përdorimi i tyre 43% janë shprehur mesatarisht të kënaqur, që në këtë rast nuk mund të konsiderohet pozitive. Nëse do të analizonim në këtë komponent, sipas konstatimit të bërë, guidat e qarkut që tregtohen për përdorim nga turistët përveç gabimeve në informacione, në disa raste nuk paraqesin gjendjen reale të objekteve kulturore.


Grafiku - Pritshmëria/kënaqësia për paketat turistike



Grafiku - Pritshmëria/kënaqësia për guidat turistike




Grafiku - Pritshmëria/kënaqësia për suveniret (produktet tradicionale)



Pritshmëria për suveniret ka qenë e lartë për 37 % të të anketuarve dhe vetëm 11% janë shprehur të kënaqur, për praninë e suvenireve apo simboleve tradicionale në zonën e vizituar. Edhe pjesa e të anketuarve që janë përgjigjur mesatarisht të kënaqur nuk mund të konsiderohet pozitive lidhur me këtë produkt kulturor turistik.


Nga përgjigjet e dhëna lidhur me vizitën në muzetë e qytetit të Korçës, 49% janë shprehur të kënaqur (duke evidentuar muzeun e Artit Mesjetar), 32% janë shprehur mesatarisht të kënaqur (jo pozitive) 8% nuk janë kënaqur, ndërkohë që 11% nuk i kanë vizituar. Këto të dhëna duhet të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes së muzeve të qytetit, më tepër se sa në promovimin e tyre.

Grafiku - Kënaqësia mbi muzetë e qytetit të Korçës




Rreth 66% e turistëve që kanë vizituar kishat e Voskopojës shprehen të kënaqur lidhur me vlerat që mbartin ato, por jo me menaxhimin e tyre. Ka vetëm 3 persona ose 4% që nuk kanë mbetur të kënaqur. Këtu do të ndaleshim në veçanti tek përqindja e personave që nuk i kanë vizituar 18%. Nga konstatimet në terren, kishat nuk qëndrojnë të hapura për vizitorët jo vetëm gjatë ditës, në një orar të rastisjes më të madhe të turistëve (ora 10.00-15.00), por edhe në ditë të veçanta. Po kështu përpos vlerave që mbartin nevoja e investimeve në to është mëse e nevojshme.

Grafiku - Kënaqësia për kishat e Voskopojës



Lidhur me vizitën në tumën e Kamenicës nga turistët që e kishin vizituar atë 60% ishin të kënaqur, ndërsa 32% u shprehën se nuk e kishin vizituar. Numri i personave të shprehur të pakënaqur është 5 ose 8% . Tuma është një objekt kulturor me shumë vlera arkeologjike dhe turistike, por është pak e promovuar.


Grafiku - Kënaqësia për tumën e Kamenicës



Pyetjes se sa të kënaqur keni qenë me vizitën tuaj në qarkun e Korçës, 60% (47 persona) janë shprehur të kënaqur, 32% mesatarisht të kënaqur dhe 8% të pakënaqur. Megjithatë pjesa më e madhe e turistëve të huaj të anketuar ka pohuar se kanë mbetur të kënaqur në vizitën e


tyre, jo e vogël është përqindja e atyre që nuk kanë shprehur ndjenjën e kënaqësisë. Këto tregues duhet të merren në konsideratë edhe për faktin se numri i turistë të anketuar është i limituar.

Grafiku - Sa të kënaqur jeni ju me vizitën në qarkun e Korçës?



Pyetësi i turistëve mbyllet me pyetjen “A bletë suvenirë?”. Ashtu sikurse njihet nga eksperiencat e turizmit, në veçanti turizmit kulturor, blerja e një suvenirë apo simboli nga vendi që vizitohet, është elementi përmbushjes së kënaqësinë në një destinacion turistik dhe marrjes së një kujtimi prej tij. Nisur nga përqindja e të anketuarve për kënaqësinë në lidhje me praninë e suvenireve apo simboleve tradicionale në qarkun e Korçës, pyetjes nëse bletë suvenir 53% i janë përgjigjur negativisht. Ky është një tregues që duhet marrë në konsideratë dhe duhet trajtuar. Vlen për t’u theksuar se faktori që kushtëzon mos blerjen e suvenireve është mungesa e dyqaneve të tilla në qytetin e Korçës, por edhe në zonat përreth.

Grafiku - A bletë suvenire?



4.3. Analiza e të dhënave nga anketimi i komunitetit


Pyetësi drejtuar komunitetit synon të nxjerr në pah njohuritë e tyre mbi trashëgiminë kulturore të qarkut, përfshirjen në sektorin turistik dhe ndikimin i tij në nivelin social-ekonomik

të komunitetit lokal. Pyetësi është i konceptuar në tre seksione: të dhëna të përgjithshme sociale dhe ekonomike të banorëve (gjinia, mosha, të ardhurat, edukimi), të dhëna mbi njohuritë për trashëgiminë kulturore dhe të dhëna mbi konceptin e turizmit dhe përfitimet që vijnë prej tij. Anketimi ka synuar një gjithpërfshirje të komunitetit, me rastisjen me të madhe në zonat e frekuentuara nga turistët vendas dhe të huaj.

Nëpërmjet pyetësit analizohen të dhënat social-ekonomike të popullsisë, perceptimet e tyre për trashëgiminë kulturore dhe impaktin e saj në zhvillimin e turizmit (ekonomik, social, kulturor dhe mjedisor). Po kështu analizohen qëndrimet e tyre ndaj turistëve, si e vlerësojnë ata zhvillimin e turizmit dhe punën e qeverisjes lokale në këtë drejtim. Për efikasitetin e pyetësit është synuar synuar përzgjedhja e një kategorie të popullsisë që ka lidhje direkte dhe indirekte me trashëgiminë kulturore dhe turizmin, me synimin për të kuptuar problemet e këtyre fushave nëpërmjet një mendimi real.

Banorët e përfshirë në anketime u përkasin zonave më të frekuentuara turistike si Korçë, Pogradec, Bilisht, Voskopojë, Boboshticë, Tushemisht, etj. Rreth 22 % (ose 22 persona) janë pyetur në qytetin e Korçës, 12% (12 persona) në qytetin e Pogradecit, 9% (9 persona) në Voskopojë, 8% (8 persona) në Tushemisht dhe Vithkuq dhe 7% (7 persona) në Liqenas ose Pustec, ndërsa pjesa tjetër në fshatra të tjerë të qarkut Korçë.

Grafiku - Origjina e banorëve të përfshirë në anketime




Për sa i përket grupmoshave mbizotëruese evidentohen ato: 31-45 vjet (39%), 35% i përket grupmoshës 46-60 vjet; 13% grupmoshësh mbi 61 vjet dhe 13% grupmoshës 15-30 vjet. Me një përzgjedhje të rastësishme gjinore, 51% e personave të përfshirë në anketim janë meshkuj dhe 49% janë femra.

Lidhur me nivelin e arsimit të personave të anketuar 43% janë me arsimin universitar (përfshirë këtu 4 studentë); 36 % me arsim të mesëm; 15% me arsimin 8-9 vjeçar dhe 6% me arsimin pas universitar.


Lidhur me të ardhurat mujore të tyre, 41% e të anketuarve sigurojnë 26 000-45 000 lekë/muaj; 30% sigurojnë nën 25 000 lekë/muaj; 12 % nga 46 000-70 000 lekë/muaj; 4% mbi 70 000 lekë/muaj dhe 13 nuk i kanë deklaruar të ardhurat.

Grafiku - Të ardhurat e banorëve të anketuar Grafiku - Niveli i arsimit



Rreth 65% e të anketuarave kanë deklaruar se nuk janë të përfshirë direkt në aktivitetet e fushës së turizmit dhe se të ardhurat e tyre kryesore i sigurojnë nga burime të tjera; 18% e konsiderojnë turizmin si aktivitet plotësues për të ardhurat e tyre, ndërsa 17% e kanë aktivitet bazë ekonomik (restorant, hotel, biznes, etj). Të pyetur nëse kanë kontakte me turistët, 46% kanë pohuar se i kontaktojnë me raste, 33% i kontaktojnë shpesh dhe 21% nuk kanë kontakte.


Grafiku - Jeni të përfshirë në aktivitet e turizmit ? Grafiku - Kontaktet me turistët



Lidhur me mendimin e të anketuarve mbi arsimin që nevojitet për të shërbyer në fushën e turizmit 41% kanë pohuar se është i nevojshëm arsimi i lartë (kryesisht në drejtimin menaxhim-turizëm dhe gjuhë e huaj), 38 % mendojnë se janë të nevojshëm arsimi i lartë dhe ai profesional

(kryesisht në profesione që lidhen me shërbimet turistike) dhe 21% kanë pohuar si të nevojshëm vetëm arsimin profesional. Është për t'u evidentuar mendësia e të anketuarve për arsimin e lartë edhe për faktin se personat me arsim të lartë paguhen më shumë se ata me arsim të mesëm ose profesional, pavarësisht punës që duhet të kryejnë.

Grafiku - Çfarë arsimi është i nevojshëm në fushën e turizmit?




Nga rezultatet e pyetësorit në tërësi, një përqindje e konsiderueshme e personave të anketuar janë shprehur pozitivisht mbi përfitimet social-ekonomike që rrjedhin nga zhvillimi i turizmit në përgjithësi dhe turizmit kulturor në veçanti. Duke patur si qëllim të anketimit evidentimin e interesit të komunitetit dhe përfitimeve social-ekonomike, që sjell zhvillimi i turizmit në rritjen e mirëqenies së tyre, është synuar pyetja *nëse kanë fëmijë mbi 15 vjet*. Lidhur me këtë 60% e të anketuarve kanë pohuar se kanë fëmijë mbi këtë moshë, çka mund lidhet edhe me orientimin e arsimimit të tyre profesional apo universitar në fushën e turizmit, duke e konsideruar turizmin si sektor përfitues.

4.3.1. Interesimi për trashëgiminë kulturore


Të pyetur nëse kanë dijeni për trashëgiminë kulturore (materiale dhe shpirtërore) në konceptin e përgjithshëm të saj, 73% e të anketuarve kanë pohuar se kanë dijeni dhe 27% nuk e njohin si koncept. Përqindja e lartë e personave që kanë njohuri mbi këtë trashëgimi lidhet me faktin se 95% e të anketuarve jetojnë në zona me objekte kulturore. Të pyetur më tej nëse kanë dijeni për ekzistencën e objekteve kulturore në dhe rreth zonës së tyre 97% janë përgjigjur po, në veçanti për kishat dhe vetëm 3 prej tyre nuk kishin dijeni.

Grafiku - A keni dijeni për trashëgiminë **Grafiku - Dini nëse ka objekte kulturore rreth destinacionit tuaj (materiale dhe shpirtërore)?**




Pyetjes nëse objektet që ndodhen në zonën tuaj vizitohen nga turistët (vendas apo të huaj) 65% pohojnë se vizitohen çdo herë, 25% ndonjëherë dhe 2% asnjëherë.

Grafiku - A vizitohen nga vizitorët vendas dhe të huaj që vijnë në zonën tuaj?



Lidhur me qëndrimin e komunitetit për turizmin 91% kanë qëndrim pozitiv dhe vetëm 9% kanë qëndrim indiferent, nuk shfaqin interes. Të pyetur nëse mendojnë se potencialet kulturore ndihmojnë në zhvillimin e turizmit në zonë 55% kanë pohuar se ndikojnë shumë, ndërkohë që vetëm 7% mendojnë se ndikojnë pak

Grafiku - Kush është qëndrimi juaj për turizmin ? **Grafiku -Ndikimi potencialeve kulturore në zhvillimin e turizmit?**



4.3.2. Të konceptuarit dhe ndërgjegjësimi për përfitimet nga turizmi

Për analizimin e njohurive mbi konceptin dhe përfitimet e turizmit, pyetjet janë grupuar në katër drejtime kryesore: në drejtim të biznesit si model analitik, në drejtim të turistëve, në aspektin ekonomik dhe në aspektin social- kulturor dhe mjedisor.

Në drejtim të biznesit që përbën shtyllën kryesore të përparimit ekonomik në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm nga 344 fshatra që ka gjithsej qarku i Korces rreth 16 prej tyre sipas të dhënave të institucionit të qarkut korçë kanë fituar statusin e “fshatit turistik” rreth 12 lokalitete. Nga këto dhjetra destinacione turistike ne kemi përzgjedhur Voskopojën.

Në këtë fshat janë shfaqur si dhe janë të njohura potencialet kulturore dhe turistike të saj por unë do të ilustroj argumentim tim me një model të thjeshtë analitik si më poshte:

Duke marrë në shqyrtim gjendjen e bizneseve të përzgjedhura në këtë lokalitet në harkun kohor të analizës studimore të viteve 2010 – 2015, për të dhënë impaktin e nevojshëm të përfitimeve ekonomike gjatë intervalit 2010 – 2015 paqarqesim këtë tabelë:

Zhvillimi i Kapaciteteve turistike në Voskopojë

Lloji i shërbimit	2010	2015
Hotel	5	11
Motele	3	12
Shtëpi pushimi	7	16
Restorante	7	19
Kisha të restauruara	1	5
Qendër hipizmi	0	1
Dyqan souveniresh	0	5

Më tej kemi zgjedhur dy njësi biznesi ndër sa e sa shërbime turistike për të vlerësuar nga ana ekonomike rritjen progressive të të ardhurave të këtyre njësive ekonomike të cialt ofrojnë shërbime turistike që konkretisht janë: Bar Restaurant Hotel “Bacelli” si edhe “Vila Falo”.

Njesia e biznesit “Bacelli” eshte themeluar ne vitin 2001 si nje bar i thjeshtë më tepër për banoret e zones dhe për ata pak turistë që vizitonin voskopojnë në atë kohë. Me disa produkte të limituara kishin të ardhura të mjaftueshme sa për të plotësuar nevojat e biznesit dhe të familjes. Vit pas viti kujton pronari vizitorët ishin më të shumtë dhe të ardhurat filluan të rriteshin aq sa na dhanë mundësinë të zgjerohim biznesin tone. Me rritjen e vizitoreve vit pas viti filluan të rritesh edhe kërkesat për ta zgjeruar gamën e shërbimeve që mund të ofrohej në atë kohë e pikërisht nga një njesi bar i thjeshte kaluam tek nje restorant sepse keto ishin kerkesat e turisteve e me vone deri me sot qe kemi dhe hotelin kujton Nexhip Bacellin pronari i ketij biznesi.

Rritja e te ardhurave per Bar-Restorant-Hotel “Bacelli”

Viti i krijimit 2001	Viti i analizes 2010	Viti i analizes 2015
Bar	2000 euro	6000 euro
Restorant	3000 euro	11000 euro
Hotel	0 euro	10000 euro
Mini market + dyqan souveniresh	0 euro	2500 euro
Total	5000 euro	29500 euro


Rritja e te ardhurave per Bar-Restorant-Hotel “ Vila Falo”

Viti i krijimit 2007	2010	2015
Bar	1800 euro	4500 euro
Restorant	2500 euro	9200 euro
Hotel	0 euro	11000 euro
Mini market + dyqan souveniresh	0 euro	2200 euro
Total	4300 euro	26900 euro


Analiza që të ardhurat brenda një periudhe 5 vjecare janë 2-fishuar apo 3 fishuar për keto biznese. Keto 2 shembuj janë tregues edhe për pothuajse gjitha njesite e tjera të shërbimit turistik që mund të marrim në shqyrtim.

Në drejtim të turistëve pyetjet janë fokusuar përgjithësisht në këndvështrimin e frekuentimit turistik të zonës si dhe në interesin e banorëve për prurjet turistike. Rreth 50% e të anketuarve janë shprehur se numri i turistëve ka ardhur në rritje nga viti në vit, ndërsa 11% e tyre nuk janë dakord me këtë deklaram. Pyetjes nëse turistët komunikojnë mirë me banorët vendas rreth 45% e të anketuarve pohojnë se kjo është e vërtetë, ndërsa 9% nuk janë dakord me këtë pohim. Për sa i përket kësaj, si edhe konstatimit të bërë gjatë anketimit me turistët, jo në të gjitha rastet turistët shfaqin interes për të komunikuar me banorët vendas.

Grafiku - Numri i turistëve ka ardhur duke u rritur nga viti në vit



Grafiku - Turistët komunikojnë mirë me banorët vendas




Për sa i përket pohimit “do të doja të vinin më shumë turistë në zonë”, banorët e anketuar kanë treguar mjaft interes nga të cilët 84% kanë pohuar se janë dakord me këtë deklaram ndërkohë që vetëm 2% nuk janë shprehur dakord me deklarimin. (graf.4, aneks 5) Ndërsa

pohimit se zona është plot me vizitorë dhe turistë ditët e festave 41% kanë pohuar se janë dakord me këtë deklaram dhe vetëm 4% kanë pohuar se nuk kanë dijeni për këtë pohim.


Në aspektin ekonomik lidhur me pohimin se zhvillimi i turizmit do të krijojë më shumë mundësi për punësim 51% janë dakord me këtë deklaram, 40% mendojnë se është përgjithësisht e vërtetë dhe vetëm 6% nuk janë dakord. E shpjeguar konkretisht disa prej të anketuarve mendojnë se nëpërmjet investimeve nga ana e sektorit publik dhe privat do të mund të krijohen mundësi të reja punësimi për to.

Grafiku - Zhvillimi i turizmit do të krijojë më shumë mundësi për punësim




Për sa i përket pohimit se turistët shpenzojnë të ardhura kur vijnë në një destinacion turistik, 51% janë dakord, ndërkohë që 38% deklarojnë se është përgjithësisht e vërtetë dhe vetëm 6% nuk janë dakord me deklaramin. Pohimit se turizmi do të ndihmojë në zhvillimin ekonomik të zonës, 61% shprehen se janë dakord, 33% mendojnë se është përgjithësisht e vërtetë dhe 4% nuk janë dakord me këtë deklaram.

Grafiku - Turizmi do të ndihmojë në zhvillimin ekonomik të zonës



Të anketuarit shprehin interes në lidhje me pohimin do të më pëlqente të kisha një biznes timin në funksion të turizmit, ku 77% kanë deklaruar se janë dakord dhe vetëm 5% nuk jam dakord me këtë deklaram.


Grafiku - Do të më pëlqente të kisha një biznes timin në funksion të turizmit




Lidhur me *investimet e huaja për zhvillimin e turizmit në zonë*, 81% e personave të pyetur kanë deklaruar se janë dakord dhe vetëm 2% nuk janë dakord me këtë deklaram.

Nëse do t'i krahasonim këto rezultate, me pohimin se *investimet qeveritare duhet të luajnë rolin kryesor në zhvillimin e turizmit në zonë*, 82% janë shprehur se janë dakord me këtë deklaram. Është interesant fakti që kjo përqindje e lartë e të anketuarve vlerëson rolin kryesor të investimeve qeveritare për zhvillimin e turizmit. Të pyetur më tepër rreth kësaj, disa pohojnë se elementët e rëndësishëm që ndikojnë në zhvillimin e turizmit, si infrastruktura rrugore, infrastruktura e shërbimeve apo investime të tjera, nuk mund të kryhen nga investitorë të huaj, që përqendrohen kryesisht në ndërtim hotelesh, restorantesh apo shërbime të tilla.

Grafiku - Do të më pëlqente të kishte investime të huaja për zhvillimin e turizmit në zonë




Grafiku - Investimet qeveritare duhet të luajnë rolin kryesor në zhvillimin e turizmit




Në aspektin social-kulturor dhe mjedisor lidhur me pohimin se turizmi ndikon në përmirësimin e transportit lokal 45% mendojnë se është e vërtetë dhe 18% janë shprehur se nuk janë dakord me deklarin. Kjo lidhet edhe me faktin se ndonëse disa zona janë objekt i vizitës së turistëve, vuajnë nga problemet me infrastrukturën dhe transportit. Për sa i përket ndikimit të turizmit në përmirësimin e cilësisë së akomodimeve 57% pohojnë se në përgjithësi kjo është e vërtetë dhe vetëm 7% nuk janë dakord me këtë deklarin.

Grafiku - Turizmi ndikon në përmirësimin e transportit lokal




Grafiku - Turizmi kontribuon në përmirësimin e cilësisë së akomodimeve



Për pohimin se zhvillimi i turizmit ka përmirësuar jetën e komunitetit të zonës, 55% pohojnë se në përgjithësi kjo është e vërtetë, 30% shprehen se janë dakord me këtë deklarin


dhe 10% e tyre nuk janë dakord. Lidhur me këtë deklaram më optimistë paraqiten personat që kanë lidhje direkte ose indirekte me përfitimet nga ardhja e vizitorëve apo turistëve në zonë.

Grafiku - Turizmi ka përmirësuar jetën e komunitetit të zonës




Të pyetur për mendimin e tyre në lidhje me pohimin se *zhvillimi i turizmit do të ndihmojë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore*, 46% nuk kanë ndonjë perceptim konkret lidhur me këtë, 35% janë shprehur se janë dakord dhe 8% nuk e dinë. Ky tregues lidhet me ndërgjegjësim e dobët të komunitetit lidhur me ndikimin që mund të ketë zhvillimi turizmit në ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Grafiku - Zhvillimi turizmit do të ndihmojë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore




Në qoftë se do të analizonin pohimin se objektet tona kulturore duhet të tërheqin më shumë turistë 84% janë shprehur se janë dakord, vetëm 1% nuk janë dakord. Sa i takon pohimit se turizmi kulturor ruan origjinalitetin kulturor të popullsisë lokale, 49% janë shprehur se janë dakord me këtë deklaram dhe 14% nuk janë dakord me këtë deklaram.

Grafiku - Objektet tona kulturore duhet të tërheqin më shumë turistë




Grafiku - Turizmi kulturor ruan origjinalitetin kulturor të popullsisë lokale



Lidhur me këtë pohimit se *turizmi kulturor sjell ndryshime në veshje, zakone dhe tradita lokale*, 49% i janë përgjigjur se është përgjithësisht e vërtetë, 15% janë dakord dhe 3% aspak dakord. Të pyetur më konkretisht rreth kësaj, disa prej personave të anketuar janë shprehur se moshat e reja përpiqen të imitojnë veçanërisht turistët e huaj në veshje dhe sjellje.


Grafiku - Turizmi kulturor sjell ndryshime në veshje, zakone dhe tradita lokale



Po kështu në lidhje me pohimin se turizmi kulturor shkakton rritje të ndotjes 48% janë shprehur se në përgjithësi është e vërtetë dhe 4% nuk kanë qenë dakord me këtë deklaram. E shprehur më tej, personat që kanë pretenduar rritjen e ndotjes nga turizmi kulturor, e kanë


konstatuar këtë në rastet e organizimit të festimeve (fetare apo te tjera) ku prania e vizitorëve ka qenë e madhe.

Grafiku - Turizmi kulturor shkakton rritje të ndotjes



Kjo do të lidhej edhe me pohimin se 46% e të anketuarve e konsiderojnë përgjithësisht të vërtetë se turizmi kulturor sjell mbipopullimin e zonës me vizitorë nga zona të tjera. Po këtu 40% pohojnë se janë dakord dhe 10 % nuk janë dakord me këtë deklaram.


Grafiku - Turizmi kulturor sjell mbipopullim të zonës me vizitorë nga vende të tjera



Duke krahasuar përfitimet ekonomike të turizmit kulturor me elementet negative që mund të sjellë zhvillimi i tij, 49% janë dakord se përfitimet janë më të shumta se elementët negativë, dhe vetëm 7% janë shprehur se nuk e dinë. Për sa i përket deklaramit se *punët që lidhen me turizmin kryhen nga individë jo të komunitetit*, 70% nuk janë shprehur dakord, 17% është në përgjithësi e vërtetë dhe 9% nuk kanë dijeni.

Mjaft interesant paraqiten rezultati për pohimin, *qeverisja lokale ka bërë punë të mirë për promovimin e vlerave të zonës*, sipas të cilit 38% janë shprehur se nuk janë dakord me këtë deklaram, ndërkohë që 22 persona ose 22% janë shprehur se janë dakord me këtë deklaram. (Personat e anketuar nuk hezituan në dhënien e opinionit të tyre lidhur me këtë çështje.)

Grafiku - Qeverisja lokale ka bërë një punë të mirë për promovimin e vlerave të zonës



4.4 Analiza e pyetësorit të njësive turistike


Krahas potencialeve kulturore, njësitë turistike luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e turizmit në një hapësirë gjeografike, pasi ato ofrojnë krahas të tjerave dy nga shërbimet më të nevojshme për turistët. Nisur nga fakti se njësitë e akomodimit dhe ushqimit janë më të frekuentuarat, anketimet u zhvilluan në 20 njësi në zonat turistike. Të gjitha njësitë e përzgjedhura janë lokale dhe pjesa më e madhe të frekuentuara rregullisht nga turistët. Anketimi i bërë me drejtuesit dhe personat e tjerë përgjegjës të këtyre njësive ka synuar të evidentojë gjendjen e këtyre bizneseve, shërbimet që ofrojnë në fushën e turizmit, si edhe problemet që lidhen me mirëfunksionimin e tyre. Prej tyre shtatë njësi janë përzgjedhur në qytetin e Korçës, pesë në qytetin e Pogradecit, tre në Voskopojë, dy në Tushemisht, një në zonën e Prespës (Zaroshkë) dhe një në Vithkuq. Sipas tipit të facilitetit 85% janë të tipit hotele, 10 % (dy) janë vila dhe 5 % (1) është bujtinë.

Tabela - Njësitë turistike të anketuara

Valid	Frekuenca	%
Hotel 1 Maji (Pogradec)	1	5.0
HotelAkademia(Voskopojë)	1	5.0
Hotel Bimbli (Pogradec)	1	5.0
Bujtina Leon (Korçë)	1	5.0
Hotel Enkelana (Pogradec)	1	5.0
Grand Hotel (Korçë)	1	5.0
Hotel Dardha (Dardhë)	1	5.0
Hotel Gold (Korçë)	1	5.0
Hotel Ilo (Liqenas)	1	5.0
Hotel Pashuta (Voskopojë)	1	5.0
Hotel Koçibelli(Korçë)	1	5.0
Hotel Konti (Korçë)	1	5.0
Life Galeri(Korçë)	1	5.0
Hotel Lyhnidas (Pogradec)	1	5.0
Hotel Perla (Pogradec)	1	5.0
Regency Hotel (Korçë)	1	5.0
Hotel Sirena(Tushemisht)	1	5.0
Hotel Vithkuq	1	5.0
VilaArt (Tushemisht)	1	5.0
Vila Falo (Voskopojë)	1	5.0
Total	20	100.0


Sipas kategorizimit të njësive turistike 40% e tyre nuk janë përgjigjur për një vlerësim të tillë, ndërkohë që 30 % (6) e tyre e klasifikojnë veten me tre yje dhe 5% (1) me katër yje. Lidhur me këtë është e nevojshme vlerësimi dhe rivlerësimi i njësive turistike dhe certifikimi i tyre nga institucionet përkatëse sipas standardeve të shërbimeve që ato ofrojnë.

Grafiku - Kategoria e njësive turistike




Sipas kapacitetit mbajtës 60% e tyre përmbajnë 5-20 dhoma, 30% përmbajnë 21-35 dhoma, 5 % përmbajnë 40-60 dhoma dhe 5% përmbajnë 65-85 dhoma. Nga sa kuptohet njësitë e akomodimit në qarkun e Korçës, kanë kapacitete të vogla mbajtëse. Kjo vihet re më së miri në ditët e festës së birrës, ku fluksi i të ardhurve në qytetin e Korçës është shumë i madh dhe nuk mund të përballohet nga njësitë e akomodimit. Lidhur me pronësinë e njësive të akomodimit 90% e tyre zotërohen nga pronari dhe vetëm 20% kanë deklaruar se i zotërojnë me qera.

Grafiku - Kapaciteti mbajtës i njësive turistike




Grafiku - Pronësia e facilitetit



Të pyetur nëse është rritur numri i turistëve nga viti në vit, 85% janë përgjigjur po, ndërsa 15% nuk kanë dhënë përgjigje. Megjithatë vlen për t'u evidentuar fakti që pothuajse asnjë nga njësitë nuk kishte të evidentuar saktë se sa ishte rritur konkretisht numri i turistëve. Për sa i përket burimeve të ngrohjes apo përdorime të tjera për nevoja të funksionimit të njësisë 65% kanë deklaruar përdorimin e drurit krahas zgjedhjeve të tjera, 55% përdorin krahas të burimeve të tjera energjinë elektrike dhe 40% lëndë djegëse (gaz).

Të pyetur nëse njësitë e akomodimit ofrojnë mundësi parkimi 100% e tyre ofrojnë një mundësi të tillë. Kjo është pozitive duke ditur se pjesa më e madhe e turistëve të anketuar e vlerësojnë këtë mundësi.

Grafik - Burimet e përdorura për ngrohje



Lidhur me shërbimet që ofrojnë njësitet turistike, 100% e tyre kanë në mjediset e tyre shërbimin bar, 89% krahas të tjerave kanë shërbimin restorant/tavernë, 84% e ofrojnë në mjedisin shërbimin kafene dhe vetëm 5% (1 njësi) ofrojnë në mjediset e tyre shërbim argëtimi si pishinë dhe disko. Pra, pothuajse të gjitha njësitet e akomodimit ofrojnë në mjediset e tyre shërbimin hotel/ bar/restorant. Nga këto 4 prej tyre ose 20% ofrojnë mjedise për organizimin e konferencave apo workshop (sallë konference).

Grafiku - Mjediset e ofruara në ndërtesë



Lidhur me shërbime të tjera që njësitet e akomodimit ofrojnë 95% e tyre e ofrojnë mëngjesin, 90% krahas të tjerave ofrojnë shërbim dhome, 89% ofrojnë shërbim valutor në hotel, 58% ofrojnë krahas të tjerave edhe transport, 16% ofrojnë guida në mal dhe 5% ofrojnë ski. Të pyetur nëse ofrojnë shërbime që lidhen me traditat lokale 80% e tyre pohojnë se ofrojnë gatime tradicionale, mjedise dhe punime artizanale.


Grafiku - Shërbime të tjera që ofroni për turistët



Lidhur me numrin e personelit të angazhuar (punësuar) në njësinë turistike, të gjitha njësitë e anketuara kanë pohuar se ka ardhur në rritje nga viti në vit. Pjesën më të madhe të personelit e përbëjnë femrat. Lidhur me nevojat e trajnimit të personelit disa prej tyre shprehen për trajnime kryesisht në profilet recepsionist, kamarier, kuzhinier, gjuhë e huaj etj. Krahas kësaj në dy prej njërive të anketuara është bërë prezent “defekti” midis arsimit dhe vendit të punës, çka nënkupton se në disa raste arsimit nuk e justifikon punën që duhet të kryhet.


Lidhur me promovimin e potencialeve kulturore në qarkun e Korçës, mendimi i njërive turistike në këtë drejtim anon në sensin negativ. Rreth 65% e personave të anketuar mendojnë se duhet të promovohen më shumë, 25% janë shprehur se janë pak të promovuara dhe 10% nuk janë të promovuara fare. Sipas tyre promovimi dhe menaxhimi më i mirë i objekteve kulturore do të rrisë interesin e turistëve për të vizituar zonat turistike (veçanërisht atyre të huaj) dhe për rrjedhojë edhe të ardhurat në destinacion.

Grafiku – Çfarë mendoni për promovimin e potencialeve kulturore në qarkun e Korçës?



Të pyetur se a rriten të ardhurat e tyre gjatë sezoneve turistike në krahasim me periudhën tjetër të vitit, 74% e tyre kanë pohuar se rriten 2 herë, 16% kanë deklaruar se rriten 3 herë dhe vetëm 10 % e tyre (2 njësi) kanë deklaruar se rriten më shumë se 5 herë. Kjo mund të konsiderohet pozitive, por gjithsesi të ardhurat e njërive të akomodimit do të rriten edhe më shumë nëse këto do të investojnë më shumë në drejtim të kërkesës së turistëve. Pra përderisa të ardhurat rriten ja vlen që të rritin cilësinë.

Grafiku - Rritja e të ardhurave në sezonet turistike



Të pyetur nëse kanë pengesa për mirëfunksionimin e aktivitetit të tyre turistike 55% janë përgjigjur po dhe 45% se nuk kanë pengesa në mirëfunksionimin e aktivitetit të tyre. Konkretisht një nga pengesat e ngritura është infrastruktura rrugore cilësia jo e mirë e së cilës kushtëzon ardhjen e turistëve në zonat e tyre. Ato shprehen se: “Unë ngre biznesin, shteti ngre infrastrukturën”. Po kështu organizmat shtetëror bëjnë promovimin e trashëgimisë kulturore.

Tabela - Pengesat e evidentuar lidhje me mirëfunksionimin e aktivitetit në funksion të turizmit

	Frekuenca	%
Duhet të përmirësohet infrastruktura rrugore	3	15.0
Duhet të promovohen më shumë vlerat e trashëgimisë kulturore	4	20.0
Duhet të përmirësohen guidat dhe mjetet e tjera promovuese	3	15.0
Të përmirësohen shërbimet e tjera infrastrukturore	2	10.0
Të ofrohen më shumë shërbime të tjera turistike	2	10.0
Më shumë qendra argëtimi, sportive, blerjesh	1	5.0
Të mos njësohen dhe trajtohen të gjitha njësitë e akomodimit me kategorinë hotele	2	10.0
Të forcohet bashkëpunimi publik-privat	3	15.0
Total	20	100.0

KAPITULLI V: Menaxhimi i trashëgimisë kulturore të Qarkut Korçë

Duke u nisur nga oferta e pasur e trashëgimisë kulturore si edhe vlerat e larta historike, arkeologjike, arkitekturore dhe kulturore që ato përmbajnë, është e nevojshme që të analizohet dhe menaxhimi i kësaj trashëgimie. Në këtë kapitull janë trajtuar çështje të cilat lidhen në mënyrë direkte me menaxhimin e trashëgimisë kulturore të qarkut Korçë.

5.1 Itineraret turistike-kulturore të qarkut të Korçës

Transformimet e thella me karakter politik, social-ekonomik dhe shoqëror, që kanë ndodhur vitet e fundit në vendin tonë, janë shoqëruar edhe me ndryshime të ndjeshme në fushën e infrastrukturës. Ndërtimi dhe përmirësimi i rrjeteve kryesore të transportit dhe komunikimit, kanë favorizuar lidhjen e destinacionit me zona të tjera brenda Shqipërisë si edhe me vendet ndërkufitare Greqinë dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Po kështu një rrjet komunikimi rrugësh dytësore, lidhin qytetet me zonat rurale dhe pranë tyre edhe qendrat e vizitueshme. Mbi bazën e këtyre rrjeteve të komunikacionit, për të vizituar atraksionet dhe zonat kulturore të përmendura më sipër, mund të organizohen disa itinerare turistiko-kulturore. Këto mund të jenë në grupe apo individuale, me kohëzgjatje të kufizuar (ditore), një ditore por edhe më gjatë. Si të tillë do të përcaktonim:

Itinerare brenda vendit

Ky itinerar mund të fillojë që nga aeroporti i Rinasit (për turistët e huaj) duke vazhduar në *Tiranë-Elbasan-Pogradec-Korçë-Ersekë-Leskovik-Përmet-Gjirokastrë-Sarandë-Vlorë* dhe të përfundojë përsëri në Tiranë. Në kuadrin e njohjes së Shqipërisë Jugore ky itinerar mund të zhvillohet kryesisht në grupe turistësh ose ture të ndërmarra nga agjencitë turistike, por edhe nga ture turistësh të pavarur. Distanca nga Tirana në Korçë (159 km) mund të përshkohet në intervalin prej 3 orësh, ndërsa distanca Korçë-Sarandë (247 km) për shkak infrastrukturës jo të mirë rrugore, mund të përshkohet për 8-9 orë udhëtim.

Një itinerar i dytë mund të nisë gjithashtu nga porti i Durrësit, në qytetin e *Durrësit-Elbasan-Pogradec-Korçë-Ersekë-Leskovik-Përmet-Gjirokastrë-Sarandë-Vlorë* dhe përfundojë përsëri në Durrës. Distanca Korçë-porti i Durrësit 200 km.

Në të dy itineraret hyrja në territorin e qarkut të Korçës bëhet në majën e Qafë Thanës (Qafë Thanë-Korçë, 57 km)²³⁵. Në se akomodimi do të bëhet në qytetin e Korçës, ndalesa e parë është në fshatin Lin, (në fund të zbritjes së qafë Thanës) ku mund të vizitohet Bazilika dhe Mozaikët e Linit. Ndalesa e dytë është në qytetin e Pogradecit, ku mund të vizitohet Muzeu Historik i qytetit, ndërkohë që vizitorët mund të soditin qytetin dhe pamjen e mrekullueshme të liqenit. Ndalesa tjetër mund të bëhet në fshatin Tushemisht. Këtu mund të vizitohet pika turistike të Drilonit, Mozaikët e Tushemishtit si dhe qendra e punimeve artizanale të grave të Tushemishtit. Gjithashtu, mund të provohen peshku i koranit dhe gatimet e tjera tradicionale në restorantet e fshatit.

Në qytetin e Korçës, mund të vizitohet Muzeu i Artit Mesjetar, Muzeu Arkeologjik, Mësonjëtorja e Parë Shqipe, Katedralja “Ringjallja e Krishtit”, Muzeu “Bratko” si edhe të vizitohet pamja arkitekturore e qytetit në qendrën historike të tij.

Itinerare brenda rajonit:

Mund të jenë njëditore ose brenda ditës. Këtu mund të përfshihen grupe studentësh apo nxënësish, të cilët mund të njihen me objektet e trashëgimisë kulturore dhe mjedisin natyror që i shoqëron ato. Gjithashtu këto itinerare preferohen nga vizitorët vendas dhe të huaj. Nisja mund të bëhet nga vendodhja më e afët.

Kështu një itinerar i brendshëm mund të nisë *Korçë-Pogradec-Tushemisht-Korçë*;

Korçë-Voskop-Voskopojë-Korçë; *Korçë-Vithkuq-Korçë*; *Korçë-Boboshticë-Dardhë-Korçë*; *Korçë-Qafë Zvezdë-Pustec-Korçë*; *Korçë-Qarrit-Ersekë-Leskovik-Korçë*;

*Brenda qarkut distancat nga qendra e qarkut janë: Korçë-Voskopojë 18 km, Korçë-Vithkuq 25 km, Korçë-Dardhë 20 km, Korçë-Boboshticë 7 km.*²³⁶

Itinerare ndërkufitare:

Zonat dhe atraksionet kulturore të qarkut, mund jenë gjithashtu pjesë të rëndësishme të itinerareve ndërkufitare me zona kulturore përkatëse në Greqi dhe FYROM. Lidhja dhe komunikimi ndërkufitar i udhëtarëve, realizohet nëpërmjet doganave të Qafë Thanës, Tushemishtit dhe Goricës me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe doganave të Kapshticës dhe Tre Urat me Greqinë. Prania e pikave doganore me rëndësi kombëtare dhe

²³⁵ Institucioni Prefektit Qarkut Korçë, Relacion vjetor, 2014

²³⁶ Institucioni Prefektit Qarkut Korçë, Sektori i Kompetencave Vendore

ndërkombëtare dhe afërsia me to, kanë favorizuar hyrjet dhe daljet e turistëve ndërkombëtarë si në drejtim të Shqipërisë, ashtu edhe drejtim të destinacionit të Korçës.

Largësia e qendrës së qarkut nga pikat doganore shprehet sipas distancave:

Kufiri me Greqinë (km)

Kapshtica 37

Tre Urat 100

Gorica 45

Kufiri me R. Maqedonisë (km)


Tushemisht 49

Qafthana 57

Gorica 45

Burimi: Institucioni Prefektit, Zyra e Turizmit.

Për turistët e pavarur që vijnë në qytetin e Korçës me kohë qëndrimi një natë fjetje në qytetin e Korçës dhe vazhdimi i udhëtimit në FYROM, itinerari mund të përfshijë:



Nisja nga Tirana-Elbasan-Pogradec-Korçë, në vazhdim Korçë-Goricë e Vogël-Bitola (63 km) apo Korçë- Goricë e Vogël –Ohër (65 Km).

Harta - Itineraret turistike të qarkut Korçë

Po kështu itinerare të tjera mund të jetë Korçë-Goricë e Vogël-Resnjë (66,5 km); Pogradec-Tushemisht-Ohër (55 km); Korçë-Qafë Thanë-Strugë (62.2 km) e në vazhdim Shkup. Gjatësia e itinerarit Korçë-Shkup është 264 km dhe kohëzgjatja e udhëtimit rreth 4 orë.

Një itinerar tjetër në drejtim të Greqisë do të përfshinte: Tiranë-Elbasan-Pogradec-Korçë-Bilisht-Kapshticë-Kostur-Kozan-Selanik. Po kështu nga qyteti i Korçës nëpërmjet doganës së Kapshticës mund të shkohet në Follorinë (57 km), Selanik (250 km), Janinë (130 km), Igumenicë dhe Athinë. Ndërkohë nga qyteti i Korçës për të kaluar në Janinë mund të shfrytëzohet dogana e Tre Urave në Leskovik. Ndonëse aktualisht jo shumë e frekuentuar, përmirësimi i infrastrukturës rrugore mund ta kthejë në një pikë të rëndësishme kalimi kufitar përhyrjen dhe daljen e turistëve nga destinacionet turistike të Greqisë. Krahas itinerareve të përmendura ekzistojnë itinerare që lidhin qytetin e Korçës me disa nga qendrat e vizitueshme si: Korçë-shpellë e Trenit, Korçë-Tuma e Kamenicës si edhe Kolonjë-Tuma e Rehovës.

Itineraret këmbësore janë një tjetër mundësi që mund t'u ofrohen vizitorëve të apasionuar pas mjedisit apo dukurive të veçanta që lidhen me të.

Për sa i përket infrastrukturës turistike, (strukturat akomoduese) në qarkun e Korçës funksiononin:

Në qytetin e Korçës -Hotel "Turizmi" (77 dhoma me 200 shtretër, 27 dhoma për të huaj); Kampi i punëtorëve (68 dhoma me 140 shtretër); hotel "Valbona" (20 dhoma me 40 shtretër); hotel "Borova"; hotel "Krimea" dhe hotel "Elbasani" në pazarin e Korçës. Hotelet funksiononin me kapacitet të plotë në sezonin e verës por frekuentoheshin edhe në sezonin e dimrit.

Në qytetin e Pogradecit -Hotel "Turizmi" (30 dhoma); hotel "Kalaja" (50 dhoma); hotel "Liqeni" (10 dhoma); Kampi i punëtorëve; Kampi i pionierëve me 27 dhoma dhe 55 shtretër, si edhe disa shtëpi për turizëm familjar. Gjatë sezonit Qershor-Shtator këto funksiononin me kapacitete të plota. Sipas dëshmive të marra nga banorët, në këtë sezon qyteti e dyfishonte popullsinë e vet.

Voskopoja kishte dy kampe; kampin e punëtorëve dhe kampin e pionierëve me kapacitete të plota në sezonin e verës por të frekuentuara edhe gjatë të dimrit.

Dardha kishte një kamp për punëtorët dhe kamp për pionierët.

Hotelet administroheshin nga shteti dhe gjatë periudhës së sezonit të frekuentimit të tyre angazhoheshin disa struktura shërbimesh shtetërore²³⁷.

Pas viteve '90, me ndryshimet e gjithanshme të vendit, në qarkun e Korçës u rrit numrin e vizitorëve vendas dhe njëkohësisht interesi i turistëve të huaj që vizitonin Shqipërinë. Klima e shëndetshme kurative, arkitektura e veçantë dhe potencialet kulturore të qytetit të Korçës dhe vendbanimeve rreth tij, janë disa nga atraksionet tërheqëse për turistët. Numri i vizitorëve vendas dhe të huaj ka ardhur duke u rritur nga viti në vit. Është për t'u evidentuar fakti i mungesës së të dhënave të sakta zyrtare mbi llogaritjen e prurjeve turistike në qarkun e Korçës dhe në zona të veçanta të tij. Për të krijuar një ide lidhur me këtë, po paraqesim të dhënat e mëposhtme.

Nga të dhënat statistikore nuk mund të llogaritet një numër i saktë i turistëve të huaj që vizitojnë qarkun e Korçës, pasi në një pjesë të mirë të rasteve vizitorët që vizitojnë qytetin e Korçës, vizitojnë edhe zonat përreth. Sipas këtyre të dhënave të bëra prezent nga njësitë e qeverisjes vendore, *Korça* është qyteti më i frekuentuar nga turistët vendas. Numri vizitorëve vendas ka ardhur duke u rritur nga 43 000 në vitin 2009 në 115 000 në vitin 2012. Sipas të dhënave të Bashkisë Korçë numri i vizitorëve në njësitë e akomodimit në qytetin e Korçës gjatë periudhës 2009-2011 ka qenë 32 295 vizitorë. (Raport përmbledhës për numrin e vizitorëve 2009-2011) Nga anketimi i bërë me turistët e huaj tërheqja e tyre kundrejt destinacionit, bazohet kryesisht në motivet kulturore. Qyteti i *Pogradecit* është zona e dytë e frekuentuar për nga numri i turistëve vendas, numri i të cilëve ka ardhur duke u rritur në 57 000 vizitorë, çka lidhet me turizmin e banjave dhe të liqenit që ofron Pogradeci në stinën e verës.

Voskopoja është fshati turistik që dallohet për numrin e lartë të turistëve vendas dhe të huaj që e vizitojnë. Nga 28 000 vizitorë vendas në vitin 2009 është rritur në 48 000 në vitin 2012. Në këtë rritje rol të rëndësishëm luan edhe organizimi i festës së Shën Prodhomit, që sjell në zonë mijëra vizitorë. Numri më i madh i turistëve të huaj është regjistruar në Voskopojë, që në vitin 2012 llogaritet 24 400 nga 1 700 në vitin 2009.

²³⁷Këto të dhëna janë siguruarngamenaxherët e këtyre njësive dhe pronarët që i blenë këto hotele pas vitit '90.

Tabela . Numri i vizitorëve vendas dhe të huaj në zonat turistike të qarkut

Rreth i	Korçë		Pogradec		Liqenas		Voskopojë		Tushemisht		Drenovë		Vithkuq	
Origjina e turistëve	Vendas	Të huaj	Vendas	Të huaj	Vendas	Të huaj	Vendas	Të huaj	Vendas	Të huaj	Vendas	Të huaj	Vendas	Të Huaj
2009	43 000	2 300	35 200	2 300	1 100	110	28 000	1 700	30 200	410	5 700	160	80	50
2010	92 000	8 000	48 600	2 700	2 000	100	32 300	20 000	35 000	460	6 200	200	70	60
2011	98 000	8 200	55 200	4 300	3 300	400	42 300	22 900	35 000	1 200	17 600	600	530	120
2012	115 000	9 000	57 000	7 000	6 000	800	48 000	24 400	35 400	2 500	18 500	1 200	2 800	1 700
Total	348 500	27 500	196 000	16 300	12 400	1 410	150 600	69 000	155 600	4 570	48 000	2 160	3 480	1 930

Burimi: Institucioni Prefektit të qarkut Korçë

Nga anketimi në terren rezulton se motivacioni kryesor i turistëve të huaj që kanë vizituar Voskopojën është ai kulturor, i cili lidhet me vizitat në kishat, arkitekturën tradicionale, mënyrën e jetesës së banorëve, gatimet tradicionale etj. Po kështu rritje të numrit të vizitorëve

vihet re edhe në zonën e Drenovës, ku përmendim tërheqjen ndaj pikave turistike të Dardhës dhe Boboshticës.

Njësitë e akomodimit, si një ndër komponentët më të rëndësishëm të sektorit turistik, ofrohen nëpërmjet strukturave akomoduese të tipit të hoteleve, shtëpive private, bujtinave dhe shtëpive të fshatit (turizëm familjar). Sipas studimit të bërë nga SNV-ja në Strategjinë e marketingut dhe zhvillimit të produktit turistik për rajonin e Korçës, evidentohen 49 njësi akomodimi apo hotele dhe 81 shtëpi pushimi²³⁸. Nga statistikat e mësipërme rezulton se numri më i madh i njësive të akomodimit, ndodhet në rrethin i Pogradecit, e lidhur kjo me faktin që Pogradeci ofron turizmin e liqenit dhe banjave të diellit, por edhe me kohën e qëndrimit më të gjatë që kërkon ky lloj turizmi. Një pjesë e mirë e hoteleve janë të lokalizuara jashtë qytetit, në Tushemisht dhe përgjatë rrugës nacionale Lin – Pogradec.

Tabela 5. Struktura akomoduese e turistëve në qarkun e Korçës

Vendndodhjet	Hotele	Shtretër	Shtëpi pushimi
Korça	9	600	
Pogradeci	27	900	10
Voskopoja	5	300	15
Dardha	2	95	10
Prespa	2	30	30
Vithkuqi	1	20	4
Boboshtica			5
Erseka	3	57	7
Total	49	2002	81

Burimi : Zyra e SNV- Korçë , 2012

Një surveyim tjetër i GIZ mbi njësitë e akomodimit në fshatrat turistike në Korçë, evidenton se në fshatin Dardhë ndodhen 6 hotele, 61 dhoma dhe 130 shtretër. Po këtu, ndodhen 6 shtëpi miqsh me 12 dhoma dhe 24 shtretër. Në fshatin Voskopojë ndodhen 7 hotele, 90 dhoma me 205 shtretër, 11 vila alpine me 35 shtretër. Këtu ndodhen gjithashtu 11 shtëpi miqësh (guest house) me 33 dhoma dhe 70 shtretër. Në fshatin Vithkuq 2 hotele, 12 dhoma me 26 shtretër.²³⁹ Në Drejtorinë e Tatim-Taksave në Korçë, rezultojnë të regjistruara 58 njësi

²³⁸ Becherel, L., Strategjia e marketingut dhe zhvillimit të produktit turistik për rajonin e Korçës, 2009, SNV, f.64

²³⁹ GIZ, 2010

akomodimi hoteleri në qarkun e Korçës. Nga sa mund të konstatojmë nga të dhënat e mësipërme disa biznese të tipit njësi akomodimi (hotel), nuk figurojnë të regjistruara si të tilla edhe pse kryejnë këtë aktivitet. *(Për shërbimet që ofrojnë njësitë e akomodimit në zonat e frekuentuara nga turistët, do ti referohemi të dhënave të anketimit tonë të bërë në to. Shih, kap.IV)* Pothuajse të gjitha njësitë e akomodimit të regjistruara si të tilla, ofrojnë edhe shërbimin e ushqimit (restorant) dhe shërbimin bar-kafene.

Shërbimi i informacionit turistik ofrohet nëpërmjet Zyrave të Informacionit Turistik në qytetin Korçës, Pogradecit, në fshatrat Voskopojë, Dardhë dhe në Parkun Kombëtar të Prespës (Goricë e Madhe) dhe Zagradec pranë liqenit të Prespës së Vogël.

Krahas elementëve të infrastrukturës speciale në shërbim të turizmit, elementë të tjerë të infrastrukturës në tërësi kanë ndikimin e tyre direkt dhe indirekt në shërbim të turizmit. Në këtë këndvështrim i gjithë qarku i Korçës ka një rrjet të zhvilluar transporti që e lidh me pjesën veriore dhe jugore të Shqipërisë. Shërbimi i transportit ofrohet rregullisht nëpërmjet mjeteve të transportit të tipit autobus, furgon dhe taksi për komunikimin nacional dhe mjetin furgon për lidhjen e qyteteve me zonat rurale të qarkut. Linja të rregullta të transportit të udhëtarëve me autobus dhe taksi lidhin Korçën si qendër qarku me Selanikun dhe Athinën në Greqi. Lidhja me qytetet Ohër, Strugë, Shkup në FYROM realizohet me shërbim taksi, nëpërmjet doganave të Tushemishtit, Goricës dhe Qafë Thanës.

Shërbimi shëndetësor mundësohet nëpërmjet spitalit rajonal në qytetin e Korçës dhe shërbimit spitalor në qytetet Pogradec, Bilisht, Ersekë. Për sa i përket furnizimit me ujë të qarkut, qyteti i Korçës ka më se 10 vjet që furnizohet me ujë të pijshëm 24 orë (projekti i Bankës Gjermane KFW në vitin 2002) dhe përmirësime në furnizimin me ujë të pijshëm kanë edhe zonat e tjera urbane dhe rurale të qarkut. Po kështu Korça si qytet, ka një rrjet funksional të kanalizimeve të ujërave të zeza, të cilat trajtohen në impiantin e pastrimit të ujërave të zeza. Ndërkohë situata paraqitet problematike në zonat rurale, në veçanti në ato zona, që frekuentohen nga turistët. Për largimin e mbeturinave të ngurta urbane situata mbetet problematike në gjithë zonat e qarkut të Korçës. Problem shqetësues përbëjnë gjithashtu për mjedisin në zonat rurale, mbetjet shtazore.

5.1.1 Zonat/fshatrat kulturorë, avantazhet dhe disavantazhet

Tendencat e fundit të lëvizjeve turistike janë të orientuara drejt qyteteve të vjetra apo fshatrave që mbartin element të së kaluarës. Objektet e kulturës tradicionale që ndodhen në to, muzetë, objektet e kultit, organizimi eventeve, i bëjnë këto vende të preferuarat e turizmit të trashëgimisë kulturore. Veçanërisht tërheqëse paraqiten “fshatrat kulturore” me larminë e tyre folkloristike, traditat dhe mënyrën e jetës, që prodhojnë eksperiencë të kërkuara nga turistët. Banesat tradicionale janë lehtësisht më të përshtatshme për t’u akomoduar në rastin e një fshati të banuar, ndërkohë që këtu turistët apo vizitorët nuk presin gjatë për të dëgjuar një këngë, shijuar një valle të artit shpirtëror apo një gatim të kuzhinës lokale²⁴⁰. Si shembull të tillë përmendim rrjetin ndërkombëtar të “fshatrave kulturore” të Evropës, si: Wijk aan Zee në Holandë, Mellionec në Francë, Bystre në Cezh, Pergine Vardarno në Itali, Paxos në Greqi, Kilingi-Nõmme në Estoni, Ströbek në Gjermani²⁴¹ etj. Nëpërmjet udhëtimeve nëpër Evropë, duke vizituar dhe promovuar kulturat tek njëri tjetri, këto fshatra kanë zbuluar vlerat e harruara të nivelit lokal. Gjithashtu ky rrjet synon t’i japë shtysë zhvillimit social ekonomik në këtë nivel.

Nëse do t’i referohemi disa prej kriterëve që e bëjnë një qytet apo fshat tradicional kulturor, (arkitektura e banesave dhe materiali vendas i përdorur për ndërtimin e tyre; artizanati dhe objekte të tjera të bëra në vend; akomodimi; servirja e ushqimit tradicional; ekzistenca e guidave ose broshurave; prania e rrëfimitarëve ose rrëfyesve; qendra të informacionit turistik, vizitorë vendas dhe të huaj;) në qarkun e Korçës do të përmendim si të tilla:

Qyteti i Korçës, qendra e qarkut, dallohet për vlerat e mëdha kulturore dhe arsimdashëse, arkitekturën tradicionale të banesave, rrugët me kalldrëm, monumentet historike, objektet e kultit, festimet e shumta, stilin e jetesës, figura të shquara patriotike dhe artistike etj.

Qyteti i Pogradecit, ofron peizazh liqenor dhe turizmin e banjave të diellit, kala (Pogradecit), objekte kulti, kulinari të veçantë, atmosferë festimesh etj.

Voskopoja, qendër e qytetërimit në shek. XVIII trashëgon elemente të infrastrukturës urbane të kohës, objekte kulti me vlera të rëndësishme, gatime tradicionale, peizazh natyror dhe klimë me

²⁴⁰Van Zyl, C.J., 2005, The role of tourism in the conservation of cultural heritage with particular relevance for south Africa, phd, dissertation, pdf, f.143

²⁴¹Në këtë rrjet “Culture village of Europe” marrin pjesë 12 komunitete të vogla europiane.<https://www.google.al/culturevillageineurope>

vlera kurative, festa fetare dhe panaire, vendi i piktorëve dhe artistëve më të mëdhenj të kohërave (Vëllezërit Zografi, Kostandin Shpataraku, etj.)

Vithkuqi, daton si vendbanim që me kalatë e Boshanjit, Leshnjës, Bellovodës, (periudha e parë e hekurit). Në mesjetë përmendet si vendbanim në Principatën e Muzakajve. (shek.XV).

Në kohën e lulëzimit të vet numëronte një sërë kishash dhe bazilikash disa prej të cilave ruhen edhe sot. Vendi i origjinës së piktorit kombëtar Vangjush Mio.

Dardha, fshat malor me bukuri natyrore, banesa guri me arkitekturë karakteristike, kisha, gatime të veçanta, organizime festash dhe ditë të shënuara etj.

Prespa si zonë e Parkut Kombëtar të Prespës, ofron peizazh liqenor dhe natyror me vlera të veçanta, rrënoja vendbanimesh prehistorike, kisha eremite, gatime tradicionale edhe prodhime bio të zonës, tradita dhe festa.

Boboshtica, fshat tradicional me kulturë të hershme dhe në qendër të vizitës së vizitorëve vendas dhe të huaj që vijnë në qarkun e Korçës. Restorantet me gatime tradicionale, shtëpitë karakteristike, kishat e vjetra, festimet dhe prodhimi tradicional i rakisë së manit mundësojnë një ofertë të pasur me interes turistik.



Harta – Zonat/fshatrat turistik të qarkut Korçë

Lini, Tushemishti dhe Driloni, të ndodhur përgjatë liqenit të Ohrit, ofrojnë turizëm të banjave të diellit, burime natyrore me ujë të ftohtë, por edhe turizëm kulturor me kisha e mozaikë, punime artizanati të zhvilluar, gatime tradicionale etj. Këtu ndodhet “Shtëpia e duarve të arta”, e cila funksionon si qendër e prodhimeve artizanale të grave me probleme sociale por edhe si qendër turistike për tregtimin e punimeve të tyre.

Rehova dhe Borova (Kolonjë) janë fshatra tradicionale me banesa të ndërtuara me gurë, rrugë të shtruara me kalldrëm dhe kisha të shek. XVII. Në Rehovë ndodhet tuma e Rehovës dhe muzeu me objekte arkeologjike. Në Borovë ndodhet një varrezë e LDB-së dhe një muze që përkujton masakrën e 106 banorëve nga ushtria gjermane. Dallohen për artizanatin dhe traditat e veçanta.

Tabela - Avantazhet dhe disavantazhet e zonave/fshatrave turistike të qarkut

Avantazhet turistike	Disavantazhet
Peizazhe natyrore dhe humane atraktive	Infrastrukturë dhe standarde të dobëta rrugore në arritjen e disa fshatrave turistike;
Parqe kombëtare dhe zona të mbrojtura	Komunikim i dobët rrugor mes zonave turistike dhe monumenteve kulturore
Klimë të freskët e të shëndetshme	Gjendje kritike e disa monumenteve, objekt i vizitës së turistëve
Objekte dhe vendbanime arkeologjike prehistorike	Ndërgjegjësim i dobët i komunitetit për ruajtjen e vlerave kulturore në zonat e tyre.
Objekte kulti, kisha me vlera të veçanta artistike dhe turistike etj;	Objekte kulturore të mbyllura për vizitorët
Pamje arkitekturore tradicionale (shtëpi karakteristike të ndërtuara me gurë)	Ndotje e brendshme e fshatrave nga mbetjet shtazore;
Mundësi për aktivitete sportive (ski në fshatin Dardhë & Voskopojë, peshkim në liqenet e Prespës dhe në atë të Pogradecit,	Mungesë e ujit të pijshëm në disa prej tyre;
Ngjarje kulturore dhe festa fetare lokale, organizim panairësh, karnavalesh (si në Polenë), serenatën korçare;	Mungesë e standardeve dhe cilësisë së shërbimit në disa njësi akomodimi dhe ushqimi;
Punime artizanati, punime dore, druri dhe guri, etj;	Mungesë e tregjeve për ekspozimin dhe shitjen e produkteve tradicionale të zonës;
Gastronomi e larmishme me gatime tradicionale;	Mungesë e dyqaneve të suvenireve dhe simboleve identifikuese të zonave të qarkut.
Turizëm qytetar, me mundësi për zhvillimin e konferencave, seminareve dhe ngjarjeve kulturore, etj;	
Mikpritje dhe qytetari ndaj vizitorëve dhe turistëve;	

Një numër fshatrash dhe qytezash, që e kanë bazuar zhvillimin e komunitetit të tyre në turizëm, u ka sjellë atyre përfitime ekonomike dhe sociale.

Lidhur me këtë, rastet e qyteteve dhe fshatrave më trashëgimi të përbashkët, si rasti Voskopojë-Vithkuq-Dardhë, duhet të mbrohet me rregullore dhe vendime të veçanta duke krijuar një rrjet të fshatrave kulturore në Shqipëri. Promovimi i vlerave të tyre si një produkt i përbashkët i trashëgimisë kulturore, menaxhimi, mundësimi i investimeve në infrastrukturë dhe shërbime turistike, do të ndihmojë në integrimin e tyre në rrjetin e fshatrave kulturore Evropianë.

5.1.2 Tregjet turistike ekzistuese dhe potenciale që vizitojnë qarkun e Korçës

Vitet e fundit, fokusimi në sektorin e turizmit ka ardhur gjithmonë duke u rritur dhe kjo është favorizuar nga iniciativat e organizatave ndërkombëtare, që kanë operuar në fushën e turizmit, si edhe materialet e shumta promovuese të vlerave të qarkut (guida, publikime, website). Nuk mund të jepen të dhëna të sakta për prurjet turistike dhe origjinën e tyre, pasi mungojnë evidenca apo studime të mirëfillta në këtë sektor. Sipasurvejimeve dhe informacioneve nga njësitë akomoduese dhe shërbimet e tjera në sektorin turistik, dëshmohet se rritja e numrit të vizitorëve, në veçanti turistëve të huaj, është shoqëruar edhe me larminë e origjinës së tyre.

Krahas trashëgimisë së pasur kulturore, prania e trashëgimisë natyrore i rrit avantazhet e hapësirës gjeografike për të tërhequr vizitorët. Në të gjitha zonat e vizitueshme të saj, mjedisi gërsheton elementet e natyrës si: liqenet, parqet, format interesante të relievit me kishat, manastiret, banesat karakteristike prej guri, rrugicat me kalldrëm, stilin e veçantë të jetesës, etj. Për të evidentuar tregun e turistëve që vizitojnë qarkun, do t'i referohemi gjithashtu disa studimeve të bëra nga organizatat SNV dhe GIZ, që kanë operuar në fushën e turizmit. Nga anketimi i kryer nga SNV-ja, në vitin 2011 mbi vizitorët që vijnë në qarkun e Korçës, rezultoi 83 % e të ardhurve janë nga Shqipëria dhe 17% janë turistë të huaj apo ndërkombëtare të ardhur nga vende të ndryshme të botës²⁴². Në qoftë se do të bënim një grupim të kategorive të vizitorëve dhe turistëve të huaj do të evidentonim :

Grupi i vizitorëve vendas, si grupi më i madh i vizitorëve,²⁴³ (75% të vizitorëve) përbëhet nga të gjithë shqiptarët kudo që jetojnë në Shqipëri, i pranishëm jo vetëm në stinën e verës, por edhe në dimër, pra gjithëvjetor. Pjesa më e madhe e tyre vijnë kryesisht nga Tirana, Elbasani,

²⁴²Ekonomia e vizitorit SNV, 2011

²⁴³Ekonomia e vizitorit SNV, 2011

Durrësi, në drejtim të qytetit të Pogradecit (kryesisht në verë për pushime), Korçës, Voskopojës dhe Dardhës. Ky grup vizitorësh të pavarur qëndron në këto zona më shumë se një ditë, i tërhequr kryesisht nga turizmi i plazhit dhe natyrës dhe pjesërisht ndaj objekteve kulturore. Po kështu ky grup përbën edhe numrin më të madh të vizitorëve të pranishëm në festën e birrës dhe në festime të tjera gjatë vitit.

Vizitorët shqiptarë etnikë, që jetojnë në diasporë (SHBA, Kanada, Australi), janë gjithashtu një grup vizitorësh interesantë, me tërheqje drejt vendlindjes apo vendit të paraardhësve të tyre. Në vizitat e tyre ata tërhiqen kryesisht ndaj atraksioneve kulturore dhe lidhjes me kulturën shpirtërore. (traditat, zakonet, festimet etj)

Tregu i turistëve të huaj, është pjesë e grupit të turistëve të huaj që vizitojnë Shqipërinë. Përbëhet nga turistë që vijnë nga Ballkani, kryesisht grekë dhe maqedonas; nga Evropa Lindore: bullgarë, polakë, çekë dhe turistë nga Evropa Perëndimore: francezë, anglezë, gjermanë, italianë, austriakë. Në shumicën e rasteve këta e vizitojnë Korçën nëpërmjet agjencive turistike, si pjesë të turit të tyre nëpër Shqipëri.

Në tregun e turistëve të huaj bën pjesë një *grup turistësh të pavarur*, që udhëtojnë individualisht. Përzgjedhja e destinacionit nga këta bëhet nëpërmjet internetit apo materialeve të tjera promovuese. Ngaurvejimi i bërë mbi këtë kategori turistësh dhe motivet kryesore të vizitës së tyre, vendin kryesor e zënë *motivët kulturore*. Ky është gjithashtu një grup i larmishëm, me origjinë nga vende të ndryshme të botës, veçanërisht nga Evropa. Përmenden këtu edhe turistët që vijnë nga kontinentet e largëta si Amerika dhe Austalia.

Përveç këtyre grupeve kryesore në qarkun e Korçës janë të pranishëm edhe grupe turistësh që e vizitojnë destinacionin për motive të tjera kulturore, (seminare, konferenca) motive biznesi etj. Po kështu një grup tjetër vizitorësh janë grupet e nxënësve të shkollave dhe studentëve të universiteteve. Këta të fundit në disa raste janë pjesë e ekspeditave mësimore nga vendi por edhe më gjerë.

5.2 Institucionet dhe aktorët e menaxhimit të trashëgimisë kulturore

Ratifikimi i konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore si edhe miratimi i legjislacionit kombëtar përkatës, mund të konsiderohen si hapat e parë për menaxhimin e trashëgimisë kulturore. Suksesi i menaxhimit është i lidhur me zbatimin e legjislacionit nga institucionet përkatëse dhe aktorët e tjerë të angazhuar në këtë proces.

Institucionet shtetërore që kanë përgjegjësinë dhe detyrimin ligjor për menaxhimin e trashëgimisë kulturore janë institucionet qendrore dhe ato vendore në nivel qarku dhe lokal. Krahas këtyre përfshihen edhe institucionet kërkimore-shkencore, organizmat kombëtarë dhe ndërkombëtarë që operojnë në fushën e trashëgimisë dhe shoqëria civile.

Institucionet qendrore përbëjnë hallkën e parë të menaxhimit të trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore. Ministria e Kulturës është institucioni më i lartë, që vepron në fushën e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë.²⁴⁴ Për sa i përket trashëgimisë kulturore, ajo ka detyrimin ligjor në hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore për mbrojtjen e saj dhe përcaktimin e drejtimeve të zhvillimit që lidhen me të. Ministria e Kulturës është institucioni përgjegjës për përgatitjen e strategjive, politikave dhe planeve të veprimit në nivel kombëtar dhe vendor. Po kështu nëpërmjet institucioneve të tjera qendrore dhe drejtorive të varësisë, mundësohet zbatimi i tyre për menaxhimin e kategorive të trashëgimisë kulturore. Të gjitha ndërhyrjet që bëhen në zonat historike dhe monumentet e kulturës, menaxhohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës. Po kështu Agjencia e Shërbimit Arkeologjik është institucion qendror që merret me kryerjen e gërmimeve arkeologjike dhe administrimin e tyre, në të gjithë territorin e vendit. Krahas këtyre Drejtoria e Arkivave luan një rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe menaxhimin e fondit të trashëgimisë së dokumentuar. Për organizimin e punës në nivel qarku Drejtoritë Rajonale të Kulturës Kombëtare në varësi të Ministrisë së Kulturës, merren me menaxhimin e trashëgimisë kulturore brenda njësisë së tyre territoriale.

Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë, ka si qëllim të punës së saj menaxhimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë së qarkut Korçë. Ndërsa menaxhimi i objekteve kulturore kryhet me fondet buxhetore të akorduara me procedurë tenderimi, drejtoria në rolin e supervizorit menaxhon anën teknike apo arkitekturore, në përputhje me kriteret ligjore të monumenteve të kulturës. Për nevojat konkrete që kanë monumentet, hartohen projekte të cilat përpunohen në Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare dhe miratohen në Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe në Këshillin Kombëtar të Restaurimit, si organ vendimmarrës.

Muzeu i Artit Mesjetar është institucion vendor në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrisë së Kulturës. Roli i tij konsiston në konservimin, menaxhimin dhe promovimin e vlerave që mbart.

Vlen për të theksuar fakti se monumentet kanë nevoja imediate, për ndërhyrje të shpejtë, por procedurat e zgjatura të tenderimit jo në pak raste shkaktojnë vonesa në ndërhyrje.

²⁴⁴ www.kultura.gov.al faqja zyrtare

Aktualisht janë në procedura rikonstruksioni dhe restaurimi shumë objekte kulti, të cilat vuajnë nga dëmtime të kohës. D.R.K.K.Korçë mbulon në ruajtje me persona përgjegjës objektet si; kishat e Voskopojës, kishat e Vithkuqit, Bazilikën e Linit dhe zonën e Prespës. Për objektet e tjera është e pamundur mbulimi me roje, nisur edhe nga vendndodhja e tyre në zonat e thella malore dhe mundësitë e kufizuara financiare të institucionit.

Menaxhimi konsiston edhe në masat e marra nga institucionet e mësipërme për vënien në gatishmëri të objekteve të vizitueshme sidomos gjatë sezonit turistik. Shumë prej objekteve kulturore të vizitueshme janë publikuar në internet me vendndodhjen dhe historikun përkatës, çka krijon më shumë mundësi për njohjen e vlerave kulturore dhe historike të tyre. Gjatë sezonit turistik janë në gatishmëri kishat në zonat e Voskopojës, Vithkuqit, Prespës, bazilika e Linit, Varret e Selcës në rrethin e Pogradecit dhe shumë prej objekteve monumentale në qytetin e Korçës. Në monumentet e vizitueshëm personat përgjegjës të punësuar nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë, kujdesen që ato të jenë të hapura për vizitorët, megjithëse në disa raste kjo nuk realizohet.

Krahas institucioneve përgjegjëse në menaxhimin e trashëgimisë kulturore, *njësitë e qeverisjes vendore, bashkitë dhe komunat*, janë gjithashtu të angazhuara në mbrojtjen dhe menxhimin e objekteve kulturore që ndodhen në territorin e tyre. Rasti i Tumës së Kamenicës që menaxhohet nga komuna Mollaj²⁴⁵, muzeu Historik i qytetit të Ersekës, objekte kulturore në qytetin e Korçës të cilët janë në administrim të Bashkisë etj.

Institucionet kërkimore-shkencore, për vet kategorizimin e trashëgimisë kulturore përfaqësohen që nga Universiteti i Tiranës me Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, programet e studimit Histori dhe Gjeografi, Instituti për kërkimet historike etj., të cilat merren me studimin e vlerave të tyre historike, arkeologjike, turistike etj. Universiteti Fan S.Noli i Korçës disponon Qendrën e Kërkimeve Shkencore dhe Projekteve, e cila angazhohet në projektet që zhvillohen në qarkun e Korçës, përfshi ato kulturore dhe turistike.

Krahas rolit që luajnë institucionet ligjore dhe ato të angazhuara, në menaxhimin e trashëgimisë kulturore të qarkut të Korçës, një rol të rëndësishëm duhet të luajë edhe *komuniteti lokal*. Ndonëse komuniteti është i ndërgjegjshëm për praninë e objekteve kulturore në

²⁴⁵Menaxhimi i kësaj pasurie, bëhet nga njerëz të apasionuar dhe aspak të vlerësuar. Mungesa e vizionit të pushtetit lokal, për t'a shndërruar në një burim të ardhurash për komunitetin, vë në dyshim efektivitetin e varësisë së plotë të monumenteve të kulturës, nga njësitë vendore.

destinacion, shkalla e ndërgjegjësimit të tij për mbrojtjen e vlerave të tyre jo vetëm si pjesë e identitetit lokal, por edhe për vënien në funksion të turizmit është ende e ulët.

5.3 Monitorimi i gjendjes aktuale të menaxhimit të trashëgimisë kulturore në qarkun e Korçës

Menaxhimi i trashëgimisë kulturore po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm jo vetëm për ruajtjen, por edhe për vet rritjen e interesit turistik në drejtim të saj. Para së gjithash, prezantimi dhe cilësia e ofruar për turistët duhet të përmbushë pritshmëritë dhe kënaqësitë e tyre dhe kjo duhet të konsiderohet gjithmonë e rëndësishme. Megjithëse nuk ekzistojnë plane apo strategji konkrete për menaxhimin e trashëgimisë kulturore, në qarkun e Korçës po ndërmerren plane veprimi për zhvillimin e zonave që ofrojnë këtë potencial. Ruajtja e monumenteve të kulturës si dhe ndërhyrjet restauruese, janë ndër angazhimet kryesore të aktorëve të menaxhimit të trashëgimisë kulturore.

Nga monitorimi i gjendjes aktuale të menaxhimit të monumenteve të kulturës në hapësirën e studimit, vihet re rritja e interesit të aktorëve të përfshirë në këtë proces dhe organizmave të huaja, për mbrojtjen e monumenteve në zonat me trashëgimi të pasur si dhe në restaurimin e objekteve të dëmtuara. Është për t'u përmendur menaxhimi që i bëhet sot Voskopojës. Voskopoja si qendër historike zhvillohet sipas një plani rregullues të miratuar nga KKRRT e Shqipërisë, plan në të cilin janë miratuar zonat e ndërtimit, zonat e gjelbra, rrugët etj. Lidhur me këtë është hartuar një rregullore nga Instituti i Monumenteve të Kulturës për përcaktimin e ndërtimeve me gur, çatitë gri, rrugët me kalldrëm etj. Në këtë kuadër janë miratuar projektet për shtrimin e dy rrugëve me kalldrëm dhe ka filluar zbatimi i tyre. Nga viti 2000 e në vazhdim, Voskopoja për shkak të vlerave dhe statusit që mbart, është vënë në qendër të projekteve qeveritare dhe atyre të financuara nga Komuniteti Evropian. Interes në këtë drejtim kanë paraqitur organizmat dhe shoqatat e huaja jofitimprurëse, që operojnë në qarkun e Korçës.

Ajo është regjistruar nga UNESCO, si një nga trashëgimitë botërore në rrezik dhe si e tillë është vënë në qendër të programeve dhe projekteve për ruajtjen e vlerave që mbart. Në bashkëpunim edhe me shoqatën franceze “Patrimoine sans Frontieres”, “Trashëgimia pa kufi”, u restaurua kisha e Shën Thanasit dhe lidhur me këtë u botua vepra “Sikstina e Ballkanit”. Konkretisht komuna Voskopojë ka zbatuar “Planin Strategjik të Zhvillimit të Komunës Voskopojë 2005-2010”, zbatimi i të cilit solli ndryshime të dukshme në zhvillimin ekonomik

dhe social të komunitetit. U ndërtua rruga nacionale Voskopojë-Voskop me impakt të dukshëm në rritjen e numrit të vizitorëve, u krye rrjeti i kanalizimeve të ujërave, u ndërtua rezervuari i Gjonomadhut që ndikoi në rritjen e sipërfaqes së ujitur, u mbollën pemëtoje të reja dhe u përmirësua mekanizmi i farave etj.

Në planin strategjik “Për zhvillimin afatgjatë e të integruar të Komunës Voskopojë”, përveç infrastrukturës dhe mjedisit një vend të rëndësishëm zë ndërhyrja për zhvillimin e kulturës së saj. Në zbatim të këtij plani në Voskopojë, me financim të Komisionit Evropian u ndërmor një program mbështetës zhvillimi nga dy shoqata (FERT&ADAD) me drejtime prioritare bujqësinë, turizmin dhe vlerësimin e trashëgimisë (2008-2012). Në këtë vlerësim përveç kishave, programi konsistoi edhe në zhvillimin e vlerave artistike, artizanatit etj. Një grup i trajnuar artizanësh të punimeve të dorës, të leshit në vegël, shtija, grep, i promovon këto vlera në shërbim të kërkesave turistike. Programi bëri të mundur gjithashtu, ngritjen e një qendre të informacionit turistik, dhe pajisjen e hapësirës turistike me sinjalistikën e nevojshme turistike. Në fushën e turizmit u bënë promovime të vlerave nëpërmjet prodhimit të guidave dhe materialeve të tjera promovuese si edhe u trajnuan grupet e interesit që ofrojnë turizmin familjar. Është rikthyer tradita e hershme e organizimit të panairit në festën e Shën Prodhomit në 24 Qershor, në të cilin promovohen gjithë produktet tradicionale të Voskopojës.

Nisur nga ecuria e dukshme e zhvillimit të territorit si hapësirë turistike, përmirësimet e bëra në jetën social-ekonomike të komunitetit, rritja e numrit të vizitorëve në zonë, potencialet natyrore dhe kulturore që mbart si dhe nga interesi i institucioneve brenda dhe jashtë vendit, qendrore dhe lokale, për të investuar projekte zhvillimi në Voskopojë, qeverisja lokale ka hartuar Planin Strategjik të Zhvillimit të Territorit 2012-2020. Ky plan përfshin të gjithë sektorët e zhvillimit, infrastrukturën dhe planin urbanistik trashëgiminë historike dhe kulturore, duke evidentuar potencialet dhe gjendjen aktuale për çdo njërin prej tyre. Gjithashtu janë përcaktuar nivelet e ndërhyrjes dhe aktorët bashkëpunues si dhe rezultatet që priten. Vizioni i përcaktuar: “*Të mbështetemi mbi forcat e së kaluarës së Voskopojës për të ndërtuar të ardhmen*”.²⁴⁶

Voskopoja është një rast konkret zhvillimi që e bën më se të domosdoshme nevojën e investimeve nga qeverisja qendrore, kryesisht në infrastrukturën rrugore, ndërkohë që në të, janë duke u zbatuar projekte të rregullimit të territorit të brendshëm të saj nga organizma të

²⁴⁶ Strategjia “Drejt zhvillimit të integruar të territorit Voskopojë 2012-2020” Komuna Voskopojë.

huaja. Pra për një zhvillim të qëndrueshëm të territorit të saj, mendojmë se është i rëndësishëm koordinimi i projekteve lokale me projekte qeveritare në zonë.²⁴⁷

Organizma të tjerë ndërkombëtare SNV (Organizata Hollandeze për Zhvillim) ka hartuar Strategjinë e Marketingut të Produktit Turistik të Rajonit të Korçës, me një theks të vecantë në zhvillimin e kulturës. Po kështu GIZ ("Deutsche Gesellschaft für internationale Zusammenarbeit") ka ndërmarrë veprime konkrete për zhvillimin dhe promovimin e produktit kulturor në funksion të zhvillimit të turizmit. Nëpërmjet planeve të veprimit konkret GIZ ka kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës turistike të akomodimit në zonat rurale kulturore, Voskopojë, Vithkuq, Dardhë. DMO (Management Destination Organization) ka ndihmuar gjithashtu në promovimin e vlerave kulturore të rajonit të Korçës duke mundësuar edhe ngritjen e Zyrës së Informacionit Turistik në qytetin e Korçës.

Për promovimin e vlerave kulturore në qarkun e Korçës janë prodhuar gjithashtu, një sërë materialesh promovuese nga agjenci dhe organizata të ndryshme si: Guida turistike-kulturore e qytetit të Korçës, Pogradecit, Dardhës, Vithkuqit, Liqenasit, Voskopojës, fletëpalosje të pikave të ndryshme si: Tuma e Kamenicës, Kisha e Shën Gjergjit Shpëskë, Teqeja e Qesarakës etj. Ekzistojnë disa website, që përshkruajnë vendet turistike si dhe shërbime të ndryshme, të lidhura me tre zonat kryesore, qytetin e Korçës dhe rrethinat përreth, qytetin e Pogradecit dhe zonën e Kolonjës, të cilat listojnë vendet turistike-kulturore dhe arkeologjike, shërbimet (akomodimet, baret, restorantet) dhe adresat e tyre respektive, harta treguese dhe mjaft informacione të tjera të dobishme. Po kështu janë ngritur zyra të informacionit turistik në qytetet Korçë, Pogradec dhe në fshatrat Voskopojë, Dardhë, Goricë e Vogël dhe Zagradec.

Krahas ruajtjes për të shmangur dëmtimet në monumentet e kulturës, veçanërisht i domosdoshëm është procesi i restaurimit. Kështu mund të përmendim rindërtimin e kishës së Lubonjës në vitin 2012 me një vlerë prej 4 milion lekë të reja, të akorduara nga buxheti i shtetit. Në gusht të vitit 2013 ka përfunduar restaurimi i kishës së Shën Mihalit në Vithkuq, me një donacion të Mitropolisë dhe restaurimi i Kishës së Shën Triadhës në fshatin Tudas të komunës Lekas, e cila ishte krejtësisht e shkatërruar. DRKK ka hartuar gjithashtu projekte restaurimi të shoqëruara me preventivat përkatës të miratuara nga Ministria e Kulturës dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës, për objektet e trashëgimisë kulturore që kanë nevojë për ndërhyrje.

²⁴⁷ Menkshi, E., & Miçi, A., 2012, Kontributi i gjeografisë në rregullimin e territorit-rasti Voskopojës, Studime albanaologjike IV, Tiranë, f.

(kisha e Ristozit, Mborje etj.) Restaurimi dhe rehabilitimi i objekteve të trashëgimisë kulturore krahas ruatjes së tyre, ka një impakt të rëndësishëm në krijimin e vendeve të punës dhe rritjen e të ardhurave të familjeve lokale.

Për mbrojtjen dhe menaxhimin e objekteve të trashëgimisë kulturore krahas mbështetjes ligjore dhe institucionale, është i rëndësishëm edhe procesi i edukimit dhe ndërgjegjësimit të mbarë shoqërisë. Veçanërisht e rëndësishme konsiderohet pjesëmarrja e komunitetit dhe të rinjve në këtë proces. Mënyra më e mirë për të rritur interesin e të rinjve është kontributi i tyre konkret në promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, nëpërmjet organizimit të workshop-ve, prezantimeve, punëve krijuese dhe punës vullnetare për mirëmbajtjen e monumenteve të kulturës në territorin e tyre. Mediat, organizatat jo fitimprurëse dhe të gjithë aktorët e tjerë të interesuar rreth trashëgimisë kulturore kanë gjithashtu një rol të rëndësishëm në këtë drejtim.

5.4 Probleme aktuale të trashëgimisë kulturore dhe turizmit kulturor

Analiza e situatës aktuale dhe paraqitjes së gjendjes në të cilën ndodhen objektet e trashëgimisë kulturore është mjaft e rëndësishme jo vetëm për ruajtjen e saj por edhe për zhvillimin e zonës në të cilën ndodhen. Lidhur me objektin tonë të studimit për integrimin e trashëgimisë kulturore në funksion të zhvillimit social-ekonomik, nëpërmjet përdorimit turistik, po prezantojmë disa probleme të evidentura nga analiza e anketimeve me turistët e huaj.

Mungesa e një strategjie të zhvillimit në nivel qarku, ku duhet të përfshihet ngritja e infrastrukturës së nevojshme në shërbim të objekteve dhe vlerave kulturore, si dhe një strategjie të zhvillimit ekonomik duke shfrytëzuar vlerat ekzistuese, është faktori tjetër dhe ndoshta edhe më i rëndësishëm në ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Probleme të marketingut dhe promovimit të turizmit në qarkun e Korçës, të cilat lidhen me, mungesën e materialeve promovuese (guida, harta etj.) për objekte dhe zona të veçanta kulturore. Është për t'u theksuar fakti se materialet ekzistuese përmbajnë përshkrime të gabuara dhe që nuk paraqesin gjenden ekzistuese të objekteve. Kjo në mjaft raste krijon zhgënjim tek turistët. Informacioni ndaj turistëve për gjithë qarkun, ofrohet vetëm nëpërmjet Zyrës së Informacionit Turistik në qytetin e Korçës. Po kështu mungesa apo përfshirja minimale e zonave kulturore, në paketat turistike vendase dhe ato të rajonit ndikon negativisht në njohjen e

vlerave të destinacionit dhe prurjet e vogla të turistëve. Mungon gjithë përfshirja e aktorëve të interesuar në këtë proces.

Probleme me infrastrukturën rrugore. Mungesa e infrastrukturës rrugore dhe cilësia e dobët e saj në zonat malore të qarkut, përbën një pengesë për njohjen e objekteve dhe elementëve të tjerë kulturore nga turistët. Lidhur me këtë, është i nevojshëm angazhimi i institucioneve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal për përmirësimin e rrugëve rurale dhe urbane, në funksion të zhvillimit të turizmit. Largësia nga aeroportet dhe portet, gjendja jo e mirë e rrugëve, i demotivon turistët për ta përfshirë zonën e Korçës në turet e tyre turistike. Ndërtimi i aeroportit në fushën ekzistuese do të rriste fluksin e turistëve në zonë. Përmirësimet janë të nevojshme edhe në sinjalistikën rrugore dhe turistike, që në mjaft raste është inekzistente.

Probleme të infrastrukturës turistike. Njësitë e akomodimit në qarkun e Korçës nuk kanë një standard kualifikimi mbi bazën e shërbimeve që ofrojnë. Tendencia e njërive të akomodimit në zonat rurale kulturore po priret drejt hoteleve të mëdha, me çmime të larta, ndërkohë që sipas kërkesave të turistëve të huaj, preferohen hotele të vegjël dhe shtëpi fshati me çmime kundrejt shërbimit. Po kështu një problem i evidentuar është mëngjesi i varfër (llojshmëria) i servirur në hotele. Sipas pretendimit të turistëve “jo dhoma të mëdha, por mëngjes të bollshëm”.

Probleme të bashkëpunimit të sektorit publik-privat. Nga anketimi me njësitë turistike konstatohen mungesa të politikave stimuluese për bizneset, që operojnë në fushën e turizmit. Është shumë i domosdoshëm krijimi i kushteve lehtësuese, gjë e cila do të sjellë rritjen e investimeve në këtë sektor. Duhet të hartohen plane bashkëpunimi dhe strategji, mbi drejtimet konkrete të investimeve në këto sektor, në mënyrë që të sigurohet zhvillimi i qëndrueshëm i tyre.

Probleme lidhur me tërheqjen turistike drejt destinacionit të Korçës. Ashtu sikurse u evidentua nga analiza e anketimit me turistët e huaj, interesi dhe numri i tyre është duke u rritur. Kjo rritje nuk mund t’i lihet spontanitetit, por duhet të menaxhohet nga institucionet përkatëse, me qëllim inkurajimin e interesit të tyre nëpërmjet organizimit të festave dhe eventeve të shumta sidomos gjatë sezonit turistik të verës, kur edhe prania e tyre është më e madhe. Po kështu e rëndësishme është ruajtja e origjinalitetit të festimeve dhe mirëorganizimi i

tyre, duke patur parasysh faktin se turisti kulturor është i prirë ndaj tradicionales dhe diversitetit.

Për t'u evidentuar është mungesa e dyqaneve të suvenireve apo produkteve të tjera kulturore identifikuese të trevave të qarkut. Çdo turist largohet pa marrë një suvenir apo një kujtim të Korçës apo zonës turistike që viziton. Po kështu vlen për t'u përmendur mungesa e promovimit dhe paketimit të produkteve karakteristike, artizanale, suvenire etj. Është më se i nevojshëm krijimi i një brandi unik për produktet turistike tradicionale të qarkut.

Për një zhvillim të qëndrueshëm dhe efektiv përdorimi i trashëgimisë kulturore si bazë për zhvillimin e turizmit kërkon plane sinjifikante, që të përfshijnë si aspektin ekonomik ashtu edhe atë të ruajtjes së saj.

5.5 Përvoja e huaj. Dobia studimore e përvojave të huaja

Në shumë vende sot në botë investimet në ruajtjen e trashëgimisë kulturore janë të lidhura me promovimin e saj për zhvillimin e turizmit. Duke e konsideruar integrimin e trashëgimisë kulturore si një element të rëndësishëm për zhvillimin social-ekonomik rajonal dhe lokal, po evidentojmë disa raste të përdorimit të suksesshëm në praktikat ndërkombëtare urbane dhe rurale.

Kështu në Evropë, Italia me Romën, Firencën, Venecian; Franca me Parisin, Marsejën, Lionin, Spanja me Madridin, Barcelonën, Gjermania me Mynihun, Frankfurtin, Nurenbergun, Greqia me Athinën, Selanikun tërheqin çdo vit dhjetëra e qindra milionë turistë.

Analizat e studiuesve të huaj, evidentojnë qasje të ndryshme, të përdorimit të trashëgimisë kulturore në zhvillimin rajonal dhe lokal, për vende të ndryshme. Rastet e trajtuara më poshtë janë përzgjedhur duke ju referuar disa karakteristikave të ngjashme me hapësirën tonë të studimit.

Për t'u evidentuar është rasti i qyteteve të Gjermanisë Lindore pas viteve 1990, ku mbrojtja e trashëgimisë dhe përdorimi i saj në zhvillimin e turizmit, u bë në përputhje me ruajtjen dhe rehabilitimin e strukturave historike urbane. Nëpërmjet një investimi të Ministrisë Federale të Transportit, Ndërtimit dhe Zhvillimit Urban dhe Zyrës Federale për Ndërtimin dhe Planifikimin Rajonal, programi i investimeve përfshiu 10 qytete të Gjermanisë Lindore (Programm

Städtebaulicher Denkmalschutz).²⁴⁸ Qytetet e përzgjedhura në pesë shtetet federale ishin Stralsund, Wismar dhe Malchow në Mecklenburg-Vorpommern; Neuruppin dhe Potsdam në Brandenburg; Tangermünde dhe Quedlinburg in Saxony-Anhalt; Görlitz dhe Zittau in Saxony; dhe Mühlhausen in Thuringia.

Në vitin 2005 nga qarkullimi i përgjithshëm i turizmit u gjeneruan rreth 1 miliard € nga vizitorët vendas dhe ata me mbi një natë qëndrimi në qendrat e akomodimit të ngritura në dhjetë qytetet. Rreth 13% ose 130 milion € ishin të dhëna me mbrojtjen e strukturave historike urbane. Megjithatë rrizhvimimi nuk do të mund të konsiderohej pa elementët kyç të ofertës së turizmit si: atë të akomodimit, tregtisë me pakicë, ofertës së mirë të gastronomisë, kulturës dhe ofertës argëtuese etj. Për më shumë kjo u vlerësua edhe nëpërmjet rritjes së interesit të turistëve për hotelet dhe qendrat e tjera historike të akomodimit. Efektet pozitive të programit për mbrojtjen e strukturave historike urbane në zhvillimin e turizmit mund të konsiderohen të padiskutueshme në studimin e këtij rasti edhe nëpërmjet rezultateve të tjera që u evidentuan.

Në Angli projektet kërkimore janë fokusuar në qëndrimin e publikun në drejtim të trashëgimisë kulturore, duke ndjerë realisht përfitimet sociale dhe ekonomike që vijnë prej saj. Nëpërmjet krijimit të fondit të trashëgimisë (Heritage Lottery Fund's Strategy) u kryen investime të reja në një gamë të gjerë të trashëgimisë kulturore me ndikim të përhershëm në vende dhe njerëz. Një prej rasteve ku u aplikua ky model, ishte Barnsley një qytet i vogël në një zonë metropolitane në Yorkshirin jugor, që mbulon një sipërfaqe prej 320 km², me popullsi 218 mijë banorë (82 000 në qytet)²⁴⁹. Pas mbylljes së industrive në mesin e viteve 1990, ekonomia lokale krijoi shumë vështirësi për jetën e banorëve. Qeverisja vendore në vitin 2002 nëpërmjet një programi të rigjenerimit “remaking Barnsley” mobilizoi 400 000 000 £ investime publike dhe private për rijetëzimin e mjedisit urban. Agjensia e Zhvillimit të Barnsley mbështeti iniciativat krijuese të komunitetit lokal dhe në vitin 2006 u formua një sipërmarrje “Creative Barnsley”, dedikuar sipërmarrësve dhe krijuesve lokalë. Më tej Barnsley ka marrë pjesë në disa rrjete Evropiane të mbështetura nga EU Territorial Cooperation Programmes siç është “Creative Clusters in Low Density Urban Areas” and “Building Healthy

²⁴⁸Dumcke, C., & Gnedovski, M., The social and economic value of cultural heritage, Literature review, EENC Paper, July 2013, f.92 Michaelis-Winter, A. and Ruland, R. (eds.) (2007): Städtebaulicher Denkmalschutz und Tourismusentwicklung unter besonderer Berücksichtigung der UNESCO – Welterbestädte. www.eukn.org/dsresource?objectid=218283

²⁴⁹Creative-based strategies, Some European Case Studies: Comparison, Dumcke, C., & Gnedovski, M., The social and economic value of cultural heritage, Literature review, EENC Paper, July 2013

Communities”. Krahas të tjerave i rëndësishëm gjithashtu është dhe sektori i ushqimit dhe pijeve, një bazë e fortë kërkimi që punëson një numër të madh njerëzish. Qyteti tashmë siguron kalimin e kohës së lirë dhe aktivitete kulturore.

Modeli i Japonisë lidhur me përdorimin e trashëgimisë kulturore në zhvillimin social-ekonomik lokal dhe rajonal, në qytetet e vegjël dhe të mesëm, bazohet kryesisht të bashkëpunimin e sektorit publik në atë privat.

Në Japoni përmes studiueses japoneze Tolina Loulanski përmenden disa shembuj të suksesshëm ku ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe rihvillimi urban, janë integruar suksesshëm në zhvillimin lokal, në veçanti në rastet e qyteteve të mesëm dhe të vegjël²⁵⁰. Qyteti i Nagahamës i ndërtuar që në shekullin e 16, ndodhet në Prefekturën e Shigës, me një popullsi prej 50 000 banorë. Gjatë viteve 1980 qyteti u përfshi nga rënia ekonomike. Në vitin 1988 nëpërmjet një projekti bashkëpunimi midis sektorit publik dhe privat u tentua rimëkëmbja ekonomike përmes rehabilitimit të trashëgimisë kulturore dhe inkurajimit të krijimit të një industrie kulturore. Ruajtja e një ndërtese tradicionale të periudhës Meji (1868-1912) e miratuar për prishje në vitin 1987 shënoi nisjen e një projekti ambicioz. Këshilli i qytetit së bashku me kompanitë private krijuan një sektor tërë të tretë sipërmarrës me një kapital prej 40 milion jen të dhënë nga qeverisja lokale dhe 90 milion jen të dhënë nga 8 kompani rajonale. Qëllimi ishte të inkurajohej aktiviteti ekonomik i biznesit në promovimin e qytetit, më tepër se në aktivitetet të mëparshme.

Vepra artizanale tradicionale dhe moderne u përdorën në bazën e strategjisë së zhvillimit të qytetit. Shtëpitë e vjetra në qytet u rinovuan dhe u bënë dyqane, restorante dhe muze apo galeri. Tashmë në qendrën e qytetit ndodhen 30 ndërtesa të konvertuara nga strukturat e vjetra banesa, magazine etj. Projekti u kthye në një katalizator për zhvillimin e mëtejshëm kulturor të qytetit, duke tërhequr më shumë njerëz të përfshirë në performimin e arteve dhe eventeve. Ai u bë gjithashtu një bazë për projektet e mëtejshme investuese publik–privat. Për më tepër, iniciativa çoi në krijimin e një qendre për rigjenerimin rajonal në vitin 1998, e cila tashmë operon në mënyrë të pavarur. Qendra funksionon si një urë veprimi midis qeverisjes lokale, dyqaneve (biznesit) dhe qytetarëve duke siguruar informacion dhe koordinuar shërbimet në shumë evente.

²⁵⁰Loulanski, T.,2006, Cultural Heritage in Socio-Economic Development: Local and Global Perspectives, IDEAS, Environments Journal Volume 34(2) 2006, f.57

Mbi të gjitha projekti është bërë i njohur si shembull domethënës i mënyrës në të cilën, restaurimi i trashëgimisë kulturore dhe ripërdorimi mund të kombinohen në një krijimin e një industrie të veçantë kulturore për promovimin e rigjenerimit dhe rijetëzimin urban.

Përpjekjet për rigjenerimin urban në Nagahama u ndërmorën për një periudhë 15 vjeçare. Që nga 1998, pra vetëm një dekadë pas fillimit të projektit, të ardhurat nga shitjet shënuan 900 milion yen dhe vizitorët numëruan 1.8 milion në vit, duke dëshmuar një zgjerim të balancuar të një industrie të rëndësishme kulturore²⁵¹. Opinioni publik lokal është mjaft pozitiv për imazhin e ri rajonal, standardin kulturor, krijimin e zonave të reja turistike, mbrojtjen e mjedisit dhe kontributin në ekonominë lokale. Rajoni i Kurokablesë është kthyer në një zonë të gjallë që vizitohen nga 2 milion turistë²⁵². Shembuj të tjerë analogë studiuesja përmend Kanazaëa, Otaru dhe ishullin Hokajdo me një peizazh unik, histori dhe trashëgimi kulturore, duke kombinuar restaurimin dhe ripërdorimin me zhvillimin e industrisë tradicionale të zejeve dhe artizanatit.

Po kështu raste të tjera të suksesshme mund të përmendim raste të integritit të trashëgimisë kulturore në zhvillimin rural në Irlandën e Veriut, Spanjë, Francë, Portugali etj., duke kontribuar në krijimin e vendeve të punës, shmangien e braktisjes së zonave rurale dhe zhvillimin e integruar rural të tyre.

5.6 Teknologjia e informacionit në menaxhimin e trashëgimisë kulturore të qarkut Korçë

Aplikimi i GIS-it ka gjetur përdorim në fusha të ndryshme si në ato ekonomike (në sferën e biznesit, turizmit, infrastrukturës, menaxhimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, lidhjen mes sferave ekonomike dhe atyre sociale etj.), në ushtri dhe veçanërisht në gjeografi (në analizat hapësinore të dukurive sociale dhe ekonomike) etj. GIS është zgjidhja me kosto më efektive për grumbullimin, menaxhimin dhe analizimin e të dhënave gjeografike dhe hapësinore²⁵³.

Përdorimi i GIS-it për krijimin e gjeo informacionit të trashëgimisë kulturore të qarkut Korçë, ka për qëllim kthimin e të dhënave të secilit objektet kulturor në forma dixhitale dhe të

²⁵¹Loulanski, T.,2006, Cultural Heritage in Socio-Economic Development: Local and Global Perspectives, IDEAS, Environments Journal Volume 34(2) 2006, f.57-58

²⁵²Ky rast dhe raste të tjera të suksesshme të aplikuara në qytetet e vegjël të Japonisë,përbëjnë një model të mire për t'u aplikuar në qytetin e Korçës.

²⁵³Dollma M., Pazari F., Kontributi i gjeografëve në evidentimin, promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, Studime albanologjike, Tiranë 2012, f.294-295

aksesueshme për të gjithë përdoruesit. Ky database dixhital ofron mundësinë e ruajtjes dhe përditësimit në mënyrë të vazhdueshme të të dhënave hapësinore, kulturore dhe historike të monumenteve të kulturës të qarkut.




Figura – Hapat e krijimit të GI të trashëgimisë kulturore të qarkut Korçë

Aplikimi i GIS për trashëgiminë kulturore mbështet planifikuesit dhe menaxherët në procesin e vendimmarrjes, në rastet e projekteve që ndërmerren në kuadër të mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore. Për këtë nevojitet një bashkëpunim midis planifikuesve dhe studiuesve të trashëgimisë kulturore nga njëra anë dhe specialistëve të GIS-it nga ana tjetër.

Për krijimin e gjeoinformacionit dhe të hartave interaktive të monumenteve të kulturës ndiqen disa hapa.






Figura – Ilustrimi i GI të TK të qarkut Korçë (Tuma e Kamenicës, Bazilika e Linit dhe Varret Monumentale të Selcës)




Hapi i parë ka të bëjë me futjen e të dhënave (input) bazë që nevojiten për krijimin e hartave me tematikat përkatëse siç janë: imazhet satelitore të zonës së studimit, harta e ndarjes administrative të qarkut Korçë, koordinatat gjeografike si dhe të dhënat që na nevojiten për krijimin e gjeoinformacionit të trashëgimisë kulturore. *Hapi i dytë* konsiston në përpunimin e këtyre të dhënave nëpërmjet software ArcGIS 10 (gjeoreferencim, përpunim dhe analizim të dhënash). Më tej procesi vazhdon me krijimin e tabelave, ku është futur informacioni përkatës për secilin objekt, dhe lidhja e tyre me të dhënat hapësinore (lokacionin e objekteve në hartë). *Hapi i tretë* është krijimi i gjeoinformacionit për secilën kategori të trashëgimisë kulturore. Pas krijimit të gjeoinformacionit output-i i përfituar janë hartat e secilës kategori të monumenteve të kulturës, të cilat janë harta interaktive dhe përmbajnë të dhënat e përfshira në database. Në figurën e mëposhtme janë ilustruar hapat e krijimit të GI të trashëgimisë kulturore.

Në database është futur informacioni bazë për çdo monument kulture si: tipi i monumentit, emri i monumentit, lokacioni i vendndodhjes (fshati, komuna/qyteti, rrethi), koordinatat gjeografike, periudha kohore, vlerat historike dhe kulturore, arritshmëria, etj. Ky database dixhital është reflektuar në hartën përkatëse, ku çdo objekt i secilës kategori është e lidhur me tabelën që përmban informacionin përkatës. Për të shfaqur gjeoinformacionin e objektit që na nevojitet, mjafton që të klikojmë mbi objekt dhe automatikisht do na shfaqet informacioni përkatës. Figura e mëposhtme ilustron gjeoinformacionin e krijuar për disa objekte të trashëgimisë kulturore (Tuma e Kamenicës, Bazilika e Linit dhe Varret monumentale të Selcës) të qarkut Korçë:



Ky informacion është i aksesueshëm dhe i azhornueshëm në çdo kohë. Për këtë arsyeje ai është i vlefshëm për *aktorët e menaxhimit*, të cilët mund të identifikojnë më me lehtësi vendndodhjen e objekteve dhe informacioneve në lidhje me to. Gjithashtu, nëpërmjet këtij gjeoinformacioni *turistët* gjejnë informacionin e nevojshëm, mbi objektet kulturore që ato dëshirojnë të vizitojnë. Gjeoinformacioni u intereson studiuesve *historianë* dhe *arkeologë* për studimet e tyre, duke ndihmuar me të dhëna në lidhje me periudhën e ndërtimit të objekteve apo informacione të tjera më të hollësishme, në funksion të qëllimit të studimit. Po kështu gjeoinformacioni i trashëgimisë kulturore të qarkut Korçë, jep informacione të përgjithshme hapësinore gjeografike dhe historike, për të gjithë të interesuarit mbi këtë fushë studimi.

I njëjti gjeoinformacion është përgatitur për kategoritë kryesore të monumenteve të kulturës dhe trashëgimisë shpirtërore. Në vijim po paraqesim hartat e monumenteve të kulturës në nivel qarku dhe të ndara sipas rretheve. (harta arkeologjike, arkitekturore, monumenteve të kultit, artistike, etnografike, gastronominë, festave etj.)




– Harta e monumenteve arkeologjike të qarkut Korçë


KALATË E QARKUT KORÇË SIPAS PERIUDHAVE KOHORE





MONUMNETET E KULTIT TË QARKUT KORÇË













Harta – Veshjet popullore, të qarkut Korçë



Harta – Gastronomia e qarkut Korçë



Teknologjia GIS asiston në menaxhimin e trashëgimisë kulturore nëpërmjet krijimit të gjeoinformacionit, i cili është një informacion dixhital dhe i ndihmon aktorët e menaxhimit për lokalizimin më me lehtësi të objekteve të dëmtuara si dhe vlerave që ato përmbajnë. Gjithashtu ky informacion u shërben të gjithë turistëve, vendas dhe në veçanti atyre të huaj, që motivacionin kryesor të lëvizjes turistike kanë atë kulturor. Lehtësia e përdorimit të këtij gjeoinformacionit u jep mundësi që të marrin një informacion të hollësishëm mbi objektet kulturore, si dhe evidentimin e vendndodhjes së tyre duke planifikuar në këtë mënyrë dhe turin e tyre turistik.

KAPITULLI VI: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Nisur nga evidentimi i trashëgimisë kulturore, dalim në përfundimin se qarku i Korçës ka potenciale të konsiderueshme të trashëgimisë kulturore materiale dhe shpirtërore, për t'i integruar në zhvillimin social-ekonomik të tij. Monumentet e kulturës materiale të përfaqësuara nga vendbanime prehistorike, tuma, kala, banesa, objekte fetare të krishtera dhe myslimane, etj., së bashku me elementët e pasur të kulturës shpirtërore (folklori, zejet, traditat, zakonet, festat, mënyra e jetesës, etj.), përpos vlerave në ruajtjen e identitetit kombëtar, rajonal dhe lokal, përbëjnë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit kulturor në këtë qark. Nëpërmjet atraksioneve të larmishme, festimeve dhe gastronomisë tradicionale, qarku i Korçës mund të sigurojë përfitime të dukshme ekonomike, sociale dhe kulturore, nga tërheqja e turistëve në destinacion.

Megjithëse, zhvillimi i turizmit është në fillesat e tij, integrimi i trashëgimisë kulturore në zhvillimin social-ekonomik, mund të konsiderohet një mundësi mjaft e mirë për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës. Larmia e llojeve të turizmit kulturor, urban dhe rural, ka bërë që numri i vizitorëve veçanërisht atyre të huaj, të rritet nga viti në vit, çka sjellë shtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës mbështetëse të shërbimeve turistike të akomodimit dhe ushqimit, si edhe shërbimeve të tjera plotësuese. Qytetet dhe fshatrat kulturore si Korça, Voskopoja, Dardha, Prespa, Vithkuqi, Pogradeci, Boboshtica etj, të përfshira në itineraret e turistëve vendas dhe ndërkombëtarë, kanë ndjerë tashmë efektin e rritjes së të ardhurave të popullsisë lokale dhe bizneseve.

Impakti dhe pritshmëria pozitive e zhvillimit të turizmit të lidhur me trashëgiminë kulturore, është shprehur gjatë anketimeve të zhvilluara me komunitetin e zonës, sipas të cilëve ai përbën një burim të rëndësishëm të ardhurash për familjet e tyre. Po kështu janë shprehur edhe njësitë e biznesit të anketuara, që ofrojnë shërbimet turistike. Nga analiza vlerësohet rritja e të ardhurave të tyre rreth 2-5 herë në sezonin turistik të pushimeve. Interesi i komunitetit dhe njësive të biznesit në drejtim të promovimit të potencialeve të trashëgimisë kulturore, për tërheqjen gjithnjë e më shumë të turistëve në zonë, ka ardhur gjithnjë e duke u rritur. Nga anketimi turistët, shprehin vlerësimin e tyre për trashëgiminë kulturore të zonës. Problematika kryesore që evidentojnë, është infrastruktura e dobët rrugore dhe turistike, si edhe informimi apo orientimi i turistëve. Përballja me mungesën e ciceronëve apo mosfunksionimin e disa

objekteve interesante për t'u vizituar, ka ndikuar në krijimin e zhgënjimeve për sa i përket pritshmërive të tyre turistike.

Ndërsa nga njëra anë interesi turistëve të huaj për potencialet e trashëgimisë kulturore, po vjen në rritje, nga ana tjetër këto objekte po përballen me probleme të shumta, siç janë dëmtimet e shkaktuara nga faktori kohë dhe ai human. Prania e kategorive të ndryshme të objekteve kulturore që i kanë rezistuar kohës, dëshmi i një zhvillimi të qytetëruar të të gjithë qarkut, tashmë shtron nevojën e ruajtjes, ndërkohë që mjaft kërcënuese paraqitet tendenca e zëvendësimit me ndërtime të reja. Menaxhimi që i bëhet sot objekteve të trashëgimisë kulturore, përveç qëllimit të ruajtjes dhe konservimit duhet të synojë edhe rritjen e cilësisë së saj si produkt turistik.

Gjeoinformacioni i trashëgimisë kulturore të qarkut Korçë i krijuar nëpërmjet përdorimit të Software ArcGIS 10, është një informacion dixhital dhe i azhornueshëm. Krijimi i këtij gjeoinformacioni i vjen në ndihmë informimit të turistëve, popullsisë lokale, institucioneve përgjegjëse të menaxhimit të tyre, etj., për njohjen e vlerave historike dhe kulturore, që përmbajnë objektet e trashëgimisë kulturore, si edhe asiston vendimmarrësit në procesin e vendimmarrjes dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore.

Integrimi i trashëgimisë kulturore në zhvillimin social-ekonomik të qarkut të Korçës, përbën një mundësi mjaft të mirë për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës, ndaj duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë si nga ana institucionale por edhe nga studiuesit, sipërmarrësit publik e privat dhe komuniteti. Në përmbyllje të këtij studimi po paraqesim disa rekomandime, për grupet e interesit të përfshira në këtë zhvillim.

Një nga çështjet kryesore, e cila duhet të përcaktohet si prioritet i zhvillimit të qarkut të Korçës, do të ishte hartimi i strategjive dhe planeve konkrete nga institucionet përkatëse qendrore, rajonale dhe lokale për zhvillimin e turizmit kulturor. E lidhur me këtë, është më se i nevojshëm inventarizimi i plotë i potencialit të trashëgimisë kulturore materiale dhe shpirtërore. Kjo do të ndihmonte jo vetëm në sensibilizimin e komunitetit për vlerat e tyre, por do të shërbente edhe si guidë për politikë-bërësit në çështjet e zhvillimit në nivel social, ekonomik dhe kulturor.

Organizmat jo qeveritare kombëtare dhe ndërkombëtare që operojnë në qarkun e Korçës, nëpërmjet projekteve të zhvillimit luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin dhe menaxhimin e potencialeve turistike. Lidhur me këtë, është e nevojshme që projektet e

ndërmarra të synojnë përfitime social-ekonomike afatgjata. Materialet promovuese që përgatiten prej tyre, të prezantojnë me objektivitet dhe profesionalizëm vlerat e zonave që promovohen. Për këtë do të rekomandonim gjithëpërfshirjen në projekte të aktorëve të interesuar dhe specialistëve të fushave. Po kështu bashkëpunimi dhe pjesëmarrja aktive e të gjithë aktorëve, (stakeholders) përdoruesve dhe përfituesve në hartimin dhe zbatimin e projekteve dhe strategjive të zhvillimit të turizmit kulturor, do të rriste ndjeshëm efektivitetin e tyre në zonë dhe komunitet.

Krahas investimeve për ngritjen e kapaciteteve turistike (hotele, bare, restorante, etj), është i nevojshëm edhe trajnimi i stafëve, të cilat përfshihen në shërbimet që ofrojnë njësitë turistike. Konkretisht trajnimet duhet të synojnë shërbimet që kanë të bëjnë me servirjen e ushqimit, shërbimet hotelerike, recepsionin, komunikimin në gjuhë të huaj etj. Shtëpitë për turistët, veçanërisht në qendrat kulturore, duhet të inkurajohen për të reklamuar produktet e tyre tradicionale, me qëllim që turistët të shohin se çfarë u ofrohet, veçanërisht për kuzhinën karakteristike të të gjitha trevave. Përsa i përket hoteleve, ata duhet të rritin frekuentimin vjetor të tyre, jo vetëm duke përmirësuar shërbimin, por edhe duke e reklamuar më mirë atë.

Realizimi i promovimit të trashëgimisë kulturore nëpërmjet organizimit të festave, eventeve, panairove nga ana e sipërmarrjeve lokale (si në zonat urbane ashtu dhe në zonat rurale) do të ndikonte në qëndrimin më të gjatë të turistëve dhe si rrjedhojë, shpenzimet e tyre do të ishin më të larta. Popullsia lokale duhet të jetë pjesëmarrëse aktive në organizimin e eventeve kulturore në zonë e më gjerë duke prezantuar produktet tradicionale të tyre. Po kështu është shumë e rëndësishme pjesëmarrja e komunitetit në promovimin e trashëgimisë kulturore dhe hartimin e strategjive të zhvillimit në nivel lokal dhe rajonal, si përfituesi kryesor nga zhvillimi i turizmit kulturor.

Agjencitë turistike të udhëtimit duhet ta përfshijnë destinacionin e Korçës, jo vetëm në udhëtime një ditore dhe kryesisht tranzit për në jug të Shqipërisë, por duhet të rezervojnë në paketat e tyre kohëqëndrim më të gjatë duke përfshirë edhe zonat rurale. Këto nuk duhet të jenë të rastësishme, por të organizuara sidomos në ditët e festave dhe panairove. Vetëm kështu do të mund të përcillej imazhi pozitiv i zonës tek turistët vendas dhe ndërkombëtar. Mediat kombëtare dhe rajonale duhet të kontribuojnë në promovimin e vlerave kulturore, që qarku i Korçës mbart për zhvillimin e turizmit.

Nga sa parashtroam më sipër, qarku i Korçës me zonat përbërëse të tij mund të konsiderohen si një destinacion turistik në zhvillim. Në këtë këndvështrim imazhi i destinacionit, si rrjedhojë e promovimit të produkteve turistike, është përgjithësisht pozitiv, por ky imazh nevojitet të forcohet dhe më tej, nëpërmjet ruajtjes së trashëgimisë kulturore, koordinimit të sektorit publik dhe privat dhe promovimit real të produkteve turistike. Lidhur me këtë, është e rëndësishme që çdo njësi vendore, që administron potenciale kulturore në territorin e vet, të hartojë plane për mirëmenaxhimin dhe vënien e tyre në funksion të turizmit.

Ky punim përbën një hap në fushën e studimit të trashëgimisë kulturore në këndvështrimin e integritetit të saj në zhvillimin social-ekonomik të një hapësire rajonale apo lokale. Do të ishte me interes, që studimet e tjera në të ardhmen, të përqendrohen në analizën e gjerë të efekteve ekonomike, sociale dhe kulturore, që rrjedhin nga vënia e vlerave të trashëgimisë kulturore në funksion të zhvillimit të turizmit. Turizmi kulturor i konsideruar si një alternativë konkrete zhvillimi, mund të studiohet më gjerë dhe më i thelluar, duke u koordinuar edhe me eksperiencën të tilla zhvillimi nga vendet fqinje apo më gjerë.

BIBLIOGRAFIA

- Adhami, S., Voskopoja e ilustruar; MIRGEERALB; Tiranë 2008; fq.3-51
- Affolter, D. 2001. The tourism marketplace: Neë Challanges. In Tourism and Hospiatlity in the 21st Century. Eds. A. Lockwood and S. Medlik. Oxford: Butterworth – Heinemann.
- Aliu, S., 2012, Tuma e Rehovës, Monografi, Kotti, Korçë, fq.37;
- Aliu, Skënder., 2012, Tuma e Rehovës, Kotti, Korçë, fq.22
- Anamali, S., 1979-1980, Kështjella e Pogradecit, Iliria IX-X, Akademia e Shkencave, Tiranë, fq.214-221
- Anamali, S.,&Adhami, S., 1974, Mozaikë të Shqipërisë, 8 Nëntori, Tiranë, fq.14
- Andrea, Zh., 1970 Andrea Zh; Rezultatet e gërmimeve arkeologjike të vitit 1970; Iliria I, Tiranë 1971, fq 42
- Baker, T. L. (1988). *Doing social research*.
- Bakui, V., 2011, Ekonomia e Turizmit, “Erik”, Tiranë, Fq.16-103
- Ballauri, R., 1978, Mësonjëtorja e parë shqipe e Korçës, Muzeu i Arsimit Kombëtar, Monumente historike në vendin tonë, 8 Nëntori, Tiranë, fq.96-97
- Becherel, L., Strategjia e marketingut dhe zhvillimit të produktit turistik për rajonin e Korçës, 2009, SNV, fq.64
- Beerli & Martin, 2004, cit.në Sérgio Dominique Ferreira Lopesi, Destination image: Origins, Developments and Implications, 2011, PASOS, Vol. 9 N° 2 fq.305-315, www.pasosonline.org
- Bejko, L., 1999-2000, Zakone mortore në bronxin e vonë të Shqipërisë juglindore, Iliria 1-2, fq.129
- Bejko, L., Tuma e Kamenicës, Histori e shkurtër dhe guidë, fq.10
- Belba, A., 2013, Desertacion Gjeografia e sektorit terciar, fq.47
- Bello, M., 2010, Desertacion, Rritja e konkurrueshmërisë në rajonin e Korçës dhe integrimi ekonomik ndërkufitar, fq.14-1-90
- Bilbili, A., 1983, Kapakë ungjilli nga Voskopoja dhe vlerat e tyre artistike; Monumentet 1; “Mihal Duri”, Tiranë,fq.105
- Borrelli, N. 2010. Lessons of Tourism in Sociology
- Butler, R., and P. Jones. 2001. Coclusions, Problems, Challenges and Solutions. In Tourism and hospitality in the 21 st century. Eds. A. Lockwood and S.Medlik. Oxford: Butteworth – Heinemann.

Cernea,M., 2008 , "The Developmental Potential of Cultural Heritage Environments," in Cultural Heritage in the Arab World, edited by Fekri Hassan, Aloisia de Trafford & Mohsen Youssef, fq.126 Alexandria, Egypt2011, fq.11

Connolly, D., And M. Olsen. 2001. An Environmental Assesment of How Technology is Reshaping the Hospitality Industry. *Tourism and Hospitality Research* 3(1): 73-93

Corijn, E. & Mommaas, H.,1995, Urban Cultural Policy Developments in Evrope. Council of Evrope, Strasbourg. cit. në Javier de Esteban Curiel, Cultural Tourism in Spain, dissertation, 2005, fq.2

Dichter, E., 1985, What is an image? *Jurnal of consumerresearch*, Vol.13, fq. 455.

Doka, Dh., 2005, Zhvillime social-ekonomike dhe rajonale të Shqipërisë pas vitit 1990, Potsdam, fq.149

Dollma M., Pazari F., Kontributi i gjeografëve në evidentimin, promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, *Studime albanologjike*, Tiranë 2012, fq.294-295

Dollma, M., 2011, *Trevat Shqiptare*, Dajti 2000, Tiranë, fq.92-93

Doswell, R., 2000, *Tourism How effective the management makes the differences*, Butterworth-Heinemann, London, England, fq.51

Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës AMT(Këshilli i Qarkut Korçë)

Drejtoria e Ndihmës dhe Përkrahjes Sociale Korçë, Relacion 2012, 2013

Drejtoria e Projekteve, Bashkia Korçë

Drejtoria e Statistikës Korçë, Të dhëna statistikore

Drejtoria e Urbanistikës, Bashkia Korçë

Drejtoria Rajonale e Arsimit Korçë, Relacion statistikor 2012, 2013,2014

Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë

Dwyer, L, and C. W. Kim. 2003. Destination Competitiveness: Determinants and Indicators. *Current issues in Tourism* 6(3): 369-413

Dwyer, L. 2003. Cooperative Destination Marketing: Revisiting the Assumed Economic Impacts. *Pacific Tourism Review* 6(2): 95-106

Escobar, A., 1995., *Encountering Development: The Making and Unmaking of the Third World*. Princeton, New Jersey: Princeton University Press, fq 4. (cit. Richtscheid, K., *The Use of Cultural Heritage in Economic and Human Development* fq. 7)

Fooladi, E., Food accepted as culture heritage-food is surely culture, <http://www.fooducation.org/2011/01/food-accepted-as-cultural-heritage-food.html>

Frashëri, Gj., & Dashi, S., 1978, Karakteristika arkitektonike të disa xhamive të vendit tonë, Monumente historike në vendin tonë; “Mihal Duri” Tiranë, fq.42

Free, A. 2000. Information and Communication Technology Research in the Travel and Tourism Domain: Perspective and Direction. Journal of Travel Research 39(November): 136-145

Gibaldi, J., 2003MLA Handbook for writers of research papers, 6th Edition, New York: Modern Language Association of America,2005

GIZ, Korçë

Glenn, J. C., T.J. Gordon eds. 200. State of the Future at the Millennium. American Council for the United Nations University.

Goce Angelicin Zura, 2004, The cave churches in the Ohrid-Prespa region (R.Macedonia, R.Albania, R.Greece) “IRIS”, Struga, fq.190

Goodman, N. and G.T Marx, . 1978,Society Today. 3-rd edition. New York: CRM Roundam House; fq. 79, (cit.Colin J.V.Zyl, The role of tourism in the conservation of cultural heritage with particular relevance for south Africa, (p.h.d.dissertation) 2005, fq.4.)

Graham, Brian, Gregory Ashworth and John Tunbridge; A Geography of Heritage –Power, Culture and Economy; Arnold, London 2000, fq. 2, 157 (cit.në Loulanski 2006, Cultural Heritage in Socio-Economic.....fq.54)

Grup autorësh, Historia e Popullit Shqiptar I, Ilirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë Shek.XVI-vitet 20 të shek.XIX, 2002, Toena, Tiranë,fq.34,67-72

Gjata A., Mbi themelimin e Korçës, Korçë, fq.23-25.

Gjergji, A., 1978, Klasifikimi i veshjeve popullore shqiptare, Etnografia Shqiptare IX, Mihal Duri, Tiranë, fq.6-29-31

Gjergji, A., 2001, Ligjërata për etnologjinë shqiptare, Extra, Tiranë, fq.118-128-144

Gjinari, J., 1960, Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria e Shkencave Shoqërore, Nr.4, Tiranë, fq.116

Gjinari, J., Shkurta, Gj., 2009, Dialektologji, Libri Universitar, Tiranë, fq.61-158

Hall, M., & McArthur S.;1996, The Human Dimension of Heritage Management: Different Values, Different Interests, Different Issues; fq. 2-21 (cit.Duhil K. Sustainable World Heritage

Site Management: Between interpretation, conservation and visitor management – case study of Bamberg, master thesis, 2005, fq.8)

Hammond, A. 1998. Which World? Scenarios for the 21 st Century: Global Destinies, regional Choices. Washington, D.C. : island Press.

Held, D., A. McGrew, D. Goldblatt, and J. Perraton. 1999. Global Transformations: Politics, Economics and Culture. Standford Press.

INSTAT, Censuri i Popullsisë dhe Banesave 2011,

INSTAT, Tiranë, 2014

J. Jokilehto; Definition of culture heritage (Originally for ICCROM, 1990); Revised for CIF: 15 January 2005; ICCROM Working Group 'Heritage and Society' // JJ; fq.4

Kallamata, K., Kisha e Shën Gjergjit, Shpiskë, guide

Karaiskaj, Gj., 1981, 5000 vjet fortifikime në Shqipëri, 8 Nëntori, Tiranë, fq.9-23

Karaiskaj, Gj., 1978, Mbi ndërtimet prehistorike në Iliri, Monumente historike në vendin tonë, Mihal Duri, Tiranë, fq.12

Karaiskaj, Gj., 1978, Mbi ndërtimet prehistorike në Iliri, Monumentet historike në vendin tonë, fq.11-464

Kod. Korçës dhe Sefalosforit, 1981, Tiranë, fq.-33

Kodiku i Korçës 93

Komuna Voskopojë

Korkuti, M., 1972, Rreth formimit të etnosit ilir, Kuvendi i studimeve Ilire, Akademia e Shkencave e RPSH, Tiranë, fq.68

Korkuti, M., 2008, Arti shkëmbor në Shqipëri, Mali Pleshti, Tiranë, fq.80

Larti S. I., 1999, Të njohim Devollin, “Gama Class”, Korçë, fq.36-37-159

Lawson, F., & M. Baud-Bovy, 1977, Tourism and recreational development, London Architectural Press, fq.37, cit. në Sérgio Dominique Ferreira Lopesi, Destination image: Origins, Developments and Implications, 2011, PASOS, Vol. 9, fq.305-315.

www.pasosonline.org

Leidner Rüdiger, 2007, The European Tourism Industry in the enlarged Community, Luxembourg: Office for Official Publications of the European Communities, fq.1. http://ec.Evropa.eu/enterprise/sectors/tourism/files/studies/sectoral_analysis/tourism_2007_sectoral_analysis_en. Pdf

Lohmann, M. 2001 Coastal Resort and Climate Changes In Tourism and Hospitality in the 21 st Century. Eds. A. Lockwood and S. Medlik. Oxford: Butterworth – Heinemann.

Loulanski, T., 2006, Revising the Concept for Cultural Heritage: The Argument for a Functional Approach, International Journal of Cultural Property, fq. 209

Loulanski, T; 2006 Loulanski, T; Cultural Heritage in Socio-Economic Development: Local and Global Perspectives Environments IDEAS, Journal Volume 34(2) 2006; fq. 54-55

Loulanski, T; Cultural Heritage in Socio-Economic Development: Local and Global Perspectives; Environments Journal Volume 34(2) 2006; fq.56-65

Mason, R., Economics and Heritage Conservation, A Meeting Organized by the Getty Conservation Institute, December 1998, Getty Center, Los Angeles, fq.11

Mayo, 1973, & Govers and Go, 2003, cit. në Sérgio Dominique Ferreira Lopesi, Destination image: Origins, Developments and Implications, 2011, PASOS, Vol. 9, fq. 305-315.

www.pasosonline.org

Meksi, A., 2004, Arkitektura e kishave të Shqipërisë (shekujt VII-XV), EUGEN, Tiranë, fq.31-39

Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar, Korçë

Myers, D. (1999). *Social Psychology*.

N.D.N, 1923, Korça dhe katundet e qarkut, Kotti Korçë, fq. 73-91

National Intelligence Council. 2000. Global Trends 2015: A Dialogue about the Future ëith Non-governmental Experts. National Foreign intelligence Board, December.

www.cia.gov/cia/publications/globaltrends2015/index.html.

Ogino, M., 2002, The Sociology of Cultural Heritage – From the Louvre to Hiroshima Dome, In Japanese, Tokyo: Shin-Yo-Sha. fq. 277 (cit. Loulanski 2006, fq.56)

Olsen, . 2001. Hospitality and the Tourist of the Future. In tourism and Hospitality in the 21 st Century. Eds. A. Lockwood and S. Medlik. Oxford: Butterworth – Heinemann.

Onuzi, A., 1978, Disa të dhëna mbi punimin e baltës në fshatin Bradvicë (Korçë) dhe në qytetin e Kavajës, Etnografia shqiptare IX, Mihal Duri, Tiranë, fq.189-313

Pacific Asia Tourism Association. 1999. 21 Issues & Trends That Will Shape Travel and Tourism in the 21 st Century. Pacific Asia Tourism Association, www.PATA.org.

Pano, N., 2008, Pasuritë ujore të Shqipërisë, Monografi, Akademia e Shkencave, “KrstalinakhH”, Tiranë, fq.296-315

- Papakozma, A., 1983, Manastiri Shën Pjetër e Pavli në Vithkuq, datimi, urbanistika, arkitektura, mjeshtrit e ndërtimit; “Mihal Duri”, Tiranë, fq.78-79
- Prendi,F., 1971, Vendbanimi neolitik në fshatin Kamnik të rrethit të Kolonjës (gërmime të vitit 1970), Iliria I, Tiranë, fq.13
- Prifti, B., 2010, Toskëria: Kolonja dhe Leskoviku-zakone, rite, ceremoni, “Vllamasi” Tiranë, fq.9-85
- Qiriaz, P., & Sala, S.& Aliu, S., Shpella Trenit, vlerë e rallë natyrore dhe historike, fq.1-7
- Qiriaz, P., 2006, Gjeografia fizike e Shqipërisë, Ideart,Tiranë,fq.235. Pjesë e qarkut të Korçës është edhe bashkia e Leskovikut dhe zonat rurale përreth që shtrihen në Krahinën Malore Jugore fq. 115-284.
- Rana, R & Piracha, A., 2007, Cultural framework, Urban crisis, Culture and sustainability of cities, Edited by M. Nadarajah and Ann Tomoko, Tokyo, fq.22
- Regional development strategy, Korça region, fq.15-24
- Richards, G., 1996, (ATLAS) Cultural Tourism in Evrope, published by CAB international, Wallingford, UK, fq.22
- Richtscheid, K., The Use of Cultural Heritage in Economic and Human Development: A Comparison of Built Heritage Projects in Morocco and British Columbia, (master thesis) 2011, fq.7
- Ritche, J. R. B., and G. Crouch. 2003. The Competitive Destination: A Sustainable Tourism Perspective. Wallingford: CABI Publishers.
- Riza, E., & Strazimiri, B., 1972, Vështrim mbi arkitekturën e qytetit të Korçës, Moumentet 3, Instituti Monumenteve të Kulturës, Tiranë, fq.120
- Rypkema, D., 1999, Culture, Historic Preservation and Economic Development in the 21st Century. Paper for the Leadership Conference on Conservancy and Development, Yunnan Province, China
- Sauvante, M. 2001. The Triple bottom Line: A Boardroom Guide. Directors Monthly 25(11): November 2-6.
- Seekings, J. 2001. Transport: The Tail that Wags the Dog. In Tourism and Hospitalityb in the 21 st Century. Eds. A. Lockwood and S. Medlik. Oxford: Butterworth – Heinemann.
- Selenica, E., 1982, Korça në faqet e historisë, Kombinati Poligrafik, 8 Nëntori, Tiranë, fq.23-24

Silberberg, T., Cultural tourism and business opportunities for museums and heritage sites, *Tourism Management*, 1995, 16 (5), 361-365 (cit.Karine, D., 2005, fq.12)

Singh, A. 1997. Asia Pacific Tourism Industry: Current Trends and Future Outlook. *Asia Pacific Journal of Tourism Research* 2: November Vol.2, No. 1, pp. 89-99.

SNV, Korçë

Sheldon, P. 2003. Tourism Information technology. In *International Handbook of International Tourism Economics*. Ed. L. Dwyer, P. Forsyth, and Edward Elgar. London: Edward Elgar.

Sheme, S., 2014, Reforma administrativo-territoriale domosdoshmëri për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve, artikull, gazeta Telegraf, fq.7

Shërbimi Meteorologjik qarku Korçë

Shoqata e grave me probleme sociale Tushemisht

Tole, V., 2007, Enciklopedia e Iso-Polifonisë Popullore Shqiptare, UEGEN, Tiranë, fq. 172-240

Trautmann, C., “Strasbourg mise sur la Culture”, *Cahiers espaces* Nr. 37, Paris, *Espaces* 1994 (cit.Karine, D., *Sustainable World Heritage Site Management: Between interpretation, conservation and visitor management – case study of Bamberg*, master thesis, 2005, fq.11)

Theobald, W. (2004). *Global Turism*. USA: British Library.

Thomo P., 2012, Korça urbanistika dhe arkitektura, Morava, Tiranë, fq.32-70

Thomo, P., 1978, Mbi urbanistikën dhe arkitekturën e qytetit të Korçës, Monumente historike në vendin tonë, 8 Nëntori, Tiranë, fq.5-256

UNESCO Report of the World Commission on Culture and Development. 1995. *Our Creative Diversity*, Paris, fq.182

UNESCO. Convention for the Safeguarding of the Intangible Cultural Heritage. 32nd Session of the General Conference, Paris, 29 September–17 October 2003. (cit. Prof. Dr. Jukka Jokilehto, On Definitions of Cultural Heritage, *Heritage Theory*, ICOMOS JURNAL 2008, fq.21.

UNWTO, *Tourism Hightlight* 2013 edition, fq.2-7

Willmott, M., and S. Graham. 2001. *The world of Today and Tomorrow The Evropean picture*. In *Tourism and Hospitality in the 21 st Century*. Eds. A. Lockëood and World Tourism Organization. 1999. *Tourism 2020 Vision*. Madrid: WTO.

World Bank. 2001, Cultural Heritage & Development : A Framework for Action in the Middle East & North Africa, Washington D.C.: World Bank. Fq.44

World Bank/UNESCO. 1998. Culture in Sustainable Development: Investing in Cultural and Natural Environments. Proceedings of the Conference sponsored by the World Bank and UNESCO, Washington 1998.

WTO 2003 World Tourism Barometer. 1(1) 2.

WTO, 1994, Recommendations on tourism statistics, United Nations, New York, fq.5-6

WTO, UNWTO Annual Report 2010, fq.61

www.en.unesco.org

www.ligjet.com

www.unesco.org

www.unesco.org

www.unesdoc.unesco.org

Yahaya A., 2006, The Scope and Definitions of Heritage: From Tangible to Intangible, International Journal of Heritage Studies (Routledge) Vol. 12, No. 3, fq.295

Yesawich, P. 2000 Ten Trends Shaping the Future of Leisure Travel. Hotel and Motel Management 215(19): 26-27.

Younnis, M. 2006 Creating a World Without Poverty. Local Development.

Younnis, M. 2013 Social Business. Doing Social Business. UET Press.

Yunnus, M. (2010). *Building social business*.

Yunus, M. (2007). *Creating a world without poverty*.

Ziko. V., 2012, Korça, qyteti dhe kujtime, Kotti, Korçë, fq.179-284

Zheji, Gj. 1998, Folklori shqiptar, Argeta-LMG, Tiranë, fq. 5


Foto të atraksioneve turistike dhe të trashëgimisë kulturore



Tuma e Kamenicës Muzeu i Tumës së Kamenicës



Muzeu Arkeologjik Pamje e brendshme e muzeut




Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar (pamje e brendshme)




Muzeu Historik i rrethit KolonjëAmbjenti i brendshëm - Oda Kolonjare.




Bazilika dheMozaikët e Linit.



Kisha e Shën Kollit (Voskopojë) Kisha e Shën Mërisë (Voskopojë)



Kisha e Shën Gjergjit (Dardhë) Kisha e Shën Triadhës në fshatin Tudas-Lekas
(pas restaurimit në vitin 2013)



Katedralja “Ringjallja e Krishtit” në qytetin e Korçës. (Turistë të huaj në qytet)



Banesa e Ilo Kotes, monument kulture (Korçë) Mysafirania e Vangjush Mios



Banesë karakteristike në fshatin Dardhë Pedonalja e qytetit të Pogradecit



Fshati Lin (Pogradec) Fshati Pustec (Prespë)

Zeje dhe punime artizanale



Veshje dhe zeje të trevës së Kolonjës të ruajtura në Muzeun Historik të qytetit të Ersekës.



Punime tradicionale të leshit në Voskopojë Punime me grep (Korçë)




Tezgjah apo vegël në Shtëpinë e Duarve të Artë Tushemisht. Produktet që prodhohen vazhdimisht, blihen nga vizitorët veçanërisht ata të huaj.

Trashëgimia kulturore shpirtërore (festat)



Atmosfera festive gjatë Festës së Birës në qytetin e Korçës. (Gusht-2013)



Festa e Kamavaleve në qytetin e Korçës. Vizitorët shijojnë festën dhe marrin kujtime.



Festa e Shën Mërisë Peshkëpi (kryerja e riteve fetare dhe atmosfera e festës) Shtator-2013



Panairi i trashëgimisë kulturore ErsekëShitja e produkteve artizanale (Pogradec)



Turistë të huaj që blejnë produkte të artizanatit lokal në qytetin e Korçës.



Paniri i punimeve tradicionale Tushemisht (Projekt i Komunitetit Evropian në mbështetje të grave me probleme sociale.)



Panairi i poçerisë (java e Pashkës Ortodokse, 20Prill2014)

Gatime tradicionale



Lakrori Dardhësme dy petëPalanik (Pogradec)



Tavë krapë (Prespë)Trahan i thartë i përgatitur me perime



Dredhanik-ëmbëlsirë tradicionale Byrek me mollë-Korçë



Dollma me lakër armeje Reçelra me markën vendase (Tushemisht-Pogradec)

Frekuentimi dhe infrastruktura turistike




Turistë të huaj në qytetin e Korçës. Qytetaria dhe mikpritja korçarekundrejt turistëve të huaj. (gjermanë)Banesa e Ilia Tilit në Bulevard Republika



Zyra e informacionit turistik Voskopojë Tushemisht (monumenti i aktore Violeta Manushinë qendër të fshatit)



Hotel Dardha në fshatin turistik të Dardhës. Hotel në Dardhë



Shtëpi turizëm familjarë Voskopoje. Atmosfera e brendshme



Restorant "Vila Melko" Boboshticë Atmosfera e brendshme (Restorant Tomasi-Boboshticë)



”Vila Falo” në fshatin turistik të Voskopojës. Atmosfera e brendshme



Banesa të dëmtuara në qytetin e Korçës.



Banesë karakteristike në qytetin e Korçës. Hani Manastirit në pazarin e Korçës.



Hani i Elbasanit(monument kulture) në oborrin e tij. Ka disa vite që vuan nevojën e investimeve.



Kisha e Shën Kollit (Hoçisht)

Parku “RINIA”, KORÇË



Fusha e Re Tenisit, KORÇË



Pazari, Korçë



Xhamia e "ILJAZ BEJ MIRAHORIT", Korçë

